

821.18.09(05)
811.18(05)

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS
SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË

STUDIME

Revistë për studime filologjike

30

2023



821.18.09(05)

811.18(05)

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS
SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË

STUDIME

Revistë për studime filologjike

30

2023



PRISHTINË
2024

821.18.09(05)

811.18(05)

KOSOVA ACADEMY OF SCIENCES AND ARTS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS
SECTION OF LINGUISTICS AND LITERATURE

STUDIES

A review for philological studies

30

2023

Editorial board

Zejnullah Rrahmani, editor-in-chief

Bardh Rugova, secretary

Victor Friedman, member

Kujtim Shala, member

Nysret Krasniqi, member



PRISHTINA

2024

821.18.09(05)

811.18(05)

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS
SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË

STUDIME

Revistë për studime filologjike

30

2023

Këshilli redaktues

Zejnullah Rrahmani, kryeredaktor

Bardh Rugova, sekretar

Victor Friedman, anëtar

Kujtim Shala, anëtar

Nysret Krasniqi, anëtar



PRISHTINË

2024

Copyright © ASHAK

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës
Redaksia e revistës “*Studime*”
Rr. Agim Ramadani, nr. 305
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel. + 383 38 249 303
E-mail: ashak@ashak.org
www.ashak.org

PËRMBAJTJA

ALI ALIU: ESAT MEKULI - MISIONARI I LETËRSISË SË KOSOVËS	7
REXHEP ISMAJLI: TRE SHËNIME PËR BAHRI BECIN - NË VEND TË IN MEMORIAM	11
NEHAS SOPAJ: ZEJNULLAH RRAHMANI	23
TOMO VIRK: LETËRSIA BASHKËKOHORE SLLOVENE DHE ROLI SHOQËROR I SAJ	41
KUJTIM M. SHALA: TRINGA E FISHTËS	53
IMRI BADALLAJ: SISTEMI EMËROR I ARBËRISHTES SË QEFTIT	81
AGOSTINO GIORDANO: ARBËRISHTJA STANDARDE DHE FJALORTHI ARBËRISHT-LËTISHT*	107
EVALDA PACI: VËSHTRIME MBI LIGJËRIMIN KISHTAR E BIBLIK NË DISA VARIANTE UNGJILLORE NË GJUHËN SHQIPE	117
LINDITA ALIU TAHIRI: RRËFIMI BRENDA LIRISË SË FJALËVE NË ROMANIN E MEHMET KRAJËS	129
MIMOZA HASANI – PLLANA: DIMENSIONET METAFORIKE NË POEZINË “GRUAJA E JASHTËZAKONSHME” MAYA ANGELOU	137

MANJOLA LUBISHTANI: FUNKSIONET E MARKERIT RIFORMULUES <i>MË MIRË</i> NË GJUHËN SHQIPE.....	151
ALBANË MEHMETAJ: NAIM FRASHËRI DHE VIRGJILI – LEXIM KRAHASUES	165
HANA RADONIQI: THEKSI I SHQIPES DHE VARIACIONET GJEOGRAFIKE.....	181
AGNESA BEQIRI: SIMBOLIKA E KONTRASTIT	197
BLERINA ROGOVA GAXHA: MITRUSH KUTELI - TEMA E VDEKJES.....	209
QËNDRESA JAKUPI: POZITAT <i>IN-SITU</i> DHE <i>EX-SITU</i> TË FOKUSIT NË GJUHËN SHQIPE	219
ZEJNULLAH RRAHMANI: POEZIA E ROMANTIZMIT	231

RECENSION

ZEJNULLAH RRAHMANI, NYSRET KRASNIQI: MUHAMET HAMITI: <i>BOTA LETRARE</i>, BOT. ASHAK, PRISHTINË, 2024.....	251
---	-----

DOKUMENT

KRISTO FLOQI: QËRTHULLI POLITIK.....	259
---	-----

Ali Aliu, Prishtinë

ESAT MEKULI - MISIONARI I LETËRSISË SË KOSOVËS

Me rastin e 30 vjetorit të vdekjes

Esad Mekuli u lind në Malit të Zi më 1916; shkollimin fillor e kreu në gjuhën serbe në vendlindje dhe gjimnazin në Pejë të Kosovës, e më pas u regjistrua dhe i përfundoi studimet në Fakultetin e Veterinarisë në Universitetin e Beogradit, ku specializoi dhe doktoroi pas lufte. Si student ra në kontakt me qarqe revolucionare dhe gjatë lufte u përfshi në aradhet partizane; për aktivitetin e tij politik ka qenë edhe i burgosur.

Edhe pse Mekuli është autor i tre librave shkencorë, emri i tij dhe kujtesa për të lidhet me poetin dhe poezinë, zhanër nga i cili ai botoi gjashtë libra, të cilat së bashku mund të përfshihen brenda një botimi të vëllimshëm. Si nxënës në gjimnazin e Pejës, ai ka shkruar edhe një roman, me titull “Vendetta” (Hakmarrje), për fatin e të cilit nuk dihet asgjë. Ishte njëri nga themeluesit dhe Kryetar i parë i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës dhe Anëtar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Malit të Zi. Pas çlirimit, figura e Esad Mekulit shquhej dhe ishte më e pranishme sidomos në tre dekadat e para të gjysmëshekullit të dytë, si në Kosovë ashtu dhe në hapësirën e ish Jugosllavisë. Poezia e tij me kohë sikur u la në gjysmë harrese, pa të drejtë, dhe shikuar nga kjo perspektivë dhe nga kjo distancë kohore, në vazhdim, do të sjell në vëmendje një aspekt dhe një anë të pa vërejtur në poezinë dhe figurën e Esadit.

Përshtypjet e para për Kosovën, Esat Mekuli i kishte marrë si nxënës gjimnazi në Pejë dhe në Prizren; takimin e vërtetë do ta përjetonte gjatë viteve të studimeve në Beograd përmes sharrëxhinjve, njëri nga profesionet më të shpeshtë të shqiptarëve nga Kosova që kërkonin punë krahu në Beograd. Në Prishtinë, me bashkëluftëtarët partizanë, do të hynte si çlirimtar në fund të Luftës së Dytë Botërore. Si poet do të njihej përmes vargjeve poetike nga koha e gjimnazistit dhe nga koha

studentore-revolucionare në Beograd, që do t'i botonte në librin emblematic "Për Ty". Ishin vargjet e para të poetit, të ngjizura që në vitin 1932, të cilat, edhe për pak do të mbushin moshën 100 vjeçare, që është dëshmi talenti e autorit dhe qëndrueshmëri cilësie e poezisë.

Pa u terur mirë gjurmët e luftës, Esad Mekuli, në vitin 1949 themeloi revistën "Jeta e Re" që do ta udhëhiqte për afro 25 vite. Duke filluar që nga numrat e parë, faqet letrare të kësaj reviste, do të ngjallin, nxisin dhe krijojnë jetën krijuese letrare, për herë të parë në gjuhën shqipe për shqiptarët e Kosovës dhe mbarë ish Jugosllavisë, gjuhë e ndaluar dhe ndëshkuar nga pushtuesit. Prandaj, shikuar nga kjo distancë, qoftë edhe si vegim, Esad Mekuli shfaqet figurë e ngjashme me një rilindës të shekullit 19, i cili e kishte ëndërruar lirinë e popullit të vet vetëm para një dekade, si nxënës dhe student para lufte, e që tashti me besim të plotë besonte dhe shpresonte se edhe për shqiptarët kishte marrë fund robëria shekullore. Që nga ky moment Mekuli do t'i japë frymë dhe kuptim zhvillimit dhe rritës letrare në gjuhën shqipe në Prishtinë. Në krye të revistës "Jeta e Re", ai do jetë misionar i pasionuar i letërsisë shqipe në ish Jugosllavi: do t'i shndërrojë faqet e revistës në një shkollë të vërtetë letrare, do të kërkojë dhe zbulojë të rinj të talentuar, jo vetëm nëpër Prishtinë por edhe nëpër shkollat shqipe në mbarë Kosovë. Duke iu kthyer më rrallë dhuntisë së vet krijuese, Esadi do ta kthejë atë në një misionarizëm, i cili i jepte frymë, hov dhe shëndet edhe nga zjarri i vet poetik, shkollës së vet letrare. Nga historia letrare botërore ka më shumë raste kur poetë të mëdhenj, shpesh fuqinë e vet krijuese e kanë konsumuar, qoftë në përkthim të kolegëve të vet, qoftë në synime të ngjashme letrare.

Faqet e revistës letrare "Jeta e Re" nëpër të cilën kalonte thuaja tërë zhvillimi e rrita letrare shqipe, kishin " dy faza shkollore", pjesën e talenteve të rinj dhe pjesën e talenteve të dëshmuar, të njohur tani përmes botimeve librash. Ata që e mbajnë mend këtë periudhë, nuk mund ta harrojnë një fakt: kur një poet a prozator, kalonte nga pjesë e talenteve të rinj në faqet e talenteve që tani e kishin kaluar atë rubikon, ishte çast i vërtetë gëzimi për të, ishte përjetim lumturie që e njohin krijuesit. Kështu radhiteshin shkrimtarë, brezash që do të përbënin një korpus letrar artistikisht të artikuluar, të njohur dhe vlerësuar në hapësirën jugosllave dhe përjashta saj. I tillë ishte brezi i tyre i fillimviteve të shtatëdhjeta, ai i Ali Podrimjes dhe Azem Shkrelit, përmasash që do të njihen dhe vlerësohen qendrave evropiane. Shumica, në mos të gjithë, e kanë ndërë dorën e ngrohtë, frymën e misionarit të madh, e kanë ndërë edhe mburojën e tij gjatë sfidave jetësore, prandaj edhe

mirënjohjen deri në adhurim. Pikërisht për këtë raport të tij me shkrimtarët, Ali Podrimja me një rast, do të shkruante: unë kam patur fat në rebelimit tim, se kisha engjëllin tim shpëtues, Esat Mekulin (pasi e kishin përjashtuar nga gjimnazi në Gjakovë për rebelimin e vargjeve të tij, Ali Podrimjen e merr në mbrojtje Esat Mekuli). Me rastin e vdekjes së tij, poeti Azem Shkreli në poezinë kushtuar Esat Mekulit, do të thotë: “ai nuk vdiq, ai shkoi vetëm në përjetësi”.

Pas Mekulit, revista “Jeta e Re” e humbi atë fluid, atë magji tërheqëse, për krijuesit dhe lexuesit, atë enigmë poetike. Do të vijnë në krye të saj, deri në ditët tona, redaktorë me emër e grada të bujshme, por, por pa praninë e dorës, frymës, shpirtit të parë. Do të mbetet mbamendje e largët mirësia dhe dashuria që rrezatonte nga faqet e revistës, nga themeluesi i saj që vihej në kërkim të adresës së autorit të ri shënuar në zarfin me poezinë brenda, që lumturohej kur ata i shkelnin zyrën, që i priste si personalitete të vërtetë, si prind i lumturuar.

Kjo pjesë e udhëtimit poetik të Esad Mekulit, e përforcon besimin se ai ishte poet i lindur, e dëshmi për këtë janë vargjet e para të tij, ato të gjimnazistit, dhe ato të zhgënjimit të madh, “Lirikat e malit Sharr”, gjatë viteve 80, me të cilat e mbyll krijimtarinë. Për më shumë, Mekuli, dhuntinë e poetit të shquar, gjatë udhëtimit të tij, në pjesën më të përkushtuar të veprimtarisë së tij poetike e vuri në shërbim të misionarit, ngjashëm me rilindësit. Këto dy dimensionet e artit të tij poetik, artikulohen e realizohen mes dy shtresave, sa të poetit, për ta shpaluar botën e vet, sa të misionarizmit iluminist. Edhe te vargjet e para rinore e revolucionare, edhe te ato të fundit, të zhgënjimit, ndihet një zjarr i brendshëm, i cili kërkon shtigje shpërthimi nga frymëzimi dehës dhe i mjegullt. Tek vargjet e viteve 80 “Lirikat e malit Sharr” që vijnë pas zhgënjimit të madh, ky zjarr ndihet përmes timit melankolik, por edhe një pasioni adhurues ndaj fenomeneve të natyrës, të gjithësisë, e cila në gjirin e vet e mban universin njeri dhe e mbron atë nga stuhitë. Në shtëpinë e tij malore brenda pyllit të bujshëm të Sharrit, Mekuli ndjen nevojë të komunikojë me krejt atë natyrë me bimësi e lule, që përballë acarit të paskëshin nevojë për ngrohtësinë e poetit, njësoj si poetët e rinj dikur për t’i mbrojtur nga pushteti.

Në mes këtyre dy fazave poetike le të sjellim ndërmend besimin e poetit se Kosova më në fund, pas luftës, është e lirë. Portreti i plotë i Mekulit ndërthen vargjet e angazhuara të entuziazmit dhe misionarizmit të tij, që shikuar nga të gjitha perspektivat, situatat e sprovat, vijnë së bashku për të imagjinuar tërësinë e tij. Dhe nga të gjitha këto perspektiva krijuese, Esat Mekuli gjatë gjithë jetës së vet rrezatonte një

mirësi të lindur njerëzore. Ai dhe poezia e tij shpesh është vënë në përjasje me jetën dhe veprën e Migjenit, poetit shkodran, që ishte 5 vite më i madh se Mekuli, por që të përbashkët kishin hapësirën gjeografike të vendlindjeve të tyre. Për Migjenin Ismail Kadareja, në librin “Migjeni ose uragani i ndërprerë” do të thotë: “Kudo në veprën e tij ndihet ndalimi i parakohshëm, ndërprerja. Ai vetë mund të mendohet si i tillë: i ndërprerë. Por ndërprerja e tij nuk qe e zakonshme përderisa ajo është ndërprerja e një uragani”. Siç dihet, censura mbretërore e viteve tridhjetë dhe sëmundja e pashërueshme ia mbylli jetën poetit pa i mbushur 28 vite. Mund të gjejmë paralelizma edhe për poezinë e penguar të Esat Mekulit, kur kemi parasysh katër faza të jetës krijuese të tij dhe sfidat, ndalesat, ndërprerjet. Vargjet rebeluese nga brenda dhe të mjegullta nga jashtë të viteve 30, vargjet rebeluese për robërinë e popullit të vet, pjesëmarrja në luftën çlirimtare me besimin e plotë se robëria edhe për shqiptarët kishte marrë fund, zhgënjimi i tij i parë gjatë terrorit të quajtur mbledhja e armëve në Kosovë dhe shpërngulja me dhunë e qindra mijë shqiptarëve gjatë viteve 50 për në Turqi, luhatje jo definitive që u vërejt në vargjet e tij të rralla, si dhe zhgënjimi i madh pas demonstratave studentore të vitit 1981 dhe tërheqja në gjirin e Malit Sharr. Nga të gjitha këto sfida e thyerje së bashku mund të na lejohet të vëmë re një ndërprerje, mbase edhe të pranisë së një uragani poetik të Esad Mekulit.

Rexhep Ismajli, Prishtinë

TRE SHËNIME PËR BAHRI BECIN - NË VEND TË IN MEMORIAM

Në jetën e tij të begatshme shkencore dhe hulumtuese Akademik Bahri Beci ka dhënë ndihmesa në shumë fusha studimore të albanologjisë. Në studimet dialektologjike ai ka qenë i pranishëm me përshkrime të gjera të të folmeve të ndryshme të shqipes. Ndhimesat e tij kanë qenë të shënueshme dhe në studimet e fenomeneve diakronike. Bahri Beci bën pjesë në grupin e studiuesve që në pjesën e dytë të sh. XX me një vështrim metodologjik dhe me një horizont unik të dijes bëri përshkrimin e të folmeve të Shqipërisë, duke na dhënë pasqyrën e tyre në një prerje kohore. Ka qenë në grupin bërthamë që hartoi Atlasin dialektologjik të shqipes. Pas përvojave në fushat e fonetikës eksperimentale dhe të studimeve fonologjike në Paris, ai erdhi me vështrime të tjera për tërësinë e studimeve dialektore të shqipes dhe për nyjetimin dialektor të shqipes. Në studimet e historisë së gjuhës Bahri Beci ka sjellë ndihmesa me interes për çështje të fonetikës historike, të historisë dialektore të shqipes. Ndhimesë të veçantë ka sjellë me studimet për historinë e standardizimit të gjuhës shqipe me interpretime kritike. Me rëndësi për studimet albanologjike kanë qenë dhe ndihmesat e tij në studimet e raporteve të shqipes me gjuhët ballkanike. Duke ndjekur konceptime më të moderuara, Bahri Beci ka bërë një punë me vlerë në gramatikëshkruarjen e shqipes, ashtu si dhe në vështrimet nga këndi pedagogjik për hartimin e gramatikave dhe të teksteve mësimore të mësimimit fillor e të mesëm në Shqipëri e në Kosovë.

Veprimtaria intelektuale e Akademik Bahri Becit në dekadat e fundit shtrihej në vështrimin kritik të veprimtarive shkencore brenda shoqërisë shqiptare. Bie në sy theksimi nga ana e tij i nevojës për të pasur sistem vlerash brenda studimeve albanologjike duke u kthyer përfundimisht drejt rrugëve të shtruara në dijet perëndimore.

Bahri Beci i ka lënë gjurmët e punës së tij në drejtimin e institucioneve shkencore në Shqipëri, të Institutit të Gjuhësisë, si punonjës nga vitet '60 të sh. XX, si sekretar shkencor dhe drejtor i tij. Brenda atij

kuadri ka vepruar në drejtimin e revistave *Studime filologjike*, *Studia albanica* dhe të botimeve të veçanta.

Bahri Beci ishte një personalitetet i rëndësishëm i gjuhësisë shqiptare të pjesës së dytë të sh. XX dhe të fillimit të sh. XXI. Lidhjet e tij me Kosovën dhe mjediset shkencore e kulturore në Kosovë kanë qenë të vazhdueshme. Përveç botimeve që ka bërë në Kosovë, ai ka dhënë një ndihmesë dhe për hartimin e teksteve të përbashkëta të gjuhës shqipe, por edhe për punën e përbashkët në Seminarin Ndërkombëtar të Gjuhës, Letërsisë dhe Kulturës Shqiptare: në vitet 1995-1996, kur Seminari nuk mund të mbahej në Prishtinë. Nga 2016 ishte anëtar i jashtëm i ASHAK-ut.

Akademik Bahri Becin e kam njohur qysh në shkëmbimet e para midis dy universiteteve tona – në Tiranë e në Prishtinë para gjysmë shekulli. Pastaj kemi pasur kontakte gjatë qëndrimit në Francë dhe më vonë gjithandej nëpër veprimtari shkencore albanologjike. Prej atëherë kishim ndërtuar një miqësi që shkonte përtej preokupimeve tona në fushën e gjuhësisë. Shuarja e tij për mua është humbje e madhe në aspektin miqësor.

AKADEMIK BAHRI BECI SI STUDIUES DHE INTELEKTUAL

Akademik Bahri Beci, një nga personalitetet e shquara të studimeve albanistike, doli nga gjiri i Shkodrës, prej kohësh vatër e kulturës dhe dijes. Pjesën e madhe të shekullit të punës shkencore e kaloi në Tiranë dhe në lëvizjet nga Tirana në Paris.

Akademik Bahri Beci edhe sot vazhdon t'i dhurojë albanistikës vepra me vlerë si kjo e fundit *Rreth rolit të shqipes në formimin e bashkësisë gjuhësore ballkanike. Bashkësia gjuhësore ballkanike në dritën e të dhënave të gjuhës shqipe*, 2021, që vjen pas botimit frëngjisht të veprës *L'Union linguistique balkanique à la lumière des données de la langue albanaise*, 2020, në të cilën ai është marrë me konceptet themelore të gjuhësisë ballkanike, pikëpamjet e studiuesve për shkaqet e formimit të bashkësisë gjuhësore ballkanike dhe për rolin e shqipes në formimin e saj, për strukturën dialektore të shqipes dhe raportet e historinë dialektore edhe në relacion me rumanishten, sidomos në krahinën dialektore të jugut, me marrëdhëniet e shqipes me rumanishten, me ndërlihdjen e kësaj bashkësie me dyndjet e sllavëve në Ballkan. Ai merret posaçërisht me rolin e elementit shqiptar në procesin gjuhësor të ballkanizimit. Me modestinë, që e karakterizon, arritjen në këtë vepër e

shprehte si vijon: “*Nuk mund të themi me bindje se e kemi gjetur rrugën e zgjidhjes, por jemi të bindur se kemi gërmuar në një drejtim që ia vlen të ecet pa e nënvlerësuar, por edhe pa pretenduar se gjithëçka që është parashtruar këtu është e vërteta e fundit. Është vetëm një përpjekje, disi e re, për të depërtuar në errësirën e formimit të bashkësisë gjuhësore ballkanike, kësaj radhe, duke u nisur nga të dhënat për shtrirjen e dukurive të përbashkëta ballkanike në hapësirën e gjuhës shqipe, përfshirë dialektet e saj, po edhe nga vjetërsia e formimit të tyre.*”

Materialet e krahasura dhe fenomenet e gjurmara autori i ka paraqitur me saktësi e mbi bazë të rezultateve të *Atlasit dialektologjik*, kështu që vlera e vepërës shkon gjithsesi përtej këtij anoncimi.

Akademik Bahri Becin e kam njohur qysh në shkëmbimet e para midis dy universiteteve tona – në Tiranë e në Prishtinë, në vitin 1972. I përkushtuar në studimet dialektologjike të shqipes që atëherë bëheshin, siç thotë ai vetë tani, sipas metodës tradicionale, sipas një modeli të hulumtimit në terren mbi bazë të parametrave të një pyetësi. Instituti i Gjuhësisë në Tiranë atëherë realizonte projektin e studimeve dialektore. E rëndësishme ishte që ato studime po bëheshin me metoda dhe sipas gjedheve të njëjta a të ngjashme të dialektologjisë, ku ndërthurshin ide të gjeografisë gjuhësore, ndonjëherë reflekse indirekte të shkollës *Fjalët dhe sendet*, elemente etnografike, etj. Përshkrimet kufizoheshin në gjuhën e sotme, por ngriheshin mbi supozime historike, sepse ndiqnin parametrat dallues midis të folmeve sipas shtresëzimeve kohore. Mbi ato baza bëheshin grupimet dialektore dhe klasifikimet. Veçori e atyre studimeve ishte përqendrimi në përshkrimin e strukturës fonetike mbi baza të perceptimit të përafërt, të strukturës morfologjike dhe diçka leksikore, vjelje fjalësh dhe çështje sintaksore, më pak. Silleshin materiale etnografike, po edhe shënime të natyrës shoqërore. Edhe në Kosovë e ish-Jugosllavi bëheshin studime të ngjashme. Kishte dhe një orientim studimesh të dialektologjisë historike, siç bënte Ajeti, ndërsa për të folme të veçanta hartoheshin monografi. Pjesa e diasporës historike gjenetikiisht toske e arbërishtes së Greqisë, e arbërishtes së Italisë, e shqipes së Bullgarisë e të Ukrainës, gege e arbënishtes së Zarës, shiheshin në funksion të klasifikimeve vetanake. Për ato varietete pati studime me vlerë sa i përket përshkrimit, metodës e arritjeve. Të gjitha së bashku jepnin një pasqyrë për varietetet e shqipes/ arbënishtes në tërësi, pasqyrë që përtregonte diversitetet hapësinore me shpjegime historike, sociale, të kontaktit, etj. Këto diversitete shpjegoheshin mbi baza klasifikuese me parametra të motivuar historikisht përmes

izoglosave tradicionalisht të identifikuara, si rotacizmi, nazalizmi, diftongimet, palatalizimet, etj. Prandaj edhe përqendrimet ishin kryesisht te tiparet fonetike e morfologjike, shpesh duke veçuar tufa specifike e duke neglizhuar përshkrimin e plotë të varietetit përkatës. Kjo qe baza për krijimin e pyetësorit dhe realizimin e Atlasit dialektologjik në rrethana të vështirësuar të ndarjeve shtetërore si një vepër sintetizuese e atyre eksplorimeve ekstensive, por të realizuara me të njëjtën metodologji në të dy anët e kufirit, pas vitit 1981 më vështirë të kalueshëm.

Në të gjitha ato procese studimi Bahri Beci ka qenë dëndësisht i pranishëm, kryesisht me studime për të folmet e gegnishtes qendrore dhe të gegnishtes veriperëndimore, me pjesëmarrje intensive në punën e Atlasit, etj. Por manifestonte gjithashtu interesa për studimin e çështjeve të ndryshme të natyrës historike. Përshkrimet e tij të të folmeve të Matit e të Dibrës, më vonë të Shkodrës e të Veriut, shkonin në gjerësi dhe sillnin materiale të bollshme kontekstualizuese.

Me Bahri Becin kam pasur kontakte dhe në kohën kur ai po niste një fazë të re studimi në Institutin e Fonetikës në Paris, ku merrej me hulumtimin e së folmes së Shkodrës në rrafshin fonetik mbi bazë të analizave spektrografike. Kjo përvojë do t'i sillte atij dhe nevojën për vështirime pak më ndryshe të tërë fenomenit të variacioneve dialektore. Dhe në këtë pikë ai me monografinë për sistemet zanore dhe bashkëtingëllore të së folmes së Shkodrës do të sjellë risi në dialektologjinë shqiptare, po edhe në fushën e fonetikës, duke i begatuar ato me rezultatet e analizave spektrografike. Mund të jetë që këtu qëndron dhe një kthesë në studimet e mëtejme të tij. Sidomos në fushën e fonetikës, po edhe përgjithësisht në raport me gjuhësinë funksionale.

Bahri Beci u mor dhe me studime të gjuhës standarde, shpesh të para në raportet me dialektet, por me vështirime kritike për proceset e formimit të saj dhe sidomos për interpretimet e mëparme. Sfondi historik i studimeve dialektore të shqipes ishte pjesë e hulumtimeve të tij, po ashtu. Në dy dekadat e fundit ai kishte zhvilluar dhe një veprimtari të gjerë të hartimit të gramatikave shkollore për të gjitha nivelet e mësimin të shqipes. Në një aspekt më të përgjithshëm ai vinte nga një horizont dialektologjik tradicional, por ndërkohë i begatonte vështirimet me studimet eksperimentale e funksionale. Këto studime në laborator ia kishin theksuar edhe më shumë tendencën që Bahri Beci e kishte shfaqur dhe më herët për respektin maksimal ndaj të dhënave, mbledhjen e tyre dhe hetimin pastaj.

Pas kësaj përvoje të gjatë si studiues, edhe si drejtues i Institutit, pas akumulimeve, ai erdhi me një vështirim të ri për tërësinë e

dialektologjisë shqiptare. Dhe ky vështrim është kritik për të arriturat e mëhershme, për mënyrën e studimit dhe për përgjithësimet edhe klasifikuese që janë bërë deri sot. I bërë nga një studiues me përvojë të atillë ky studim paraqet vlerë më vete. Do theksuar me këtë rast kërkesa e tij për të shkuar më tej me vështrimin e tij ndërtues, paraqitjen e modelit që ndjek, përmes një rrjeti tipologjik tiparesh. Në librin *Struktura dialektore e shqipes. Një qasje e re*, 2016, ai bënte një paraqitje kritike të zhvillimeve dhe të rezultateve të arritura në studimet dialektore të shqipes, në raport me dukuritë dialektore dhe metodat e studimit të tyre. Aty ai artikulonte dhe pikëpamjen e tashme për këto probleme. Në pjesën për strukturën dialektore të shqipes ai sillte pikëpamjet e tij për strukturën dialektore të shqipes, gjithnjë në raport me përgjithësimet e bëra më herët në faza të ndryshme, nga Gjinari, Gjinari-Shkurtaç etj. Pas kritikës për ndarjen e mëparme në dialekte, nëndialekte e të folme, ai vinte me propozimet e tij për krahinat dialektore, për zonat dialektore dhe për rajonet dialektore, për të cilat besonte se mund të sjellin pasqyrim më adekuat të gjendjes së shqipes në terren.

Në pjesën e mbylljes ai bën dhe një vështrim më të përgjithshëm për zhvillimet e atyre studimeve në Shqipëri, duke theksuar se ato ishin bërë kryesisht në periudhën e monizmit dhe me orientim tërësisht lindor. Për pasqyrat e përgjithësimin të dialekteve të shqipes pas ndryshimeve në Shqipëri, por në të njëjtën vijë (Gjinari/ Shkurtaç), ai vërente se “*vihet re një kthesë e plotë drejt literaturës perëndimore*”, përkatësisht “*përpyekja për ndryshimin, jo të kritereve të studimit të dukurive dialektore të shqipes, po të kritereve të paraqitjes dhe klasifikimit të të dhënave dialektore*”. Ai vërente kapërcimin nga një paraqitje dhe klasifikim tradicional te një klasifikim mbi bazën e kritereve funksionale a strukturore dhe këtu ai vërente momentin, për të, të papranueshëm: të njëjtat dukuri të përshkruara më parë me terminologji tradicionale tani kërkohet të jepen me terminologji funksionale a strukturore, duke vënë re po ashtu se ka dallime metodologjike në këtë aspekt dhe në raport me paraqitjet e niveleve fonetike e morfologjike.

Përgjithësimi i tij përfundimtar vjen si vijon: “*tek ne ka munguar një formim teorik i specializuar në fushën e dialektologjisë*”. Edhe për konceptimin dhe hartimin e Atlasit ai vëren se është bërë në kohën e monizmit, “*në kushtet e mungesës së lirisë akademike në Shqipëri*” me mbështetje në gjuhësinë marksiste, e marksiste-leniniste. Kjo nënkuptonte përvojat e gjeografisë gjuhësore lindore. Vështirësitë në këto drejtime e bëjnë autorin të konstatojë se “*përpyekjet tona në këtë libër për të arritur në përfundime shkencore, nuk mund të vlerësohen si*

përfundimtare, por si një synim për të shmangur... mangësitë e trajtimeve përgjithësuere të derisotme..., po edhe për të krijuar kushtet për një përjasje të re ndaj kësaj problematike... “

Objekt kërkimi i tij ka qenë struktura dialektore e shqipes, historia e formimit të dy dialekteve të saj në kontekstin ballkanik. Në fushën e fonetikës ka sjellë të dhëna me interes për strukturën fonetike të gegnishtes veriore dhe të gjuhës letrare duke u mbështetur në analizat spektrografike e funksionale. Ka trajtuar probleme të historisë së formimit të shqipes standarde me vështrime të mprehta kritike.

NDIHMESAT E RËNDËSISHME NË FUSHAT STUDIMORE

1. Në studimet dialektologjike ai është i pranishëm dendësisht me përshkrime të gjera të të folmeve të ndryshme të gegnishtes qysh në vitet '60 të sh. XX, konkretisht me përshkrimet e të folmeve dhe të grupeve të të folmeve të arealit të gegnishtes qendrore dhe të gegnishtes veriperëndimore. E folmja e Shkodrës ka qenë objekt i veçantë i studimeve të tij me zbatime të përshkrimeve akustike. Ndhimesat e tij në këto fusha kanë qenë të shënueshme dhe në studimet e fenomeneve të ndryshme diakronike. Bahri Beci bën pjesë në grupin që në pjesën e dytë të sh. XX me një vështrim metodologjik dhe me një horizont unik të dijes bëri përshkrimin e shumë të folmeve të Shqipërisë, duke na dhënë kështu pasqyrën e tyre në një prerje kohore. Ka qenë në grupin bërthamë që hartoi Atlasin dialektologjik të shqipes. Pas përvojave në fushat e fonetikës eksperimentale dhe të studimeve fonologjike në Paris ai erdhi dhe me vështrime të tjera për tërësinë e studimeve dialektore të shqipes, për tërësinë e dialekteve të shqipes dhe në veprën e fundit. Pas një kritike nga brenda të asaj përvoje dhe të atyre rezultateve ai na vjen me një propozim të ri për ndarjen dialektore të shqipes duke marrë parasysh dhe elemente të tjera si aspektet tipologjike, etj.

2. Në studimet fonetike të shqipes, fushë në të cilën për shumë kohë në Shqipëri sundonin konceptet teorike të shkollës sovjetike, Bahri Beci solli përvojën e hulumtimit akustik, duke i zbatuar këto metoda në përshkrimin e të folmes së Shkodrës, për të vazhduar pastaj me tekstin e fonetikës së shqipes e studime të tjera.

3. Në studimet e historisë së gjuhës Bahri Beci ka sjellë ndihmesa me interes për çështje të fonetikës historike, të historisë dialektore të shqipes. Ndhimesë të veçantë e ka sjellë me studimet për historinë e standardizimit të gjuhës shqipe me interpretime kritike e të ndryshme nga standardet në Shqipëri para viteve '90.

4. Aspekt të veçantë paraqesin ndihmesat në studimet e raporteve të shqipes me gjuhët ballkanike.

5. Në fushën e studimeve gramatikore Bahri Beci ka dhënë një ndihmesë me vlerë me gramatikën e tij, duke ndjekur konceptime më të moderuara nga tradicionalet në Shqipëri. Lidhur me këtë është dhe veprimtaria e tij e dendur pedagogjike me hartimin e gramatikave dhe të teksteve mësimore të gjuhës në të gjitha nivelet e mësimin fillor e të mesëm në Shqipëri e në Kosovë. Këtu mund të dëshirohej zbatimi më i përkushtuar i qëndrimeve rinuese që i ishin shpërfaqur me kthesën metodologjike pas përvojës së analizave spektrografike dhe funksionale në rrafshin fonetik-fonologjik.

6. Aspekt i veçantë i veprimtarisë intelektuale të Bahri Becit është ai i vështrimit kritik të veprimtarive shkencore brenda shoqërisë shqiptare, konkretisht në kuadër të zhvillimeve brenda Akademisë dhe Institutit të Gjuhësisë. Pas viteve '90 ai e ka ndjerë nevojën të merrej me konceptimet themelore ideologjike brenda veprimtarive shkencore shqiptare, për çka ka botuar tre libra. Bie në sy theksimi nga ana e tij i nevojës për të pasur sistem vlerash brenda studimeve albanologjike, natyrisht, duke u kthyer përfundimisht drejt rrugëve të shtruara në dijet perëndimore. Në shqyrtimet e tij kritike për kushtëzimet ideologjike në gjuhësinë shqiptare mund të dëshirohej një vështrim më rrënjësor teorik e më pak personal e biografik, sado që edhe këto aspekte meritojnë vëmendje të plotë.

Bahri Beci ka lënë gjurmët e punës së tij në drejtimin e institucioneve shkencore në Shqipëri, më konkretisht të Institutit të Gjuhësisë, si punonjës nga vitet '60, pastaj sekretar shkencor dhe drejtor i tij. Brenda atij kuadri ka vepruar në drejtimin e revistave *Studime filologjike*, *Studia albanica* dhe të botimeve të veçanta. Shtrirja e syrit kritik në implikimet ideologjike në këto hapësira, me zbatime konkrete të konceptet dhe skemat e studimeve do ta begatonin ndihmesën e tij në këtë fushë.

Bahri Beci është një nga personalitetet e rëndësishme të gjuhësisë shqiptare të pjesës së dytë të sh. 20 e të fillimit të sh. 21. Ai ka lënë gjurmë në studimet dialektologjike shqiptare, në studimet fonetike, në studimet e historisë së gjuhës e të historisë së standardizimit të shqipes, ashtu si në orientimin e këtyre studimeve në vitet '90 të sh. 20. Nuk qëndroi indiferent ndaj zhvillimeve sa u përket metodave të studimit, kuadrit kulturor e shoqëror të zhvillimit të studimeve e të rrjedhave në

albanologji në tërësi. U shqua me një sërë reagimesh kritike dhe thirrjesh për kthim në shtratin normal perëndimor të dijeve kombëtare, në frymën e vlerave të mirëfillta.

STRUKTURA DIALEKTORE E SHQIPES

I përkushtuar në studimet dialektologjike të shqipes që atëherë bëheshin, siç thotë ai vetë tani, sipas metodës tradicionale, sipas një modeli të hulumtimit në terren mbi bazë të parametrave të një pyetësi me historik lidhur me një atlas dialektologjik që do të bëhej më vonë. Instituti i Gjuhësisë në Tiranë atëherë bënte një punë në fushën e studimeve dialektore, duke eksploruar në të gjitha anët e Republikës së Shqipërisë.

Nën drejtimin e Mahir Domit, grupi i dialektologëve Jorgji Gjinari, Bahri Beci, Mehmet Çeliku, Spiro Floqi, Minella Totoni, Qemal Haxhihasani, Xheladin Gosturani, Gjovalin Shkurtaj, Shefqet Hoxha e të tjerë po botonin rezultatet e hulumtimeve të tyre në terren për shumë të folme anë e mbanë Republikës. E rëndësishme ishte që ato studime po bëheshin me metoda dhe sipas gjedheve të njëjta a të ngjashme të dialektologjisë tradicionale, ku ndërthureshin dhe ide të gjeografisë gjuhësore, ndonjëherë reflekse indirekte të shkollës *Fjalët dhe sendet*, elemente etnografike, etj. Të gjitha ato përshkrime kufizoheshin në gjuhën e sotme, por në fakt ato ngriheshin mbi supozime historike, sepse ndiqnin parametrat dallues midis të folmeve sipas shtresëzimeve kohore. Mbi atë bazë bëheshin sidomos grupimet dialektore dhe klasifikimet. Udhëzuesit dhe pyetësorët ishin pak a shumë të njëjtë apo të ngjashëm për të gjithë.

Veçori e atyre studimeve ishte përqendrimi në përshkrimin e strukturës fonetike mbi baza të perceptimit të përafërt, të strukturës morfologjike dhe diçka leksikore, vjelje fjalësh dhe çështje sintaksore më pak. Silleshin dhe materiale etnografike, po edhe shënime të natyrës shoqërore. Sfondi i tyre ishin studimet dhe vrojtimit për dialektet, për historinë e gjuhës dhe më të përgjithshme për gjuhën shqipe të bëra nga albanistët vendorë dhe të huaj qysh nga Hahni, Meyeri, Pedersen, Jokli, Lambertzi, Tagliavini, Pekmezi, sidomos Çabej, Cimochowski, Desnickaja, Domi e të tjerë.

Edhe në Kosovë e ish-Jugosllavi bëheshin studime të ngjashme mbi afërsisht po ato baza, por metodikisht jo gjithnjë të drejtuara nga pyetësorë dhe metoda ashtu eksplicite. Këtu kishte dhe një orientim studimesh të dialektologjisë historike, siç bënte Idriz Ajeti, ndërsa për

të folme të veçanta hartoheshin monografi nga autorë si Latif Mulaku, Hilmi Agani, Tafil Kelmendi, Imri Badallaj, Mehmet Halimi, Naser Pajaziti, Fadil Raka, Remzi Nesimi, Zini Osmani, Fadil Sulejmani, Lumnije Jusufi e të tjerë. Në të dy anët referohej dhe monografia e Waclaw Cimochofskit për të folmen e Dushmanit, apo studimet e Carlo Tagliavinit e të tjerëve më herët. Mund të thuhet se këto studime përbëjnë një tërësi me arritje pak a shumë të ngjashme dhe mbi baza të dialektologjisë tradicionale. Pak më vonë do të ketë dhe tendenca të tjera me botime të ndryshme.

Me përjashtim të studimeve për arbnishten e Zarës, mund të thuhet se ato përshkruanin pak a shumë materialin dialektor të shqipes së trungut sipas skemës ndarëse etnografiko-historike gegnishte/ toskërishte. Mbi këto baza dhe përmes izoglosave gjithnjë të shpjeguara historikisht bëheshin dhe klasifikimet.

Pjesa që për mua, gjithnjë me referenca historike, duhej cilësuar si dialekte të shkallës së dytë, pra pjesa e diasporës historike gjenetike të toskës e arbërishtes së Greqisë, e arbërishtes së Italisë, e arbërishtes së Zarës dhe e shqipes së Bullgarisë dhe të Ukrainës, që për një kohë kishin jetuar zhvillime të ndara dhe në kontekste të tjera, në klasifikimet që bëheshin në Tiranë shiheshin vetëm në funksion të klasifikimeve të veta bazë. Por, për ato varietete pati dhe studime me vlerë sa i përket përshkrimit, metodës dhe arritjeve: le të përmendim këtu studimet e Eric Hampit, Claus Haeblerit dhe H.-J. Sasses, me metoda strukturale për të folmet e arbëreshëve të Greqisë, të Titos Jochalasis më tradicionale dhe të Lukas Cicipiisit me vështrime rrënjësisht sociolinguistike; studimet strukturale të Hampit, të Camajt, të Guxetës, pastaj të Solanos dhe një vargu studiuesish deri te brezat e Altimarit, të Belushos me mbështetje edhe metodash të fonetikës moderne. Nuk ka dyshim se këto studime pasqyronin mbështetje më të diversifikuara metodologjike dhe më pak synime klasifikuese si ato të trungut historik ballkanik. Në ato tradita kishte dhe përshkrime strukturale si ai i Leonaerd Newmarkut për të folmen e Beratit, etj.

Sido që të jetë, të gjitha së bashku jepnin një pasqyrë për varietetet e shqipes/ arbër/nishtes në tërësi, pasqyrë që përtregonte diversitetet hapësinore me shpjegime historike, sociale, të kontaktit, etj. Këto diversitete shpjegoheshin kryesisht mbi baza klasifikuese me parametra të motivuar historikisht përmes izoglosave tradicionalisht të identifikuar, si rotacizmi, nazalizmi, diftongimet, palatalizimet, etj. Prandaj edhe përqendrimet ishin kryesisht te tiparet fonetike dhe morfologjike,

shpesh madje duke veçuar tufa specifike dhe duke neglizhuar përshkrimin e plotë të varietetit përkatës. Merreshin parasysh dhe rezultatet e gjeografisë gjuhësore.

Aspektet sociale e të tjera të variacionit, sidomos të para në vështrim sociolinguistik të kohëve më të vona mbeteshin në hije.

Sido që të jetë, kjo qe baza edhe për krijimin e pyetësorit dhe realizimin e Atlasit dialektologjik të realizuar në rrethana të vështirësuar të ndarjeve shtetërore si një vepër sintetizuese të atyre studimeve dhe eksplorimeve ekstensive të realizuar me të njëjtën metodologji në të dy anët e kufirit pas vitit 1981 më vështirë të kalueshëm.

Në të gjitha ato procese studimi Bahri Beci ka qenë dëndësisht i pranishëm, kryesisht me studime për të folmet e gegnishtes qendrore dhe të gegnishtes veriperëndimore, me pjesëmarrje intensive në punën e Atlasit, etj. Po manifestonte gjithashtu interesa për studimin e çështjeve të ndryshme të natyrës historike. Përshkrimet e tij të të folmeve të Matit e të Dibrës, më vonë të Shkodrës shkonin në gjerësi dhe sillnin materiale të bollshme kontekstualizuese. Indikonin një studiuës të stërvitur për shënimin e njësisive tingullore me perceptim të zakonshëm.

Me Bahri Becin kam pasur kontakte dhe në kohën kur ai po niste një fazë të re studimi në Institutin e Fonetikës në Paris, ku po merrej me hulumtimin e përqendruar të së folmes së Shkodrës në rrafshin fonetik dhe mbi bazë të analizave spektrografike. Kjo përvojë do t'i sillte atij dhe nevojën për vështrime pak më ndryshe të tërë fenomenit të variacioneve dialektore.

Bahri Beci u mor dhe me studime të gjuhës standarde, shpesh të para në raportet me dialektet, ashtu si dhe me aspektet ballkanike të shqipes. Vrojtimet historike dhe sfondi historik i studimeve dialektore të shqipes ishin pjesë e hulumtimeve të tij, po ashtu. Në dy dekadat e fundit ai kishte zhvilluar dhe një veprimtari të gjerë të hartimit të gramatikave shkollore për të gjitha nivelet e mësimin të shqipes. Në një aspekt më të përgjithshëm ai vinte nga një horizont dialektologjik tradicional, por ndërkohë i begatonte vështrimet e tij me studimet eksperimentale dhe implikimet që kishin ato për studimet në terren. Nga këndi i vrojtimit të mia si koleg këto studime në laborator ia kishin theksuar edhe më shumë tendencën që shfaqte Bahriu edhe më herët për respektin e të dhënave, mbledhjen e tyre dhe hetimin pastaj. Në këtë kohën e dytë atij i dilte nevoja për krijimin e relevancave të reja që impononin materialet dhe të dhënat e rritura nga të gjitha këto përvoja.

Pas gjithë kësaj përvoje të gjatë si studiues, por edhe si drejtues i Institutit, pas gjithë atyre akumulimeve, ai na vjen tani me një vështrim të ri për tërësinë e dialektologjisë shqiptare. Dhe ky vështrim është kritik për të arriturat e mëhershme, për mënyrën e studimit dhe për përgjithësimet edhe klasifikuese që janë bërë deri sot. I bërë nga një studiues me përvojë të atillë ky studim paraqet vlerë më vete. Do theksuar me këtë rast kërkesa e tij e hetuar gjithandej për të shkuar më tej me vështrimin e tij tani ndërtues, paraqitjen e modelit që ndjek, përmes një rrjeti tipologjik tiparesh.

Në këtë libër ai e ka ndjerë nevojën të bënte një paraqitje kritike të zhvillimeve dhe të rezultateve të arritura në studimet dialektore të shqipes, së pari në raport me dukuritë dialektore dhe metodat e studimit të tyre. Në këtë pjesë ai vjen të njëjtë dhe pikëpamjen e tij të tashme për këto probleme duke u nisur nga vështrimi i përgjithshëm tipologjik i të dhënave në rrafshet fonetik, morfologjik dhe leksikor.

Në pjesën e dytë të librit ai merret me strukturën dialektore të shqipes duke bërë paraqitjen e parimeve dhe të kriterëve për vështrimet në këtë pikë dhe në fund vlerësimet e veta kritike. Këtu ai vjen me një problematizim të posaçëm të konceptit të të folmeve kalimtare dhe në fund me paraqitjen e pikëpamjeve të tij për strukturën dialektore të shqipes, natyrisht gjithnjë në raport me përgjithësimet e bëra më herët në faza të ndryshme, nga Gjinari, Gjinari-Shkurtajt etj. Pas kritikës për ndarjen në dialekte, nëndialekte e të folme, ai vjen këtu me vështrimet dhe propozimet e tij për krahinat dialektore, për zonat dialektore dhe për rajonet dialektore, për të cilat beson se mund të sjellin pasqyrim jo vetëm të ri po edhe më adekuat të gjendjes së shqipes në terren.

Pjesa e tretë e librit i kushtohet studimit të tipareve dalluese të njësisve dialektore të shqipes, gjithnjë me metodologji të njëjtë: paraqitje kritike e studimeve të derisotme, parashtrim i pikëpamjeve të autorit për to.

Në pjesën e mbylljes ai nuk e lë pa bërë dhe një vështrim më të përgjithshëm për zhvillimet e atyre studimeve në Shqipëri, duke theksuar se ato ishin bërë nga Jorgji Gjinari kryesisht në periudhën e monizmit dhe me orientim tërësisht lindor. Për pasqyrat e përgjithësimet të dialekteve të shqipes pas ndryshimeve në Shqipëri, të bëra tani në bashkautorësi të Gjinarit/ Shkurtajt, ai vërente se “*vihet re një kthesë e plotë drejt literaturës perëndimore*”, përkatësisht “*përpyekja për ndryshimin, jo të kriterëve të studimit të dukurive dialektore të shqipes, po të kriterëve të paraqitjes dhe klasifikimit të të dhënave dialektore*”. Ai vërente kapërcimin nga një paraqitje dhe klasifikim tradicional në një

klasifikim mbi bazën e kriterëve funksionale a strukturore dhe këtu ai vërente momentin për të të papranueshëm: të njëjtat dukuri të përshkruara më parë me terminologji tradicionale tani kërkohet të jepen me terminologji funksionale a strukturore, duke vënë re po ashtu se ka dallime metodologjike në këtë aspekt dhe në raport me paraqitjet e niveleve fonetike e morfologjike.

Beci ka vërejtjet e tij dhe lidhur me materialet e mbledhura, me mungesat në procedurat e regjistrimit, etj. Përgjithësimi i tij përfundimtar vjen si vijon: *“tek ne ka munguar një formim teorik i specializuar në fushën e dialektologjisë”*. Edhe për konceptimin dhe hartimin e Atlasit ai vëren se është bërë në kohën e monizmit, *“në kushtet e mungesës së lirisë akademik në Shqipëri”* me mbështetje në gjuhësinë marksiste, e marksiste-leniniste. Por në fakt ai vërente se kjo nënkuptonte përvojat e gjeografisë gjuhësore lindore.

Vështirësitë në këtë drejtim e bëjnë autorin të konstatojë se *“për-pjekjet tona në këtë libër për të arritur në përfundime shkencore, nuk mund të vlerësohen si përfundimtare, por si një synim për të shman-gur... mangësitë e trajtimeve përgjithësuese të derisotme..., po edhe për të krijuar kushtet për një përqsje të re ndaj kësaj problematike...”*

Libri që përurohet sot paraqet gjithsesi një ndihmesë për këto studime të bërë nga një autor brenda tyre dhe me një përvojë të gjatë studimi në këtë fushë.

Nehas Sopaj, Shkup

ZEJNULLAH RRAHMANI

U lind në Ballovc më 1952. Shkollën fillore dhe atë të mesmen i kreu në Podujevë. Është diplomuar në Fakultetin Filozofik të Prishtinës. Studimet pasuniversitare i mbaroi, magjistroi dhe doktoroi në Universitetin e Prishtinës. Është anëtar i ASHA të Kosovës. Jeton dhe vepron në Prishtinë.

Vepra letrare:

1. *Zanoret e humbura*, roman, Rilindja, Prishtinë, 1974.
2. *Udhëtimi i një pikë uji*, novelë, Rilindja, Prishtinë, 1976.
3. *Sheshi i unazës*, roman, Rilindja, Prishtinë, 1978,
4. *E bukura e dheut*, roman, Rilindja, Prishtinë, 1987.
5. *Udhëtimi arbdhetar*, roman, 1992.
6. *Mjeshtri i vetmisë*, tregime, 1995.
7. *Jusufi*, roman, Dukagjini, Pejë, 1999.
8. *Romani për Kosovën*, roman, Sh.B.Faik Konica, Prishtinë, 2000.
9. *99 Rruzaret prej smaragdi*, roman, Faik Konica, Prishtinë, 2006.
10. *Tregimet e Ballofcit*, tregime dhe novela, Faik Konica, Prishtinë, 2008.
11. *Iluminacion*, proza poetik, Otava, 2008
12. *Lypësi dhe Sofia*, roman, Faik Konica, Prishtinë, 2011.
13. *Pesë vakte*, roman, Faik Konica, Prishtinë, 2013.
14. *O Njeri*, ASHAK, Prishtinë
15. *Djemtë e Ballofcit*, Faik Konica, Prishtinë 2021
16. *Deti i zi*, Onufri, Tiranë 2022

Nga moria e romansierëve modernë që sot në letërsinë shqipe nuk janë të pakët, Zejnullah Rrahmani është një zë i veçantë që dallohet me shumësinë e rrëfimeve, me trajtat e ndryshme rrëfimore që përdor në romanet e tij. Duke filluar me përmbledhjen e tregimeve *Udhëtimi i një pike uji* dhe duke vazhduar me romanet *Zanoret e humbura*, *E Bukura e Dheut*, *Sheshi i Unazës* dhe më vonë, me romanin *Udhëtimi arbdhetar*, ai ua tërhoqi vëmendjen lexuesve dhe kritikës me rrëfimin e gjith-anshëm që mëton t'i zërë të gjitha fijet e individuale dhe të kolektives, në prozën e tij voluminoze. I mësuar nga tradita kulturore shqiptare, i mësuar por edhe nga tradita botërore, ai sikur përpiket ta bëjë një rrëfim universal që do t'i përfshinte si zërin e brendshëm të personazheve, ashtu edhe zëshmërinë e ditëve tona, por edhe të zërave tjerë që dalin nga historia si zë kolektiv, si zë që mëton të jetë tërësi e zërave të ndryshëm përmes një rrëfimi të përgjithshëm kombëtar dhe universal. Për dallim nga veçantia e zërave të brendshëm e të jashtëm të personazheve në romanet tjerë të sotëm, që secili më vete marrin dhe e thellojnë një zë individual të veçantë nga njëri - tjetri dhe varësisht nga gjerësia e temave të caktuara, në të gjitha romanet e Z. Rrahmanit thellohet vetëm një zë, por një zë që është sa kombëtar, po aq edhe universal, dhe shtrihet prej romani në roman duke zënë timbre historikë, folklorikë, psikologjikë, etnopsikologjikë, realë, imagjinarë, por edhe lirikë, një rrëfim të përgjithshëm që prej romanit të parë dhe deri tek i fundmi vjen duke e qartësuar gjuhën e rrëfimit dhe duke e begatuar formën dhe përmbajtjen. Nga shumësia e personazheve kryesorë dhe terciarë, heronjtë kryesorë, siç janë 'LB'N te *Zanoret e humbura*, Prifti dhe Mark M. te *Sheshi i unazës*, Princi dhe *E Bukura në E Bukura e Dheut* dhe Unë në *Udhëtimi arbdhetar*, në gamën e interesimit krijues të autorit shëtit një rrëfimtari i gjithëdijshëm që e bart tërë rrëfimin e romaneve të tij dhe krijon një konglomerat personazhesh të ndryshëm, pozitivë dhe negativë, dhe krijon distanca të ndryshme duke përshndërruar zërin që herë është pozitiv e herë negativ, e herë pastaj është edhe indiferent. Në romanet e tij të shkruar në vetë të parë njëjës (*Zanoret e humbura* dhe *Udhëtimi arbdhetar*) dhe në romanet të shkruar në vetë të tretë (*E Bukura e Dheut* dhe *Sheshi i Unazës*), rrëfimtari i gjithëdijshëm gjatë krijimit të distancave që janë distanca të rrëfimit gjithëfarësh dhe jo distanca të raporteve psikologjike të personazheve të caktuar, herë e mban një vokacion pozitivisht të orietuar kah lënda rrëfimore, e herë e mban një qëndrim negativ ndaj lëndës rrëfimore, e me këtë krijohen zëra të përshndërrura me fone ironike, sarkastike etj. ndaj lëndës rrëfimore që ka të bëjë me këto distanca.

Dalja në horizontin e letërsisë të Z. Rrahmanit ishte sihariq letrar, pikërisht në këtë drejtim. Në romanet e tij mungon fabula romaneske pothuaj në nivelin zero, kurse personazhet pozitivë dhe negativë që mëtojnë të jenë prodhim i botës psikologjike të autorit, në raportet e tyre dalin në sipërfaqe me botën e tyre sa reale, po aq edhe imagjinare, kurse kontaktimi i tyre të shpeshën ndërpritet sa herë që t'i kujtohet rrëfimitarit i cili qëndron në distancë të plotë me to. Në romanin *Udhëtimi arbdhetar* që është tentim për ta shqiptuar zërin e brendshëm të autorit në rrafsh tërësor, pas tentimeve serioze në këtë drejtim në romanin *Zanoret e humbura*, po edhe në romanet tjera, ky është romani që në mënyrë të plotë e shqipton intencën qendrore të autorit, ide e tij e kahershme që gjallon në veprat e tij tjera që përmes defabulizmit të etosit romanesk thuhet hapur dhe pa autocenzurë - e vërteta sa kombëtare, po aq edhe universale, e vërteta personale, individuale dhe e vërteta kozmike. Qëllimi i kahmotshëm i autorit (por që nuk është vetëm qëllim i tij, ky është qëllim i pjesës dërmuese të krijuesve shqiptarë), qëllim të cilin e ka paralajmëruar në romanin *Zanoret e humbura*, në këtë roman del i plotë dhe pa pengesa. Megjithatë menjëherë duhet thënë se mjehrisht degradohet nga rrethanat e sotme politike të cilat dinë të ngarendin shpesh më shpejt se ç'ka dashur të thotë autori me veprën e tij, nganjëherë madje duke ia karikuar idenë atij, sepse udhëtimi Ynë në këtë roman di të bëhet nganjëherë stereotip dhe i bajatshëm nga që qysh më parë në zbulimin e tij tashmë prej përpara publikisht politikisht janë bërë hapa kah qëllimi që autori e ka thënë paraprakisht më me veshtirësi.

Fjala është për censurën prej së cilës para viteve nëntëdhjeta nuk kishte shkrimtar shqiptar që nuk ndeshej si problem i parë krijues. Romani është shumë interesant për shumë arsye, një sepse i këndohet historisë së humbjes kombëtare; dy, sepse përmes humbjes dëshirohet të pasqyrohet aspirata dhe synimi i arritjes së asaj që nuk është bërë në planin kombëtar; tre, sepse romani është shkruar me një gjuhë më të qartë se romanet tjerë, që dinë të jenë eksperimentues; katër, sepse në zëvendësim të psikologjizmit romanesk del sheshit gjuha e universales romaneske dhe pesë, sepse përmes shumësisë së rrëfimit, gravitojnë një mori zërash sa të jashtëm po aq edhe të brendshëm shpirtërorë. Në tërë diagramin e rrëfimit hiqen dy vija vertikale të rrëfimit që unë do t'i pagëzoja si dy rrëfime: vija e parë është ajo e rrëfimit universal, i përgjithshëm, kombëtar, altruist, përkundraill vijës së dytë që përbën rrëfimin e Uriit të rrëfimitarit, rrëfimi i personales, vetes. Të dyja këto rrëfime kanë të njëjtin qëllim që ta plotësojnë njeri-tjetrit dhe e mbajnë

pezull lexuesin që në ftohtësinë e rrëfimit pa fabul, si edhe në romanet e tij të mëparshëm, i rëndojnë fjalitë e gjata, të stërzgjatura të rrëfimitarit, i cili duke e rrëfyer lëndën në formë monologjike, të shpeshtën lodhet dhe e flak leximin. I mësuar nga leximi i trendeve moderne të letërsisë së sotme botërore, veçanërisht nga letërsia latino-amerikane, autori i ka përvetësuar të gjitha përparësitë e leximit të romanit modern, dhe duke e lokalizuar atë në ambientin shqiptar, ndjehet njëlloj gjithkund. Atë që kahmot e ka paralajmëruar si udhëtim kolektiv në veprat e tij të mëparshme, këtu në romanin *Udhëtimi arbdhetar* ai synimin e idealit artistik e ka arritur plotësisht dhe mund të themi se ky roman është kulmi i tij.

Duke filluar sipas metodës logjike që prej induksionit të shkohet kah deduksioni, në roman radhiten dhe shtrihen temat njëra pas tjetrës, kurse që në fillim, lexuesi e ka të qartë qëllimin e autorit që udhëtimin t'i hyhet në mënyrë universale, kurse qëllimi i tij që gjatë historisë kombëtare shqiptare, të nxjerrë data kyçe të historisë së re shqiptare, siç janë 1878 (Lidhja e Prizrenit), 1912 (Shpallja e pavarësisë së gjysmës së Shqipërisë), 1924 (Revolucioni i Qershorit i F. Nolit, i përmbysur nga reaksioni zogist në kolaborim me mbretërinë pashiqiane të Jugosllavisë), 1945 (rindarja e tokave në dy regjione të ndryshme soc-komuniste), 1989 (aneksimi i autonomisë së Kosovës të fituar me gjak nga ana e regjimit aktual serbosllav), lë shumë zbrazëtira. Megjithatë, meqë autori është vetëm romancier dhe jo edhe historian, për ne më me rëndësi është ta shohim lëndën romenske ashtu siç autori e ka paraqitur ai, kurse kategoritë historike të ndërlidhura me totalitetin rrëfimor romanesk dhe udhëtimin nëpër trojet shqiptare ta kundrojë në shumësinë e temave periferike të humbjes.

I pajisur me dokumentaritet historik, etnokulturor kombëtar dhe jashtë kombëtar, në roman vegjeton një *konglomerat* rrëfimor. Aty has lexuesi një mori temash që marrin koriotim rrëfimor autonom, kurse në pasuse të veçanta ndeshemi një mori perifrazash të ndryshme, ndërkaq në ndonjë kaptinë të posaçme siç është ajo kah fundi, është dhënë një konglomerat eksperimentesh gjuhësore dialektore dhe nëndialektore. Në morinë e rrëfimit, në qendër është *Uni i rrëfimitarit* të gjithëdijsëm që i mban frenjtë e rrëfimit dhe udhëheq nëpër tema të ndryshme. Nëpër frazat e stërzgjatura Uni i rrëfimitarit të gjithëdijsëm i mban frenjtë e rrëfimit dhe udhëheq nëpër tema të ndryshme. Nëpër frazat e stërzgjatura të këtij rrëfimtari shpejt ai shndërrohet në një ne kolektiv, ndërkaq në retorikën e bardhë rrëfyese, ai humbet pothuaj duke u tretur dhe fati nuk ekziston fare. Por, meqë siç thamë në roman janë dy vija të gjata vertikale që i bartin dy tipa të mëdha të rrëfimit, *rrëfimi personal*

dhe *rrëfimi universal*, prej të cilëve *Unë* lidhjet me rrëfimin personal, kurse *Ne* me atë universal. Kështu rrëfimi monologjik përmes rrëfimit të Unit shpejt zhduket, kurse në të folurit në vetë të parë njëjës, ndërhyjnë gjuha retorike e autorit rreth çështjeve kyçe, për të dalë prapë sa herë që autorit i duhet për ta bërë rrëfimin më sintetik, më fleksibil dhe më atraktiv për lexuesin ose për ta mbajtur një ritëm të brendshëm romanesk. Shumësia e rrëfimitarit në vetë të parë, e përcakton edhe shumësinë e rrëfimeve që në roman shtresohen njëra pas tjetrës, përmes një retorike të shkallëzuar me fraza të stërgjatura, kurse këto fraza mëtojnë të jenë gjithë kallëzuese, rrallë e tek edhe poetike.

Por ta shohim romanin për nga linja horizontale e rrëfimit. Në këtë roman pa fabul të mirëfilltë, ekzistojnë disa tema që shtrihen në temën gjenerale, që kanë karakter etnopsikologjik dhe që synojnë të dalin me një modus artistik duke u shtrirë në vijën vertikale në histori. Në plan të parë është shpirti shqiptar dhe lëvizjet e tij nëpër histori duke e marrë në konsideratë konstatimin paraprak se ai shpirt *ka lënguar dhe lëngon për shkak të ndarjeve të imponuara nga faktori i jashtëm, siç është të jetuarit ndarë në dysh, kurse nga aspekti fetar që mëton të jetë frymëmarrje e shpirtit të një kombi, është i ndarë madje më tresh. Nën moton Njih, duaj dhe ndërto Atdheun autori synon të jetë një moto që konstiston t'i bëjë rezistencë shkapërderdhjes shpirtërore të qenies shqiptare nga fakti religjioz katolikomyslimanorthodoks të këtij trupi që derdhjen në të katër anët e botës e ka fatkobësi historike të trashëguar nëpër histori. "Ky qëndrim shprehej përmes frazës 'Ne jemi popull shumë i pasur me zotëra; i kemi tre, pra kemi aq sa i ka shumica tjetër e Evropës', e gjitha së bashku. Gjithashtu qarkullonte qëndrimi tjetër që i trajtonte si një çështje fare të kundërt me të parën, pra që është kundër tre zotërave tonë... Kështu, e kundërta me pajtimin, me faktin që populli shqiptar kaq i paktë ka gjetur hapësirë shpirtërore për të na bërë vend bashkë ekzistues i tri botërave aq individuale të dy religjioneve, që i ka tre zotëra ose ka shumica tjetër e Evropës së bashku, që shprehej përmes frazës (Ne jemi populli shumë i pasur me zotëra, i kemi tre, pra i kemi aq sa shumica tjetër e Evropës) shprehej me të njëjtat fjalë, pa ndryshuar asnjë zë, mirë po intonacioni ishte tjetërfare dhe për secilin shqipfolës mund të kuptohej qartazi që, në të vërtetë, nuk kishim tashmë zot fare, do të thotë mbasi që i kemi tre, ata e përjashtojnë mundësinë e ekzistimit të njeri-tjetrit."¹*

¹ Rrahmani, Z. Udhëtimi arbdhetar, NB. Rilindja, Prishtinë, 1992 fq. 20

Pas konstatimit se shqiptarët i kanë dy fe, me Objekte sakrale të ndryshme, në zërin e rrëfimitarit të gjithëdijshëm ndërhyjnë një zë i brendshëm parodik që në thelbin e vet sikur do ta fshehë një përqeshje ironike dhe sarkastike me këtë fakt. Ky është zëri tjetër që e demanton këtë begati religjioze, ky është *zëri tjetër*², zëri i dytë i rrëfimitarit që del si fakt se ideologjia komuniste për hir të bashkimit kombëtar shqiptar, shpik zhdukjen e dy konfesioneve fetare me tre objekte sakrale gjë që në fakt, e varfëron këtë begati fetare. Zëri tjetër që vihet në raport me zërin e parë të rrëfimitarit, sikur bën një dialog të brendshëm vetëm me veten e rrëfimitarit. Zëri i parë i rrëfimitarit është parodik dhe në lirinë e vet të gjerë të kësaj parodie, ndjehen variacione të ndryshme të një pasurie të madhe modalitetesh të pozitës së rrëfimitarit të gjithëdijshëm. Duke qenë në qendër të kuptimit semantik, paraodia e rrëfimitit në variacionet e shumta të rrëfimitarit i cili dëshiron t'i pushtojë të gjitha format e një kategorie filozofike, siç është shpirti, nëpërmjet kategorive etnopsikologjike dhe sociologjike, dëshirohet të rrëfëhet gjithçka prej asaj që është në fokus të interesimit e deri te kuptimet tjera aluzive, me çka synohet të preket tërësia rrëfimtare.

Duke iu referuar *Kanunit* të Lekë Dukagjinit të mbledhur nga Shtjefën Gjeçovit, prift shqiptar i Prizrenit, të vrarë nga pushteti serb duke e kaluar lumin Drin, pra duke iu referuar një vepre të madhe që lidhet me rregullimin e jetës shpirtërore të shqiptarëve, jashtë ligjeve të pushtuesve të ndryshëm, por edhe me faktin se ley prift me vdekjen e tij e ka vulosur fatkeqësinë e vet, në rrëfimin e Unit të rrëfimitarit radhiten një mori frazash të gjata që në vete se janë me kuptim të drejtpërdrejtë, po aq asocionojnë kuptime më të gjera interesimesh të ndryshme. Duke e shpaluar faqen e parë të shpirtit shqiptar dhe duke e lidhur atë me dashurinë si kategori estetike, psikologjike dhe thjesht intime, në fjalën e rrëfimitarit, përsëritet një sekuencë e përpunuar gjuhësore; "*Pra, bukuria e dashurisë shqiptare domosdo është e parritshme në mos belaformuese, madje vdekjeformuese në Shqipërinë Veriore. Pas saj ecën borxhi i gjakut siç ec në jetë nëpër vijë të gjakut jeta e familjes, me humbjet, me fatkeqësitë, me historinë.*"³ Përkundër fjalëve të drejtpërdrejta të rrëfimitarit, ndërhyjnë një mekanizëm gjuhësor që synon të thotë diçka më të madhe, po që mbetet e përealizuar deri në fund. Të dy fjalët e përbëra "belaformuese" dhe "vdekjeformuese" në thelbin e vet mëtojnë të thonë 1. pengesën e bashkimit kombëtar nga

² *Zëri tjetër*; në pamundësi të një termi tjetër më të përshtatshëm, këtë nocion po e nënvizoj për ta shprehur kuptimin e tij të dytë.

³ Rrahmarë Z. Ibidem fq. 23

jashtë dhe 2. pengesën e bashkimit kombëtar që është pos faktorit të jashtëm është pengesë nga vetvetja. Shpirti shqiptar i pasqyruar nga këndi i rrëfimitarit të gjithëdijshëm, do të ishte i mangët po të mos pasqyrohej edhe me ritin popullor të vdekjes. Autori po ashtu i referohet veprës së Sh. Gjeçovit, por edhe veprave tjera të ndryshme të autorëve të ndryshëm dhe folklorit.

T'i kthehemi strukturës së ndërtimit të romanit. Romani përbëhet prej tri pjesëve të mëdha të shënuar në numra arabë dhe në të tri pjesët gjenden nga dhjetë e më tepër kapituj që në këtë ndarje të jashtme nuk afrohen strukturat e brendshme rrëfimore. Sipas diagramit, vërehen dy linjat e mëdha që përbëjnë dy struktura të mëdha rrëfimore që dallojnë jo vetëm me pozitën e *Unit* rrëfimitar të unit si *Unë* dhe unit si *Ne*, por edhe me dy struktura të mëdha që përbëjnë dy grupacione rrëfimesh të ndryshme me tema, motive dhe realizime të ndryshme gjuhësore që dukshëm dallojnë. Hiq disa pjesë kur dy rrëfimet në makroplan shkrihen dhe bëhen një rrëfim mikst, në pjesët kryesore të këtyre dy rrëfimeve gjenden kallëzime të posaçme që alternohen nëpër faqet e romanit duke e filluar rrëfimin gjeneral nga anë diametralisht të kundërt që gjatë faqeve të romanit në fund shkrihen dhe bëhen një, duke e plotësuar njëra - tjetrën. Uni i rrëfimitarit rrallë e tek rrëfen në monolog për vetveten e tij, aty pothuaj ai unë gati shkrihet fare në retorikën e gjerë të rrëfimit dhe gjatë leximit fare shpejt lexuesi do të harrojë se ky roman është roman monologjik. Hiq linjën e dytë të rrëfimit kur në gro-plan Uni flet për vetveten e tij dhe përmes një dialogu evokues me Andetin, Ardiannën, Natyrën, Belcin etj. pothuaj në tërë romanin ndërrohen strukturat e ndryshme rrëfimore, përmes fjalës së drejtpërdrejtë të rrëfimitarit, i cili e ka humbur veten e tij të parë.

Në rrëfimin e tij pavetor, rrëfimtari i gjithëdijshëm flet drejtpërdrejt për çështje nga më të ndryshmet nga totaliteti i realitetit objektiv, kurse gjatë të folurit të tij herë pas here e ndërron pozitën e tij dhe duke e shndërruar edhe të folurit e tij duke futur një ligjëratat e tij, fillon të frymojë një nëntekst. Dielli fiton një konotim metaforik, në fjalitë ku përshkruhet drita e diellit që te lexuesi vetvetiu imponohet komponenta e harmonisë fizike dhe shpirtërore, sepse në Ungjill thuhet se drita është burimi i jetës, prandaj drita është burimi i jetës, prandaj drita e diellit është burim i jetës, është dashuria që e synojnë të gjitha gjallesat mbitokësore. Në tekstet e ndryshme rrëfimore shpesh ndërhyjnë një konotim tjetërfare që lexuesit ia përmbys imazhin e krijuar të leximit. Në konotime të tilla siç është përshkrimi i atmosferës me borë është asociacion i labirinthit ku bie individit që ka imagjinatë të krijuesit. Në

një atmosferë vetmie ku bie individi dhe ku çdo gjë kapërthehet nga një kohë e pakohë dhe ambienti i humb dimensionet e vendit të caktuar, ku gjithçka e mbulon bora, në faqet 74-79, fitohet përshtypja se lexuesi futet në vetminë e labirintheve të E. Sabatos (për këtë shih romanet e tij *Tuneli* dhe *Mbi heronjtë dhe varrezat*). Në frazat e gjata dhe të shkurtra, rrëfimi i Unit kap rrëfimin e drejtpërdrejtë dhe simbolik:

"Ishte një fushëbardhë në të cilën bora po binte me të madhe, tashmë gjysmë metër, pak më vonë ende binte, kishte ndoshta një metër borë dhe nuk e kisha më aspak të qartë çfarë copë e ditës kishte tretuar në atë borë, çfarë viti e deкаде kishte humbur përfundimisht nën atë borë... vetëm se ishte e sigurt që ajo borë kishte filluar të binte me rrem-bim, i kish kapur në befasi shumicën e njerëzve, disa sipërmarrje kishin tentuar të bënin diçka me rrugët, t'i mbronin duke hedhur kripëra, mirëpo s'kishin pasur sukses, pastaj makinat e rënda qenë gozhduar në akull dhe qenë mbuluar me borë, kështu që rrugët qenë të pambrojtura dhe shtëpitë u mbyllën në vete, më vonë njerëzit hoqën dorë ta hiqnin e pastronin borën para shtëpisë, sepse më s'kishin ku të shkonin, as kush t'u vinte, mandej filluan të pësonin godinat e mëdha nëpër qytet, mbasi që nuk e mbanin gjithë atë borë që i mbulonte sipërfaqet e tyre të rrafshëta, kulmet e shtrira mbi pjesë të tëra të qytetit e të krahinës: shkollat u mbuluan dhe shkatërroheshin me të madhe, pastaj antenat e televizorëve, godina e madhe e radios, pallati i shtypit, institutet, arkivat dhe akademia, godina e qeverisë tashmë nuk duhej kurrkund, kish tretur krejt... dhe duke parë dhe menduar kështu, një moment u ndala si hu midis fushe e ktheva kokën drejt qiellit: një qiell i ulët si një shoshë, kurse unë sillesha si me qenë mu mbi kokën time dielli, si me u pas afruar dielli mbi krye, mirëpo prej andej reshte borë. Hiç nuk mund të caktohej sa mund të shikohej përpjetë në atë qiell, nën atë reshje bore! Ndoshta pesë hapa, ndoshta as aq, tre - katër? Isha i humbur... Mirëpo, duhej të mendoja për gjëra shumë të rëndësishme: si të shpëtoja lekurrën? Si ta ruaja kokën? Si të përmbledhesha e të mos çmendesha në midis tëfushës së bardhë?⁴

Nga citati i mësipërm shihet qartë përshkrimi i pushtimit më të ri të Kosovës e vitit 1989 përmes një peizazhi që nuk është peizazh i rëndomtë; në të faktikisht as që bëhet fjalë për përshkrimin e natyrës me borë; aty çdo gjë flet hapur për pushtimin më të ri të Kosovës. Në vitin kur botohet ky roman fare qartë është se është guxim intelektual të krijohet aluzioni konkret i këtij pushtimi tonin klasik dhe të thuhej e

⁴ Rrahmani Z. *Udhëtimi arbdhetar*, NB Rilindja, Prishtinë, fq. Nr. 75

vërteta ishte guxim krijues; megjithatë me prishjen e Ish Jugosllavisë kur krahas këtij pushtimi derdhet Utopia e fundit komuniste hiqet edhe censura kurse vetëm një vit më vonë madje lirisht mund ta thuash të vërtetën hapur qoftë edhe si parullë stereotipe, atëherë s'ka dyshim se nganjëherë koha ec më shpejt se vetë ndryshimi i mentalitetit të robit i cili i mësuar me trysni dhe robëri, druan ta shofë hapur të vërtetën. Në vijat e nënvizuara të citatit të sipërm flet nënteksti që lidhet me idenë qendrore të autorit që ka të bëjë me realitetin e ditëve tona bora simbol i vetmisë, asocionon shqetësimin e brendshëm të shpirtit, i cili synon harmoninë dhe idealin e udhëtimit, kurse fjala e përbërë fushëbardha shndërrohet në një stilemë që flet për dykuptimësinë e vet alias për robërinë.

Në ornamentikën e të folurit të rrëfimitarit të gjithëdijsëm, në fq. 90 del një personazh anonim që me daljen e tij në sipërfaqe e ndryshon zërin e tij. Prezenca e tij e përshndërron natyrën e të folurit të drejt-përdrejtë, kurse hija e fjalës së tij, të folurit e tij e bën plotësisht një zë parodik dhe sarkastik. Në faqen 124-130 paraqitet një rrëfimtari tjetër, ndryshe nga Onisi, personazhi (krijues) negativ, ai shfaqet me maskë të re pseudopatriotike dhe e mban një fjalim të gjatë retorik, përplot eufori për bashkimin kombëtar shqiptar. Kjo asocionon në liderët partiakë të ditëve tona (të mos them se në të vërtetë frymëzimin e gjen aty), të cilët le që s'e kanë për ideal atë që e deklarojnë, por përkundrazi, duke synuar ta vjelin masën e verbër që në çaste euforie e besojnë, marrin pozitën dypalëshe: një që ta rrjepin popullin dhe dy që të krijojë imixhin e oratorëve alias të shpëtimtarit kombëtar të ditëve tona. Prej faqe 157 deri 188, pothuaj plotësisht radhiten rrëfimet negative që bredhin në emër të idealit të *Udhëtimit arbdhetar* dhe që i mbushin xhepat sa të munden dhe në konglomeratin e rrëfimit të alternuar, ndërron dy rrëfimet gjenerale të "unit" në "ne" dhe të "ne" në "unë", prandaj edhe alternohen në formë fragmentariteti njëra nga tjetra. Brenda faqeve të përmendur, pos që ndërrohen rrëfimet gjenerale aty bëhet një vijë e rrëfimit të brendshëm të rrëfimitarit të gjithëdijsëm i cili rrallë e tek del në sipërfaqe t'i mbledhë rezonet nga rrëfimet e shumta që aty dalin dhe të konstatojë pikërisht atë tragjiken e humbjes së këtij udhëtimi maratonik metaforik (shih. fq. 164 dhe 186-187).

Është atmosferë e ndryshimeve të mëdha të *udhëtimit* në këto troje dhe populli lëviz vazhdimisht nga apelet që i bëjnë atij udhëheqësit e saj. Prijësit popullorë siç janë Bariu me kryq të madh, i pari, Bari-hoxha, i pari i të drejtave njerëzore, Plaku i Odave dhe një varg udhëtarësh rrëfimtarë të tjerë anësorë të cilët bëjnë gara se kush do ta marrë

flamurin e shpëtimit kombëtar, në ndërkohë që, të cytur nga këto lëvizje popullore, pushtuesi e forcon dhunën dhe pushtetin policor. Në përshkrimin e alternuar ku Uni i rrëfimtari është humbur, gjuhën e tij rrëfimorë e ka parodizuar dhe karikuar tërësisht duke iu afruar gjenezës së tragjikomedisë kombëtare dhe duke ua lënë gojën të flasin vetë pa ndërhyrje të veten. Natyrisht, është pothuaj e pamundur të radhiten të gjitha ato variacione të së keqes që dalin nga garat që u bënë në Kosovë gjatë zgjedhjeve, Z. Rrahmani i zgjedh vetëm ato segmente që lidhen me udhëtimin metaforik, segmente që kanë konotacion pezhorativ. Është interesant zëri i huaj i një rrëfimtari i cili mëton të jetë zë i përgjithshëm, zë metaforik - alegorik që del të flasë dhe që në patosin e retorikës së tij dyzet herë e përdor vetën e parë njëjës, duke e shquar "unin" e tij dhe që ka timbrin e një personazhi ngjashëm si të romanit *Vdekja më vjen prej syve të tillë* të R. Qosjes:

- Unë jam i pari i më të parëve që mendoj se këto duhet të jenë me vete e të popullqeverisin veten! Line jam më i pari prej të parëve që kam kërkuar për këta njerëz të mrekullueshëm të kenë bukë! Unë jam më i pari që kam kërkuar për këtë popull të ketë dritë Unë jam më i pari që kam kërkuar për këtë popull diell! Unë jam i pari që kam kërkuar për këtë popull të këtyre vendeve të jetë zot në shtëpinë e vet! Unë jam më i pari që kam kërkuar për këtë popull të ketë liri! Unë jam më i pari që kam kërkuar që ky popull të ketë paqë! Unë jam më i pari që kam kërkuar që ky popull të gëzoj punën e vet! Unë jam më i pari që kam kërkuar që ky popull ta mbajë për vete grurin që e prodhon vetë!..."¹ *Pozita e humbur e Unit të rrëfimtari (që të shpesh të përqafton pozita edhe e autorit të romanit) përkarshi unit të prepotencuar të këtij rrëfimtari prepotent, hetohet vetëm në alegorinë dhe komikën e shpirtit kombëtar që në këtë atmosferë duhet të shpërblehet me tragjikomizëm. Në këtë alegorezë, në rrëfimin e tij ka hyrë dhe është tretur zëri i jash-tëm. "Mandej ishin ato, thirjet që prekin ndjenjën, zemrën, mendjen e shqiptarëve: O popull i vuajtur! O popull i mbuluar! O popull i dy gishtave! Populli është i lodhur! Populli është në skaj të durimit! Edhe sa do të presë e do të durojë ky popull! O popull i robëruar! o popull i ndaluar!"⁵*

Në romanin *Udhëtimi arbdhetar* pozita e rrëfimtari të gjithë-dijshëm ndërmjet zërave tjerë që ia zënë frymën, del papritur e plotë në formë kolazhesh. Në udhëtimin metaforik që synon harmorninë,

⁵ Rrahmani Z. Ibidem Iq. 157

mirëqenien kombëtare (dhe ndërnacionle) harmoninë e shpirtit në uni-
 verzum, në udhëtimin nëpër borë të unit të personazhit kryesor, vetëm
 në përmbyllje të kolazheve rrëfimore del monologu kryesor, vetëm në
 përmbyllje të kolazheve rrëfimore del monologu i tij. Përpos retorikës
 së rrëfimtariëve anësorë që dalin shpesh dhe qëndrojnë në korniza të
 fjalës së drejtpërdrejtë të rrëfimtari, në formë kolazhesh flasin gegë-
 risht nga një sekuencë gjuhësore nga një fjalim të tërë të nxjerrë nga
 dokumentariteti i heronjve të traditës kombëtare. I pakompleks dhe
 plotësisht i lirë në retorikën historike, në retorikën sociopsikologjike
 dhe në retorikën përgjithësisht gnoseologjike, rrëfimtari i gjithëdijshëm
 në rrëfimin e tij që lidhet me të ashtuquajturën independencë, kohën
 midis dy luftë- rave botërore përqendrohet në pjesëri dermuese me
 rrëfimin global që ka të bëjë me mbretin shqiptar (Zog) dhe Faetonin
 (F. Nolin) si dhe me tërë rrethanat socikulturore në udhëtimin kardinal
 metaforik. I pakompleks dhe me një liri disi "të tepruar" ai në përshkrimin
 e personalitetit të Faetonit dhe në përgjithësi me fenomenin e tij të
 rrallë dhe intelektual, ai atë e vë në një krahasim metaforik parodizues
 me atë të Don Kishotit. Udhëtimi si "ne" i unit të rrëfimtari që mëton
 të jetë udhëtim-sfidë si udhëtim i Krishtit që vetëm pëson në këtë botë,
 bëhet nëpër "ne" udhëtim i Fatonit tragjik, i cili çdo gjë flizon mu si Don
 Kishoti, duke iu kthyer flijimi i tij në formë të një bumerangu tragjik
 (revolucionin e qershorit 1924 i F. Nolit dhe shuarja e tij me gjalc). Duke
 i përpunuar më vete të gjitha veprat origjinale dhe të përkthyer me të
 bëmat si njeri dhe si prift, në rrëfimin e rrëfimtari të gjithëdijshëm,
 synohet të shihet fytyra e Fatonit në kompleksitetin e personalitetit historik,
 letrar, muzikor, përkthyes, orator etj. në një dritë të re, në një dritë
 "më objektive" se ç'është, në një dritë të një objektiviteti imagjinar ku
 pësimet e tij vështrohen brendapërbrenda dhe krahasimi me Don Kishotin
 del si krahasim letraresk dhe paksa ekstravagant: *"Në vitin 1924
 ndodhi një ngjarje e jashtëzakonshme për hartëshkrimin e këtij udhë-
 timi, ngjarje e cila përfundimisht u regjistrua dhe mbeti pothuajse krejt
 e veçantë për gjithë shkrimet hartopolitikografike shqiptare. Deri më
 sot shumica e atyre shkrimeve vazhdojnë të ushtrojnë në shenjë lavdie
 e madhështie për gjestin që bëri Faetoni, një njeri shumë i çudiçëm,
 prift i rritit orthodoks, burrë shteti dhe mandej poet, historian e përk-
 thyes. Ish një njeri me sytë si gacë prushi mbuluar me hi. Fatoni ishte
 një udhëtar, ataherë i rëndishëm, që me vite të tëra kish udhëtuar e
 marrë pjesë në shumë punime, në shumë vizita dhe në shumë ndërtime
 të kohës, sidomos në botën e gjerë të huaj. Atë kohën e paktë të jetës në
 atdhe me dhjetëra herë bashkudhëtarëve u kish treguar për një trim -
 kalorësin të pathyeshëm Don Kishot.*

Fill pas rrëfimit që lidhet me figurën e Faetonit veprat dhe të bëmat e tij dhe të shokëve të tij që filloi ta ndjekë Mbreti me zagarët e tij, duke filluar prej faqes 238 e deri te faqja 244, në roman del një rrëfim dokumentar që ka të bëjë me atmosferën morbide mbretërore dhe nga dokumentariteti i asaj kohe radhitet koniuktura e përditshmërisë mbretërore. Në zërin e rrëfimitarit të gjithëdijshtëm, ndërhyrja e zërit i huaj (psh. zëri i M. Ugolinit, një personazhi fare të parëndësishëm): *"Ta zëmë, M. Ugolini erdhi befasisht dhe me të zbritur në Portin e Durrësit tha për shtypin, që ishte mbushur me informacionin mbi triumfin heroik të forcave të Zogut që po kthenin qetësinë dhe r'endin e prishur prej atij rusofilin Theofan (i cili ishte krejt i mrekulluar nga idetë e tyre komunisto-kristiano-sllave) se s'i interesonte tjetër pos koleksionit të Kolegjit Jezusit të Shkodrës dhe si ta shihte e ta regjistronte atë, do të mirrej me koleksionin e Ekrem Vlorës në Vlorë"*². Po e citoj këtë personazh dokumentar të parëndësishëm për ta parë të potencuar jashtë zërave të shumtë që dalin shpesh në këtë roman dhe për ta parë mosndërhyrjen e rrëfimitarit (dhe të autorit) dhe me këtë për ta parë indiferencën e pangjyrosur të qëllim të rrëfimit dokumentar. Në rrëfimin e këtyre vargërohen personazhe të shumtë të parëndësishëm që e marrin në gojë rrëfimin më së tepërmi në gegërishte dhe pos kuriozitetit thjesht gjuhësor (variacionet e të folmeve të ndryshme nëpër trojet e banuar me shqiptarë, gjithandëj edhe në diasporë) nuk kanë ndonjë rëndësi tjetër të posaçme.

Gjer tani e pamë rrëfimin e tipit të parë gjeneral të rrëfimitarit. Më poshtë do të shohim rrëfimin e tipit të dytë të rrëfimitarit të gjithëdijshtëm, i cili dallon për nga tematika që shtjellon në diskursin e të folurit të tij dhe jo edhe për nga struktura e thjeshtë gjuhësore. Për lexuesin kjo linjë e dytë e rrëfimit përherë është linjë e parë, sepse në fund të fundit, në këtë konglomerat rrëfimesh të lidhura në një vend as që do të pranohej si struktura romaneske po të mos ishte kjo linjë që është struktura e brendshme e Unit të rrëfimitarit. Nga një konglomerat gjuhësor tipash të ndryshëm rrëfimorë, për ta bërë romanin të lexohet si tërësi e rrumbullaksuar, është pikërisht ky rrëfim i dytë ai që si tërësi e dytë e plotëson të parin dhe e bën atë më tërheqës për t'u lexuar. Ky rrëfim linear autobiografik i Unit të kryeprotagonistit (që është edhe rrëfim i rrëfimitarit të gjithëdijshtëm) që flet në vetë të parë njëjës, me të ndërprera fillon evokimin e kohës së fëmijërisë dhe i vazhdon storiet e shkurtra emocionalisht të ngjyrosura që përbëjnë strumbullarin e rrëfimit dhe që zgjatet deri në faqet e fundit të romanit. Me këtë, autori përpiket të nxjerrë konkluzione gnoseologjike që nga fëmijëria dhe

lidhet me vargun e temave të ndryshme nëpër të cilat do të jenë në fillim të reduktuara në një linjë, kurse më vonë do të zgjerohen dhe do të bëhen dykahëshe, duke përfshirë një hapësirë më të zgjedhur.

Për dallim të rrëfimit të parë, ku Ne është e madhe përkundër Unit të vogël, në rrëfimin e dytë Ne është e vogël, kurse Unë është i madh, prandaj përkundër rrëfimit gjeneral ku në konglomeratin e rrëfimeve retorike të rrëfimit të parë kryqëzohen si fjalë e drejtpërdrejtë e rrëfimitarit që ka të bëjë në groplan udhëtimin metaforik, në rrëfimin e dytë hasim intimën e Unit rrëfimitar dhe rrethin e ngushtë dhe shokët më intimë siç janë Ardiana, Andeti, Natyra, pastaj Beltoi, mësuesi Isë dhe një mori personazhesh episodikë që dalin aty-këtu rastësisht. Përkundër retorikës së bardhë të rrëfimit të parë, në rrëfimin e dytë përcillen disa linja auto- biografike të autorit si reflekse të evokimit që ia zgjojnë kureshtjen lexuesit dhe bëhen linja të karaktereve dhe të temperamenteve të personazheve që aty gdhenden me vija të holla, por gjithnjë me të njëjtin diksion të frazave të stërgjatura si në tërë romanin bëjnë portretin e heronjve. Kur jemi këtu, është e udhës të bëjmë një digresion. Siç dihet edhe ky roman si edhe romanet tjerë monologjike, në strukturën e ndërtimit të vet, e redukton fabulën e mirëfilltë.

Duhet thënë ndërkaq se për dallim nga tre romanet tjerë, ku autori fabulën pothuaj tërësisht e ka eliminuar, në romanin për të cilin po bëjmë fjalë linjat e një fabule të futur në kornizat e një dioptrie të brendshme gjenden pikërisht në këtë rrëfimin e dytë për të cilin po flasim tani. Disi me marrjen frymë më lirisht këtu në këtë rrëfim auto-biografik arrihet të bëhet mbledhja e të gjitha rrëfimeve si të rrëfimitarëve anësorë ashtu edhe të gjitha rrëfimeve të ndryshëm të rrëfimitarit të gjithëdijsëm në një rrëfanë që është gjenetike. Të gjitha farët e tablove, imazheve dhe retorikave të ndryshme mblidhen shi në udhëtimin tonë metaforik dhe në udhëtimin tim të sintetizuar me një gjuhë të brendshme, kurse Ne dhe Unë këtu shkrihen në një të vetmen gjuhë që autori e ka përdorur. Si edhe në romanin latino-amerikan këtu bëhet përzierje rrëfimesh që plotësojnë njeri- tjetrin me qëllim që të zihet zëri i të vërtetës si të njeriut në vetminë e kozmosit, ashtu edhe të kozmosit që e ndrydh individin. Një lloj paralelizmi, që hetohet me personazhet e romanit Mbi heronjtë dhe varrezat të E. Sabatos siç janë Unë - Martini, Ardiana - Alehndra, Beltoi - Bruno, mësuesi Isë - Fernando, megjithatë nuk më jep të drejtë të them se Z. Rrahmarii është i ndikuar nga romani i lartpërmendur i E. Sabatos. Ndarja e romanit në tri pjesë që korrespondon brendapërbrenda rrëfimit të personazheve, nuk e dëshmon "mësimin" nga shkolla letrare e Sabatos sepse çdo lexues i thjeshtë do

të hetojë se Z. Rrahmani i modelon tjetërndryshe rrëfimet e tij. Megjithatë duhet thënë se këto coincidenca dhe sidomos gjuha me fjali të stërzgjatura e ka atë kuptim, pra se si edhe realitetet e ndryshme që ata i pasqyrojnë shkrimtarët, si atje ashtu edhe këtu, bëjnë të jenë ngapak identike, të gjejnë pika të përbashkëta ashtu si edhe orientimi për transformimin e rrëfimit e ka po atë kuptim. *Rrëfimi i gjithëdijshëm* i Z. Rrahmanit në romanin *Udhëtimi arbdhetar* është ndërkaq më i konkretizuar përkundër rrëfimeve të romaneve të tij paraprak, synimi që të ketë timbrin dhe lokacionin e vet autonom, shpesh merr konotime të një retorike biblike të mësuar nga stili borhesist, por edhe nga literatura tjetër nga letërsia e përbotshme.

Evokimi i kujtimeve fëmijërore dhe sidomos figura e më sue sit Isë, përbën një botë më vete që do të ndikojë për shumë çka në jetën e ardhshme të Unit të personazhit të paemërtuar, sidomos ekstravaganca e mësuesit Isë që aspiron lirinë e plotë shpirtërore dhe fizike, prandaj edhe sillet ashtu siç edhe mendon; në botën e brendshme të Unit do të ndikojë sidomos aspirimi i lirisë ideale personale të thvejë shumë tabu të krijuara në personalitetin e tij, sidomos në raportet intime me Ardianën, vashën e dashurisë së hershme. Novela e Andetit për Natyrën të shndërruar prej një vashe të re të moralshme në një grua të pjelcur lavire, përbën rrëfimin e personazhit anësor që në nëndijen e lexuesit duket se është rrëfim i Unit të rrëfimtari të gjithëdijshëm. E pagëzava novelë rrëfimin e Andetit për Natyrën, sepse në të vërtetë lexuesi i kujdesshëm këtij romani do të hetojë se aty gjendet një rrëfim i posaçm që mëton të thyejë dogmën për moralitetin e femrës së sanskionuar nga *Kanuni* i Lekë Dukagjinit dhe nga tre konfesionet shqiptare. Në rrëfimin e rrëfimtari të gjithëdijshëm shëtit një eksperimentim sa thjesht gjuhësor aq edhe etnopsikologjik:

"Më në fund ata ndodheshin thellë në pyll, larg e larg prej rrugës dhe me dhjetëra kilometra nuk ndodhej frymë njeriu.

Ndodheshin vetëm, në kohë të Kanunit. I fejuemi u ndal. (For, a ishte vonë athua?!)

- U lodhe? - e pyeti Andeti.
- Hemm, - murmuriti ai.
- Si të mos lodhem?!
- Rrimë këtu. - tha Andeti.

Ai qëndroi. Andeti lëshoi përmbi bar valixhen.

- Banu gatil - urdhëroi ai.¹

Edhe nga ky shembull flet nënteksti tjetër; shkrimtari me qëllim e shpie rrëfimin kah ky nëntekst; aty sikur dëshirohet të vihet në lojë

një normë etike shqiptare siç është nderi i gruas i koncipuar sipas kanunit, kurse përshkrimi në formë të një dialogu të mirëfilltë ku Uni i rrëfimitarit është tretur fare, ka të bëjë faktikisht për humbjen e nderit të burrit, siç është (poashtu sipas Kariurtit) marrja revolverit nga gruaja dhe drejtimi i tij kah ai. Megjithatë është interesant eksperimenti etnopsikologjik dhe gjuhësor që përshkruhet brenda faqeve 177-181 që e bën rrëfimtari me rastin e Andeti dhe të të fejuarit. Duke e marrë për shembull një fejesë në djep, një zakon popullor yni dhe duke e vënë në kontekst të aktualitetit, rrëfimtari i gjithëdijshëm përpos retorikës së bardhë dhe retorikës së fjalës së huaj në vetëdijen e tij, në zhvillimin e ngjarjes së fejesës në djep, fut mekanizma të ndryshme etnike dhe thjesht gjuhësore që do të ishin interesante për një etnolog dhe dialektolog. Duke e shënuar të njëjtin zakon në Kosovë, Maqedoni, në Malësi të Madhe, Lezhë, Berat, Piana dhe Çamëri dhe duke ua vënë në gojë (Andetit dhe të fejuarit) reagimet e ndryshme në formë dialogu, autori krijon edhe një tip të rrëfimit dialektor që është shumë mbresës.

Rrëfimi i *rrëfimitarit* të gjithëdijshëm ka gjithçka që nga realiteti i përditshëm e deri te realiteti imagjinar - kozmik të mbushulluar me një shtysë të brendshme kombëtare dhe më saktë me një shtysë të brendshme shqiptare të Veriut. Duke e koncipuar udhëtimin si udhëtim nëpër trojet shqiptare, aty gjen njeriu gjithçka - edhe histori, edhe gjuhë gjithëfarëshe (dialektizma, arkaizma), edhe etnologji, eseizim përrallor (*psh. n'doren tande* more Diell - nxjerrur nga epika legjendare, Martesa e Halilit), dashuri kombëtare, intimitet, erudicion, erotikë, rrëfime pagane, doke popullore, gjithçka që për lexuesin do të krijonte imazhin e imagjinatës sa reale po aq edhe kozmike, gjithëpërfshirëse. Ky rrëfim, le të më lejohet ta pagëzoj strukturalist (ky term synon të përfshijë tërësinë e llojeve të materies gjuhësore), mëton ta shënojë gjerësinë e elementeve, duke filluar nga empiria e krijuesit e deri te fjala e huaj, që d.m.th. tërësinë gjuhësore rrëfyese që e udhëheq dhe organizon Uni i rrëfimitarit nëpërmjet monologut të tij. Në këtë konglomerat rrëfimor në masë të madhe nëpër tërë faqet e romanit, ndërhyjnë mekanizmi i dialektizmave dhe të arkaizmave të ndryshme, të shpeshtën e rasteve atëbotë kur rrëfimtari ia jep fjalën personazheve sporadike, të rastit, po shpeshherë edhe me ngjyrimin emocional të zërit, ai e përdor atë gjuhë duke u munduar ta tipizojë ose thjesht ta dallojë dukshëm nga zëri njëtrajtësor i tij. Në kuadër të rrëfimit në fjalitë e stërzgjatura, që është karakteristikë e Z. Rrahmanit, shpeshherë në qëllimin rrëfimor ndërhyjnë qëllime të tjera parciale që nganjëherë mbeten vetëm të pre-

kur dhe semantikisht të porealizuar. Këputjet e rrëfimit dhe fragmentarizmi i kësolllojshëm i këtij romani janë të shpeshta dhe shndërrimi i temave brenda monologut të rrëfimitarit është karakteristikë e posaçme e tij. Përpos fragmentarizmit dhe shëtitjes nëpër tema të ndryshme, në fjalitë e gjata të rrëfimitarit ndërhyjnë mikrorrëfime të mëvetësishme që zgjojnë asociacione të veçanta nga largësia që janë të realizuar, sidomos në ato raste kur rrëfimtari është i përqendruar në rrëfimin qendror dhe kur rrëfimet sporadike janë fjali tipizuese dhe që nuk e rëndojnë lexuesin. Të këtilla janë p.sh. fjalitë e gjata kur ai rrëfen një ngjarje intime (p.sh. në kontaktet me Ardianën, Natyrën, Andetin etj.) dhe që këtu në bazë të kësaj, mund të thuhet se mikrorrëfimet e ndërtojnë në gro-plan fabulën e shkapërderdhur në këtë roman.

Literatura

1. Krasniqi, N. *Letërsia e Kosovës 1953-2000*. Prishtinë: AIKD. 2016.
2. Hamiti, S. *Letërsia Bashkëkohore, Vepra Letrare, 10*. Prishtinë: Faik Konica. 2002.
3. Krasniqi, N. "A/Z". *STUDIME: Revistë për studime filologjike*, numër 25. Prishtinë: ASHAK. 2019.
4. Hoxha, B. RËNIA E TË JASHTMES SË JETËS DHE VETËMBROJTJA NGA TËHUJSIMI. *STUDIME: Revistë për studime filologjike*, numër 25. Prishtinë: ASHAK. 2019.
5. Çitaku, M. SHESHI I UNAZËS - ROMAN ME PARABAZË FIGURËN". *STUDIME: Revistë për studime filologjike*, numër 25. Prishtinë: ASHAK. 2019.
6. Çitaku, M. *Romani simbolist i Kosovës*. *STUDIME: Revistë për studime filologjike*, numër 24. Prishtinë: ASHAK. 2018.

Rrahmani Z. *Ibidem* fq. 172, 3

~608~

⁴ *Ibidem* fq. nr. 211

⁵ *Ibidem* fq. nr. 238

⁶ *Ibidem* fq. nr. 169, 70, 71

Tomo Virk, Lublanë

LETËRSIA BASHKËKOHORE SLOVENE DHE ROLI SHOQËROR I SAJ

Nocioni "letërsia bashkëkohore sllovene" në dekadat e fundit gjithnjë e më vështirë po bëhet kapshëm. Ndërkohë që në vitet e pesëdhjeta të shekullit të kaluar çdo vit botoheshin pesë deri në dhjetë vepra origjinale letrare sllovene, në dy dekadat e fundit çdo vit botohen më se njëqind romane origjinale sllovene, e për përmbledhjet e prozës së shkurtër, poezisë pastaj botimeve të veprave dramatike në formë libri, autobiografive, udhëpërshkrimeve letrarë dhe të ditareve as të mos flasim. Pra, çdo vit një grumbull i pamatshëm i noviteteve letrare, që është vështirë - gati e pamundshme -t'i përmbledhim në formë të thukët, e të dukshme në një sintezë shkencore. E si, atëherë ta paraqesim në formë të kuptueshme literaturën bashkëkohore sllovene?

Si njëra nga zgjidhjet e mundshme na ofrohet shtjellimi i literaturës sllovene nga një këndvështrim i posaçëm, i përkufizuar, dhe kësaj mundësie do t'i qasem edhe unë. Literaturën bashkëkohore sllovene do të tentoj ta prezantoj nga këndvështrimi i rolit të saj shoqëror. Veçantia e rolit shoqëror të letërsisë bashkëkohore sllovene do të jetë mjaftueshëm i dukshëm vetëm ashtu që ta vendos në kontekst të rolit shoqëror të letërsisë sllovene që nga fillimet e saj e tutje. Në paragrafët hyrës fillimisht do të flas shkurtimisht mbi rolin tradicional shoqëror të letërsisë sllovene, që bashkëformëson në mënyrë vendimtare edhe vijat specifike të saj.

Literatura sllovene me shekuj të tërë ka qenë letërsi e popullit pa shtetësi vetjake të tij. Fakti se sllovenët një kohë aq të gjatë nuk kishim shtet tonin dhe institucionet e tij, ka shkaktuar, në mes tjerash, që një domethënie e rëndësi të ngritur në shekullin e 19. ka fituar kultura, e brenda saj, para së gjithash, literatura. Literatura sllovene ishte në shekullin 19. njëri nga mediat më të rëndësishme të vetëdijesimit kombëtar. Siç kanë konstatuar historianët udhëheqës të letërsisë, por edhe filozofët, kjo ishte pasojë e vogëlsisë së popullit slloven, që së paku në një të ardhme të afërt, nuk mund të premtonte krijimin e pavarësisë së vetë politike dhe shtetërore. Këtë mungesë, mungesën e shtetësisë me

të gjitha institucionet shtetërore e zëvendësonte literatura. Ky rol i rëndësishëm shoqëror - më mirë të them detyrë - që i takoi literaturës, e formësoi edhe pasqyrën klasike të saj. Udhërrëfyysi i parë i literaturës nuk ishte artistikja, por ishte roli i ruajtjes dhe konstituimit kombëtar i saj; shkrimtarët me veprën e vet fillimisht zgjonin vetëdijen kombëtare, e vetëm më vonë mund të ishin artiste. Kuptohet, kjo nuk do të thotë se literatura sllovene në kulmet e saj nuk kishte edhe artiste të vërtetë në nivelin evropian të cilësisë, p.sh. Franc Preshern dhe Ivan Cankarin. Por, edhe opusi i artistëve të tillë të mëdhenj përshkohej në mënyrë thelbësore me mendësinë kombëtare. Natyrisht se një gjë e tillë frenonte inovativitetia estetik, për çfarë literatura sllovene - me përjashtime të rralla - deri në shekullin 20 vononte në aspektin stilistik për disa dekada në krahasim me rrjedhat letrare evropiane (vonesa). Pamundësia e arritjes së sovranitetit nacional, formësoi në të njëkohësisht një strukturë mallëngjyese, të tillë si e zhvillonte romani tipik slloven me personazhin mallëngjyesh dhe me përbërje të brendshme lirike. Lloji themelor letrar ishte lirika, romane të vërteta shoqërore - për shkak të mungesës së bazës reale institucionale - gati që nuk kishte.

Letërsia tradicionale sllovene e ruajti rolin e vet konstitutiv kombëtar deri në fund të Luftës së Parë Botërore, madje edhe deri në fund të së dytës. Menjëherë pas Luftës së Parë Botërore u krijua "Shteti i Sllovenëve, Kroatëve dhe Serbëve" si krijesë njëmuje, që edhe përkundër sovranitetit të realizuar nacional, ishte tepër jetëshkurtër për ta plotësuar qëllimin e dhënë, ndërsa pasuesit e tij, Mbretëria SKS dhe Mbretëria e Jugosllavisë as përafërsisht nuk e zgjidhën çështjen kombëtare sllovene, por e lanë në statusin e projektit. Në rrethana të vështira të kushtetutës së Vidovdanit dhe diktaturës së mëvonshme të mbretit Aleksandër me kushtetutën e autorizuar, projekti i sovranitetit nacional mbeti edhe më tutje desiderat, që për shkak të ndryshueshmërisë së politikës sllovene dhe pragmatizmit të saj - shumica e partive, veçanërisht ato me drejtim të majtë, mbështesnin centralizmin jugosllav; madje edhe te vetë sllovenët nuk ishte i rrallë mendimi mbi një komb, kombin jugosllav, dhe tre fiset e tij - mbështetjen më të vazhdueshme të vetë ende e kishte në kulturë, posaçërisht në kulturën letrare. Shprehja më e artikuluar e kësaj ishte eseji i Josip Vidmarit, kryetarit të mëvonshëm të ASHAS, *Problemi kulturor i sllovenizmit*¹ i vitit 1932, që vërteton bindjen se thelbi i vërtetë i sllovenizmit ishte në kulturën, gjegjësisht letërsinë e tij. Ta pasqyroj me disa të dhëna, se sa ndikim dhe rëndësi kishte literatura për sllovenët gjatë tërë historisë kombëtare

¹ Kuhurni problem slovenstva, *vër. e përkth*

për shkak të rolit të saj komb-ruajtës dhe komb-konstitutiv. Gjatë Luftës së Dytë Botërore, së paku pesë brigada partizane, që e kuptonin luftën e vetë si nacionalçlirimtare, mbanin emrin e poetëve dhe shkrimtarëve. Kjo, kuptohet, ka pasur vlerë të madhe simbolike, gjë që shihet edhe nga fakti, që brigadat nuk emëroheshin sipas shkrimtarëve luftarakë, por kryesisht sipas lirikëve të ndjeshëm dhe pesimistë, që për letërsinë sllovene janë reprezentues. (Nëse kësaj ia shtoj edhe rastin anekdotik nga përvoja ime personale: në Jugosllavinë komuniste kazerma e APJ-së, ku kam qenë në shërbimin ushtarak, quhej - ashtu siç quhej edhe një brigadë partizane - Simon Gregorçiq; natyrisht jo për faktin se ishte meshtar, por që edhe *përkundër* faktit se ishte meshtar, për shkak se ishte *poet*.) Më tutje: festa kulturore nacionale sllovene i përkushtohet vetëm një artisti, poetit Presheren (edhe një argument, se në vetëdijen shoqërore sllovene pikërisht ai është figura simbolike nacionale); institucioni qendror kulturor slloven mban emrin e Ivan Cankar-it, ndonëse në të nuk mbisundojnë shfaqjet letrare dhe ndonëse në historinë tonë kemi artistë më zulumëmadh dhe më të njohur në fushat tjera; çmimi kombëtar për arritjet në (të gjitha) fushat e artit quhet Çmimi i Presherenit, pra, sipas poetit kombëtar, e gjithashtu edhe çmimi për punimin më të mirë të diplomës apo të magjistraturës në Universitetin e Lublanës, pavarësisht nga fusha (këtu mund të hyjë edhe veterinaria dhe prodhimtaria ushqimore, për shembull). Edhe himni kombëtar, tekst ky si gjysmë sakral është poezi e poetit të sakralizuar kombëtar, më të madhit që e kemi (dhe kjo assesi nuk është karakteristikë e përgjithshme e himneve, por më parë një përjashtim i rrallë). Në këtë sërë bën pjesë edhe përdorimi i miteve letrare si argument në luftën politike; citatet e Presheren-it, Cankar-it dhe literateve të tjerë të kanonizuar, ishin gjatë të gjitha periudhave, dhe janë edhe sot jo vetëm moto të fjalimeve festive të personaliteteve më me ndikim shtetëror, por edhe parulla luftarake të partive politike. Dhe, jo në fund, në këtë kontekst të rëndësisë së madhe kombëtare dhe shoqërore të literaturës është edhe e ashtuquajtura "kushtetuta e shkrimtarëve", kushtetuta e parë e Sllovenisë së pavarur, që e kanë bashkë-krijuar shkrimtarët, pastaj një rol padyshim i rëndësishëm (konflikti zhvillohet vetëm për sasinë e madhësisë së pjesëmarrjes) që kanë luajtur shkrimtarët drejtpërdrejt në procesin politik të demokratizimit dhe pavarësisë nacionale, pra në përfitimin e shtetësisë, e edhe fama ende e madhe ndër të huajt, që mund të gjendet edhe në manualët turistike - kuptohet, bëhet fjalë për stereotip, por edhe kjo vlen -, se jemi komb i poetëve.

Ky rol tradicional shoqëror i literaturës, i lidhur me vetëdijen kombëtare, pas Luftës së Dytë Botërore është modifikuar paksa. Nuk është shuar plotësisht, por është zhvendosur në prapavijë, ndërsa në vendin e saj ka ardhur (dhe pjesërisht është ndërthurur me të) funksioni tjetër dominues shoqëror. Literatura sllovene pas vitit 1945 e deri te ndryshimet dramatike politike të sistemit dhe pavarësimit, më 1991, ka luajtur rol jashtëzakonisht të rëndësishëm shoqëror me faktin se ka shpalosur hapësirën e lirisë shpirtërore dhe asaj të mendimit dhe që në diskursin publik i ka futur temat e ndaluara si dhe ka problematizuar historinë zyrtare, ideologjikisht të kufizuar. Shkrimtarët, kështu, u janë rrekur vrasjeve brutale të pas luftës të kundërshtarëve të komunizmit, versionit slloven të proceseve staliniste, problematikën e Informbyrosë, Goli otokut etj. Vetëm për ilustrim të rolit të ri shoqëror të literaturës, po i cek fjalët e historianit me autoritet, profesorit të universitetit dhe akademikut Bogo Grafenauer, që i ka shkruar në gjysmën e parë të viteve të tetëdhjeta:

Kam konstatuar se historia bashkëkohore në të gjithë shtetet e »Ilagerit« dhe këtu te ne përfundon me vitin 1945. Disa herë kam tërheq vërejtjen në rrethin e historianëve se historiografia që nga konstituimi i saj e deri më sot askurrë nuk ka ngecur më shumë pas së vërtetës historike. Këtu bëhet fjalë për një ligjësi, pasi karakteristikë e njëjtë vlen për të gjithë shtetet socialiste [...] Dhe kam shtruar tezën [...] se shkak për këtë gjendje jashtëzakonisht të dëmshme [...] është fakti se historiografia e historisë bashkëkohore ende nuk disponon me atë lirinë, që — së paku tani - e ka përfituar literatura.

Ose, siç ka konstatuar historiani tjetër: "Liria artistike u ka lejuar letrarëve që të flasin për mëkatet e pushtetarëve më shpejtë dhe në mënyrë më të hapur se historianët, që kanë qenë të shkëputur nga kushti thelbësor për hulumtimin e së kaluarës, burimet arkivore." Kështu, literatura, në një periudhë ka qenë alternative e pastër e regjimit njëpartiak ekzistues, alternative, që dalë-ngadalë është shndërruar edhe në realitet të prekshëm politik: dy prodhimet finale në masën më të madhe të përpjekjeve letrare (ndonëse kuptohet jo vetëm të atyre) ishin vendosja e shoqërisë politikisht dhe ideologjikisht pluraliste, demokratike, si dhe pavarësimi në vitet 1989 deri në 1991. Në këtë mënyrë, literatura sërish ka luajtur rol të jashtëzakonshëm, rol gati të pazëvendësueshëm shoqëror.

Për vitet e nëntëdhjeta të shekullit të kaluar, do të thotë, për dekadën e parë të Sllovenisë vërtetë të pavarur dhe sovranë, kur, të më lejohet të përdor shprehjen tradicionale, populli slloven si i tillë për herë

të parë është realizuar në tërësi si nacion, pra edhe si shtet, është karakteristik kërkimi i theksuar i sfidave të reja individuale dhe estetike. Tensioni shoqëror kritik i literaturës zhvendoset në prapaskenë, gjë që është e kuptueshme, ngase literaturës nuk i duhet më të kompensojë as mungesën e sovranitetit nacional dhe as mungesën e pluralizmit demokratik, politik, ideor dhe të mendimit.

Mirëpo, pas vitit 2000, shoqëria sllovene filloi të ballafaqohet me sfida të reja. Në mesin e tyre është anëtarësimi në Bashkimin Evropian, në NATO dhe në organizata tjera ndërkombëtare, futja e euros, kriza ekonomike botërore e vitit 2008, anomalitë e kapitalizmit liberal, problemi i migrimëve etj. Pas një dekade përgjumjeje, kultura letrare sllovene përsëri ndien nevojën për një rol të shprehur shoqëror. Për një gjë të tillë, me siguri nuk e kanë nxitur vetëm sfidat e reja të kufizuara shoqërore, por edhe marginalizimi gjithëpërfshirës shoqëror i literatures. Ndërkohë që në dy periudhat e përparshme, për shkak të rolit të vet të pazëvendësueshëm shoqëror, në mesin e sllovenëve gëzonte autoritet të padiskutueshëm dhe gjithashtu kishte rolin e autoritetit moral, në rrethanat e reja shoqërore të ekonomisë së tregut dhe të kapitalizmit liberal, ky ishte ndryshuar dukshëm. Hiperproduksioni letrar, të cilin e ceka që në fillim të kësaj ligjërate, assesi nuk është tregues i prosperitetit shoqëror të literaturës bashkëkohore sllovene, por më parë qëndron e kundërta, simptoma e marginalizimit të saj, apo me shprehje pak më të egër: paraqitja e inflacionit si e vlerës estetike, ashtu edhe rëndësisë shoqërore e literaturës. Nëse literatura në dy periudhat e para e kishte rolin e vet shoqëror, por edhe efektet thjeshtë konkrete shoqërore, në periudhën e fundit ndodh e kundërta. Literatura edhe më tutje - e madje në mënyrë më të prerë dhe më programore se përpara - hap temat qendrore të patologjisë bashkëkohore shoqërore. Mirëpo, këtu ekziston një rrethanë, që ia parandalon kulturës letrare, të jetë aq e rëndësishme sa ç'ishte para vitit 1990. Literatura nuk *zbulon* patologjinë e vërtetë shoqërore, ashtu siç bënte ajo gjatë regjimit komunist, por pak a shumë të gjitha anomalitë shoqërore dhe ekonomike (lokale dhe globale) para saj i kishin njohur dhe artikuluar mjaft qartësisht mediat, organizatat joqeveritare, publicisten me ndikim, shoqëria civile, e madje edhe vet politika. Literatura gjatë shqyrtimit të këtyre temave (devijimet e kapitalizmit liberal, dobësitë e demokracisë parlamentare, problematika e shtetësisë së pjesëtarëve të kombeve të tjera nga territori i ish RFSJ, që pas pavarësisht mbeten pa shtetësi, në përgjithësi raporti ndaj këtyre kombeve, ksenofobia, homofobia e tj.) nuk është çështje pioniere por as nuk ofron shikim përmbajtësisht të ri në to, por mesazhi i tyre më së

shpeshti është në pajtim me politikën e deklaruar (nëse jo të qeverisë, së paku të opozitës). Thënë shkurt, te të gjitha këto probleme literatura tërheq vërejtje në ato këndvështrime, për të cilat që përpara kanë shkruar gjerësisht mediat, e shumë shpesh ishin - duke dhënë edhe zgjidhje, gjegjësisht propozime për zgjidhje - edhe debate parlamentare.

Gjithë kjo që u tha më sipër nuk do të thotë, se në letërsinë sllovene nuk kemi krijime artistike, por vetëm po tërheq vëmendjen për rënien e rolit të saj shoqëror. Ndërsa roli i saj në periudhat e përparshme historike ishte i pakontestueshëm, kultura bashkëkohore letrare sllovene në periudhën e margjinalizimit të saj shoqëror duhet ta ri-definojë atë. Thënë ndryshe: duhet të gjejë një argument të përshtatshëm në rrethanat e realitetit slloven të kohës, që nuk janë aq favorizuese për të, pse është ende e rëndësishme për shoqërinë.

Kaq për perspektivën zhvillimore. Për të mos mbetur te kjo pasqyrë e përgjithshme, paksa abstrakte, të zhvillimit të rolit shoqëror të letërsisë sllovene, për në fund do të cek edhe disa shembuj reprezentues të prodhimit bashkëkohor letrar slloven. Pavarësisht nga ajo që thash më sipër për rolin shoqëror të letërsisë bashkëkohore sllovene, për margjinalizimin e saj, të shtoj se veprat më të mira të letërsisë bashkëkohore sllovene janë artistikisht kualitative. Këtë kulm të cilësisë e formësojnë për shembull - t'i numëroj vetëm ata që janë gjallë dhe që krijojnë - akademikët Niko Grafenauer, Millan Jesih, Millan Dekleva, Boris A. Novak, Zorko

Simçiç, Drago Jançar, Maja Haderlap, e përpos tyre edhe Feri Llainshček, Katarina Marinçiç, Urosh Zupan, Jani Virk, Matjazh Zhupançiç, Simona Semençiç, Jasmin B. Frelih, Primozh Čučnik- dhe një varg i tërë të gjatë vërtet i mirë i shkrimtareve dhe shkrimtarëve bashkëkohorë, emrat e të cilëve do të mund t'i numëroja. Mirëpo, vetëm renditja e emrave, kuptohet, nuk thotë shumë, për atë arsye më me vullnet do ta bëj një seleksionim aspak falënderues dhe nga secili lloj i letërsisë të përmend vetëm nga një dukuri shkrimtari, që formëson dhe shënjon në mënyrë vendimtare territorin letrar bashkëkohor slloven.

Do të filloj me dramatikën. Drama bashkëkohore sllovene gati kryekëput është e orientuar kah kritika shoqërore. Edhe klasikët modernë të letërsisë sllovene, siç janë për shembull akademikët Jançar dhe Novak, në veprat e tyre, sipas formës tradicionale ballafaqohen me temat aktuale shoqërore dhe politike. Për këtë arsye, drama duket edhe më posaçërisht e përshtatshme dhe se shkrimtarët e njohur të gjeneratës

së mesme dhe të vjetër e shfrytëzojnë së forti. Mirëpo, krahas kësaj klasike, ekzistojnë edhe trendët modernë. Ndoshta shembulli më i shprehur dhe kumbues i dramatikës sllovene është, në këtë aspekt, autorja e re e dramës sllovene Simona Semeniç, që i ka dhënë lamtumirën tradicionales dhe formave më të kapshme për publikun klasik dhe i është përkushtuar teatrit të ashtuquajtur post-dramë, me një kritikë jashtëzakonisht të shprehur shoqërore, madje edhe politike. Temat e dramave të saj kanë ngjyrosje të dhunës politike në përgjithësi, për shembull në regjimet totalitare, dhunës mbi femrat, anashkalimin shoqëror e të ngjashme, por ballafaqohet edhe me problematikat politike sllovene. Për aq më tepër, shënjestër e kritikës së saj është orientimi saktësisht i caktuar politik. Forma e post-dramës, që nuk lodhet aq për tekstin, që i shmanget mimetizmit tradicional, që jep liri më të gjerë qasjes regjisoriale, dhe që në mënyrë aktive, në formën e performansit, kyç edhe publikun dhe e nxit atë në bashkëveprimin aktiv gjatë shfaqjes, madje, deri në bashkautorësi, për shkak të spontanitetit të vetë duket tejet e përshtatshme pikërisht për tematizimin e temave aktuale politike. Mirëpo, një gjë e tillë - e kjo vlen edhe për dramën e Simona Semeniçit së paku në hapësirën bashkëkohore kulturore sllovene, haset me dy vështirësi. Përkundër letërsisë shoqërore - kritike, që është krijuar gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe gjatë pavarësimin slloven, nuk hap tema të heshtura politike, së paku këndvështrime të reja politike ndryshe, por vetëm reprodikon përmbajtje, që i kanë shtjelluar përpara edhe mediat tradicionale dhe bashkëkohore, mediat elektronike e madje edhe debatet parlamentare. Pasi dramën e Simona Semeniç, në rrethanat e pluralizmit dhe botëkuptimit politik, janë jashtëzakonisht të njëanshme dhe i drejtohen një pjese të publikut, ato nuk arrijnë atë universalizmin dhe pakohshmërinë, që janë karakteristike për dramën më të mira klasike. Shkakut tjetër, se pse ndikimi i këtij teatri është i kufizuar vetëm në një grusht njerëz, është natyrisht forma post-dramë, që shumë adhurues të teatrit klasik paksa i huton. Pra, dramën politike të Simona Semeniçit janë të gjetura dhe cilësore, por ndikimi i tyre jashtë një rrethi të ngushtë të ekspertëve dhe adhuruesve është tejet i vogël.

Jehonë më të madhe ka poezia sllovene. Ajo veçanërisht ballafaqohet me marginalizimin shoqëror dhe tenton të kacafytet me të në mënyra të ndryshme, në mes tjerash edhe ashtu që është shumë shpesh, por jo gjithmonë, jashtëzakonisht kritike në aspektin shoqëror dhe politik - që në poezi parimisht ndodh më rrallë se në dramë dhe prozë. Ndërkaq autoriteti i saj në mesin e lexuesve bazohet - për fat të mirë, do të mund të thoshim - në fuqinë e saj artistike, e jo në porositë

eventuale ideologjike a politike, për ç'gjë në kushtet e demokracisë parlamentare vështirë mund të garojë me mundësitë tjera shprehëse. Kështu, me krijimet e tyre lirike "klasikët modernë" ende më së shumti i përfitojnë lexuesit, të themi për shembull akademikët Jesih, Dekleva, Grafenauer, Novak, por edhe disa krijues të rinj, siç janë Urosh Zupan, Primozh Čučnik, Jure Jakob ose Anja Golob. Dukuria, do të thosha ngjarja më e shprehur e poezisë bashkëkohore sllovene është vepra monumentale, eposi në rimë në tri pjesë i akademikut Boris A. Novak *Vrata nepovrata* (Dera e moskthimit), që është e jashtëzakonshme si për nga këndvështrimi i shprehjes (fjalëpërzgjedhjes), pra formës poetike, ashtu edhe ai përmbajtjesor, pra i porosisë.

Vrata nepovrata (Zemljevidi domotozja, 2014), *Cas ocetov* (2015), *Bivalisca dus* (2017), *Dera e moskthimit* (*Hartat e nostalgjisë*, 2014), *Koha e etërve* (2015), *Vendbanimet e shpirtrave* (2017) paraqesin hibrid fatlum të poezisë, madje lirikës së pastër, dhe traditës rrëfimore epike. Të tri pjesët e kanë secila fillin e vet të kuq; në të parën është toposi arketipik i rrugëtimit (edhe rrëfimi, kuptohet, është rrugëtim), në të dytën kataklizmat luftarake të shekullit 20, ndërsa në të tretën, siç thotë vet autori, dashuritë e tij. Në këtë krijimtari voluminoze poetike, që në shumë gjëra gjen mostër te Dante (ndonëse lidhjet ndërmjet fjalëve arrijnë shumë më gjerë, që nga antika e tutje deri në sagat isllandeze dhe *Parajsës së humbur të* Miltonit, për shembull), Novaku rrëfen sagën familjare të të afërmeve të vetë, e njëkohësisht edhe historinë e përgjakur të shekullit 20. Që nga fillimi i pjesës së parë e tutje, ku poeti përmes rimës domethënëse "Ante" - "Dante" fut babin e vet Anten si udhëheqës shpirtëror nëpër labirintet e *Komedisë njerëzore*, e deri te vargjet e fundit të librit të tretë, që për nga kjo është shumë më intensiv, me shkëputje dhe kapërcime, ndërsa kah fundi gjithnjë e më ngjeshur shtrihen temat e dashurisë, miqësisë, bashkëjetesës dhe afërsisë shpirtërore, por edhe të faljes dhe pajtimit. Krahas këtyre fijeve tematike, në ep gjendet, kuptohet, edhe një antologji e vërtetë e temave të nxehta, të amshueshme, gjysmë të kaluara apo aktuale të kritikës shoqërore, atyre politike dhe ideologjike, më së shpeshti drejtpërdrejt, e nganjëherë me ndërmjetësimin e, para së gjithave, mitologjisë greke (që për Novakun ishte mjet transportues për pasqyrimin e problematikës aktuale që në dramën *Kasandra*). Novaku, kështu i tematizon "kapitujt e zgjedhur" nga Lufta e Dytë Botërore (që lidhen veçanërisht me anëtarët e familjes së tij), larjen e ndërsjellët partiake të hesapeve dhe likuidimet ndërmjet dy luftërash, solidaritetin dhe guximin e partizanëve, vrasjet masive të pasluftës të domobranëve,

ndërtimin e atdheut të ri, Goli otokun. Temë e fuqishme është edhe lufta e mëvonshme e Bosnjës, me valën e parë të madhe të refugjatëve, ndërkaq epi i Novakut prek edhe luftën në Irak, Afganistan, Libi, Siri dhe krizat e refugjatëve të lidhura me to. Ankthit të njerëzve në Sarajevën e rrethuar (si edhe në dramën e Novakut *Kassandra* ashtu edhe në *Dera e moskthimit*, ndërmjetësues poetik është *Iliada* e Homerit me rrethimin e Trojës) u bashkëngjiten ankthet e refugjatëve të sotëm, kritika e islamofobisë dhe mediave si bashkëfajtorë edhe për viktimat masive, para së gjithash në mesin e civilëve, etj. Në listë, në të cilën drejtohet gishti i pamëshirshëm kritik i Novakut, gjendet edhe Sllovenia aktuale, shteti i vogël në "skaj të Ferrit", i vogël, i vockël, atavist, me banorë që janë proverbialisht keqdashës dhe inatçinj, të pangopshëm për të mirat materiale, jo mikpritës dhe ngatërrestarë, ideologjikisht të përçarë, për ç' arsye edhe atdheu i tyre sot është *panoramë sentimentale bidermajeriane* dhe *banana republikë* kiç. Sidoqoftë epi nuk përmbillet me këto tone kritike dhe pesimiste. Libri i tretë, që u kushtohet shpirtit të dashurisë përmbillet me mendimin gati religjioz, panteist (apo ndoshta budist; apo Niçean?) mbi botën si karusel të amshueshëm, në të cilin ulemi kur dalim për *Dere*, që tani nuk është më derë e moskthimit.

Epi i Novakut është jo vetëm vepër unike poetike (në gjuhën sllovene, e me siguri edhe në përmasa globale), por për opinionin slloven gjithnjë e më të shkujdesur ndaj poezisë, është *ngjarje*, që është bërë mediatike. Asnjë vepër tjetër poetike sllovene në këtë periudhë nuk ka përjetuar aq vëmendje mediatike por edhe profesioniste dhe (padyshim) të lexuesve.

Për shkak të vet natyrës së llojit letrar, vëmendjen më të gjerë të lexuesve ende e merr romani. Në fakt, ky për shkak të formës së vet përfshin në mënyrë më të tërësishme tematikën e ekzistencialen personale, por edhe më gjerë, atë shoqërore, historike. Përpos kësaj, romanet e suksesshëm nganjëherë i zhvendosin në formën e skenimit, qoftë ajo teatrore apo filmike, dhe një këtë mënyrë tërheqin vëmendjen në mënyrë më të vazhdueshme sesa llojet e tjera letrare.

Romani bashkëkohor slloven përfshin, në të vërtetë të gjitha temat kritike shoqërore të literaturës bashkëkohore sllovene dhe, shikuar në tërësi, në aspektin ideologjik është më së shumti pluralist, gjithsesi më shumë se dramatika, që në diapazonin politik - përpos përjashtimeve të rralla - është shumë më e njëanshme, deri në një masë madje edhe shprehje e njëmendësisë. Vetëm në roman, vërtet rrëfohen perspektiva dhe vështrime të ndryshme të ndonjë teme tradicionale, apo aktuale të

shoqërisë sllovene, për shembull edhe ajo që sllovenët edhe sot na përçan më së shumti: Lufta e Dytë Botërore, që në Slloveni ishte jo vetëm luftë nacionalçlirimtare dhe luftë kundër okupatorit, por edhe luftë qytetare me revolucionin komunist, kontrarevolucionin, kolaboracionin, ployën vëllavrasëse etj. E gjitha kjo tërësi në dy dekadat e fundit është bërë temë e romaneve të autoreve dhe autorëve të famshëm sllovenë. Nëse i numërojmë, ata janë *Saga mbi valixhen* (2003) e Nedelka Pirjevec, *Druri pa emër* (2008), *Atë natë e pashë* (2010) dhe *Dhe dashuria gjithashtu* (2017) të akademik Drago Jançar, *Vrasja e gjarprit* (2009) e Jozhe Snoj, *Në mesditë vallëzojnë çizmet* (2011), Zdenko Kordiç, *Engjëlli i harresës* (2012) e akademike Maja Haderlap, *Të kisha frikë?* (2012) e Marusha Krese, *Vëllezërit e dhjetë të fundit* (2012) e akademik Zorko Simçiç, *Klithje pa jehonë* (2015) Marijana Eiletz, *E shkuara tjetër* (2017) e Vinko Moderdorfer, *Shtylla korintase* (2017), e akademikut tanimë të ndjerë Allojz Rebullla dhe *Ivana para detit* (2019) e Veronika Simoniti.

Vija e përbashkët (përpos temës, me siguri e vetmja e përbashkët) e veprave të cekura është, para së gjithash, ajo që pak a shumë të gjithë dëshirojnë të anashkalojnë skemën e ashpër ideologjike, që e përçaktonte këtë zhanr deri në vitet e tetëdhjeta të shekullit të kaluar. Dhe këtu, pak a shumë përfundon gjëja ku ata pajtohen. Pasi që, jo vetëm se kanë sukses të ndryshëm, por (përkundër tentimit për "objektivizëm", paanshmëri dhe neutralitet) marrin qëndrime të ndryshme të këndvështrimit (apo madje edhe ideologjike). Vetëm të rrallët ia arrijnë deri te jo ngar-kesa ideologjike.

Në mes të atyre të rrallëve bën pjesë edhe akademiku Drago Jançar, që është marrë me këtë temë disa herë, madje nga perspektiva të ndryshme. Këtu do ta paraqes krejt shkurt romanin e tij *Atë natë e pashë*, jo vetëm për faktin se është një vepër kulmore artistike, por edhe për shkak të reflektimeve për të, që prapëseprapë tregojnë në lidhje ende të ngushtë të literaturës dhe shoqërisë sllovene. Jançari në këtë roman tregon fatin e vërtetë të bashkëshortëve Hribar, pronarëve të kështjellës Strmoll, afaristëve, që gjatë luftës (për shkaqe afariste) janë shoqëruar me gjermanët, por që njëkohësisht fshehtazi kanë ndihmuar edhe partizanët, madje edhe të burgosurve të gestapos. Kanë përfunduar tragjikisht, likuiduesit komunistë të partizanëve, para përfundimit të luftës, pa kurrfarë shkakut të bazuar, i kanë ekzekutuar në mënyrë brutale. Të gjitha këto janë fakte të pamohueshme historike, prej të cilave Jançari nxjerr rrëfimin e vet. Ngjarjet luftarake në roman janë vetëm pra-

paskenë kronotopike, ku Jançari vizaton "obsesionin" e vet të shkrimtarit, të treguar para kësaj edhe në shumë novela e romane të tjerë: fatin e papritur dhe të pakapshëm (historikisht), që sajton jeta e individit - në këtë rast personazhit Veronikës, "që dëshiron vetëm të jetojë", por që rrethanat e ashpra historike ia ndalojnë këtë. Jançari mundohet shumë që romani të mos tingëllojë ideologjikisht. Në mes tjerash i fut edhe pesë perspektiva të ndryshme të rrëfimit, që zbardhin ngjarjen, secila nga këndvështrimi i vet dhe fitohet bindja, se këtu ia arrin. Siç shënon historiani i letërsisë, Matevzh Kos, Jançari nuk mbështet, gjegjësisht nuk privilegjon asnjërën prej palëve, të futura gjatë luftës në konflikt vëllavrasës. Nuk e intereson perspektiva e fituesve *apo* perspektiva e të mundurve, por e gjitha ajo që, në tregimet e mëdha historike, zakonisht heshtet: fati i individëve, nxitjet që orientojnë, ngatërrojnë dhe japin zgjidhje jetës së protagonistëve, të gjuajtur në rrjedhën e pandalshme të historisë.

Edhe përkundër kësaj romani ishte edhe pjesë e shumë reflektive ideologjike. Shumica e lexuesve profesionistë e kuptoi drejt poentën e Jançarit; madje romani u vlerësua për romanin më të mirë të vitit. Mirëpo, edhe te profesionistët, edhe te lexuesit e thjeshtë u paraqiten lexime rreptësisht ideologjike: disa e kuptuan romanin si demaskim i krimeve komuniste dhe të partizanëve gjatë luftës, të tjerët si atak mbi "të arriturat e LNÇ-së dhe revolucionit", nëse e përdor sintagmën e harxhuar nga koha e komunizmit, gjegjësisht - pasi që prapaskena dokumentuese nuk mund të mohohej - si moskuptim i thelbit të vërtetë të luftës partizane dhe etikës së saj nën maskën e humanizmit abstrakt. Kështu, "revizionistët" si "fuqi e vazhdimësisë" me këtë rast e gabuan plotësisht intencën dhe thelbin e romanit, dhe në këtë mënyrë me efektin e vet i ndihmuan romanit ta shpërfaqë gjendjen aktuale të shoqërisë sllovene, të përçarë rreptë dhe papajtueshëm në dy pole ideologjike. (Ndoshta për shkak të këtij moskuptimi Jançarit iu desh të shkruajë edhe romanin "në mes" *Dhe dashuria gjithashtu* që jep më pak baza për vërejtje të tilla, përndryshe të paarsyeshme.)

Mesiguri, pikërisht shqetësimi i shkaktuar nga romani i Jançarit, vitet e ardhshme ka nxitur produksionin e përshpejtuar të romaneve sllovenë me temë Luftën e Dytë Botërore. *Të kisha frikë?* i Marusha Kresesë në fakt nuk korrespondon në mënyrë eksplicite me Jançarin, por në mënyrë autoritare vendos të vërtetën "e saktë" mbi ngjarjet gjatë luftës (pra, atë që Jançari nuk dëshironte ta bënte), në mënyrë të njohur me një diskurs të afërt të ndjenjave dhe me retorikën e sinqertë dhe të përkushtuar që u drejtohet lexuesve (bashkëmendimtarëve ideologjikë)

në mënyrë të fuqishme dhe bindëse. - Më dukshëm me romanin e Jançarit lidhet në mënyrë polemike Moderdorferi me *E shkuara tjetër*, që paraqet përcaktim të ngjashëm ideologjik si edhe romani i Martusha Kresesë. Në roman, Marusha Krese në mënyrë të qartë dhe pa kompromis (madje edhe paksa ashpër) i akuzoi palën e kundërt nga ajo partizane, bashkë me pasardhësit e tyre, ndërkaq Moderdorferi, nëse poentoi pakëz ashpër, edhe ata që në kohën e luftës dëshironin "vetëm të jetonin" i vendos në anën e armikut, okupatorit dhe në atë mënyrë, ngjashëm me Marusha Kresene, polemizon fshehtëazi me veprën artistike të Jançarit.

Romanin e Jançarit dhe fatin e tij nuk e zgjedha krejt rastësisht për këtë vështrim. Pasqyra ime e zhvillimit të rolit shoqëror të literatures sllovene ka treguar se literatura bashkëkohore sllovene ende kërkon vendin e vet në shoqëri, e cila për të nuk lodhet më aq sa në të kaluarën. Ndërkaq, romani i Jançarit tregon njëherë nga mundësitë se si të definohet ky rol. Roli shoqëror i letërsisë bashkëkohore sllovene nuk është më në nxitjen, ndërtimin dhe ruajtjen e vetëdijes dhe identitetit kombëtar, as në kompensimin e mungesës së pluralizmit politik, ideor dhe të mendimit; por do të mund ta formulonim ashtu që letërsia ia vendos pasqyrën patologjisë së shoqërisë bashkëkohore sllovene. Këtë përmasë, kuptohet, letërsia e ka pasur edhe më parë, por vetëm sot duket se do të mund ta merrte vendin e rolit të saj qendror shoqëror

Përktheu: Nikollë Berishaj

Kujtim M. Shala, Prishtinë

TRINGA E FISHTËS

Abstrakt

Këngët për Tringën, heroinën e imagjinuar të Gjergj Fishtës, janë nga më të bukurat e *Lahutës së Malcís* (1937), me natyrë epike, me drama dhe me tregime fantastike. Cikël i rrëfimit të moralitetit tipik të vendit, trimërisë dhe të sakrificës për nderin personal, të cilin Fishta e projektton si nder nacional. Vargut të heronjve epikë të Fishtës i bashkohet Tringa, e portretizuar me atributet e pastërtisë morale krishtere dhe të burrërisë shqiptare. Tringa shëmbëllen me Shën Mërinë, pastaj me motrën tradicionale shqiptare, që jep jetën për vëllain, si dhe me heroinën që mbron nderin, në shembullin e burrave të malësisë. Secili ka nderin e vet, qoftë burrë apo grua, nder që përshkruhet në termat e njohur ambientale, të lidhur me moralitetin e jetës së gjallë, që në trajtë diskursive i jep *Kanuni i Lekë Dukagjinit*. Bota e Kanunit, e moralitetit dhe e sakrificës, shoqërohet nga besimi ambiental në një botë fantastike, me qenie mitologjike, me orë dhe zana, që mbrojnë vendin dhe personazhet. Por figura që mbizotëron është ajo e Tringës, e imagjinuar dhe ndërtuar fund e krye nga autori, për të dhënë veprimin heroik, bazën morale të veprimit dhe projeksinin ideologjik se: kush mbron nderin e vet, mbron atdheun.

I

CIKLI

Cikli i Tringës, në botimin e plotë të *Lahutës së Malcís*, të vitit 1937, është i pesti; nis me këngën e njëzetë e dytë dhe mbyllet me të njëzet e pestën, ndërsa kënga e njëzet e gjashtë, e titulluar *Koha e ré*, e lidh këtë cikël dhe gjithë ngjarjet e epokës së Lidhjes së Prizrenit me ciklin e gjashtë dhe të fundit të veprës, me tematikë ngjarje të fillimit të shekullit XX. Këtë cikël e përbëjnë këngët: *Tringa, Ke Tbanat e Curr Ulës, Zana e Vizitorit dhe Gjaku i Marrun*. Ky cikël tematik kap kohën historike të Betejës së Nokshiqit që vjen para *kohës së ré*, asaj të pavarësimit të Shqipërisë. Është cikël që e shënjon akti heroik i Tringës, vazhdon me rënien e saj, me vajin për të dhe mbyllet me këngën e lumturisë së Zanës së Madhe të shqiptarëve, pasi ajo ka marrë gjak për Tringën e vrarë nga malaziasit dhe pasi shqiptarët kanë fituar Betejën e Nokshiqit.

Fishta betejat dhe fitoret e shqiptarëve i këndon me shembujt e heronjve, me shembujt e tyre personalë, gjithnjë si një dëshmi letrare, prandaj dhe si mësim letrar. Shembujt e këtij cikli, përpos dëshmi të nderit personal dhe të fisit, si te rasti i Tringes, heroinës së ciklit, janë edhe shembuj të ngjyrosur me politikën e kombit, ashtu siç atë e konceptonte Fishta, të lidhur me jetën autentike shqiptare, prandaj të lidhur me jetën e malësorëve, të cilët nderin e tyre tashmë e lidhin me nderin e vendit, të *Ámtes*, si një cilësim politik. Vërtet, ky është një projektion ideologjik/politik i Fishtës, kështu që veprimet e personazheve të tij bëhen shembuj konkretizimi të ideologjisë së autorit. Me shembuj Fishta e jep mësimin më mirë e më bukur.

Nuk dij çka me thanë. Gjatë rinisë sime kamë pyetë e stërpyetë mbí kët episod heroik aq të bukur, por kurr nuk kam marrë përgjegjen as po as jo. Ndoshta ndoshta krejt ky cikël áshnt ndërtue nga poeti në ngjasim të legjendës madhshtore të motrës së Gjergj Elez Alisë, për me u tregue shqiptarëve se nderi personal áshnt nderi i fisit e i kombit.¹

Ky nënvizim i Zef Pllumit, i vetmi për këtë cikël në interpretimin e tij për *Lahutën e Malcís*, shënjon modelin e supozuar të ciklit, legjendën e motrës së Gjergj Elez Alisë, dhe synimin për të treguar se nderi personal është dhe nder i kolektivitetit, i fisit, në trajtën e manifestimit autentik të tij, apo nder i kombit, kur veprimet marrin ngjyrimet e vetëdije politike. Vërtet, modeli i tillë poetik, tematika dhe mësimi që jep ky cikël përputhen si *kushte* të gjinisë letrare të veprës. Tringa është dhe motra e tipit tradicional, Tringa është heroina që flijohet për vëllain, ndërsa veprimi i saj mund të këndohet vetëm si një ngjarje heroike. Ky, vërtet, është modeli bazik poetik i veprës së Fishtës, sidomos i këngëve që kanë shtresime legjendare. Dilema e Pllumit ka të bëjë jo me ngjashmëritë e këtij “episodi heroik”² me Këngën e Gjergj Elez Alisë, por me largesat, për shkak të dorës së fortë të Fishtës, dorë në të cilën modeli mbetet nën hije, ndërsa mbizotëron shenja poetike e tij si *krijues*.

Në kuptimin strukturor, ciklin e Tringës cikël të pestë të *Lahutës së Malcís* e bën tematika e tij dhe kronologjia/vendosja historike e ngjarjes themelore që rrëfëhet e që është Beteja e Nokshiqit. Kjo ngjarje rrëfëhet me fantazi, mbështillet me mitologji e jepet si poezi. Këto janë vetitë që e përcaktojnë ciklin, me theksim të referencës historike, me mbitheksim të fantazisë si krijim autorial dhe artikulum të mitologjisë,

¹ Át Zef Pllumi O.F.M., *Parathanje*, në Át Gjergj Fishta O.F.M., *Lahuta e Malcís*, “Botime Françeskane”, Shkodër, 2006, f. XVIII.

² Po aty.

si një pasqyrë në të cilën jepet jeta shqiptare; të gjitha këto si tematikë letrare, madje si *ontos* letrar, prandaj, përfundimisht, si një vepër pastërtisht letrare.

II TRINGA

Tringa është titulli i këngës, titulli që shënjon ciklin, si dhe emër i heroinës së këtij cikli. Kështu, titulli thekson heroinën e këngës dhe të ciklit, shënjon se ngjarjet që rrëfen Fishta në këtë cikël lidhen me Tringën, ndërsa shënjimi është lidhja letrare e ngjarjeve, meqë Tringa nuk është një heroinë e historisë, nuk është një personazh historik i Betejës së Nokshiqit, por një krijesë letrare e poetit.

Në kuptimin letrar, Tringa është shembulli i flijimit i këtij cikli, shembulli i mbrojtjes së nderit personal e të fisit, i rrethuar me shembuj të tjerë individuale, por që, të veshur me ideologjinë autoriale, ngadalë marrin motivim politik, meqë lufta bëhet për të mbrojtur tokat shqiptare, tokat e atdheut. Nder e vetëdije politike lidh ky cikël, i cili, paradoksalisht, është cikli me shtresëzimet më të forta mitologjike i veprës. Pikërisht në shtresëzimet mitologjike artikulohen idetë autoriale, shenjat e një ideologjie autentike shqiptare, madje të politikës shqiptare. Tringa shembullin e jep me *veprimin* e saj. Në rrëfimin e pashoq të Fishtës, njohim Tringën heroinë të moralitetit dhe të autentikes shqiptare, modelin heroik të epikës legjendare shqiptare, si dhe shembullin e krishterë të pastërtisë së gruas.

Portreti i Tringës, në diskursin e Fishtës, është moral e fizik dhe synon perfeksionin poetik. Vërtet, portreti i tillë njeh paradigmën e krishterë të pastërtisë (morale) de të bukurisë fizike. Nderi mbrohet me jetë, meqë jeta pa nder nuk ia vlen të jetohet; ky është një gjykim autentik shqiptar, por dhe një gjykim i krishterë origjinar. Autentikja ka të bëjë me jetën e gjallë shqiptare, si me shembujt oralë, ndërsa shtresëzimi fetar nuancohet si një ideologji autoriale, e projektuar në figurën e Tringës, e cila portretohet si një Shën Mëri, si dhe si një heroinë legjendare shqiptare. Kështu i jep Fishta faqet e portretit të Tringës, të cilat duhet të merren të plota, duke rimarrë diskursin e Fishtës, por dhe duke e lidhur këtë diskurs me veprimin heroik të heroinës së ciklit. Tringa ka *pashinë* (bukurinë) e një zane e *trimninë* e një burri malësie, meqë është rritur me kodin e nderit të Malësisë shqiptare. Heroina e tillë jep jetën dhe, bashkë me të, edhe shembullin sesi mbrohet nderi personal, nderi i familjes dhe i fisit.

1.

Veç, po, 'i vashë un jam tue pá
 Vashë të ré n'xhubletë të bardhë,
 Me nji rubë rreth ballit ardhë
 Qi mje m'vetlla m'i ká rá;
 E derdhë flokët jashta shamís,
 Dalë më paska m'dér të shpís,
 Njanin brryl m'ballnik ngujue,
 Ndêjka e kqyrka m'kâmë harû,
 Si Nokshiqi rrin t'u kallë,
 Plaçkë si bâhet gjâja e gjallë:
 Si nper prroska, rrgallë e záll
 Jesin dekun grá e fëmij
 Per nen plume t'Malit t'Zí.
 Por se prap kurrkund neshtrasha
 Mue s'm'i dán, ka' e shof m'at derë,
 Se ká menden me hikë vasha
 E me u bâ ajo me shokë tjerë,
 Per t'pshtuem vetë edhë bagtija,
 Pa t'cillat s'ká t'gjallë Malcija.
 A thue, Zânë, mos kjoftë premtue!
 E ré vasha tue qillue,
 Mos të ket ajo gabue
 Me ndo 'i Shkjá me u miqasue;
 E prandej, n'uzdajë të mikut,
 S'dahet shpís as çarranikut
 E harû m'rri pshtetë ke tbana?
 Pse edhë t'mirë po e kisht' bâ nâna:
 Ardhun shtatit si "breshana",
 Sýnin hýll, ballin si hana,
 Dishka njethë si molla m'rrêm,
 Si ajo lulja shperthye m'gêm:
 Qi ke dalë m'ká ashtû te dera,
 Sikur bân me çilë prendvera;
 Sikur bân dielli me dalë
 Neper aha, brej e halë:
 Kaq gjâ t'mirë Zoti e ká falë!³

³ P. Gjergj Fishta O.F.M., *Lahuta e Malcís*, "Shtypshkroja Françeskane", Shkodër, 1937, f. 308-310.

2.

Ç'm' duhet jeta sod me sod?!
 Nanë e tatë tue u kalbë nen dhé
 Vllau i vetem dekë mbí dhé:
 Ç'm' duhet jeta kish t'a dí?!...
 A veç sa per t'shkuem n'Mal t'Zí,
 Faqe t'zezë vedit me i shkruë,
 Fis e giúhë e Fé me ndrrue,
 Nanë e tatë un me marrue:
 Me i xí ftyren vllaut të dekun
 Me njiherë porsa ká hjekun?!
 Jo, per Zotin! lavdi Zotit!
 Se mâ Tringa per mbas sotit
 Gjallë 'i ças s'do ajo me kënë.
 Por, persè p'r'i nieri t'kshtënë
 Me mbytë vedin s'e ep Feja,
 Vetë do t'dal, po, gjofti rrfëja!
 Ballë per ballë me u gjuejtë me Shkjá,
 Perdhuini m'e bâ me m'vrá:
 Mue me m'vrá, po, n'gjak me m'lá:
 Por jo kurr në Karadak,
 Veç këtu, shì per nen prak
 Të derës s'eme. Jam bí malit:
 S'báj un marre per s'të gjallit!
 Zot, mishrirë të keshë per mue,
 Per shka vetë mund t'kém gabue
 Në ket jetë, hiri a pá hiri
 Shtatë herë n'ditë kû fye edhë i miri!
 Ti edhë m'ep forcë e fuqí,
 T'mos t'i lâ vedit korí.
 Se un t'rijt t'ém nuk po e báj fli,
 Per t'm'dalë kanga n'Male t'Mdhá;
 Por per erz, per Fé, per vllá,
 Dekë mbí dhé qi mbetun m'ká,
 Me m'i a pré kryet Shkjau per s'dekuni,
 Mal e fis me na i koritë!
 Deh! Ti doren me m'a njitë
 Në ket t'mbramen per mue ditë:
 E mos lën, jo, gjallë me m'qitë
 Shkjau në dorë!⁴

⁴ Po aty, ff. 322-323.

Kur këto dy fragmente të këngës i lidhim në një lexim të vetëm, përnjëherë hapet situata e Tringës, fitohet portreti i saj fizik e moral dhe shënjohe veprimi i saj; të gjitha këto jepen me figura ambientale, tipike për diskursin epik të Fishtës. E gjithë ndodhia shënjohe nga këto fragmente, madje jepet e përqendruar si ligjërim i Tringës, i cili është moral (ambiental), një ligjërim me burim kodin dhe gjuhën e vendit, “gjuhën ‘mashkull’”.⁵

Përballja e Tringës me malaziasit për të mbrojtur nderin nuk llogarit pasojat e tjera, meqë jemi brenda universit autentik të Malësive shqiptare, brenda jetës që ndërtohet dhe që mbrohet me nder. Tringa jep jetën, por, më parë, *nxjerr* veten, mbron prapen dhe shtëpisë, nderin e vet, të vëllait, të familjes dhe të fisit. Kënga *Tringa* mbyllet me theksimin e faktit që ajo “Shkjaut n’dorë s’rá!”,⁶ si fakt moral thelbësor, i përkthyer përgjatë veprës në një fakt themelor shqiptar, ngjyrosur dhe me nuanca politike. Kapërcimi nga nderi personal dhe nderi i fisit, nga *autentikja* e vendit te *politikja*, te vetëdija për atdheun si identifikim politik, është rrafshi themelor ideologjik i *Lahutës së Malcís*.

*Por, kur bâ ká me i u afrue,
Sa shpejt Tringa 'i hap po kthen!
Sa shpejt "huten" po e merthen!
M'parzme Shkjaut se ç'po i a vën!
Hiqi gisht, he bujareshë!
Se 'imend kênke 'i bí prej fisit!
Bjeri shkjaút, bre sokoleshë!
Mu në parzme per mjedisit!
E t'a diej Knjazi n'Cetinë,
Se edhë n'qitët Shqyptarët aj fare,
Pasha Zotin, n'Shqypní s'hînë,
Dér t'jetë gjallë ndo 'i bí shqyptare,
Qi per erz, e Besë, e Atdhé
Kto edhë desin si me lé.
Edhë "huta" bani "bam"!
N'kokerr t'shpinës bjen Gjuri m'shkam:
I âsht derdhë mulla nper rragam,
Pshesha n'ujë, 'dhe atà haram,*

⁵ Lasgush Poradeci, *Gjergj Fishta lirik, shkëmb i tokës dhe shkëmb i shpirtit shqiptar*, në revistën *Gjergj Fishta*, nën kujesin e revistës “Shkëndija”, shtypi “Luarasi”, Tiranë, 1914, f. 25.

⁶ P. Gjergj Fishta, vep. e cit. f. 326.

Çika vendit por s'po lot.
 Sÿnin kokerr, flakë e agzot,
 N'krismë t'pushkës kah shokët e Gjurit
 Shef se vrap i'n vû atij gurit,
 Sa me turr qi i a ká hejkë
 "Hutës" fyshekun; veç tue u rrekë
 T'dytin mbrendë ajo m' i a qitë,
 Vasil Ndreka, nji uk malit,
 M'tê "novicen" terezitë,
 E i a njet shì n'lule t'ballit.
 Dekun m'tokë bjen Tringa e mjera
 Shta'n n'oborr e kryet te dera,
 Mollza e faqes krejt n'gjak lá!
 Edhè dielli dheut i rá.
 Gjallë por Tringa Shkjaut n'dorë s'rá!⁷

III

ZANA E VIZITORIT

Zana e Madhe e Vizitorit është Zana e Shqipërisë që merr në dorë fatin e shqiptarëve në kohët e liga dhe në situatat e tyre më të rënda, që vajton për humbjet e që lumnon për fitoret e shqiptarëve. Fishta ia kushton Zanës së Madhe gjithë këngën e njëzet e katërt të *Luhutës së Malcís*, të titulluar *Zana e Vizitorit*. Kjo këngë e përqendron gjithë ciklin e pestë të veprës, duke rimarrë të përqendruara situatat themelore të ciklit. Situatat shqiptare rrëfohen ashtu si duken në syrin e Zanës së tyre, mbrojtëses së tyre, të veshura me mitologji e me fantastikë letrare që kanë origjinë oralitetin. Diskursi oral (figura dhe frazeologjia) shtrihet kudo këngës, si shenjë mendësie dhe si shenjë poetike e këngës. Por, në tërësinë e saj dhe për nga statusi ontologjik/estetik, *Zana e Vizitorit* është këngë autoriale dhe jo një "hipertekst"⁸ i një teksti oral, edhe pse ka referenca të forta me oralitetin, me mitologjinë shqiptare.

Çfarë rrëfen Fishta në këtë këngë?

Kshtû n'Nokshiq lufta po vlote,
Zana e Madhe e Vizitorit

⁷ Po aty, ff. 325-326.

⁸ Shih Gérard Genette, *Palimpsestes - La littérature au second degré*, Édition de Seuil, Paris, 1982, ff. 12-14.

Më kisht' dalë ajo n'nji kep,
 Prej ka', e Mira, po kundrote
 Si terthores së Nokshiqit
 Rrihte "huta" edhë "novica":
 Si flakojshin n'diell taganat
 E si grîheshin n'mjet vedi
 T'idhtë Shqyptarët e Cerrnagorasit:
 Nji grusht trima kta, qi Mbretit
 Të Stambollës, manati i Zotit,
 Pesqind vjet kokerr m'i ndëjen
 E askurr pushken dá s'm'i a kan.
 T'lrë nper krepa tue e shkue jeten,
 Si ajo shqypja skepekrruta:
 Ndersa Serbi 'i belaçi,
 Me Turk nisë kishte krushqi
 E po rrite aj me dorë m'ballë
 Tue i bâ Turkut "tungiatëtjeta",
 Turkut tue i lá pagë e t'dheta:
 Pesqind vjet harap i shitun!
 E ashtû ndêjë e Bukra e Dheut
 M'at t'thepisenen maje kepi,
 Rreth e rrotull rrokullote
 Synin flakë, si flaka e diellit,
 Tue kundruem e, shêj tue vûm
 Se kujë pushka mâ hollë vritte,
 Kujë mâ ters tagani ndritte:
 Kush po hapej, kush po zmbrapej,
 Kush po msýte mâ furishem
 Malazezt a po Shqyptarët:
 T'cillve n'mní, kishe me thânë,
 Se edhë fort vehtja u kisht' ardhë,
 Q'se atý jeten, sado qi e ambel,
 Kurrkush máll, besa, s'po e bâte:
 Rrezja e sýnit, kur, qe, i priret
 Ka' ato tbanat e Curr Ulës,
 Kû të mjerem Tringë per s'dekuni
 Ká pá shtrî terthuier oborrit,
 N'nji hurdhë gjaku kryet sharrue
 Shî te praku i derës së vet.⁹

⁹ P. Gjergj Fishta O.F.M., vep. e cit., ff. 362-363.

Beteja e Nokshiqit vlon, shqiptarë e malazias priten e vriten; shqiptarët për të mbrojtur tokën e tyre, malaziasit për të zënë tokën e tjetrit. Zana e Madhe, kujdestarja e shqiptarëve, kundron rrjedhën e betejës. I zë syri Tringën e shtrirë në prag të derës, vëren plagën e saj në ballë dhe e kupton që e kanë vrarë. Tringa ka qenë nën mbrojtjen e Zanës qysh se fëmijë; Zana herë artikulohej si mbrojtëse, herë si motër e herë si nënë e Tringës. Në këtë pikë, *Zana e Vizitorit* bëhet këngë e vajit dhe e trishtimit për Tringën e vrarë në pragun të derës. Zana e Madhe thërret zanat që ta qajnë Tringën së bashku e ta bëjnë gati për ta varrosur. Zana vajton me dhimbjen e nënës për të bijën, me shenjat e vajit tipik të vendit, në ambientin tipik të Malësisë.

*Oyqja, Moter, se ç'm'ká gjetë!
 Se un mâ t'gjalltë nuk kam shka e bâj!
 Se mue Tringen m'a kan vrá!
 Se mue t'rijt-o m'a kan thá!
 Të dy sýt m'i kan verbue!
 Bjeshkë e vrrî m'i kan shkrûmue!
 Gurrë e prrue m'i kan helmue!
 As nuk kam pse t'hî nder valle!...
 As nuk kam pse t'bij nder zalle!...
 Pse t'kerkoj hije edhë mriza...
 Pse t'kerkoj gurra e çurrila...
 T'kerkoj lila e drandofille,
 T'ndjeki flutra neper shtoja,
 Mollakuqe e xhixhilloja:
 Të prigioj un zogjt bylbyla!
 Kta per mue, Zot, u farojshin!
 Kurr mos kndojshin! mos vallzojshin!
 Kurr mos dalët per mue prendverë,
 Tash qi m'vrán Tringen e mjerë,
 Qi e kam dashtë si sýt e ballit:
 He mue m'gjoftë moti per s'kthiellti!¹⁰*

Pas kësaj ndodh kthesa dhe vajtimi bëhet rrëfim krenarie, meqë Ora e Madhe e Trojanit kishte parë gjithë çfarë kishte ngjarë me Tringën, kishte parë aktin heroik të saj dhe ia rrëfen të gjitha Zanës së Madhe. Rrëfimi i Orës së Madhe është rrëfimi i qëndresës dhe i rënies

¹⁰ Po aty, ff. 386.

së Tringës si një heroinë dhe bëhet fakt që zbut dhimbjen e Zanës, ndërsa, përfundimisht, kthehet në krenari dhe në një detyrim për t'u hakmarrë për Tringën e për shqiptarët.

*Se tý Tringa nuk t'ká dekë:
 Nuk t'ká dekë, moj, pasha veren!
 Pasha voesen, qi rigë Drita,
 Kur vegon m'at buzë të malit!
 Nuk t'ká dekë, moj, por t'ká lé
 Sod per s'dyti: se n'Nokshiq
 Shqyptaris i a la ajo nâm!
 Se kur sod nper buzë t'agimit
 Krisi pushka në Nokshiq
 E zû shkja me djegë, me pjekë,
 Me vrá gjind, e me rá pré
 M'dhên e dhí e m'lopë e qé:
 Si atij p'rherë i a ká hjekë dera:
 Cull e mullë, shka i kisht' shpëtue,
 U vû m't'hikun, e muer rreget
 Rrezga-bjezga drejt Sutjesket,
 E as rob nierit s'mbet n'Bajrak;
 Veç se Tringa me t'vëllán,
 Me at Curr Ulen shtrî per dekë:
 Shtrî per dekë kah nisë me hjekë.
 Anë e kand visesh s'Nokshiqit
 Rrihte pushka kurr pa prâ:
 Stane e tbana i'n flakadâ:
 N'tym t'agushtë qiella merthye,
 Mos me u pá shoqi per brî:
 Tue lurue shkina edhë shkjë,
 Si lavë uqsh zijet në Shndré,
 Kah robitshin, kah plaçkitshin,
 Pleq e cull e grá kah vritshin:
 Me gjith kta kjo e bija e botës,
 Tringë Ûlja e Ûlë Keqotës,
 Vllaut, fisnikja, nuk u dá,
 Dér qi sýt ktij mbyllë s'i a ká.
 E si vllaut sýt mbyllë i a ká,
 E ká ndie si Shkja po rrâte
 Drejt kah tbani i sajë, kqyr ç'bâni*

Tringa at herë. Në kamë âsht çue,
 Edhë atÿ, mbi vllá të dekun,
 Ká zânë vasha 'i bé të madhe:
 Ká bâ Zotin kjoftë levdue! -
 Gjallë Shkjaut n'dorë se s'do t'i bijte,
 Tatë e nanë se s'do t'koritte,
 S'do t'koritte vllán per s'dekuni,
 Fisit marre s'do t'i líte:
 Edhë, kapë "huten" e vllaut,
 Fill n'oborr vasha ká dalë.
 E ká pá, nji Shkjá kryekcyem;
 E ká pá, keq ká mendue,
 Fort mâ keq desht me punue:
 Me e çue rob per vedi n'shpí.
 Por, kur, qêni i biri i qênit,
 Ká marrë turrin me e robitë,
 Sa shpejt Tringa atÿ i ndëj gati,
 Edhë m' "hutë", po sokolesha
 Mu në parzem shkjaut i a njiti,
 M'rragam dekun edhe e qiti.
 At herë shkjet Tringen kan vrá.
 Nuk ké, Zânë, pra pse me kjá;
 Se, manà, bija e malcores
 Ká qindrue si t'gjith fisniket:
 Per të gjallë nuk u dá vllaut,
 Gjallë në dorë nuk i rá shkjaut;
 Edhë vedin ká pague
 Si mâ i miri burrë n'Malcí;
 S'ká koritë as t'parë as t'mbramë:
 Shqiptarís i a la ajo nám!
 Ká me dalë kanga dikúr,
 E kahdo qi shqypja t'flitet
 - Kjo e mashkulla giuhë hyjnísh -
 Ká me u kndue nder burra t'dheut
 Per shka bâni e bija e botës,
 Tringe Ûlja e Ûlë Keqotës,
 Kur pat krisë lufta n'Nokshiq;
 E dér rrezja shekllit t'endet,
 Êmni i Tringës larg do t'permendet!¹¹

¹¹ Po aty, ff. 387-389.

Prandaj Zana e Madhe nuk vajton më:

*Shka i ká thânë, vall, Zana e Madhe:
T'paçim, Orë, sa gjith kto male!
Morì e mbrûmjja me voesë qiellit,
Morì, e njeshmjja me gjeth lilit,
Mirë shartue me rreze t' diellit:
Qi m'a ké sýnin si hýll,
Qi m'a çilë e qi m'a mbyllë
Si ajo hâna neper pyllë:
Se mue shpirtin m'a freskove,
Se mue zêmren m'a balçmove
Me kto fjalë, moj, t'u ngjatët jeta!
Moj pinjolla, vetull-holla.
Se, manà, tash kurnji grimë
Un per Tringen s'po kam dhimë;
Ke ajo, lule në ket jetë,
Lule paska shkue n'at jetë,
Edhë faqe t'bardhë Malcís
Lânë i paska, e 'i nám Shqypnís.¹²*

Zana tashmë dëshmon, si një *vetje tjetër* e autorit,¹³ me të gjitha shenjat e qëndrimit dhe të ideologjisë së autorit:

*Veç ndigjoni, oj Orë e Zana,
Se me zanë due bét e mdhana:
Pasha rrezet qi lshon hana!
Pasha voesen mbí ledina!
Pasha brej, aha e çetina!
E per mriza e qepariza!
E per gurra neper curra!
E per lila e per bylbyla!
Pasha t'rijt e pasha veren!
Mos e pritshta kurr prendveren!
E as mâ Zanë mos m'thaçin mue,
Se un dér neser, pa marrë dielli,
S'e la Tringen pa e pague!*

¹² Po aty, f. 389.

¹³ Sabri Hamiti, *At Gjergj Fishta*, “Botime Françeskane”, Shkodër, 2020; shih faqet 19, 35, 41 dhe 90.

Do t'i marr, po, treqind krena;
 Treqind shkjé rob kam me i zanun:
 Trí mij çika e nuse t'reja:
 Po, trí mij, moj, pasha Zotin!
 Trí mij çika e nuse t'reja
 Para kohës kam me i lânë t'veja.
 Me kjá ato, po, si gjith qyqet
 Nper kasolla t'Karadakut,
 Si ato bubat pshtjellë në zí.
 Se as e mejra kjo Shqypní
 Kurr tue pá s'ásht dritë me sý,
 Ke ksajë Shkjau, ndëjë orrl mbí krye,
 Kurr të keqen s'm'i a ká dá:
 Vidh, robit, plaçkit, bje pré;
 Këtu luej gúr e kufí,
 Atje vrà bulq e barí,
 Veç pse bâjn hije mbí dhé!
 Sod mâ teper vraja çikat,
 Nderës e jetës kah zot me i dalun
 Duen fisniket! Mlidhu çetë,
 Dyndu ushtrí, ngref pushkë e top,
 Edhë dil e bje n'Shqypní,
 Si me rá n'tokë t'Parvet t'vet:
 Thue se i Lumi Perendí
 Per Shqyptarë Shqypnín s'e fali,
 Por per Shkjá. Madjè, mâ teper
 Krajl e Mbret n'kuvend bashkue
 N'at Berlin: jo per t'drejtue
 A per t'sjellë ndo'i punë per s'mari,
 Se kta t'maren kû m'a kan?!
 Kta, qi, shpirtin jahudí,
 Zëmren, pus, rrênen kanû,
 Besë e fé qitun mbas shpinet,
 S'kqyrin erz, s'kqyrin drejtsí:
 E qi n'luftë qesin me u grí,
 Ndermjet vedi djelmt e rí
 P'r 'i top basme per dimí!
 Por se i cilli me ngopë barkun
 Sa mâ ding me gjá t'mâ t'ligshtit:
 Si atà derrat n'kallamoq:
 E rri e haju shoq me shoq,

*Si ato kurvat n'punë kopilash,
 Veç per t'hypë sho'it kaliboç
 Edhë shpirtin ktij m'i a xjerrun
 Per gazep, po: dorë i dhankan
 - He atà Zoti m'i marroftë! -
 Knjaz Nikollës me hî n'Shqypní,
 Dér kû dán vendi me Drî:
 Dér m'kështjell të Rozafatit
 N'at mollë Shkodre, m'krye t'Shqypnís.
 Por nuk hîn, moj êmni i Zotit!
 Dér t'jët gjallë nji nip Kastrjotit;
 Pse Shqyphtarët as sod as motit
 Sa me dhûnë, s'ká mûjtë me i shtrûe
 Kurr i huej. Po, Mali i Zí
 Para hupë - e hupët! - se Knjazit
 I bjen n'dorë Shkodra mizore.
 Un, po, vetë, un do t'u a kalli
 N'zêmer burrave t'Malcís
 T'hershmen flakë të trimënís
 T'besës shqyptare e të burrnís;
 E s'lâ kurr e per ket jetë,
 Pasha tokë e pasha dét!
 Fjalën Krajlave pa u a thye:
 Per pa e thye, per pa e poshtnue,
 Edhë Tringen pa e pague!¹⁴*

IV ELEGJIA

Në trupin e këngës *Zana e Vizitorit* strukturohet elegjia e rrallë e Zanës së Madhe kushtuar Tringës, një vepër vaji dhe identifikimi me Tringën e zemrës. Elegjia është një gjini letrare e përcaktuar nga tematika e humbjes dhe e artikuluar në diskurs vajtues. Elegjia e Fishtës shfaq shenjat e gjinisë, me dhimbjen për humbjen, evokimin dhe me “vajin e çitun” për Tringën që nuk është më. Elegjia del edhe te cikli i këngëve për Vraninën, kur vajtohet vrasja e Avdi Hises dhe është një nga pjesët më të bukura të epit të Fishtës. Ndërsa Tringën te *Zana e Vizitorit*, në një elegji të thekshme, e vajton Zana e Madhe, për t'i dhënë humbjes përmasa mitologjike. Kjo e dhënë, si dhe fakti që elegjia thuret

¹⁴ P. Gjergj Fishta O.F.M., vep. e cit, ff. 392-395.

në trupin e një teksti epik, e bën atë një vajtim madhështor. Ndjesia lirike, dhimbja e vaji i hollë e bëjnë këtë fragment një vepër estetike tipike, ndërsa fakti që vajton Zana e Madhe dhe konteksti epik e shënojnë humbjen e Tringës edhe si një humbje krenare.

Diskursi elegjiak është thurur me figura të bukura të dhimbjes, ashtu që figura të provohet si një kategori thelbësore e diskursit dhe jo si një stoli e tij. Figura e tillë e përqendron dhimbjen dhe, kur plas vaji, “pëlçet“ edhe figura. Ky fragment i këngës përbën një prej pjesëve më pak të retorizuara të të gjithë veprës dhe të tillë e bën edhe figura. Në gjerdanin e gjatë të figurave të elegjisë për Tringën, mbretëron metafora, me rrënjë në oralitet dhe në *ontos*-in ambiental, por e artikuluar rishtas në diskursin autorial, gjë që i jep kuptim të ri, të lidhur përmjet përngjasimit me të vjetrin; i jep vlerë estetike, në kuptimin kantian që estetiken e lidh me një tendencë të caktuar.¹⁵ Tendencja e tillë e lidh *bukurinë* me kuptimësinë,¹⁶ ashtu që kuptimet të thuren dhe të jepen në mënyrë estetike. Një vaj zbulon zemrën, ndërsa një elegji e artikulon humbjen dhimbshëm e bukur. Ndjesia lirike rritet, meqë elegjia është vepër për persona të dashur, të humbur, që nuk janë më, prandaj, që në krye të herës, është një gjini letrare e personalizuar.

Por çfarë ndodh kur vajtohet si te Fishta? Në raste të tilla, konteksti epik, që përcaktohet dhe nga “distanca absolute epike”,¹⁷ imponon një soj neutraliteti tipik për epin, por atipik për elegjinë. Neutraliteti i tillë, te ky fragment i Fishtës, i ka dhënë vlerë elegjisë në rrafshin estetik dhe vajin e ka “nxjerrë” në trajtë figurash të lidhura. Vërtet, i gjithë cikli për Tringën është një vepër pastërtisht estetike, ontologjike letrare, një cikël që e provon fantazinë dhe dorën e autorit, d.m.th. fuqinë e tij krijuese, edhe pse "Ndoshta ndoshta krejt ky cikël është ndërtuar nga poeti në ngjasim të legjendës madhështore të motrës së Gjergj Elez Alisë (...)."¹⁸ Diskursi është *përftya* e kësaj fuqie, shembëllimi i bukur i saj.

Figurën ambientale Fishta e ka dhënë në trajtën e saj paradigmatiske, të kërkuar dhe të latuar me kujdes; në trajtën e parë ajo duhet të lexohet si shenjë kulture e mendësie, ndërsa në trajtën e dytë si një krijim letrar autorial. Në të dyja rastet, figura e mbush rrafshin semantik

¹⁵ Shih Immanuel Kant, *Mbi të bukurën dhe të madhërishten*, “Pema”, Prishtinë, 2017.

¹⁶ *Kuptimësi* - rrafsh semantik i tekstit.

¹⁷ Mihail Bahtin, *Epi dhe romani*, në *Çështje të romanit*, “Rilindja”, Prishtinë, 1980, f. 30.

¹⁸ At Zef Pllumi O.F.M., tekst i cit., f. XXVIII.

të tekstit dhe “na flet” edhe ne, ndërsa ne duhet të njohim kulturën paradigmatiche të figurës, ashtu si edhe metodën e krijimit të Fishtës. Kur kemi vetëdijen për figurën e thurur në këtë mënyrë, kemi parasysh origjinën e saj, bashkë me poetikën e autorit, të lidhur me figurën dhe me diskursin në përgjithësi.

Kur në një tekst epik kalojmë nga figura te statusi i elegjisë, atëherë duhet të kemi parasysh kontekstin dhe moralitetin e ngjarjes së rrëfyer, në të cilën, në rastin tonë, Tringa jep jetën për të mbrojtur nderin dhe kjo nuk është një humbje, meqë, për moralitetin autentik, jeta pa nder nuk është jetë dhe nuk ia vlen të jetohet. Në këtë kuptim, në rrafshin ontologjik letrar e të moralitetit, elegjia duket e ndërshtënë, por motivohet në rrafshin estetik të ciklit dhe lidhet me shtresimin e fortë mitologjik të tij, meqë, të rikujtojmë, vajton Zana, një figurë mitike. Vërtet, këtu si kudo, mitologjia shqiptare hapet si rrëfim alternativ i situatave shqiptare, në të cilin qeniet mitologjike vështrojnë jetën e njerëzve, marrin anë, ndjejnë me ta dhe pastaj bëhen palë në beteja, si në këtë cikël, në të cilin është pikërisht Zana që merr hak për Tringën e vrarë nga malaziasit. E interpretuar kështu dhe duke njohur karakterin alternativ të shtresëzimit mitologjik të veprës, si shenjë të ndërhyrjes autoriale, edhe elegjia përbën një ndërhyrje të tillë.

V

GJAKU I MARRUN

Pas vajtimit dhe betimit vjen hakmarrja e madhe e Zanës së Madhe, në *Gjakun e Marrun*, këngë që mbyll rrëfimin e këtij cikli. Ngjarjen e përcakton ndërhyrja e Zanës, si në epet klasike, në të cilat Perënditë ndërhyjnë në zhvillimin e ngjarjeve dhe e përcaktojnë rrjedhën e tyre, bashkë me fatin e personazheve, meqë, në rrëfimet e tilla, secila palë ka Perënditë mbrojtëse, ndërsa në epin e Fishtës secila palë ka Zanën e vet mbrojtëse. Madje Zana e Shqipërisë dhe Zana e Malit të Zi përleshën njëra me tjetrën, krahas betejës që bëjnë shqiptarë e malazias. Zana e Madhe merr hak për dashurinë për Tringën dhe për betimin që kishte bërë për ta mbrojtur atë. Kështu dashuria lidhet me betimin dhe përkthehet në akt moraliteti, meqë fjala e dhënë dhe betimi i bërë duhet të mbahen. Zana shqiptare gjithnjë mban fjalën, meqë kështu e do moraliteti i sjelljes shqiptare. Pra, lidhja e personazheve me qeniet mitologjike, në diskursin e Fishtës, në thelb, përbën një raport moraliteti, provuar dhe përfaqësuar në situata konkrete të rrëfimit. Zana e shqiptarëve është si shqiptarët, meqë njeh të njëjtin kod moraliteti,

prandaj dhe veprimet e saj në rrafshin e moralitetit janë aq të motivuara e te matshme me jetën morale (tradicionale) të shqiptarëve.

Gjaku i marrun është kënga e fitores dhe e idealitetit shqiptar, madje kënga e fitores ideale, meqë gjithçka mbështillet me mitologjinë e vendit. Shqiptarët fitojnë, meqë luftojnë dhe meqë ashtu do Zana e Madhe; ata fitojnë, meqë kanë besim. Raporti i tillë me mitologjinë nuk është vetëm një përcaktim, por një mendësi, meqë mitologjia e tillë është e vendit, ndërsa vendi e beson dhe jeton me të. “Oren çuet e ká Shqyptari / Qi ‘Shqyptar’ vedit i thotë”.¹⁹

Koncepti i *gjakut të marrun* është i natyrës morale: jeta pa shpangim e pa nder nuk ka vlerë; gjaku duhet marrë. Kështu moraliteti i vendit, i normuar në trajtë kanuni të ligjëruar, bëhet dhe moraliteti i mitologjisë, meqë botëkuptimi i vendit jetën e vendësve e njeh të lidhur me qeniet mitologjike, madje të përcaktuar nga ato. Të kemi parasysh se Fishta rrëfen ngjarje me referenca historike, por i vesh me rrëfime mitologjike, duke ndjekur edhe një model autentik të historisë orale që lë faktin dhe lidhet me *rrëfimin*. Në këtë model, Tringa dhe Zana lidhen motivueshëm dhe rrëfimi për to duket si një rrëfim i zakonshëm, kur, në të vërtetë, është krejtësisht fantastik. Kujtojmë se edhe të këngët e Lidhjes së Prizrenit,²⁰ të një konteksti historik, paralelisht me kuvendin e burrave në Prizren, rrëfehej për orë e zana. Lidhjet e tilla të jetës me besimet e vendit shtrihen gjithandej rrëfimit të Fishtës, jo vetëm si një fakt letrar, por si një fakt mendësie shqiptare. Nënvizojmë se *mendësi* dhe *histori* nuk janë e njëjta gjë, meqë mendësia është e vendit, ndërsa historia, përveç se është *post rem*, përbën rrjet raportesh, që përfshin dhe të *tjerët*; historia është jeta me të tjerët, madje dhe kundër të tjerëve.

Si merr hak Zana e Madhe e shqiptarëve? Zana e Madhe është përcaktuesja e fatit të betejës së shqiptarëve kundër malaziasve në Nokshiq; për të fituar shqiptarët, Zana e Madhe duhet ta mund së pari Orën e Malit të Zi, e cila merr fytyrën e Njegoshit dhe nxit Mark Milanin që të sulmojë shqiptarët. Që një qenie mitologjike të marrë fytyrë tjetër është tipike jo vetëm për mitologjinë, por dhe për epet e tipit të atyre të Homerit. Ushtria e Malit të Zi sulmon shqiptarët, ndërsa Ora e Dormitorit i jep zemër, duke marrë pamje të ndryshme. Zana e Madhe e Vizitorit e vëren dhe nis betejën me të. E ndihmuar nga shtrigat, Zana e Madhe e zë dhe e lidh Orën e Malit të Zi për blirin e ngulur te varri i Tringës. Pas kësaj, ushtrinë e Malit të Zi e lëshon zemra.

¹⁹ P. Gjergj Fishta O.F.M., vep.e cit., f. 434.

²⁰ Po aty, ff. 75-122.

Atëherë shqiptarët lëshohen mbi ta. Malaziasit marrin ikën. Shqiptarët u vihen pas dhe marrin hak. Kështu edhe Zana e Madhe e Vizitorit merr hak. Kështu përmbushet edhe rrëfimi i Fishtës.

*Ora shkinë e Dormitorit
 Mbasì lidhë kje ajo per blî,
 Lidhë prej Zanet t'Vizitorit:
 Njat ushtrín e Malit t'Zí
 E lshoi zêmra gjithunjí,
 E muer hiken. Fulikare
 I u shtrî m'shpinë ushtria shqyptare,
 Me nji brimë qi me t'shurdhue:
 Kê tue vrá, kê tue shitue,
 Dikê krejt tue shkurtue:
 Tjerët në Lim vojte e sharrue,
 Trí taborre Mark Milanit
 Hupë i kan n'at log mejdanit,
 Treqind krena edhë i kjenë pré,
 Rob janë zanun treqind Shkjé!
 Zana e Madhe ç'po lumnon;
 Kep më kep po fluturon;
 Ká marrë kangen e po kndon;
 Po këndon m'kep t'Vizitorit,
 Larg me u ndí m'Boka t'Kotorrit:
 A t'kam thânë, 'or' Knjaz Nikolla,
 Se un, dér sande pa marrë dielli,
 Tringen do t'a kish' pague:
 Treqind krena un tue t'i pré,
 Treqind rob un tue t'i zanun,
 Trí mij çika e nuse t'reja
 Para kohës tue t'i lânë veja:
 Me kjá ato, po, si gjith qyqet
 Nper kasolla t'Karadakut,
 Si ato bubat pshtjellë në zí?
 Po m'a pvet njat Mark Milanin,
 E aj, po, ty ká me t'kallxue,
 Ká me t'dhânë t'zín zihariq,
 Se sa ushtriya t'met n'Nokshiq:
 Oren çuet se e ká Shqyptari,
 Qi "Shqyptár" vedit i thotë:*

*Se atje lufta ndezet zhari,
Breshen krenat bijn per tokë,
Kúr t'i mbushet mendja e vet
Me qindrue p'r Atdhé e Mbret.²¹*

VI FIGURA DHE PROCEDURA

Figura nuk është vetëm çështje stili, por dhe çështje e estetikës/ontologjisë letrare, meqë shënjon natyrën e krijimit letrar përmjet përngjasimit (metafora), vartësisë (metonimia), zmadhimit (hiperbola), zvogëlimit (litota), pjesës për të tërën dhe anasjelltas (sinek-doka) etj.²² Në këtë kuptim dhe në rrafshin e stilit, hiperbola është tipike për një vepër heroike. Ndërsa, kur heroikja kthehet në rrëfim fantastik, siç ngjan te cikli për Tringën, hiperbola, nga figurë, kthehet në procedurë që prodhon fantastikën letrare. Kështu që, figurat e tjera i brenda-shkruhen kësaj procedure, si çështje stili apo dhe si çështje krijimi. Hiperbola, si figurë dhe si procedurë/metodë, mbizotëron sidomos këngët *Zana e Vizitorit* dhe *Gjaku i marrun*, këngë me status të një *letërsie fantastike*,²³ të tipit të fantastikës orale dhe të epeve të vjetra, në të cilat jeta e njerëzve lidhet me kujdesin e qenieve mitike, madje përcaktohet nga veprimet e atyre qenieve. Por, në rastet e tilla, thelbësore është që të kapet procedura e krijimit, e manifestuar në *ontosin/statusin*, stilin dhe qëllimin e veprës.

Vetë Fishta, në këngën *Koha e ré*, e cilëson ligjërimin e tij, kur thërret Zanën t'i ndihmojë, cilëson natyrën e veprës, qëllimin, madje edhe trashëgiminë e saj. Cilësimi i gjuhës së veprës kthehet në cilësim të natyrës së krijimit, në hullitë e burmisë, herë të butë e aty të rreptë dhe dërrmuese, që të mbushë mendjet dhe të prekë e të thyejë zemrat, njerëzit t'i çojë nga e mbara, për të mbarën e fesë dhe të atdheut. Në disa vargje, përmjet figurave, cilësimit dhe shpalljes, Fishta e artikulon mënyrën e tij të krijimit, natyrën e stilit të tij, madje dhe ideologjinë e veprës së tij. Fishta thekson natyrën morale të veprës, prirjen nga e mbara, si theksim të estetikës tipike të një veprë letrare që do të japë mësimin e mirë (moral), me shembuj të mirë. Këto janë shenjat e një

²¹ Po aty, f. 433-435.

²² Figura letrare, e konceptuar në këtë mënyrë, nuk është vetëm një stoli, siç e konceptonte retorika e vjetër, por një veti tipike (thelbësore) e diksurit letrar.

²³ Shih Tzvetan Todorov, *Hyrje në letërsinë fantastike*, "Pika pa sipërfaqe", Tiranë, 2015, ff. 31-50.

teorie të krijimit, të kënduara në trup të veprës, të shenjuara me figura dhe të lidhura në stilin tipik të Fishtës, ndërsa, të artikuluar në këngën ndërlidhëse me titull *Koha e ré*, bëhen dhe shënjuese të procedurës dhe të procedimit (stilit/metodës) të ciklit të fundit të veprës:

*Morì e Mira rritë në halë,
Dér në Lissus ti me m'dalë,
Per me m'vû kangen per fille,
E tue m'ndritë menden me kshille,
E tue m'majtë mbrenda hullís
Së burrnís e t'bujarís,
T'bâjsh qi fjala: e butë herherë
Si njaj flladi në Prendverë:
Tash e fortë, e rrebtë, dermuese,
Si duhija shungulluese:
T'm'rrjedhë e marë e kund pa neje,
Qi t'rysë mendet, zemrat t'theje,
T'i reshë gjinden kah e mara,
Fén e Atdhén t'i lvisë perpara.
Pse, po m'u end kanga per s'marit,
Vonë e vonë fisi i Shqyptarit,
Manà tý ká me t'urue,
Bjeshkë e vrrî me t'u lulzue,
Si don vetë moti me t'shkue:
Kangë nper hanë e kangë nper dritë.²⁴*

Në vijim, do të japim disa nga figurat tipike të këtij cikli, me të cilat shënjohet procedura e krijimit dhe provohet stili:

*Tue kthye n'mbramjet n'shpí me gjâ,
Rrugës shkon lisat m'gur tue gjuejtë
Mbrendë kû strukë t'jenë zogjt me bujtë,
Trêmshim zogjt prej lisash dalin,
E nji fushen, nji merr malin,
Neper muzg fershillojn me fletë:
Kshtû Nokshiqasit e shkretë,
Mbrendë nder shpija qillue fjetë,
Kur nper mal zû Shkjau me djegë²⁵
Ardhun shtatit si "breshana",*

²⁴ P. Gjergj Fishta O.F.M., vep. e cit., ff. 438-439.

²⁵ Po aty, f. 305.

*Sÿnin hÿll, ballin si hana,
Dishka njethÿ si molla m'rrÿm,
Si ajo lulja shperthye m'gÿm:
Qi ke dalÿ m'ká ashtÿ te dera,
Sikur bân me çilÿ prendvera;
Sikur bân dielli me dalÿ
Neper aha, brej e halÿ:
Kaq gjâ t'mirÿ Zoti e ká falÿ!²⁶*

*Porsa u shkim Tringa n'oborr,
Si ajo lulja, qi, shatorr
Çilÿ, prej gÿmit t'a shkpusÿ breshni,²⁷*

*Lesht e hundÿs si qyme uku,
Dredhÿ mustakun giatÿ nji pllâmÿ.²⁸*

*Lum e lum per t'Madhin Zot!
Kur janÿ ndeshÿ shqyptarÿ e shkÿjÿ
Kur janÿ ndeshun flakÿ e agzot:
N'mni t'shoshoqit atâ lé:
Se ç'âsht ndezÿ lufta m'at hera!
Fort t'ká vlue "huta" e "novica"!
Ç't'ká plasÿ vigma edhÿ potera!
Ç't'janÿ perzi "ksula" e "kapica"!
Edhÿ topat tue bumllue!
Shprazu gjylet flakÿ e shkndija!
Larg Trojani ç't'ká gjimue!
Ç'ká shungllue kjo Metohija!
Nen kamÿ toka tue lkundÿ shrregull,
Âsht dyndÿ pluhni rê mbí krye,
Muzÿ âsht qiella n'tym e njegull:
Mâ Nokshiq s'pá kush me sye!²⁹*

*Fort gjimue kan bjeshkÿ e male,
Fort shungllue kan prroje e zalle,
Prroje e zalle edhÿ livadhe,*

²⁶ Po aty, f. 309-310.

²⁷ Po aty, f. 327.

²⁸ Po aty, f. 338.

²⁹ Po aty, f. 361.

Kur piskatë ká Zana e Madhe,
 Zâna e Madhe e Vizitorit:
 Ushtoi bjeshka e Durmitorit!
 Larg piskamen paska ndie
 Ora thepe e Malit t'Zi,
 N'Durmitor qi m'a ká, shkina,
 Bigen nalt mbrendë nder do stiena,
 Tanë lëmashk, tanë lerë e rrgallë:
 Kû bËjtë hala m'shkam të gjallë,
 Hellë, ngallitë, thue po do qiellen
 Me pershkuem, e mbí të cillen
 Çilë sËzhgjeta shqype zogat,
 Kû edhë sutat kerkojn llogat,
 E as Shnaprendjet s'dëhet bora.
 Piskamen ká ndie, po, Ora
 N'Durmitor, edhë sa ndora
 N'tingell zânin njoftë e ká:
 Njoftë e ká, mirë m'të i ká rá,
 Se SËgrizha e Vizitorit,
 Si njaj plajmi n'muej t'Brymorit,
 Po i bijte ajo rrfë Shqypnis,
 Per t'grishë burrat e Malcís,
 Me i rrâ nihmë ushtrís shqyptare
 N'at Nokshiq: kû tash batare
 Pushkë e top po rri tue vlue,
 Gjylja e plumja tue vringllue,
 Porsì breshni me murrâ.³⁰

Edhë muzgu, si u muer drita,
 T'zezë pelhuren dheut i a shtrËni.³¹

Lum e lum per t'Madhin Zot!
 Qi s'kem' kënë e na ká falë!³²

Ardhun shtatit si "breshana"
 Rreze diellit dora e llana,
 Ftyra shtrue n'fletë t'drandofillit,

³⁰ Po aty, f. 398-399.

³¹ Po aty, f. 420.

³² Po aty, f. 424.

*Kama matë per gjeth të lilit,
Shartue zâni m'zâ t'bylbylit,
Dishka borë e dishka brymë
Si njaj hylli me ferflimë:
Mori sumlla sumollore,
Mori dardha dimënore,³³*

*Se mue kripit m'i rá bora,
Se kah m'lên ásht kama e dora,
Se edhë as vonë, tham, s'ká me shkue,
N'jetë pertej un pa u kalue,
Prej kah s'lânë kend me u kthye dalë...³⁴*

VII KOHA E RÉ

Koha e ré është kënga që lidh ciklin e parafundit të *Lahutës së Malcís* me ciklin e gjashtë dhe të fundit të saj. Nga tridhjetë këngët që përbëjnë *Lahutën e Malcís*, kjo këngë është shkruar e fundit,³⁵ por që në botimin e plotë të veprës është strukturuar si kënga e njëzet e gjashtë. Është këngë e shkurtër, pa rrëfim veprimesh dhe me ndjeshmëri të fortë lirike. Është kënga që na çon te cikli i fundit, më politiku i veprës, i cili ka tematikë ngjarje të fillimit të shekullit XX, deri në pavarësimin e Shqipërisë, ndërsa kënga është krejt e veçantë me lirizmin e saj, me diskursin e personalizuar nga ana e autorit, diskurs që është kthyer në monolog, në ankim, thirrje e lavde për Zanën, për simbolin e frymëzimit autorial.

Titulli *Koha e ré* shënjon tematikë të lidhur me një epokë tjetër, prandaj kënga këndohet që të lidhen kohët e cikleve dhe të rrëfimit të veprës. Kohë e re, epokë tjetër, me heronj të tjerë, por që janë shembuj të rinj të kulturës autentike të mbrojtjes së nderit duke dhënë jetën. Vërtet, përmjet kësaj kënge hyjmë në një epokë në të cilën veprimet shënjojnë nga vetëdija politike dhe në të cilën kultura autentike morale i shërben kësaj vetëdijeje. Kështu, moraliteti i vendit merr shenjat e një politike të propozuar, një politike më shumë të projektuar, prandaj dhe

³³ Po aty, f. 436.

³⁴ Po aty, f. 437.

³⁵ Tonin Çobani, *Figurat mitologjike në Lahutë të Malcís*, “Botimet Toena”, Tiranë, 2008, f. 43.

në ciklin e fundit, në nivel idesh dhe ideologjie, Fishta duket më shumë sesa në ciklet e tjera.

Koha e re ose kanga e njizetegjashtët që lidh ngjarjet e shekullit të nandëmdhetë me ato të fillimit të shekullit të njizetët ose luftat deri atëherë të zhvillueme nga shqiptarët për mbrojtjen e tokave të veta nga “shkjau” sllav, ndërsa tash shi ata malsorë e të bijtë e po atyne do të zhvillojnë luftat e tjera për të largue pushtuesin turk.

Mendoj se kjo kangë âsht ajo që italianët e thrrasin “Canto del cigno” ose kanga e mjellmës, sepse ajo para se të mbarojë jetën e vet këndon melodinë mâ të bukurën, kështu edhe në kangën Koha e re poeti e ndien vedin të plakun e thotë:

*A din shka moj gerxhelí,
Mori rrezja nper frangí:
Se mue kripit m'i rá bora,
Se kah m'lên âsht kama e dora,
Se edhë as vonë, tham, s'ká me shkue,
N'jetë pertej un pa kalue,
Prej kah s'lânë kend me u kthye dalë...
Pra ndîgjio ma ktû nji fjalë:
(rr. 35-42)*

Poeti e shef se ka shkue tepër gjatë pa u përfundue poemi i filluem në rini, prandej don të shkrijë edhe një herë gjithë vrullin poetik për me i dhanë veprës një përfundim të pritun nga të gjithë shqiptarët e i kërkon Zanës që ta ndihmojë, sepse gjatë shumë vjetësh poeti kishte përballue një jetë tepër të ngërthyeme ndër të gjitha çashtjet jetike të kombit, gjatë të cilave Zana nuk e frymzonte. Në këtë kangë e thrret aty në Lezhë, qytet antik i ilirëve me mure çikloprike, qandër e kujtimeve legjendare të të kaluemes ilire, arbnore e shqiptare, ku ndodhi vdekja e Heroit Kombëtar Gjergj Kastriotit. Në të vertetë Fishta kishte projektue restaurimin e Kuvendit të vjetër të Françeskanëve; aty kishte rezervue një dhomë për vete që të përfundonte Lahutën e Malcís. Kjo dhomë në të cilën Fishta punoi, mendoj se duhet të shpallet monument kulture e të mbrohet nga kombi.³⁶

³⁶ Át Zef Pllumi, tekst i cit., ff. XIX-XX.

Koha e ré është strukturuar në trajtë të një monologu të gjatë lirik, ngjashëm me një poemë lirike, në blloqe ligjërimiti që këputen si për t'u "mbushur frymë" autori, por që kthehen në blloqe tematike. Poeti i drejtohet Zanës, si një *vetë tjetër*, ndërsa i flet *vetjes tjetër*, meqë në një tekst të tillë "tregimi është i thjeshtë";³⁷ d.m.th. autori flet në emrin e tij. Kushtet e tilla të ligjërimitit tekstin e kësaj kënge e bëjnë krejtësisht metaforik; çdo gjë i nënshtrohet imagjinatës së autorit, një universi të përngjasuar, të mundshëm, që jepet si i mirëqenë, meqë jepet në kushtet e ligjërimitit letrar. Këtu diskursi i Fishtës nuk përfaqëson,³⁸ por thuret si imagjinim i çliruar nga situatat e përballjeve, të dramave dhe të rrëmujës; i kthyer në vetë, si rrallë herë në gjithë veprën e gjerë të tij. Gjuha e Fishtës ("Kjo e mashkulla giuhë hyjnësh -"³⁹), e lidhur me copat e jetës shqiptare, bëhet gjuhë e brendisë, e "zbutur" në ankime, e thurur me figura, si një dëshmi e autorit për veten, pasi ka rrëfyer situatat shqiptare gjatë gjithë jetës. Këto veti e bëjnë të domosdoshme që *Koha e ré* të dëshmohet si ndërlidhëse e dy cikleve, aq më tepër kur mungon vepërimi, mungon situimi historik i referuar, prandaj mungojnë edhe situatat. Teksti i kësaj kënge artikulon *gjendje*, ndërsa referencat ndërlidhëse janë strukturuar në trup të tekstit, si referime të autorit, dhe japin kontekstin e situatave të ciklit të fundit të veprës. Përmjet këtyre referimeve hapim faqet e ciklit të fundit të veprës, ciklit që lidh situatat shqiptare me ideologjinë autoriale, madje me vetëdijen e tij politike, e cila bëhet kategori themelore në këngët e tij.

Behma ktû n'ket Lissus t'vjeter,
Kû, larg zhurmet e poteret,
Dola edh' un n'ket buzë Prendveret,
Per me kndue m'Lahutë t'Malcís,
Se si u end fati i Shqypnís,
Kûr pshtoi kthetrave t'Shkjenís
E duel zgjedhet të Turkís:
Perendija si e kisht' shkrue:
E zojë m'vedi edhe u ndertue,
Mbas sa gjakut qi pat dkue.
Pse kaq njerzit po i'n të kqí,

³⁷ Platoni, *Republika*, CEU & Shtëpia e Librit & Phoenix, Tiranë, 1999, ff. 104-105.

³⁸ Për konceptin e *përfaqësueses (representatives)*, shih Zherar Zhenet, *Figura*, "Rilindja", Prishtinë, 1985, ff. 111-186, si dhe Gérard Genette, *Mimologies*, University of Nebraska Press, Lincoln & London, 1995.

³⁹ P. Gjergj Fishta O.F.M., vep. e cit., f. 389.

*Sa qi askund m'ket shekull t'zi
Pa shkue gjaku ví e ví,
Nuk po gzohej, jo, liri.⁴⁰*

*Se Shqyptari s'ásht gabel,
S'ásht shkerbé pjellun n'zabel,
Mos me pasë aj fis e Atdhé,
Veç me shkelë m'tê Turq e Shkjé:
Jashtë Shqypnijet se Osmanllija
Duhej dbue: se vetë Shqypnija
Duhej qitë ajo zojë m'vedi:
M'tê mos me sundue kurr Mbreti
I Stamollës e se të huejët
Do t'shkojn gjúhen tuj e ruejtë
Píjt nder dhâmë, per kto punët t'ona.
Edhë kshtú, njitash n'e vona,
Nisë Shqyptarët kan me mendue
Per punë t'veta, e shqyp me shkrue:
Shqyp me shkrue, po, shqyp me msue
Neper shkolla; e pse të holla
Mendt po i ki'n, e kryet jo shtamë,
Kta per fije janë vû n'lamë
T'ditunís e t'gjtetnís:
E medjë, sod prej Turkís
Janë tue lypë autonomín:
Se per ndryshe, thonë, lirin
Me armë n'dorë do t'a fitojn:
Nen kamë t'huej gjallë mâ s'rrogojn.⁴¹*

⁴⁰ Po aty, ff. 437-438.

⁴¹ Po aty, ff. 446-447.

Referencat

1.

- P. Gjergj Fishta: O.F.M.: *Lahuta e Malcís*, Shkodër, 1937

2.

- Lasgush Poradeci: *Gjergj Fishta lirik, shkëmb i tokës dhe shkëmb i shpirtit shqiptar*, në revistën *Gjergj Fishta*, nën kujdesin e revistës “Shkëndija”, Tiranë, 1941

- Gérard Genette: *Palimpsestes - La littérature au second degré*, Paris, 1982

- Zherar Zhenet: *Figura*, Prishtinë, 1985

- Gérard Genette: *Mimologics*, Lincoln & London, 1995

- Platoni: *Republika*, Tiranë, 1999

- Immanuel Kant: *Mbi të bukurën dhe të madhërishtmen*, Prishtinë, 2017

- Mihail Bahtin: *Epi dhe romani*, në *Çështje të romanit*, Prishtinë, 1980

- Át Zef Pllumi O.F.M.: *Parathanje*, në At Gjergj Fishta O.F.M., *Lahuta e Malcís*, Shkodër, 2006

- Tonin Çobani: *Figurat mitologjike në Lahutë të Malcís*, Tiranë, 2008

- Tvzetan Todorov: *Hyrje në letërsinë fantastike*, Tiranë, 2015

- Sabri Hamiti: *Át Gjergj Fishta*, Shkodër, 2020

3.

- *Visaret e Kombit, Vëllimi II, Kângë Kreshnikësh dhe Legenda, Mbledhë e redaktuëm nga At Bernardin Palaj dhe At Donat Kurti*, Prishtinë, 1996

- Kujtim M. Shala: *Fishta përballë Fishtës*, Prishtinë, 2004

- Át Shtjefën Gjeçovi O.F.M.: *Kanuni i Lekë Dukagjinit*, Shkodër, 2010

81'374.3=18
811.18'282.4(450)'374.3
811.18'282.4(450)'36

Imri Badallaj, Prishtinë

SISTEMI EMËROR I ARBËRISHTES SË QEFTIT

Ku ndodhet Qefti (it. Chieuti).

Qefti është një katund dhe bashki në Provincën e Foxhias në rajonin e Puljes (në Itali), i cili krejtësisht është i banuar me arbëreshë, të ardhur në këtë vend midis viteve 1461 dhe 1470. Ky ngulim arbëresh u shtua dhe u bë bashkësi e madhe, sidomos kur Gjergj Kastrioti me ushtrinë e tij ndërhyri në mbështetje të Ferdinandit I të Aragonës kundër Johanit të Anzhuinëve.

Gjeografikisht Qefti kufizohet në lindje dhe në jug me komunën e Serrakapriolës, në perëndim me komunat Kampomarinos dhe të San Martinos së Pensilisit të Provincës së Kampobasos dhe në veri ka Detin Adriatik.

Territori i Qeftit është ngulitur në zonën ku ndodhej qyteti i lashtë *Cliternia Frentanas*, i cili u shkatërrua nga gotët në vitin 495 pas Krishtit.

Përroi i Saçunit, duke vazhduar në drejtim të Apenineve Jugore të Sanitëvet, nuk e ndan vetëm Puljen nga Moliza, por edhe territorin e Qeftit nga Këmarini, që ky i dyti ka një shtrirje tokësore mjaft të gjerë. E gjithë sipërfaqja e Qeftit kap 6060 hektarë, terren ky, që përshkohet nga disa kodrina jo të larta me tokë të butë, e cila dallohet për rritjen fort të suksesshme të produkteve bujqësore, sidomos të drithërave dhe në mënyrë të veçantë të bimësisë mesdhetare.

Deti Adriatik lag territorin e Qeftit me një gjatësi 7.5 km, që plazhi i tij ka një rërë shumë të përshtatshme për ata, të cilët kanë dëshirën dhe mundësinë të shkojnë dhe të shtrihen mbi të, për t'u rrezitur dhe për t'u larë në ujët e ngrohtë të këtij deti.

Kjo bukuri e rrallë bregdetare ka tërhequr vizitorë që nga kohërat e hershme, jo vetëm nga Italia, por edhe nga vendet e tjera evropiane. Përveç bukurive natyrore, që ka ky bregdet, janë për t'u përmendur edhe një vistër hotelesh dhe restorantesh, ku për ushqim shërbehet vetëm me produkte vendore, që freskia dhe shija e tyre brenda ditës të kënaqin dhe të bëjnë për vete.

Përveç restoranteve, ku mund të hahen shumë specialitete peshku edhe piceritë janë një segment i kërshërisë së vizitorëve, sepse qeftiotët dallohen për gatesat e një kualiteti të lartë dhe me një shije specifike, që rrallë mund t'i gjesh në vende të tjera brenda Italisë.

Për të arritur në qendër të Qeftit, duke ardhur nga ana e detit, më parë kalohet mbi hekurudhë dhe mbi udhën shtetërore anës bregut n^o 16, që lidh Termolin me Foxhën. Trafiku te kryqëzimi është i pajisur me semafor, që shërben pa u ndalur kurrë dhe si të kalohet ky, ndodhesh në tokat bujqësore të Fantinës, ku jetojnë shumë banorë të ardhur nga Margerita e Savojës, që janë me zë për kultivimin e perimeve të të gjitha llojeve.

Duke u larguar nga qendra e banuar e Qeftit vendin e tokave ranore e zënë dherat argjilorë, që përshkohen nga një thatësi, por me kanalet e hapura nga bujqit e vyer bëjnë ujitjen e të mbjellave, që u sjellin atyre rendimente mjaft të mira, si në sasi, ashtu edhe në cilësi.

Përbri këtyre kanaleve, që përfundojnë në det, rritet një bimësi e dendur, që për faunën ka krijuar kushte optimale. Prandaj, derrat e egjër, lepujt dhelprat, ketrat dhe shumë egërsira të tjera, kahdo që të shikosh mund t'i hasësh me shumicë.

Pa hyrë në katund përballësh me Qendrën Agroturistike *Padre Pio Giovane* e ndërtuar sipër një masarie shumë të vjetër, që mban emrin *Kasa Kapana*, e cila ndodhet midis një ambienti fort të këndshëm me bukuri të rralla natyrore, që në afërsi të kësaj qendre me shumicë shtrihen plantacionet e vreshtave, të ullinjve dhe të mjedrave.

Me të arritur në qendrën e katundit Qeft, i cili ndodhet sipër nivelit të detit 222 m. shtrihet një peizazh i mrekullueshëm drejt detit. Ky peizazh rrit bukurinë e tij me *Ishujt e Tremtit*, por nga lindja mali *i Garganit* dhe ai *i Majelës* të bëjnë të mahnitesh me atë konfiguracion, që ia ka dhuruar natyra.

Gjatë shekujve XV dhe XVI ky vend ishte një fortesë e vogël, që posedonte *katër torre tetëkëndëshe* e rrethuar me mure të larta.

Si ngulim arbëresh u themelua në vitin 1462, kur pas fitores së Skënderbeut në Orsara, i cili i kishte ardhur në ndihmë mbretit të Napolit, i sulmuar nga anzhuinët, e si preventivë kërkoi nga luftëtarët arbërorë të qëndrojnë në feudin e Serrës.

Nga këta ushtarë ardhës, që ishin të gatshëm në çdo moment t'i vijnë në ndihmë mbretit Ferdinand I u ngulitën banorët e parë në këtë vendbanim arbëresh, që gati për gjashtë shekuj e ruajtën gjuhën, doket, zakonet dhe krijimtarinë gojore shumë të pasur. Pra, ky ngulim, që në

histori dhe toponomastikë njihet me emrin *Keuti (Chieuti)*, ndërsa vetë qeftiotët katundin e tyre e quajnë *Qeft* në të cilin vend ky grup i vogël ngriti disa shtëpi rreth *Kishës së Shën Gjergjit*.

Duke kaluar vitet, banorët e këtij ngulimi u rritën, sidomos pas vdekjes së Skënderbeut dhe shkeljes së Arbërisë anë e kënd nga osmanët, në Itali arritën shumë familje, që disa prej tyre më 1680 së bashku me murgun Gjergj Sevasto u vendosën në Qeft, që ky vendbanim tani vjen e shtohet dhe gjithsesi bëhet sadopak një forcë për t'i rezistuar sulmeve, të cilat ishin mjaft të shpeshta nga fqinjët, që ndodheshin në afërsi të kësaj kolonie arbëreshe ose edhe nga kishtarët e ritit latin, që përkundër tyre, ardhësit manifestonin ritin bizantin të sjellë nga Dheu i Arbrit, të cilin rit e ruajtën deri në fund të shekullit XVIII, që vendësit lëtirë këtë rit nuk e duronin dhe si të tillë, pa ndërprerë e luftonin edhe me armë.

Gjithë ushtarëve të Skënderbeut që u ndalën në këto treva të Pulies, mbreti Ferdinand u dha shumë toka, me qëllim që këto forca ushtarake t'i ketë pranë si garanci për shuarjen e revoltave kundër tij, që përpjekjet e tilla nuk ishin të pakta. Kështu, Pulia vjen e bëhet treva me një numër të madh arbëreshësh të ikur nga presioni dhe persekutimet e përgjakura, që u shkaktonte pushtuesi osman.

Në këto mote Qefti si famullitar pati fatin ta ketë Nikollë Filien (*Nicolò Figlia 1693-1769*), i cili vinte nga Munxifsi (Mezzojuso)-katund arbëresh i Sicilisë, që përveç shërbimeve fetare të ritit bizantin, ky bënte shumë shërbime të tjera në ruajtjen e gjuhës dhe gjithë kulturës arbëreshe.

Në saje të tij Qefti vjen e dallohet nga ngulimet e tjera arbëreshe për një zhvillim edhe letrar. Në këto mote më 1760 sheh dritën një poemë lirike me titull: *Tarandishe hiridhone*, që u botua pa emër të autorit. Edhe *I Krështeri arbëresh* janë vepra të Filies. Mirëpo, kryevepra e tij gjithsesi do të mbetet *Kodiku i Keutit (Il Codice Chieutino)*, në të cilën vepër shkriu gjithë dijen dhe talentin e tij. Pra, Qefti u bë i njohur në tërë regionin e Kapitanatës si qendër e kulturës arbëreshe.

Pas vdekjes së Nikollë Filies famullinë e Qeftit e ushtron i nipi i tij – Andre Filia (*Andrea Figlia, 1731-1781*), që pasi vdiq edhe ky, bëhet një trysni e paparë nga peshkopatat latine mbi këto bizantine dhe në këtë rast riti latin del ngadhënjyes, sepse kishte pas vetes Papasin e Romës.

Qefti në sferën e kulturës u bë tërheqës edhe për shumë dijetarë nga ngulimet e tjera arbëreshe. Sidomos ruajtja e krijimtarisë gojore

ishte fort e pasur, çfarë Mikele Markiano nga Maqi mblodhi shumë këngë dhe materiale të tjera, të cilat më 1908 i publikoi në Napoli.

Këto materiale, të regjistruara nga Mikele Markiano janë me interes, sepse përfaqësojnë një thesar të moçëm të krijimtarisë, që qeftiotët e kishin ruajtur me shekuj këtë pasuri të shpirtit të tyre.

Mirëpo, lexuesi i këtyre materialeve duhet ta ketë parasysh, se për një studim të veçorive gjuhësore mund të na shërbejnë pak, ngase autori, para se t'i publikojë i ka përshtatur sipas të folmes së Maqit.

Shumë ngulime arbëreshe në fillim të vendosjes së tyre në shtatë regjionet e Italisë nga një trysni dhe mëri e lëtirëvet janë detyruar t'i lëshojnë vendet e zëna dhe të kërkojnë troje të tjera. Mirëpo, me Qeftin kjo nuk ndodhi, sepse ata i dolën zot katundit dhe banorëve të tij, shpeshherë duke u mbrojtur edhe me armë.

Emri. - Në të folmen arbëreshe të Qeftit (it. Chieut-it) emrat në të shumtën e rasteve dalin në gjininë mashkullore dhe femërore, si: *mali*, *djali*, *plaku*; *motra*, *unaza*, *lule*, *gruo*, por gjinia asnjëse, edhe pse më rrallë, ajo gjallon në këtë të folme, sidomos janë ruajtur emrat, të cilët emërtojnë lëndë, si: *misht(carne)*, *ujët(acqua)*, *ballt(fronte)*, *pleht (pol-vere)*, *diatht (formaggio)*, *vajt(olio)*, *mjaltët (miele)*, *dillët(sole)* etj.

Mirëpo, disa emra, të cilët pothuaj se në gjithë shqipen janë të gjinisë femërore, në Qeft dalin si emra mashkullore: *furri (forno)*, *buzi (labbro)*, *kapurdhi (fungo)*, *shoshi (vaglio)*, *gjingalli (cicala, çufi-i (fiocco), mac-i(mazzo), etj.*

Gjithashtu, edhe emrat: *krija (tèsta)*, *tëtima (freddo)*, që do të duhej i pari të jetë i gjinisë asnjëse dhe i dyti i gjinisë mashkullore, në këtë të folme arbëreshe janë emra, të cilët shkojnë me gjininë femërore. Me gjininë mashkullore shkon edhe emri *kafeu(caffè)*, që në gjithë shqipen është emër i gjinisë femërore: *kafeja*.

Në përgjithësi emrat e gjinisë mashkullore në numrin njëjës në trajtën e shquar të nominativit marrin mbaresën **-i**, ose **-u**: *mali*, *lumi*, *dheu*. Ndërsa, ata të gjinisë femërore marrin mbaresën: **-a** ose **-ja**: *vajza*, *mëma*, *nusja*, *delja* etj., ndërsa ata të gjinisë asnjëse marrin mbaresat: **-t**, **-ët** dhe **-të**: *djatht (il formaggio)*, *dillët (cereo)*, *leshtë (la lana)*, *trut (le cervello)*, *ballët (la fronte)*, *t'ngrënt (il mangiare)* *t'pirt (il bere)* etj.

Si në mbarë të folmet e shqipes edhe në arbërishten e Qeftit, për emrat e frymorëve, vetë gjinia natyrore përcakton edhe gjininë gramatikore: *uça (fratello)* – *motër (sorella)*, *gruo (donna)* – *burrë (uomo)*, *lopë (mucca)* - *ka (bue)* etj.

Ndërsa kafshët e reja emërtohen me emra që kryesisht i përkasin gjinisë mashkullore: *shtjerr-i* (*agnello*), *kaciq-i* (*capretto*), *viç-i* (*vitello*) etj. // *shtjerri i butë ndukën di: si:s – l'angelo mite succhia due mamme-lle//si një shtjerr e rrëmbien – lo afferrarono come un agnellet*¹.

Për të pasur një pasqyrë sa më të qartë mbi sistemin emëror të kësaj së folme, ne këtu më poshtë do t'i shtrojmë disa paradigma të emrave të të gjitha gjinive, në numrin njëjës dhe në numrin shumës, në trajtën e pashquar dhe në trajtën e shquar.

1. Gjinia e emrave

Emra të gjinisë mashkullore

Të pashquar	Të shquar	Opozicionet
mal (montagna)	mali (la montagna)	ø/i
ka:l (kavallo)	kali (il cavallo)	ø/i
tho (unghia)	thoi (l'unghia)	ø/i
dhe: (terra)	dheu (la terra)	ø/u
krah (braccio)	krahu (il braccio)	ø/u

Emra të gjinisë femërore

Të pashquar	Të shquar	Opoz.
shpi (casa)	shpia (la casa)	ø/a
faqe (faccia)	faqja (la faccia)	e/ja
motër (sorella)	motra (la sorella)	ër/ra

Emra të gjinisë asnjënjësore

Të pashquar	Të pashquar	Opoz.
mish (carne)	misht (la carne)	ø/t
tru (cervello)	trut (le cervelia)	ø/t
kria (testa)	kriat (la testa)	ø/t
djath (formaggio)	djatht (il formaggio)	ø/t

¹ Emanuele Giordano, *Fjalor i Arbëreshvet t'Italisë*, Castrovillari, 2000, fq.. 399,483

2. Lakimi i emrave

Gjinia mashkullore

Numri njëjës			
	Njëjësi i pashquar	Njëjësi i shquar	Opozicionet
N.	<i>mal (monte)</i>	<i>mali</i>	\emptyset /-i
Gj.	<i>(i,e) mali (i,e)</i>	<i>malit</i>	\emptyset /-t
D.	<i>mali</i>	<i>malit</i>	\emptyset /-t
Ak.	<i>mal</i>	<i>malin</i>	\emptyset /-n
Abl.	<i>mali</i>	<i>malit</i>	\emptyset /-t
Numri shumësor			
	Njëj. i pashquar	Njëj. i shquar	Opoz.
N.	<i>hu</i>	<i>huri</i>	\emptyset /-ri
Gj.	<i>(i,e) huri</i>	<i>(i,e) hurit</i>	\emptyset /-t
D.	<i>huri</i>	<i>hurit</i>	\emptyset /-t
Ak.	<i>hu</i>	<i>hurin</i>	\emptyset /-rin
Abl.	<i>huri</i>	<i>hurit</i>	\emptyset /-t
	Shum. i pashq.	Shum. i shquar	Opoz.
N.	<i>hunje</i>	<i>hunjet</i>	\emptyset /-t
Gj.	<i>(i, e) hunjeve</i>	<i>hunjevet</i>	\emptyset /-t
D.	<i>hunjeve</i>	<i>hunjevet</i>	\emptyset /-t
Ak.	<i>hunje</i>	<i>hunjet</i>	\emptyset /-t
Abl.	<i>hunjesh</i>	<i>hunjevet</i>	-sh/-vet
	Shumësi i pashquar	Shumësi i shquar	Opoz.
N.	<i>male</i>	<i>malet</i>	\emptyset /-t
Gj.	<i>(i,e) maleve (i, e)</i>	<i>malevet</i>	\emptyset /-t
D.	<i>maleve</i>	<i>malevet</i>	\emptyset /-t
Ak.	<i>male</i>	<i>malet</i>	\emptyset /-t
Abl.	<i>malesh</i>	<i>malevet</i>	-sh/-vet

	Njëjësi i pashquar	Njëjësi i shquar	Opoz.
N.	<i>plak (vecchio)</i>	<i>plaku</i>	<i>0φ/-u</i>
Gj.	<i>(i,e) plaku (i,e)</i>	<i>plakut</i>	<i>φ/-t</i>
D.	<i>plaku</i>	<i>plakut</i>	<i>φ/-t</i>
Ak.	<i>plak</i>	<i>plakun</i>	<i>φ/-un</i>
Abl.	<i>plaku</i>	<i>plakut</i>	<i>φ/-t</i>

	Shumësi i pashquar	Shumësi i shquar	Opoz.
N.	<i>pleq</i>	<i>pleqt</i>	<i>φ/-t</i>
Gj.	<i>(i,e) pleqve (i,e)</i>	<i>pleqvet</i>	<i>φ/-t</i>
D.	<i>pleqve</i>	<i>pleqvet</i>	<i>φ/-t</i>
Ak.	<i>pleq</i>	<i>pleqt</i>	<i>φ/-t</i>
Abl.	<i>Pleqësh</i>	<i>pleqvet</i>	<i>-ësh/-vet</i>

	Njëjësi i pashquar	Njëjësi i shquar	Opoz.
N.	<i>kruo (fonte)</i>	<i>kroi</i>	<i>-uo/-oi</i>
Gj.	<i>(i,e) kroi (i,e)</i>	<i>kroit</i>	<i>φ/-t</i>
D.	<i>kroi</i>	<i>kroit</i>	<i>φ/-t</i>
Ak.	<i>kru</i>	<i>kroin</i>	<i>-u/-oin</i>
Abl.	<i>kroi</i>	<i>kroit</i>	<i>φ/-t</i>

N.	<i>kronje</i>	<i>kronjet</i>	<i>φ/-t</i>
Gj.	<i>(i,e) kronjeve (i,e)</i>	<i>kronjevet</i>	<i>φ/-t</i>
D.	<i>kronje</i>	<i>kronjevet</i>	<i>φ/-vet</i>
Ak.	<i>kronje</i>	<i>kronjet</i>	<i>φ/-t</i>
Abl.	<i>kronjeve</i>	<i>kronjevet</i>	<i>φ/-t</i>

N.	<i>dhe</i>	<i>dheu</i>	<i>φ/-u</i>
Gj.	<i>(i,e) dheu</i>	<i>dheut</i>	<i>φ/-t</i>
D.	<i>dheu</i>	<i>dheut</i>	<i>φ/t</i>
Ak.	<i>dhe</i>	<i>dheun</i>	<i>φ/-n</i>
Abl.	<i>dheu</i>	<i>dheut</i>	<i>φ/-t</i>

	Njëjësi i pashquar	Njëjësi i shquar	Opoz.
N.	<i>dhera</i>	<i>dherat</i>	\emptyset / <i>i</i>
Gj.	<i>(i, e) dherave</i>	<i>dheravet</i>	\emptyset / <i>t</i>
D.	<i>dherave</i>	<i>dheravet</i>	\emptyset / <i>t</i>
Ak.	<i>dhera</i>	<i>dherat</i>	\emptyset / <i>t</i>
Abl.	<i>dherash</i>	<i>dheravet</i>	<i>-sh/-vet</i>

Disa emra të gjinisë mashkullore e formojnë shumësin, duke iu nënshtruar alternimeve tingullore, si:

<i>plak (vecchio)</i>	<i>pleq</i>	<i>a/e</i>	<i>k/q</i>
<i>dja:l (ragazzo)</i>	<i>djem</i>	<i>a/e</i>	<i>l/m</i>
<i>ka:l (cavallo)</i>	<i>kuej</i>	<i>a/ue</i>	<i>l/j</i>
<i>ka: (bue)</i>	<i>qe:</i>	<i>a/e</i>	<i>k/q</i>

Gjinia femërore

	Njëjësi i pashquar	Njëjësi i shquar	Opoz.
N.	<i>vajzë(bambina)</i>	<i>vajza (la ragazza)</i>	<i>- ë/-a</i>
Gj.	<i>(i,e) vajze</i>	<i>(i,e) vajzës</i>	<i>-e/ës</i>
D.	<i>vajze</i>	<i>vajzës</i>	<i>- e/-ës</i>
Ak.	<i>vajzë</i>	<i>vajzën</i>	\emptyset / <i>n</i>
Abl.	<i>vajze</i>	<i>vajzës</i>	<i>-e/-ës</i>

Shumësi

N.	<i>vajza (ragazza)</i>	<i>vajzat(le ragazza)</i>	\emptyset / <i>t</i>
Gj.	<i>(i,e) vajzave</i>	<i>(i,e) vajzavet</i>	\emptyset / <i>t</i>
D.	<i>vajzave</i>	<i>vajzavet</i>	\emptyset / <i>t</i>
Ak.	<i>vajza</i>	<i>vajzat</i>	\emptyset / <i>t</i>
Abl.	<i>vajzash</i>	<i>vajzavet</i>	<i>-sh/vet</i>

Njëjësi

	Njëjësi i pashquar	Njëjësi i shquar	Opoz.
N.	<i>lulje (fiore)</i>	<i>lulja (il fiore)</i>	<i>-e/-ja</i>
Gj.	<i>(i,e) lulje</i>	<i>(i,e) luljes</i>	<i>ø/-s</i>
D.	<i>lulje</i>	<i>luljes</i>	<i>ø/-s</i>
Ak.	<i>lulje</i>	<i>luljen</i>	<i>ø/-n</i>
Abl.	<i>lulje</i>	<i>luljes</i>	<i>ø/-/s</i>

	Shumësi i pashquar	Shumësi i shquar	Opoz.
N.	<i>lulje (fiori)</i>	<i>luljet (il fiori)</i>	<i>ø/-t</i>
Gj.	<i>(i,e) luljeve</i>	<i>(i,e) luljevet</i>	<i>ø/-t</i>
D.	<i>luljeve</i>	<i>luljevet</i>	<i>ø/-t</i>
Ak.	<i>lulje</i>	<i>luljet</i>	<i>ø/-t</i>
Abl.	<i>luljeve</i>	<i>luljevet</i>	<i>ø/-t</i>

	Njëj. i pashquar	Njëj. i shquar	Opoz.
N.	<i>dele (pecora)</i>	<i>dele (pecore)</i>	<i>ø/ø</i>
Gj.	<i>(i,e) dele</i>	<i>(i,e) deleve</i>	<i>ø/-ve</i>
D.	<i>dele</i>	<i>deleve</i>	<i>ø/-ve</i>
Ak.	<i>dele</i>	<i>deleve</i>	<i>ø/ø</i>
Abl.	<i>dele</i>	<i>deleve</i>	<i>ø/-ve</i>

	Njëj. i shquar	Shum. i shquar	Opoz.
N.	<i>delja (la pecora)</i>	<i>delet (le pecore)</i>	<i>-ja/-et</i>
G.	<i>(i,e) deles</i>	<i>(i,e) delevet</i>	<i>-s/vet</i>
D.	<i>deles</i>	<i>delevet</i>	<i>-s/-vet</i>
Ak.	<i>delen</i>	<i>delet</i>	<i>-n/-t</i>
Abl.	<i>deles</i>	<i>delevet</i>	<i>-s/-ve</i>

	Njëj. i pashquar	Njëj. i shquar	Opoz.
N.	<i>dhi (capra)</i>	<i>dhia (la capra)</i>	<i>ø/-a</i>
G.	<i>(i,e) dhie</i>	<i>(i,e) dhi:s</i>	<i>-e/-s</i>
D.	<i>dhie</i>	<i>dhi:s</i>	<i>-e/-s</i>
Ak.	<i>dhi</i>	<i>dhi:n</i>	<i>ø/-n</i>
Abl.	<i>dhie</i>	<i>dhi:s</i>	<i>-e/-s</i>

	Shum. i pashquar	Shum. shquar	Opoz.
N.	<i>dhi</i>	<i>dhit(ë)</i>	\emptyset / <i>t(ë)</i>
Gj.	<i>(i,e) dhive</i>	<i>(i,e) dhivet</i>	\emptyset / <i>t</i>
D.	<i>dhive</i>	<i>dhivet</i>	\emptyset / <i>t</i>
Ak.	<i>dhi</i>	<i>dhit(ë)</i>	\emptyset / <i>t(ë)</i>
Abl.	<i>Dhish</i>	<i>dhivet</i>	<i>-sh/-vet</i>

Emrat: *dhe (terra)*, *mal (montagna)*, *mullir (mulino)*, *mot (tempo)*, *sama:r (basto)*, *nderim (saluto)*, *faj (peccato)* etj., janë ambigjenë dhe si të tillë në shumës dalin me mbaresën **-e**: *dhera, male, mullire, mote, samar, nderime, faje* etj., çfarë, kjo dukuri e formimit të shumësit të këtyre emrave ka gjetur shtrirje edhe në të folmet e tjera arbëreshe dhe më gjerë brenda shqipes dialektore.

Mirëpo, emrat: *krah (braccio)*, *dit (giorno)*, *nuse (sposa)*, *këmbë (piede)*, *magje (madia)* e bëjnë numrin shumës si në njëjës. Pra, opozicioni i këtyre emrave në njëjës dhe në shumës është \emptyset/\emptyset .

Emrat asnjanes.- Sa i përket emrave të gjinisë asnjanesë, të tillët në shqipen e sotme përbëjnë një segment emëror, që numri i tyre vazhdimisht vjen e rrudhet dhe dita-ditës do të mbeten shumë pak. Mirëpo, shqipja e moçme ishte shumë më e pasur me emra asnjanes, çfarë edhe arbërishtja e Qeftit, si njëra ndër të folmet e vjetra italo-arbëreshe, i ka ruajtur emrat asnjanes dhe si të tillë në këtë idiomë dialektore kanë një shtrirje të dendur.

Në këtë të folme, si emra të gjinisë asnjanesë dalin disa sish, që kryesisht emërtojnë lëndë, si: *mish-misht (la carne)*, *kiumsh-kiumsht (il latte)*, *lesh-lesht (la lana)*, *diath – djatht (il formaggio)*, *tru-trut (le cervella)*, *kria-kriat (testa)*, *pleh-pleht (polvere)*, *bay- bayt (fronte)*. ku disa prej tyre u zunë ngoje edhe në fillim po të kësaj njësie të sistemit emëror.

Edhe disa mbiemra të emëruar në Qeft janë emra asnjanes, si p.sh.: *t'ngroht (caldo)*, *t'fhoht (freddo)*, *t'ngrent (un magiare)* etj.

Ndërsa emrat e nyjshëm prejfoljorë të formuar nga emërimi i pjesoreve, si: *t'folurit*, *t'ecurit*, *t'ngrenit*, *t'kënduorit* etj., janë shumë të shpeshtë në gojët e qeftiotëve.

	Njëjësi	Shumësi	Opoz.
N.	<i>ujët (l'acqua)</i>	<i>ujrat (le acque)</i>	<i>-ët/-rat</i>
G.	<i>(i,e) ujit.</i>	<i>(i,e) ujravet</i>	<i>-it/-ravet</i>
D.	<i>ujit</i>	<i>ujravet</i>	<i>-it/-ravet</i>
Ak.	<i>ujët</i>	<i>ujrat</i>	<i>-ët/-- rat</i>
Abl.	<i>ujit</i>	<i>ujravet</i>	<i>-it/-ravet</i>
N.	<i>djatht(ë)(il formaggio)</i>	<i>djathrat (i formaggi)</i>	<i>-thit/-ravet</i>
Gj.	<i>(i,e) djathit</i>	<i>djathravet</i>	<i>-it/-ravet</i>
D.	<i>djathit</i>	<i>djathravet</i>	<i>-it/-ravet</i>
Ak.	<i>djathë</i>	<i>djathrat</i>	<i>-e/-rat</i>
Abl.	<i>djathit</i>	<i>djathravet</i>	<i>-it/-ravet</i>
	Njëjësi	Shumësi	Opoz.
N.	<i>mishtë (carne)</i>	<i>mishrat</i>	<i>-të/-rat</i>
Gj.	<i>(i,e) mishit</i>	<i>(i,e) mishravet</i>	<i>-it/-ravet</i>
D.	<i>mishit</i>	<i>mishravet -it/</i>	<i>- ravet</i>
Ak.	<i>mishtë</i>	<i>mishrat</i>	<i>-të/-rat</i>
Abl.	<i>mishit</i>	<i>mishrave</i>	<i>-it/-rave</i>
N.	<i>t' ecur (il camminare)</i>	<i>t' ecurit</i>	<i>ø/-it</i>
Gj.	<i>(i,e) t' ecuri</i>	<i>(i,e) t' ecurit</i>	<i>ø/-t</i>
D.	<i>t' ecuri</i>	<i>t' ecurit</i>	<i>ø/-t</i>
Ak.	<i>t' ecur</i>	<i>t' ecurit</i>	<i>ø/-t</i>
Abl.	<i>t' ecuri</i>	<i>t' ecurit</i>	<i>ø/-t</i>
N.	<i>t' ecura</i>	<i>t' ecurat</i>	<i>ø/-t</i>
Gj.	<i>(i,e) t' ecurave</i>	<i>(i,e) t' ecuravet</i>	<i>ø/-t</i>
D.	<i>t' ecurave</i>	<i>t' ecuravet</i>	<i>ø/-t</i>
Ak.	<i>t' ecura</i>	<i>t' ecurat</i>	<i>ø/-t</i>
Abl.	<i>t' ecurish</i>	<i>t' ecuravet</i>	<i>-ish/-avet</i>

Nga vetë shembujt shihet qartë, se emrat në të tria gjinitë në numrin njëjës dhe në numrin shumës marrin këto mbaresa:

	Njëj. mash.	Njëj. fem.	Njëj. asnj.
N.	-i, -u	-a, -ja -	të, -t
Gj.	-it, -ut	-s	-t
D.	-it, -ut	-s	-t
Ak.	-in, -un	-n	-të, -t
Abl.	-it, -ut	-s	-t, -ish
	Shum. mash.	Shum. fem.	Shum. asnj.
N.	-t	-t	-t
Gj.	-vet	-vet	-vet
D.	-vet	-vet	-vet
Ak.	-t	-t	-t
Abl.	-vet	-vet	-vet

Pra, siç u pa edhe këtu më sipër nga paradigmat e shtruar, emrat përveç gjinisë, shquarsisë dhe rasës, në këtë të folme kanë edhe numrin, që mund të dalin në shumës ose vetëm në njëjës.

Emrat që përdoren vetëm në njëjës: *guxim (coraggio)*, *grari (le donne)*, *djalëri (gioventù)*, *gjindje (gente)*, *këlqere (calce)*, *rërë (sabbia)*, *gji:z (ricotta)*, *fruth (morbillo)*, *va:p (calore)*, *thekër (segala)*, *tërshërë (avena)*, *shëndet (salute)*, *diell (sole)*, *arbërishtja (l'albanese)*, *kimia chimica*) e të tjerë. Ndërsa vetëm në numrin shumës, më dendur dalin këta emra: *ko:lla (tosse)*, *brekt (mutande)*, *t'korrrat (mietitore)*, *t'mbjellat (seminare)*, *t'shtipurit (... e grurit) (la trabbiatura)*, *prëngat (ceppi)*, *ethet (febbre)*, etj.

Është për t'u përmendur, se në arbërishten e Qeftit strukturën gramatikore të emrit nuk ka mundur ta trazojë as edhe ndikimi shumëvjeçar i italishtes, edhe pse në shumë segmente gjuhësore është evident, por tek emrat ky ndikim as sesi nuk arriti në thellësitë strukturore. Megjithatë, ndonjë përjashtim i vogël edhe mund të haset, sidomos kur në disa raste përdoret nominativi në vend të akuzativit, si psh.: // *mos më pëgë kutra // nuk vete se shpia u ka të shinj // kush jëma ka bje:rr//* etj.

Mbiemri.- Edhe në këtë idiomë dialektore, si edhe në shumë të tjera, mbiemri del dy farë: i nyjshëm dhe i panyjshëm, që shikuar anën funksionale të tyre, nuk kanë as më të voglin dallim midis tyre. Prandaj, dallimi hetohet vetëm në saje të treguesve gramatikorë.

Dihet mirëfilli se mbiemri emërton një tipar të frymorit, të sendit ose të ndonjë fenomeni, që si i tillë edhe në këtë të folme përshtatet me emrin në gjini, në numër, e një pjesë e tyre edhe në rasë. Kështu që mbiemri, si pjesë e ndryshueshme e ligjëratës edhe në të folmen e Qeftit ka kategoritë gramatikore: të gjinisë, të numrit, të shkallës, të rasës dhe të shquarsisë.

Këto kategori brendapërbrenda të të folmeve italo-arbëreshe dalin me dallime të dukshme, që pa dyshim kjo vetëkuptohet, sepse arritja e arbëreshëve në Itali është bërë nga territore të ndryshme të trungut të Arbërisë, në një anë, dhe krijimi i këtyre kolonive në dheun e huaj, në anën tjetër, është krijuar edhe me distanca të moteve, çfarë ka ndikuar edhe në lëvizjen e tipareve gjuhësore.

Në të folmen e Qeftit mbiemrat formohen në mënyra të ndryshme, por mënyrat më produktive për fjalëformimin e mbiemrave janë: prejardhja, konversioni dhe përbërja.

Megjithatë, edhe pse në numër janë më të pakët mbiemrat të parmë, këtu në Qeft dëgjuam dhe i regjistruam nga folësit e moshave të ndryshme, si: *i gja:γ*, *i mi:r*, *i ri*, etj. Edhe disa mbiemra me origjinë të huaj: *elegant*, *absolut*, *naiv* etj., që gjithsesi shkojnë me mbiemrat e parmë, që gjithashtu kanë gjetur shtrirje të mjaftueshme.

Mbiemrat me prejardhje, të cilët formohen me pjesëmarrjen e morfemave të ndryshme fjalëformuese, si me parashtesa, prapashtesa, nyjëzim e prapashtesim dhe nyjëzim e parashtesim e prapashtesim njëkohësisht janë evidentë në këtë të folme, si: *i pabërë*, *i paduruor*, *i palindur*, *anormal*, *antifashist*, *i proamerikan*, *djeps*, *shirës*, *mbiells*, *dialektor*, *atomik*, *frontal*, *i hershëm*, *i mëngët*, *i këtushëm* etj.

Mbiemrat e formuar me temë ndajfoljore dhe me temë foljore janë shumë të shpeshtë, si: *i largët*, *i tepërt*, *i sheshtë*, *i tëtimtë*, *i ngrohtë* etj. Mirëpo, mënyra e formimit të mbiemrave nga tema numërorësh, gjithashtu është mjaft produktive: *i ditë*, *i pestë*, *i shtatë* etj., që zakonisht janë të karakterit përkatës.

Mbiemrat e formuar me konversion, d.m.th. fjalë, të cilat nga pjesë të tjera të ligjëratës kalojnë në mbiemra pa ndonjë ndajshitesë, që pa dyshim, të tillat fjalë që e humbin paradigmen e tyre të parë, por në strukturën e kësaj idiome dialektore, fitojnë paradigma të reja, thjesht të karakterit mbiemëror, duke i marrë plotësisht edhe të gjitha kategoritë

e tjera gramatikore, që i përkasin një mbiemri, si: *prapanik, dokumentar, kiç, ndihmës* etj., janë mbiemra të shpeshtë.

Mbiemrat e formuar nga dy tema emërore në leksikun e arbërishtes së Qeftit kanë një shtrirje jashtëzakonisht të dendur, si psh.: *zëmbërgur, silesh, ngjirëhiri, dorëmbarë, fjalëmbël, zëmbërlig* etj.

Këtu më poshtë do t'i shtrojmë disa paradigma mbiemërore, për t'i parë më përafri, se si ata dalin në këtë të folme.

Gjinia e mbiemrave.- Dihet mirëfilli se forma e gjinisë mashkullore është trajta përfaqësuese e mbiemrit, sepse duke u mbështetur në disa rregulla të caktuara gjuhësore, formohet forma e gjinisë femërore, që këto rregulla vlejné si për mbiemrat e nyjshëm, ashtu edhe për të panyjshmit.

Mbiemrat e nyjshëm e formojné gjininë femërore, duke ndryshuar vetëm nyjën e përparme *i* të gjinisë mashkullore në *e*: *i madh–e madhe, i kuq–e kuqe, i pari– e para, i verdhi–e verdha* etj.

Edhe formimi gjinisë femërore të mbiemrave të panyjshëm në të folmen e Qeftit nuk ndryshon nga të folmet e tjera, nga se edhe në idiomën tonë, duke i shtuar temës së gjinisë mashkullore mbaresën femërorizuese *–e*, pa marrë parasysh se mbiemrat e tillë janë të parmë, të prejardhur a të formuar me konversion, formohet a ndërtohet një mbiemër i gjinisë femërore: *dimëror – dimërore, fluturak – fluturake, zëmbërak- zëmbërake, e keqe* etj.

Janë një varg mbiemrash femërorë në këtë të folme, të cilët për nga forma dalin të njëjtë me emrat femërorë përkatës: *pla:k (gruo pla:k), verdhake, kuqëlore, bardhulore* etj. Mirëpo, duhet përmendur me këtë rast, kur është fjala për formimin e gjinisë femërore të mbiemrave të tillë, jo shpesh, por megjithatë hasen edhe si mbiemra femërorë, të cilët dalin njësoj si në gjininë mashkullore, psh.: *flokart / po t' bukur flokart*², *gojëmbël // Shumë gojëmbël isht ajo vashëz // etj.*

Shkallët e mbiemrave.- Këtë kategori gramatikore e kanë vetëm mbiemrat cilësorë, sidomos kur shprehet në masë të ndryshme cilësia e tyre, përndryshe të tjerët nuk mund të shkallëzohen.

Aftësinë për ta shprehur cilësinë në mënyrë të shkallëzuar e kanë vetëm mbiemrat dhe pjesërisht edhe ndonjë adverb. Ky shkallëzim në këtë të folme shprehet në tri shkallë: në shkallën pohore, si: *vajza e mi:r*;

² E. Giordano, *Fjalor i Arbëreshvet t'Italisë, Castrovillari, 2000, aq..115*

në shkallën krahasore, kur cilësia e dhënë krahasohet me të njëjtën cilësi ose me një cilësi tjetër: //e ka motrën më t' mi:r se u //; në shkallën sipërore, kur mbiemri shpreh cilësinë në shkallë shumë të lartë, që zakonisht kjo realizohet, duke zmadhuar cilësinë e mbiemrit me anë të një mbiemri tjetër, a të një ndajfolje, e cila ka atë cilësi në shkallë të lartë: //kjo e vogla isht më e bukura //.

Mirëpo, duke bërë hulumtimet tona në këtë të folme, hasëm edhe në disa mbiemra, të cilët cilësinë e dhënë nuk mund ta shprehin si të shkallëzuar: *i pasmi, i vdekur, i pakëmbë* etj.

Lakimi i mbiemrave mashkullorë

Numri njëjës

	Trajta e pashquar	Trajta e shquar
N.	<i>burr i mi:r</i>	<i>burri i mi:r</i>
Gj.	<i>burri t' mi:r</i>	<i>burrit t' mi:r</i>
D.	<i>burr t' mi:r</i>	<i>burrit t' mi:r</i>
Kc.	<i>burr t' mi:r</i>	<i>burrin e mi:r</i>
Abl.	<i>burr t' mi:r</i>	<i>burrit t' mi:r</i>

Shumësi

	Trajta e pashquar	Trajta e shquar
N.	<i>burra t' mi:r</i>	<i>burrat e mi:r</i>
Gj.	<i>burrave t' mi:r</i>	<i>burrave t' mi:r</i>
D.	<i>burrave t' mi:r</i>	<i>burrave t' mi:r</i>
Ak.	<i>burra t' mi:r</i>	<i>burra t' mi:r</i>
Abl.	<i>burrave t' mi:r</i>	<i>burrave t' mi:r</i>

Lakimi i mbiemrave femërorë

Njëjësi

	Trajta e pashquar	Trajta e shquar
N.	<i>una:z t' gishtit</i>	<i>unaza e gishtit</i>
Gj.	<i>unaze t' gishti</i>	<i>unazës t' gishtit</i>
D.	<i>unaze t' gishtit</i>	<i>unazës t' gishtit</i>
Ak.	<i>una:z t' gishtit</i>	<i>unazën e gishtit</i>
Abl.	<i>unaze t' gishtit</i>	<i>unazës t' gishti</i>

Shumësi

	Trajta e pashquar	Trajta e shquar
N.	<i>unaza t' gishtit</i>	<i>unazat e gishtit</i>
Gj.	<i>unazave t' gishtit</i>	<i>unazave, t' gishtit</i>
D.	<i>unazave t' gishtit</i>	<i>unazavet t' gishtit</i>
Ak.	<i>unaza t' gishtit</i>	<i>unazat e gishtit</i>
Abl.	<i>unazash t' gishtit</i>	<i>unazave t' gishtit</i>

Ja këtu po i shtrojmë edhe disa mbiemra të tjerë, të cilët janë mjaft të përhapur në këtë të folme dhe si të tillë tregojnë cilësi:

i bardh, i kuq, i mblert, i madh, i vogël, i fo:rt, i shpe:jt, i nguar; e shurdhër, e dashur, e vickërr, e mi:r, e shpe:jt, e li:g, e ve:rdh etj.

Në të folmen e Qeftit alternimi i zanores në rrënjën e fjalës mbiemër, te disa mbiemra është mjet dallues midis njëjësit dhe shumësit, si p.sh.:

a/e: i gjat - të gjat, e gjatë - të gjeta // Mëngët më rrinjën

të gjeta - Le maniche mi restano linghe//³ //e lart(ë)- të lerta - shkolla të lerta, i madh - të mbdhenj, lisi gjatë - lisa t'gjeta etj.

o/i: i vogël - të vigjël // I vejen pas atij gjith(ë) të vigjëlit e katundit// etj.

Numërorët.- Edhe përkundër trysnisë së madhe të italishtes, që pa reshtur bën mbi arbërishten e Qeftit në të gjitha segmentet e saj, numërorët apo fjalët që shënojnë sasi të caktuara, ose shprehin marrëdhëniet e një sendi a frymori në sasi, janë ruajtur mjaft mirë deri në ditët tona.

Po nisemi nga numërori *një*, i cili del edhe në trajtën *njari*, por si rendor: *i pari, e para*, d.m.th. e ndërron krejtësisht natyrën e temës së fjalës.

Numërorët nga *dy* e lart, gjithmonë marrin mbaresën: **-i** për gjininë mashkullore dhe **-e** për gjininë femërore: *i pesti, e pesta, i shtati e shtata*, ose në kontekst: // *Isht e para hors//E treta vajti// Janë e vejen tre burra e tri gra etj.*

³ Mario Massaro, *Dizionario comparato delle parlate arbëreshe di Casalvecchio e Chieuti*, Apricena, 210, fq. 60

Numri *di* (*dy*) dhe *tre* kanë gjini: *tre trima – tri: vasha*. Për numrin *dy*, gjininë e përcakton kuantiteti i vokalit: *di*: (gj. femërore) dhe *di* (gj. mashkullore): // *vajtën di: gra/vajtën di burra* //

Gjithashtu edhe numërori *katër* ka gjini: *katër* për gjininë mashkullore dhe *katra* për gjininë femërore, si psh.: // *po vinjën katra* // *po vinjën katër*// etj.

	Num. themelorë	Num. rreshtorë
1	<i>një</i>	(i.e) <i>parë</i>
2	<i>di</i>	“ <i>ditë</i>
3	<i>tre</i>	“ <i>tretë</i>
4	<i>katër</i>	“ <i>katërt</i>
5	<i>pesë</i>	“ <i>pestë</i>
6	<i>gjashtë</i>	“ <i>gjashtë</i>
7	<i>shtatë</i>	“ <i>shtatë</i>
8	<i>tetë</i>	“ <i>tetë</i>
9	<i>nën</i>	“ <i>nëntë</i>
10	<i>dhjetë</i>	“ <i>dhjetë</i>
11	<i>njëmbëdhjetë</i>	“ <i>njëmbëdhjetë</i>
12	<i>dymbëdhjetë</i>	“ <i>dymbëdhjetë</i>
13	<i>trembëdhjetë</i>	“ <i>trembëdhjetë</i>
14	<i>katërmëdhjetë</i>	“ <i>katërmëdhjetë</i>
20	<i>njëzet</i>	“ <i>njëzet</i>
21	<i>njëzetënjë</i>	“ <i>njëzetënjëjtë</i>
22	<i>njëzetëdi</i>	“ <i>njëzetëditë</i>
30	<i>tredhjetë</i>	“ <i>tredhjetë</i>
40	<i>dizet (katërdhjetë)</i>	“ <i>dizetë</i>
50	<i>pesëdhjetë</i>	“ <i>pesëdhjetë</i>
60	<i>gjashtëdhjetë</i>	“ <i>gjashtëdhjetë</i>
70	<i>shtatëdhjetë</i>	“ <i>shtatëdhjetë</i>
80	<i>tetëdhjetë</i>	“ <i>tetëdhjetë</i>
90	<i>nëntëdhjetë</i>	“ <i>nëntëdhjetë</i>
100	<i>njëqind</i>	“ <i>njëqind</i>

102	<i>njëqindedi</i>	“ <i>njëqindeditë</i> ”
200	<i>diqind</i>	“ <i>diqind</i> ”
201	<i>diqind e një</i>	“ <i>diqindenjë</i> ”
300	<i>treqind</i>	“ <i>treqind</i> ”
400	<i>katërqind</i>	“ <i>katërqind</i> ”
500	<i>pesëqind</i>	“ <i>pesëqind</i> ”
1000	<i>njëmijë</i>	“ <i>njëmijëtë</i> ”
2000	<i>dimijë</i>	“ <i>dimijëtë</i> ”

Përemrat.- Përemri si pjesë e ligjëratës, në përgjithësi nëpër dialekte dhe të folme të shqipës del fort i larmishëm, por edhe mjaft i ndërlikuar për t’i shpjeguar dhe ndriçuar trajtat e shumta, që mund t’i ketë.

Pra, edhe në këtë të folme kemi hasur shumë forma e trajta, që pa dyshim janë me interes t’i vëmë në dukje dhe t’i shpjegojmë, për ta pasur një pasqyrë edhe për këtë segment të të folmes së Qefitit.

Në këtë të folme realizohen këta përemra:

Përemrat vetorë.- Në arbërishten e Qefitit përemrat vetorë janë: *u’ (io), ti (tu), ai (egli)- ajo(ella); na (noi), ju (voi), ata (essi)-ato (esse)*, të cilët po i përshkruajmë edhe në deklinacion.

Përemrat vetorë: *u’, ti, ai (ajo); na, ju, ata (ato)*

Veta I

	Njëjësi	Shumësi
N.	<i>u’ (io)</i>	<i>na (noi)</i>
Gj.	-	-
D.	<i>mua, më,</i>	<i>neve, na</i>
Ak.	<i>mua, më</i>	<i>neve, na</i>
Abl.	-	-

Veta II

	Njëjësi	Shumësi
N.	<i>ti (tu)</i>	<i>ju (voi)</i>
G.	-	-
D.	<i>tija, t'</i>	<i>juve, ju</i>
Acc.	<i>tija, t'</i>	<i>juve, ju</i>
Abl.	-	-

Veta III

	Njëj. mashk.	Njëj. fem.
N.	<i>ai (egli)</i>	<i>ajo (ella)</i>
Gj.	<i>(i,e) atija</i>	<i>(i,e) saj</i>
D.	<i>atija,</i>	<i>i asaj, e</i>
Ak.	<i>atë, e</i>	<i>atë, e</i>
Abl.	-	-

Shumësi

	Shum. m.	Shum. f.
N.	<i>ata (essi)</i>	<i>ato (esse))</i>
Gj.	<i>(i, e) tire, atireve</i>	<i>(i,e) tire, atireve</i>
D.	<i>atire, atireve</i>	<i>atire, atireve, i</i>
Acc.	<i>ata, i</i>	<i>ato, i</i>
Abl.	-	-

Përemrat dëftorë: *ki (kjo), ai (ajo);kta (kto), ata (ato)*

	Njëj. m.	Shum. m.
N.	<i>ki (questo)</i>	<i>kta (questi)</i>
Gj.	<i>(i,e) ktija</i>	<i>ktire, ktireve</i>
D.	<i>ktija</i>	<i>ktire, ktireve</i>
Ak.	<i>këtë</i>	<i>ktaj</i>
Abl.	-	-

	Njëj. f		Shum. f.
N.	<i>kjo (questa)</i>		<i>kto (queste)</i>
Gj.	<i>(i,e) ksaj</i>		<i>ktire</i>
D.	<i>ksaj</i>		<i>ktire</i>
Ak.	<i>ktë</i>		<i>kto</i>
Abl.	-		-
	Njëj. m.		Njëj. f.
N.	<i>ai (egli)</i>		<i>ajo (ella, essa)</i>
Gj.	<i>i,e atija</i>		<i>(i,e) asaj, (t'asaj, t'asana)</i>
D.	<i>atija</i>		<i>asaj, asanja</i>
Ak.	<i>atë</i>		<i>atë</i>
Abl.	-		-
	Shum. m.		Shum. f.
N.	<i>ata (essi)</i>		<i>ato (esse)</i>
Gj.	<i>(i, e) atire, atire(ve)</i>		<i>(i,e) tire, atire(ve)</i>
D.	<i>atire, atire(ve)</i>		<i>atire (ve)</i>
Ak.	<i>ata</i>		<i>ato</i>
Abl.	-		-
	Shum. për tri gjinitë		
N.	<i>ato (quelli-e)</i>		
Gj.	<i>(i,e) atire</i>		
D.	<i>atire</i>		
Ak.	<i>ato</i>		
Abl.	<i>atire</i>		

Përemrat pronorë: *jimi (jimja), të mit(të miat); joti (jotia); t'ut(ë), t'uot*

Njëj. m.

N. *jimi (il mio)*
 Gj. *(i,e) jimit*
 D. *jimit*
 Ak. *jimin*
 Abl. -

Njëj. f.

jimia (la mia)
(i,e) s'imes
s'imes
jimen
 -

Shum. për tri gjinitë

N. *t'imet*
 G. *(i,e) t'imvet*
 D. *t'imvet*
 Ak. *t'imet*
 Abl. -

Shum. m.

N. *joti (il tuo)*
 Gj. *(i,e) jotit*
 D. *jotit*
 Ak. *jotin*
 Abl. -

Shum. f.

jotia (la tua)
(i,e) jotes
jotes
joten
 -

Shum. për tri gjinitë

N. *t'otet (i tuoi – e)*
 Gj. *(i,e) t'otvet*
 D. *t'otvet*
 Ak. *t'otet*
 Abl. -

	Sing. m.	Sing. f.
N.	<i>joni</i>	<i>jonja</i>
G.	<i>(i,e) jonit</i>	<i>(i,e) jones</i>
D.	<i>jonit</i>	<i>jones</i>
Ak.	<i>jonin</i>	<i>jonin</i>
Abl.	-	-

Shum. për tri gjinitë

N.	<i>t' onet (i nostri)</i>
G.	<i>(i,e) t' onvet</i>
D.	<i>t' onvet</i>
Ak.	<i>t' onet</i>
Abl.	-

	Njëj. m.	Njëj. f.
N.	<i>juoji (il vistro)</i>	<i>juoja</i>
G.	<i>(i,e) juojit</i>	<i>(i,e) juojes</i>
D.	<i>juojit</i>	<i>juojes</i>
Acc.	<i>juojin</i>	<i>juojen</i>
Abl.	-	-

Shum. për tri gjinitë

N.	<i>t' uojt</i>
Gj.	<i>(i,e) t' uojvet</i>
D.	<i>t' uojvet</i>
Ak.	<i>t' uoj</i>
Abl.	-

Përemrat pyetës. - Në të folmen e Qeftit edhe këta përemra janë ruajtur mirë dhe në komunikim janë mjaft të shpeshtë, si: *kush (chi)*, *cili-cila (chi)*, *cilët-cilat (quali)*, dhe *çë (che)*

Përemrat e pacaktuar.- Në strukturën e së folmes, të cilën e kemi objekt studimi, mjaft dendur i kemi hasur edhe përemrat e paku-fishëm, si: *ndonjë (qualche)*, *mosnjë (nessuno-a)*, *nganjë (ognuno)*, *njari, gjith (tuto-a)*, *mosnjë (nessun uomo)*, *dikush, kurrkush, tjetri (l'altro)*, *mosgjë (niente)*, *kurgjë (ngë shtojën kurgjë fjalëve t'saja)*, *asgjë etj.*

Bibliografia

- AA.VV.**, *Alfabetizzazione Arbëreshe*, 2 volumi, Edizione Il Capitello, Torino, 2000.
- Altimari**, Francesco, *Studi linguistici arbëreshë*, Quanderni di Zjarri, vol. 12, San Demetrio Corone, 1988.
- Altimari**, Francesco, *Vëzhgime gjuhësore dhe letrare arbëreshe*, Prishtinë, 2002.
- Altimari**, Francesco, *Gjurmë të paskajoreve të shqipes në arbërishten e Italisë: Përjasje diakronike, në Çështje të studimeve diakronike të shqipes* (ASHAK), Prishtinë, 2010.
- Badallaj**, Imri, *E folmja e Hasit*, Prishtina, 2001.
- Badallaj**, Imri, *Sistemi vokalik i të folmes së Kazallveqit*, Jeta Arbëreshe, nr. 80, Eianina (Italia), 2016.
- Badallaj**, Imri, *Disa dukuri fonetike në arbërishten e Kazallveqit*, Jeta Arbëreshe, nr. 83, Eianina (Italia), 2017.
- Badallaj**, Imri, *Vrojtime gjuhësore*, Prishtinë, 2017.
- Badallaj**, Imri, Martin Camaj në këndvështrimin e studimeve italo-arbëreshe, në *Studime albanistike në Itali*, ASHAK, Prishtinë, 2019.
- Badallaj**, Imri, Rreth kuantitetit të vokaleve në “Mesharin” e Gjon Buzukut, Seminari XVII
- Badallaj**, Imri, Particolarità linguistiche della parlata di Chieuti, Apricena (Italia), 2011.
- Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, Tiranë, 1996.
- Badallaj**, Imri, *E folmja arbëreshe e Kazallveqit*, Prishtinë, 2017.
- Camaj**, Martin, *La parlata albanese di Greci in Provincia di Avellino*, Firenze, 1971.
- Camaj**, Martin, *La parlata arbëreshe di San Costantino Albanese in Provincia di Potenza*, 1993.
- Camarda**, Demetrio, *Saggio di Grammatologia comparatasulla lingua albanese*, Livorno, 1864.
- Camarda**, Demetrio, *Appendice al Saggio di Grammatologia comparata sulla lingua albanese*, Prato, 1866.
- Çabej**, Eqrem, *Italo-Albanische Studien*, Universität Wien (doktorat), 1933.
- De Rosa**, Luis, *Elementi di grammatica albanese- arbëreshe del Molise*, Rur, 2005.
- Eric**, Hamp, *La parlata di Vaccarizzo Albanese: premesse fonetiche, në I dialetti italo-albanesi*, Roma, 1994.
- Figlia**, Niccolò, *Il Codice Chieutino*—a cura di M.Mandalà, Comune di Mezzojuso, 1995.

- Fiorilli**, Giuseppe, *Dizionario Arbresh di Ururi*, (Ch), 2002.
- Fortino**, I. Costante, *Frangjisk Andon Santori, Romanci i tretë: Brisandë, Lletixja e Ulladheni, transkriptimi i tekstit origjinal të pabotuar dhe ndryshimet e redaktimit të parë, me një hyrje dhe një Fjalorth nga I. K. Fortino*, Stab.Tipografico Biondi, Cosenza, 1977, pp.225.
- Fortino** I. Costante, *Giulio Varibobba, La Vita di Maria*, Edizioni Brenner, Cosenza 1984, pp.347.
- Fortino**, I. Costante, *Osservazioni sull'infinito in albanese. Contributo delle parlate e della letteratura arbëreshe në Problemi di morfologia della lingua albanese. Atti dl IV Convegno Internazionale di Studi sulla Lingua Albanese, Fisciano, 1-2 dicembre 1992, a cura di Addolorata Landi Patricia del Puente*, Salerno 1993.
- Giordano**, Agostino, *Shënime mbi të folmet arbëreshe të Ejaninës dhe të Frasnitës, në Jeta Arbëreshe*, nr.82, Eianina (Itali), 2016.
- Giordano**, Emanuele, *Fjalor i Arbëreshvet t'Italisë*, Edizioni Paoline, Bari 1963.
- Giordano**, Emanuele, *Fjalor*, II edizione, ed. IlCosile, Castrovillari 2000.
- Giordano**, Emanuele, *Gramatikë Arbëreshe*, Manduria (Ta), 2005.
- Hamp**, Eric, *La parlata di Vaccarizzo Albanese*, premesse fonetiche, *I dialetti italo-albanesi*, Roma, 1944.
- Ismajli**, Rexhep, *Rrënjë e fortë (Antologji e poezisë bashkëkohore e Arbëreshëve të Italisë)*, Prishtinë, 1979.
- Ismajli**, Rexhep, *Gjuha shqipe e Kuvendit të Arbënit (1706) – Hulumtime grafiko-fonologjike*, Prishtinë, 1985.
- Ismajli**, Rexhep, *Gramatikë e parë e gjuhës shqipe (1710) – Studim, transkriptim dhe fotokopje*, Prishtinë, 1982.
- Ismajli**, Rexhep, *Rreth kuantitetit të vokaleve të theksuara të shqipes, Gjurmime albanologjike, III*, Prishtinë, 1973, 1975.
- Ismajli**, Rexhep, “Një gjuhë” dhe “për gjuhë”, Pejë, 1998
- Ismajli**, Rexhep, *Studime për historinë e shqipes në kontekst ballkanik*, ASHAK, Prishtinë, 2015.
- Lambertz** Maximilian, *Italo-albanische Dialektstudien, Die albanischen Mundarten in der italienischen Provinzen Compobasso und Foggia (Molise)*, in *Zeitschrift für vergleichende Sprachforschung*, (1923-1925).
- Guzzetta**, Antonino, *La parlata di Piana degli Albanesi*, Parte I – Fonologia, Palermo, 1978.
- La Piana**, Marco, *Studilinguistici albanesi – Varia*, Palermo, 1949.
- Leka**, Ferdinand-**Simoni**, Zef, *Fjalor shqip-italisht, Fjalori italisht-shqip*, Tiranë, 1996.

- Leotti**, Angelo, *Dizionario Albanese-Italiano*, Istituto per l'Europa Orientale, Roma, 1938.
- Librandi**, Vincenzo. *Grammatica Albanese*, Milano, 1896.
- Marchiano**, Michele, *Canti popolari Albanesi della Capitanata e del Molise*, Casa Editrice "Apulia", Martina Franca (Ta), 1912.
- Massaro**, Mario, *Dizionario comparato delle parlate arbëreshe di Casalvecchio e Chieuti*, Apricena, 2010
- Massaro**, Mario - **Badallaj**, Imri, *Chieuti e la sua parlata arbëreshe*, Apricena, 2012.
- Osmani**, Tomor, *Udha e shkronjave shqipe*, Tiranë, 2008.
- Savoia**, L. Mario, *I dialetti albanesi dell'Italia meridionale*, në *Lingua albanese dell'Italia meridionale*, Atti del I Convegno di Studi sulla Lingua Albanese, Fischiano, 5-7 dicembre 1989, Salerno 1991, f. 53-66.
- Solano**, Francesco, *La parlata albanese di Firmo*, Quaderni di Zjarri, 1983.
- Solano**, Francesco, *Le parlate albanese di San Basilee Plataci*, Quaderni di Zjarri, 4, San Demetrio (Italia).1985. Corone, 1979.
- Solano**, Francesco, *Manuale di lingua albanese*, Corigliano Calabro, 1972.
- Shkurtaç**, Gjovalin, *Ligjërimet arbëreshe*, Tiranë, 2006.
- Topalli**, Kolec, *Theksi në gjuhën shqipe*, Tiranë, 1995.
- Topalli**, Kolec, *Zhvillimi historik i diftongjeve të shqipes*, Tiranë, 1996.
- Topalli**, Kolec, *Shndërrime historike në sistemin zanor të gjuhës shqipe*, Tiranë, 1998.
- Topalli**, Kolec, *Mbylltoret e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2002
- Topalli**, Kolec, *Dukuritë fonetike të sistemit bashkëtingëllor të gjuhës shqipe*, Tiranë, 2004
- Topalli**, Kolec, *Fonetika historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2007.
- Topalli**, Kolec, *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2012.

81 '374.3 =18
811.18 '282.4(450) '374.3
811.18 '282.4(450) '36

Agostino Giordano, Itali

ARBËRISHTJA STANDARDE DHE *FJALORTHI* *ARBËRISHT-LËTISHT*

Kush më shumë e kush më pak, gjithë autorët arbëreshë kërkuan të përdorjen, te shkrimet e tyre, një arbërishte sa më të kulluar. Zu e u fol hapët për një 'koinè arbëreshe' me Zef Skiroin (1865-1927), ka Hora e Arbëreshëvet/Pa, poet e profesor gjuhje shqipe në Institutin Universitar 'L'Orientale' të Napolit, por 'koinè-ja arbëreshe' e tij është shumë 'shqipe'.

Zoti Emanuele Giordano (1920-2015), ka Frasnita/Cs, më parë se të punonej për një 'arbërishte standarde', ndër vitet '50 të shekullit 'shkuar, zu e adaptoi në gjuhë arbëreshe 'Meshën e shën Janijt Hrisostom' (të pjerrë shqip nga greqishtja ka Fan S.Noli (Korçë,1929) dhe e përdori te famullia e tij, Ejaninë/Cs. Vitin 1968, pra, te një formë koinëje shqipo-arbëreshe, qe botuar Grotaferratë/Rm dhe e përdorur ka Eparkia e Ungrës (po jo ka Eparkia e Horës s'Arbëreshëvet, që preferoi redaktimin zakonor në të folmen e Horës). Një 'kompromis gjuhësor' - si shkruan kryetari i Komisionës liturgjike të Eparkisë s'Ungrës, zot Francesco Solano - që mbajti parasish situatën politike të Shqipërisë, që asikohe lëngonej shumë nën regjimin e egër komunist: ki tekst u mendua se mund t'i nevojitej edhe bestarëvet të krishterë të Qishës Ortodhokse Shqiptare. E, pas 'Meshës s'Hrisostomit', edhe di t'tjera Shërbesa liturgjike bixantine (*Shërbesa e Vajit të shëjtë*, Ungër 1994; *Shërbesa e Pagëzimit të shëjtë*, Ungër 2006) qenë pjerrë te kjo 'formë koinëje arbro-shqipe', më shqipe se arbëreshe. S'kem harromi se Zoti E.Giordano, vitin 1963, kish edhe shtypur '*Fjalorin e Arbëreshëvet t'Italisë*' – vepër madhështore që përmban a) Leksik të t'folmevet arbëreshe, b) Fjalë të nxjerra nga më të shumët e veprave të shkrimtarëve arbëreshë, c) Fjalorin-dorëshkrim të B.Bilotës. Pas përvojës njëmbëdhjetvjeçare si drejtor i revistës '*Zëri i Arbëreshvet*'(1972-1982), Emanuele Giordano zu e u dha punës sistematike të përkthimeve 'sa më shumë arbërisht' të Vangjeleveve të e Frasnitës pa vënë dorë në redaktim e as në lekturë.

Shërbesavet Liturgjike Bixantine, në tekste e në muzikë; ndërkaq zu e hartoi një ‘Gramatikë Arbëreshe’. Kështu, ndër vitet ‘80-’90, zunë punët për një ‘arbërishte standarde’. E kur errú Ligja 482, vitin 1999, zoti Emanuele Giordano – trim tetëdhjetëvjeçar – duall me një edicionë të re të ‘Fjalorit’ (1963), kuj i shtoi, - edhe i ndihur ka u -, një ‘Fjalorth Italisht-Arbërisht’; e pra duall me përkthimin arbërisht (arbërishte standarde) të *Vangjelit të Shën Matesë* (2000). Po nd’atë vit dualltin nga shtëpi, në 2 vëllime, edhe ‘Alfabetizzazione Arbëreshe’, (të koautorëvet I.C.Fortino, E.Giordano, A.Giordano,

C.Stamile, E.Tocci, V.Bruno / *Il Capitello*, Torino 2000), ku u dha provë, nganjë si mundi, i një ‘koinè-je arbëreshe’. Kur pra, vitin 2002, themelova revistën ‘Jeta Arbëreshe’, zotilalë Emanuele Giordano u dha, shpirt e kurm, pas objektivit ‘Arbrishte Standarde’. Vitin 2005 shtëpi libret ‘Gramatikë Arbëreshe’ dhe ‘Himne Liturgjike bizantino-arbëreshe’, tekste në muzikë bizantine. Vitin 2006 shtypi libret ‘Vangjeli’ dhe ‘Mbledhje këndimesh arbereshë’, tekste në muzikë perëndimore.

Ndërsa, mbi rivistën ‘Jeta Arbëreshe’, – njera ndë shkurt 2015, muaji i vdekjes s’tij - Emanuele Giordano vijoi tue pjerrë arbërisht (Arbërishte Standarde) e tue përfunduar (e pjesërisht botuar mbi rivistën, o si **e-book** mbi sitinweb e rivistës, **jetarbreshe.it**), - edhe me ndihmën time -, pothuaj gjithë ‘Shërbesat Liturgjike’ të ritit bixantin, e jo vet.

Përvoja ime personale, pra, në shkrimin arbëresh, ka pasur ndërrime gjatë vitevet. Në fushën poetike, zura vitrat ’70 të shekullit shkuar me poezi të shkruara arbërisht, me gjë ‘stërpikje shqipe’ (*Hroaza* 1971) dhe i mbëllijta me poezi të shkruara shqip (*Hapa mbi kalldrëm, Shkup* 1976). Vijova të përdorja shqipen njera ndë fund të vitevet ’90 (*Bota Arbëreshe, Tiranë* 1997). Pra, me themelimin e rivistës ‘Jeta Arbëreshe, vitin 2002, ndërrova. Me të zu ‘stina e Arbërishtes’: nga t’Folmet katundare njera te ‘Arbrishtja standarde’.

Mbi ‘J.A., bashkëpunëtorët shkruajen tek t’Folmet arbëreshe katundare’, kurse u, mësegjithë tek Editorialet, qella përpara një shkrim arbëresh më t’kulluar. Mbi ‘Arbrishten Standarde’ zura e shkruajta hapët vitin 2006, te Kriearikulli ‘Arbërishtja standarde’: “(...) *Ndë Shqipëri dhe Kosovë u hap diskutimi mbi Shqipen standarde, këtu në Arbëri ish mirë ndëse zë’ e diskutojim mbi Arbërishten standarde. Ndër të Folmet Arbëreshe gjëmi adhe, këtu këtë, gjallëri leksikore dhe thjellsí gramatikore. Prandaj arbëreshi, ndëse do, mund të shkruanj arbërisht, e mirë. Po ka të verë mbatanë kufinjvet lokalë e të marrë hua*

ka të tjerët katunde arbëreshë ato fjalë dhe ato forma gramatikore që te katundi i tij u buartin o u shtrëmbuan. E, ndëse gjë fjalë Arbërishtja s'i ka, ka t'i marrë, me urtësi, ka gjuha-motër shqipe. Arbërishtja standarde kish t'ish ëndrra e çdo shkrimtari arbëresh, arritja e çdo studiuesi arbëresh. Të shkohet tek Shqipja, pa njohur e pa provuar mundësitë e Arbërishtes, është si të bëhesh burr pa qënë trim. Arbëria ka mundësi të fshehta në gjithë fushat, duhen vet zbuluar.

Zëmi ka Gjuha. Zëmi e stismi Gjuhën Standarde Arbëreshe. (Nga Kriekartikulli 'Arbërishtja standarde', J.A.nr.49/2006).

E vitin 2009, në Seminarin për Gjuhën e Kulturën Shqipe, në Prishtinë, mbajta kumtesën 'Arbërishtja, arbërishtja standarde, shqipja'.

Vitin pas, 2010, Prishtinë mbajta njetër kumtesë: 'Prirje për një farë standardizimi të Arbërishtes: kontributi i Emanuele Giordano-s'.

Te viti 2013, pra, plotësoja kthimin tim poetik në 'arbërishten standarde', me përmbledhjen 'Telet e zëmrës' (Faik Konica, Prishtinë 2013), ku arbëreshizova edhe, sa munda, poezitë e mëparshme, të shkruara shqip.

Me të vërtetë, ç'kur duall Ligja 482/99, e si zura e botova rivistën J.A., fjalimet e mi ndër kuvendet ku mora pjesë, mbrënda e jashtë Arbërisë, i mbajta ngaherë në gjuhë arbëreshe, te nj'Arbrishte standarde. Ndiha, pra, sa munda lalën Emanuele zot Giordano në t'pjerrit arbrisht të Vangjelevet dhe të Tekstevet Liturgjikë bixantinë. Me të vërtetë unë u shtijta edhe më atë se lala, arbreshizova edhe më shumë ca tekste liturgjikë, - si për shembull, 'Meshën e shën Janjit Hrisostom'. Po Eparkia e Ungrës mënon të nxjerë hundën përjashta djepes s'varesisë. Ndërkaq bestarët arbëreshë presën...

Fjalorthi Arbërisht-Lëtisht

Bashkëpunimi i Arbëreshëvet me J.A., vitin 2002, zu mirë. E, për t'i jipej atyre një ndihmë tek të shkruarit arbërisht, mendova, bashkë me lalën, të dilej me një 'Fjalorth Arbërisht-Lëtisht'(nr.21,2003, f.7): fjalë të nxjerra nga 'Fjalori' i tij (E.Giordano). Fjalët i zgjodha ngaherë u, dhe firma e lalës dil ëh e jo. Vajta kështu përpara njera te shkronja 'O' (nr.90/2020). Pra, pësë vjet pas vdekjes s'lalës - edhe sepse kopjet e 'Fjalorit' të tij, të ribotuar vitin 2000, ishen po t'mbarojen - mendova t'e mbaroja të tërë 'Fjalorthin' dhe pra t'e nxirja si 'e-book' mbi sitin-web të rivistës (**jetarbreshe.it**), ku mund t'shkarkohej.

E kështu zgjodha një ‘Metodë’ për redaktimin e këtij *Fjalorthi*. Fjalorth xhepi, i thjeshtë.

Metoda, në dica pika kriesore

1. Përdorënj Allfabetin e Monastirit, kuj i shtonj shkronjën ‘hj’, që djovaset si ‘χ’-ja greke (për sh.: *hjë, hjidhí, hjódha, éhje*), ndërsa, tek ‘Fjalori i Arbëreshëvet t’Italisë’ i E.Giordano-s, fjalët që zënë me ‘hj’ gjënden mbrënda shkronjës ‘h’.

- Shkronja ‘l’ ká tringëllin lëti/italljan “glià, gliè, gli, gliò, gliù” (për sh.: *lalë, lesh, lip, lopë, lugë*);

- Shkronja ‘ll’ ká tringëllin lëti/italljan “la, le, li, lo, lu”, (për sh.: *llamë, llezë, ill, llóre, llumbárdhë*);

2. Vijonj ‘Rregullat e Drejtshkrimit’ të gjuhës shqipe’. Po zanoren ‘y’ s’e kanë Arbëreshët, as tek t’folit sa tek t’shkruarit; vendin e saj e muar ‘i’-ja o ‘u’-ja. Te Fjalorthi citonj fjalët me ‘y’-në, po pra dërgonj te forma arbëreshe (për sh.: *ky → ki, ynë → inë, atý → ati*);

3. Veç studimit të ‘Fjalorit’ t’E.Giordano-s, ka po buron ki ‘Fjalorth’, djovasa me ré edhe: a) ndríshe

‘Fjalorë’ të t’Folmevet Arbëreshe të këtire katundeve: *Qefti e Kazallveqi/Fg* (M. Massaro), *Shën Marcani/Ta* (G. Gallo), *Katundi/Av* (L. Perillo, L. Gliatta, N. Scrima), *Shën Kostandini Arbëresh* (P. Scutari), *Hora e Arbëreshëvet/Pa* (G. Schirò di Modica, G.Gerbino), *Ruri* (L. De Rosa),

Marçedhuza (G.Gangale); b) *Arbashkuar* (C.Bellusci-F.D’Agostino); c) ‘*Lexicon i Rapsodivet*’ të

J. De Radës; c) ‘*Fjalorin shqip-italisht*’(2003) e *Fjalorin italisht-shqip*’(2002) të shqiptarëvet

F.Leka e Z.Simoni; d) ‘*Fjalorin drejtshkrimor të gjuhës shqipe*’, të Akademisë së Shkencave të RPS të Shqipërisë, Tiranë 1976; e) ‘*Vocabolario Calabrese-Italiano*’, L.Accattatis (Castrovillari 1895); f) ‘*Vocabolario della Lingua Italiana*’, Treccani (Il Conciso, Roma 1998).

4. Kjo e Fjalorthit është një ‘Arbërishte standarde’. U nisa ka leksiku i t’Folmevet Arbëreshe; shosha leksikon e autorëvet arbëreshë; mbajta përpara sívet leksikon e standardit shqiptar; e zgjodha ato fjalë që përdorjën e ndëlgojën arbëreshët dhe ç’shqiptarët kuptojën. Zgjodha leksikon më të thjeshtë e të përbashkët e kështu kërkova t’lidhënj arbërishten e shqipen. Për Arbëreshët është një bazë e sigurtë leksikale, e besueshme, dhe e vërtetuar ka storja gjuhësore arbëreshe, aq shoqërore sa letrare; një bazë nga ku mund t’niset njetër herë Arbëria, si pakicë gjuhësore e vërtetë: e lashtë, po e fortë dhe e gjallë.

5. Lé ka nj’anë: arbërishten letrare e vjetruar dhe neologjizmet; letërsinë arbëreshe (e djeshme dhe e sotme) ku përdoret vet shqipja; italljanizme dhe fjalë djalektale lëtire të arbëreshizuara; fjalë tipike të t’Folmevet arbëreshe katundare.

6. Arbërishtja e ‘Fjalorthit’ ndahet kështu: ajo e folur ka populli (pjesa më e gjerë), ajo që gjëndet te Rapsodhët (*raps.*) o te Kalimeret (*kal.*); ajo e përdorur ka autorët arbëreshë (*letr.*) o fjalë të marrë hua ka Shqipja (*shq.*).

7. Të foljevet citonj të parën vetë të s’tashmes dëftore, në të gjitha format: vetvetore (*për sh.: bëhem*), o e ndërsjelltë (*për sh.: gjëtem*), o vetvetore+e ndërsjelltë (*për sh.: bashkohem*), o jokalimtare përemrore (*për sh.: bërem*), o pavetore (*për sh.: flitet*).

8. Hereherë citonj dí forma të një fjälje: atë t’përdorur më shumë ka arbëreshët dhe atë më pak (po krejt e përdorur nga shqiptarët) (*për sh.: gjálpër / gjárpër, gjisht / gisht, gramísënj / gremísënj*).

9. Hereherë siglla *shq.* kallëzon një fjalë pothuaj si ajo arbëreshe (*p.sh.: gjëndje → gjëndje*).

10. Shkruanj të ngjitura ato fjalë që fonetikiisht shqiptohen gjithnjë e formojën ndajfolje o përemra (*p.sh.: gjategjërë, buzëkùq*).

11. Ndërronj lidhjet konsonantike ‘fj’ në ‘fl’, ‘bj në bl’, ‘pj’ në ‘pl’ sepse të përdorur ka dica t’folme arbëreshe e ka Shqipëria. (*për sh.: fjamur → flamur; bjenj → blenj, bithëpjotë → bithëplotë*);

12. Për të dihet ndëse një fjalë përdoret ka populli, nisem ka njohuritë e veta, pra vrenj si është e shënuar te Fjalori i E.Giordanos; ndëse pra përdoret aq ka populli sa ka autorët, përdorënj siglën /letr. (për sh.: *bádhër-dhra*)

13. Fjalët monosillabike nëng i theksonj/; gjithë t'tjerat i shënonj me theks të mprehtë. (për sh.: *áfër, agjërím*)

14. Ëmrat që kanë shumësin e parregulltë, i citonj vet te forma e pacaktuar. (për sh.: *háll-héle, kalth-kuélz, kallí-kálléz*);

15. Shumë herë, te një 'fëmilë fjalësh', Arbërishtja

a. mbajti fòljen (për sh.: *harrónj, harróhem*), po buar ëmrin, që pra formon, me pjesoren e foljes të lakuar në gjini asnjànëse (*harrúar-it (të)*). Ëmri, o gjëndet tek autorët arbëreshë, o te shqipja (për sh.: *fërkónj, fërkóhem; // fërkím (letr./shq.)*);

b. mbajti ëmrin, po jo foljen (për sh.: *hjidhí // hjidhísënj, hjidhísem /letr.*);

c. mbajti mbiëmrin, po jo ëmrin (për sh.: *gjérë (i,e,të) // gjerësi /letr.*);

d. mbajti ndajfoljen, po jo ëmrin e foljen (për sh.: *bashkë; / bashkí, bashkonj /letr.*)

16. Mbiëmrat dhe përëmrat vetorë, dëftorë, pronorë, lidhorë, etj..., i citonj vet në formën njëjës të rasës ëmërore (për sh.: *im-e/ími-ja, it-íti/jote-jótja, etj...*)

Me të vërtetë, i pari qëllim, në redaktimin e *Fjalorthit*, që aì t'i jipej/t Arbëreshëvet, samëparë/shpejt, një *Fjalorth xhepi e të thjeshtë*, për të përdorënj 'arbërishten standarde' ngahërë ç'i lipset, tek t'folit e tek t'shkruarit. Si një mik i urtë që të mban mendë fjalën e harruar, që t'këshillon fjalën e duhur për çdo fjalim. Sepse kjo 'orë historike' për Arbërishten është e rrëzikshme. E Shpisë Arbëreshe i duhen shtëlla të rea, për mos t'bjerë.

E para 'Vlerë Arbëreshe' që rrëzikon, më se t'tjerat, është Gjuha. Gjuha Arbëreshe, Arbërishtja. Vëni ré: kur përpiqemi me jetrin, Fjala është e para që përdoret, më parë se shtrëngimi i Dorës; e, ndëse fjala s'mbahet e gjallë, e pastër, mund e zërë ndrishku, mund

xhavaret/çmprehet, mund grisët, mund shkatërrohet, mund harrohet. E Fjala e Arbëreshit, me të vërtetë, vete ture u grisur. Ture u harruar. Janë ata që mbledhën leksik katundar, e bëjnë punë të merituar. Po nëng sosën. E Folmja katundare rron sa rron katundi, sa rrojën folsit e katundit. Po një Gjuhë meriton të rronjë më se një e folme katundare t'asaj gjuhje.

Si lehet Standardja? Nga çdo e Folme Arbëreshe zgjidhen ato fjalë, ato forma gramatikore e sintaksore që mbajnë të pacënuar bukurinë e parë të Arbërishtes. E duan zgjedhur jo vet ndëpërmes të Folmevet, po kjo zgjedhje do bënë edhe ndër veprat e autorëvet arbëreshë. Kështu dërtohet Arbërishtja Standarde. E, për të gjetur leksik sa më arbëresh, ish mirë t'vehej prapë, te 'rrënjat e arbrishtes', tek t'paret shkrimtarë arbreshë, ata që s'pat'tin fare, o pak, kontakte me shkrimtarë shqiptarë (njera te shek.XVIII); sepse, ç'ka De Rada e këtej, (shek.XIX), huazime gjuhësorë shqiptarë, ku më shumë e ku më pak, i gjën ndër veprat e autorëvet arbëreshë.

E kështu, për të mirën e Arbërisë, brezevet të rinj i trashëgohet një Arbërishte e kulluar: sa më e ndëlgúame/kuptuashme ka Arbëreshët, sa më afër Shqipës. Një Gjuhë që shkruesi, gazetari, shkrimtari arbëresh mund t'përdorënj thjeshtë. Një Gjuhë që i duhet samëshumë atire katundeve arbëreshë ç'e buartin t'Folmen e tire, o ç'janë po t'e bjerën, o ç'e kanë ashtu të shkatërruar sa kanë turpë t'e foljën/flasën e t'e shkruajën.

Po kujdes! Një Gjuhë vlen aq për t'e folsh sa për t'e shkruash! Një Fjalor shfletohet, këshillohet/konsultohet, studjohet aq për t'shkruash sa për t'folsh. Çdo katundar, njera t'vdesë, flet gjuhën katundare; po ndëse do t'e mirësonjë gjuhën ç'folen/flet, ka t'hapënj fjalorin. Nj'Fjalor është fjalor: ndihën gjuhën e pendën. Nëng do zvogëluar vlerja e fjalorit. Ashtu edhe Fjalorthi i Arbërishtes Standarde: i bën mirë Arbërishtes e Arbëreshvet, Fòlësvet e Shkrùesvet. Të dive.

Arbërishtja Standarde i shton nderë Arbëreshëvet. E i jep vlerjen e duhur t'Folmevet Arbëreshe si edhe gjithë Autorëvet arbëreshe, ç'ka Matranga (shek.XVI) e këtej, çë krijuan, - me ato t'Folme - një letërsi arbëreshe të çuditshme. E më parë se shqiptarët, që vuajen nën Turqit.

Edhe ndëse mënoi 50 vjet mbrej 'Shqipës standarde', sot edhe Arbëria mund t'ketë *Arbërishten* e saj *standarde*. Arbërishtja Standarde: Gjuhë me të drejta të plota, si 'Shqipja Standarde', motra e saj.

Përfundime

‘Fjalorthi’ ka, si Autor, ëmrin e Emanuele Giordano-s, sepse buron ka ‘Fjalori i Arbëreshëvet t’Italisë’ të tij (1963/2000), është një shkurtim i tij. Me të vërtetë, më se ndonjeri, kur djovasën ëmrin e zotit Emanuele Giordano si autor të ‘Fjalorthit’, mendon se është një dorëshkrim i tij, i mbetur pabotuar, e çë u redaktova e pra nxora në dritë. Jo, s’është kështu: qe imi mendimi të botoja Fjalorthin pakepak mbi rivistën Jeta Arbëreshe (dakord lala), imja zgjedhja e fjalëvet, imja puna hartuese për t’e botoja si ‘e-book’.

Fjalori i E.Giordano-s (1963) qëndron i pari ‘Fjalor i Arbëreshëvet’: atjè mbrënda gjëni arbëreshët me t’folmet e tire, dhe shkrimtarët arbëreshë me veprat e tire; fjalë e shprehje, idiomatizme e fjalë t’urta; neologjizme, italianizme e fjalë shqipe. Një enciklopedí leksikore arbëreshe. Ku fjalë katundare gërshetohen me fjalë të përbashkëta. Një Fjalor i pashoq.

‘Fjalorthi Arbërisht-Lëtisht’, përkundra, kur zu e u botua mbi faqet e J.A. (nr.21/2003), kish t’ish vet një ‘Leksikon thelbësor i Arbërishtes, për t’ndihnej Arbreshin tek t’folit e t’shkruarit e tij. E u lanë mbrënda italianizme t’arbreshizuar e samëgjë. E u vate përpara kështu njera tre vjet prapë, kur vendosa t’dilja në formë ‘e-book’ dhe Fjalorthit i dhë gjak e shpirt të një Arbërishte standarde. Domethënë zgjedha vet fjalë të përbashkta arbëreshe e le jashtë italianizme, lokalizme, neologjizme e, për sa munda, fjalë shqipe; po le disa fjalë me origjinë greke. Djovasa e studhjoja edhe të tjerë Fjalorë, ture plotësuar kështu leksikon e marrë ka Fjalori i E.Giordano-s. E zgjedha 4700 fjalë arbëreshe. Të përbashkëta. Një Arbërishte Standarde, e kulluar. Çë Arbëreshët ndëlgojën&flasën dhe çë Shqiptarët kuptojën. Domethënë se ‘Fjalorthi’ ndërroi lëkurë e mish gjatë vitevet, ashtu si mirrë këmbë Arbërishtja Standarde, te shkrimet-përkthimet e mi dhe te përkthimet-shkrimet e lalës.

Ja ‘rrura qëllimit? Mund t’e ketë edhe Arbëria një ‘Arbërishte standarde’, si Shqipëria ka ‘Shqipen Standarde’? Mund t’jetë. Varet ka Arbëreshët. Mësemë ka shkruarit e shkrimtarët arbëreshë. Sadopak, ki shërbim i buthton Arbëreshëvet sa e bukur e sa e shtrënjtë është Gjuha e tire; i buthton Shqiptarëvet: a) sa e bëgatë është Arbërishtja, b) sa fjalë Arbërishtja ka të përbashkëta me Shqipen,

c) sa Arbërishtja e fuqizon dhe e nderon Gjuhën tonë Mëmëtare; i buthton Lëtinjvet: a) si Arbërishtja është e vetmja Gjuhë e një Pakicje

gjuhësore historike nd'Italì çë, e xheshur ka t'gjitha huazimet, - e pas gjashtë shekujsh- mban hjënë e një Gjuhje të shëndoshtë. Një çudi. E 4.700 fjalët e 'Fjalorthit' e vërtetojnë.

Ndëse 'vet sot' Arbërishtja, si Gjuhë, zë e tëhelq vëmendjen e t'urtëvet dhe zbulon mundësitë e saja, ftesjën katedrat universitare të 'gjuhës e letërsisë shqipe' nd'Italì, çë këtij problemi i dhanë ngaherë pak vlerje. Sepse studiuan vet t'Folmet arbëreshe katundare, pa menduar se ka t'Folmet më t'mira mund t'dilë jashtë struktura e njëi 'Gjuhje të përbashkme Arbëreshe'. Arbërishtja standarde, pikërisht. Studimi zu, dhe qëndroi, vet mbi t'Folmet katundare: u rua gjishti e jo hëna, ç' ai gjisht buthtonej. Sepse, sipas mendimit të këtyre gjuhëtarëve arbëreshë, mundësitë gjuhësore të t'Folmevet arbëreshe katundare ishen shumë të pakta, të vogla. E kjo 'miopí' dënoi fort t'lerit e 'Arbërishtes standarde' e shtijti shkrues e shkrimtarë arbëreshë të shlllohshin ndër krahët e Shqipës. O të Italishtes. Pa alternativën konkrete të një 'Gjuhje Arbëreshe të përbashkme', u preferua shqipja, o italishtja. Po Korsi universitar i 'Djalektevet Arbëreshë të Italisë s'Jugut' i hapur (1980) ka prof.F.Solano, në Universitatën e Kosenxës, kish kish pasur - si 'qëllim i fundit' – dhjaj krijimin e njëi 'Gjuhje Arbëreshe të përbashkme', dmth. të njëi 'Arbërishtje standarde'. Dhe kështu edhe Ligja 482/99 kish pasur një aktualizim normal: ndër katundet arbëreshë, mësimi i arbërishtes, për gjithë, u kish nisur ka 'e folmja lokale', për të shkuar pra, thjesht, tek 'arbërishtja standarde'. Po s'u bë kështu. U preferua:

a) të interpretohej 'shtrëmbur' (me dashje) Ligja 482, b) të imponohej drejtpërdrejt mësimi i shqipës,

c) të krijohet kaosi ndër skollat arbëreshe. E kështu të rinjvet arbëreshë ju shkund aq t'folurit e t'folmes s'tire katundare, sa ëndja t'shkruhshin në korset universitare të gjuhës shqipe. Imponimi i shqipës shkatërroi arbërishten e shqipen. Më turpja! Bie fjala ime: armiqtë e Arbëreshëvev rrojën mbrënda Arbërisë, armiqtë e Arbërishtes janë Arbëreshët. Pak, po të liq më se djalli.

Kërkimtarët arbëreshë, në vend të analixojen, për dhjetra vjet rresht, të Folmet Arbëreshë në gjithë çikërrimet e tyre shkencore - më të fshehta e t'holla e stërholla e t'kota e abstrakte (t'mira vet për t'shtipjen ujë te murtalli/havan) – kish kishen analizuar konkretisht vet 't'Folme më t'mira' ka ku t'mirrjen leksikun më të kulluar. Sot si sot, Arbërisë i lipset 'urtësia konkrete' çë prodhon pak, mirë e mbjatu. Arbëreshit nëng interesojën fare stërhollimet e Gjuhëtarëvev, çë ndajën qimen katrësh.

Falë ‘Jetës Arbëreshe’ e njoha prësafri, e konkretisht, botën gjuhësore arbëreshe dhe, me një idë të qartë ndë kríe, zura e eca udhën e ‘arbërishtes standarde’: e vetmja udhë – për mua - që mund shpëtonjë Arbërishten, aq tek t’folit sa tek shkruarit. Një zgjidhje që gjeta mbrënda Arbërisë, jo jashtë. Ndër t’folmet arbëreshe e mbrënda vepravet arbëreshe; e mësemë te ‘Fjalori’ i E.Giordanos. Afër e gjeta jatrinë, jo llargu. E s’ka ‘kundërkshillime/controindicazioni’ për shëndetën gjuhësore t’arbëreshëvet, s’ka ‘efekte anësore/effetti collaterali’. ‘Fjalorthi Arbërisht-Lëtisht’ mund i sjellë të vjelë/vjellje vet atíre që s’duan t’xënë.

Ki ‘Fjalorth’ është një dhuratë që, si drejtor i ‘Jetës Arbëreshe’ - në 21vjetorin e kësaj rivistje eroike e unike: 93 numra e 3.179 faqe t’shkruara arbërisht - i bën Arbëreshëvet t’urtë, që e duan ‘vërtet’ Arbërishten. Është ‘Fjalorth’ që mund t’mirësohet, patjetër. kur të mirren parasísh edhe t’tjera vepra autorësh arbëreshë, (të djeshëm e t’sotëm) që zoti E.Giordano s’kish, kur hartoi ‘Fjalorin e Arbëreshëvet t’Italisë (1963).

Mbrënda vitit 2025, pra, - kur bie dhjetëvjetori i vdekjes s’zotit E.Giordano (1920-2015) – këtij

‘Fjalorthi Arbërisht-Lëtisht’ do t’i shtohet e dijta edicionë e ‘Fjalorthit Lëtisht-Arbërisht’ (autorë Emanuele Giordano e Agostino Giordano): bashkë e kishem zënë, pas vitit 2000, po pra e lamë mënjanë. Në Arbërishte Standarde edhe ai. Një vepër ‘adhë më e duhur’ për Arbëreshët.

Evalda Paci, Tiranë

VËSHTRIME MBI LIGJËRIMIN KISHTAR E BIBLIK NË DISA VARIANTE UNGJILLORE NË GJUHËN SHQIPE

Abstrakt

Në këtë trajtesë tonën përpiqemi të vëmë në dukje rëndësinë e njohjes së disa varianteve ungjillore, të përpiluara disa dekada më parë, të mbetura në gjendje dorëshkrimi për shumë kohë. Rëndësia e njohjes së këtyre varianteve përbën një shtysë të rëndësishme dhe në vështrim të rindërtimit të një panorame më të plotë mbi shqipërimin e tekstit biblik dhe kontekstualizimin e tij në një kuadër që lidhet si me historinë e shkrimit të shqipes, si me tekstin letrar që receptohet në pjesë të veçanta të Biblës. Janë të larmishme përpjekjet për të sjellë në disa gjuhë variante të Biblës e të pjesëve të veçanta të saj, ashtu si janë komplekse dhe çështjet e reflektimit gjuhësor e letrar të tyre. Dhe Ungjijtë janë një burim gjurmimesh në pikëpamje të qëmtimit të letrarësisë dhe elementeve qenësore letrare, jo rrallë dhe argument diskutimesh mbi çështje të brendësimit tekstor dhe qasjesh me variante në disa gjuhë, ndër të cilat më të rëndësishme paraqiten ebraishtja, greqishtja e vjetër dhe gjuha latine. Çështjen e përpilimeve më të hershme të varianteve të Ungjijve dhe njohjen e tyre në shekujt e parë mbas lindjes së Krishtit e cekin në sprovat e tyre dhe Át Donat Kurti O.F.M. e Át Daniel Gjeçaj O.F.M., sigurisht në vështrimet e tyre individuale, por të domosdoshme për të kuptuar më mirë dhe objektivat e punës së tyre me tekstin biblik dhe hollësitë e përftesave përkatëse gjuhësore, stilistike dhe letrare. Sprovat e tyre janë pjesë e pandarë e një kuadri diakronik, që paraqitet përherë më i pasuruar dhe falë njohjes më të afërt nga studiuesit e fushës pas botimit besnik të teksteve të shqipëruara e të pajisura dhe me elemente kritike e shpjeguese.

Vëmendja ndaj ligjërimeve më specialistike që përfshijnë në mënyrë të drejtpërdrejtë gjuhën dhe përdorimet në tekste e përpilime nga fusha më të ngushta të kulturës e të lëvrimin libror ka pasur një rritje të ndjeshme dekadat e fundit, fakt që duket i ndikuar si nga ndryshime të caktuara të natyrës historike e shoqërore, ashtu dhe nga prirje që u reflektuan me botime të shtuara mbi tekstin biblik dhe traditën e njohjes së tij në kontekste të kulturës shqiptare.

Një traditë e pasur që u lëvrua në shfaqjet më të hershme nga autorë që përpiluan modele të lidhura me zhvillimet e kohës (shekujt

XVI-XVII), me reformimet në fushë të kulturës së librit dhe më tej, të atij kishtar e liturgjik, u pasua në shekuj të mëvonë nga të tjera zhvillime, që për nga shtysa dhe orientimi qenë dhe mbeten njaft themelore.

Shkrimi i Shenjtë, letërsia kishtarë dhe veprat që i përruan ato në gjuhën shqipe janë trajtuar në një sërë punimesh apo studimesh tematike, përfshirë dhe sprovat për të rindërtuar një panoramë të historisë së letërsisë së shkruar shqipe, me një prirje të qartë për t'i dhënë një hapësirë të konsiderueshme dhe dokumentimit shkrimor të gjuhës sonë në shekujt që lidhen me kulturën e shkrimit dhe përparimin e shtypshkrimit si teknologji.

Të flasësh për një gjuhë të liturgjisë, kërkon domosdoshmërisht të kesh në konsideratë një diakroni të mirëfilltë në realizime veprash e vepërzash, që cekin periudha të mëhershme të zhvillimeve në fushë të shkrimit shqip e të historikut specifik të tij për nga inicimi e më tej për nga profilizimi. Të marrësh në shqyrtim një itinerar të mirëfilltë në pikëpamje studimesh e përpilimesh dhe në lidhje me transmetimin e tekstit biblik në gjuhën shqipe, kërkon gjithashtu të ngërthesh në një optikë të përbashkuar sprova, kontribute, reflektime nga tradita të afërta që ndikuan gjerësisht dhe në procese të shkrimit e të përshtatjes dhe në gjuhën tonë. Tekste të natyrave të ndryshme, me orientime dhe ndaj praktikash shkollore dhe edukative në dekadat e para të shekullit të kaluar, nuk kanë munguar të reflektojnë një prirje të qartë për të përforcuar një leksik të mirëfilltë të liturgjisë së krishterë, të pasuar dhe nga botime më të thelluara, që sot rigëzojnë sërish vëmendjen e studiuesve të leksikografisë historike e disiplinave të tjera me objekt diakroninë e shqipes. Në veçanti këto sprova e njëkohësisht dëshmi të lëvrimin të regjistrave të veçantë gjuhësorë në gjuhën tonë mund të konsiderohen dhe si ndërmjetësues për përveçime që dhe në shekujt e mëparshëm u rimorën përmes autorësh të rëndësishëm, por u shoqëruan dhe me ndërtime të reja, që në një mënyrë ose tjetër u reflektuan në përpilime autoriale që i përkasin një periudhe më të veçantë si nga profili, ashtu nga konteksti gjeokulturor.

Ruajtja e një lidhjeje të natyrshme me përdorime të hershme që në të vërtetë qëndrojnë në thelb të çdo trajtëse që ka për objekt ndjekjen e një ecurie të veçantë në lidhje me leksikun e liturgjisë dhe me tekste që janë transmetuar në gjenerata, duke pasur parasysh dhe një traditë të ngulitur hershëm në psikologjinë e përdorimit përkatës përbën një domosdoshmëri që ka gjetur hapësirë reflektimi dhe në këtë punim tonin.

Ka jo pak modele e shembuj autorialë për t'u marrë në shqyrtim, ka dhe përpilues të veçantë që njihen e konsiderohen me të drejtë dhe autorë tekstesh që janë bërë pjesë e një rrugëtimi e përvijimi të gjinive letrare në gjuhën shqipe, si dhe pjesë e një diakronie përpilimesh që e kanë sjellë letërsinë e mëhershme shqipe në një kuadër të përshtatshëm për t'u përfshirë në historinë e letërsisë sonë të shkruar.¹

Për vetë objektin e veçantë dhe për vetë ecurinë në pikëpamje jo thjesht kronologjike, veprave që kanë përruruar shkrimin shqip në një këndvështrim kompleks për nga brendia dhe ndërtimi u duhet dhënë përherë një hapësirë më vete, që ka në vetvete dhe dimensionin analitik të tematikës së këtyre të fundit. Diversiteti i modeleve, pasuar nga kontribute që përtej rendit kronologjik, janë reflektim i përrurimit të sprovave të reja librore dhe në fushë të praktikës liturgjike, përbën një tjetër faktor që shtyn drejt orientimit të vëmendjes ndaj ruajtjes së ndërtimeve që nuk humbasin vlerën konotative (semantike), dhe pse konteksti i përrdorimit shpie drejt tekstesh më të ndryshme në pikëpamje të konkretizimit. Sprovat e lavdërueshme në këtë drejtim që janë konsideruar dhe përruruese ndaj shkrimit shqip dhe veçorive të reflektimit të tij, qoftë dhe në drejtim të një njësimi që vonoi të mbërrihej në pikëpamje kronologjike, meritojnë përrzgjedhje dhe evidentime që përtej ndarjeve të arsyetuara në aspektin kronologjik, i shërbejnë në të njëjtën kohë dhe vetë kontekstualizimit të letërsisë kishtarë në historinë e letërsisë së shkruar shqipe, e iniciuar si në shumë vende të tjera me arritje e realizime që mëtojnë të sjellin në shqip Shkrimin Shenjt, por dhe të tjera vepërza që mbështeten në këtë të fundit e duke mbetur në të njëjtën kohë instrumente të receptimit të një kulture të njohjes së besimit dhe të liturgjisë.²

Nuk janë të pakët përrpiluesit që i janë bashkuar një tradite që është vijuar jo në të njëjtën mënyrë a dinamikë në viset ku shqipja flitet e lëvrohet. Ndërkohë jo pak emra të përveçëm kujdesuesish do të duhej t'u bashkoheshin sprovave për të rindërtuar një sferë komplekse në terma, përveçime e përrdorime e në këtë vështrim, pavarësisht kohës kur

¹ Në librin e parë të shkruar në gjuhën shqipe e që në vijimësi e gjejmë të emërtuar si *Meshari* i Gjon Buzukut, do të mund të gjurmohet një sërë ndërtimesh që duke pasur përkatësi ndaj liturgjisë dhe observimit të ritualeve përkatëse, janë dhe një shtysë reflektimi për çka ruhet më vonë dhe si pasohet në një traditë shkrimi që ka dhe prurje të lidhura me shekujt në të cilët shkrimi shqip merr një zhvillim të mëtejshëm.

² Át Donat Kurti O.F.M., *Parathanje, në Biblja Shëjte (Testamenti i Rí) Kater Ungjijt - Punët e Apostujve. Blëni I*, Botime Françeskane, Shkodër, 2023.

realisht kanë konkretizuar veprimtarinë e tyre, konteksti gjegjësis do të paraqitej mjaft i pasuruar.³

Duhet vënë në dukje ndër të tjera që Tetëqinda mund të konsiderohet një shekull i rëndësishëm në pikëpamje të rimarrjes së teksteve të kësaj tematike, me prirje paralele që shohin sidomos në dekadat e fundit të aktivizuar edhe Mjedjen, edhe klerikë të tjerë, edhe Kostandin Kristoforidhin në përpilime që tashmë janë pjesë e një biblioteke antikuari që përbën dhe një udhërrëfyes të çmuar në pikëpamje të rindërtimit të një historiku të posaçëm kushtuar çështjeve të sipërcituara.⁴

Ndre Mjedja (1866-1937) përfaqëson një shembull të përpiluesit, shqipëruesit e përshtatësit që kishte në vëmendje tematikën e agjio-grafisë, përherë grishëse për studiuesit e teologjisë së krishterë, si dhe autorë të veçantë të letërsisë kishtare shqipe të shekujve XVI-XVII.⁵ Justin Rrota O.F.M. (1889-1964) e po ashtu, edhe V.Prennushi O.F.M. (1885-1949) (ky i fundit autor homelish të shkëlqyera që dëshmojnë dimensionin edukativ e baritor të tij) figurojnë në libërtha lutjesh që kanë marrë aprovimin përkatës të hierarkisë kishtare, ndërkohë që sintagma a përdorime të veçanta të përmbajtura në këto të fundit sot e kësaj dite vijnë të jenë referenciale në kontekste të celebrimit liturgjik, me një përfshirje të gjerë të popullit e besimtarëve.⁶

³ E kemi shtruar dhe më herët çështjen e vëzhgimeve krahasuese mes varianteve të përgatitura nga Át Donat Kurti O.F.M. dhe Át Daniel Gjecaj O.F.M., të lidhura me Besëlidhjen e Re, cilësuar nga të dy si Testamendi i Ri. Në punën e të dy përpiluesve dallohen prurje të një rëndësie të veçantë në vështrim të ndërtimeve të përfshira në tekste, një pjesë e mirë e të cilave është e lidhur me formimin përkatës individual të tyre dhe me praktikën e përdorimit konkret në liturgjinë e përditshme. Një vështrim i gjerë krahasues që merr në konsideratë dhe përpilimet e ngjashme të realizuara nga Át Benedikt Dema O.F.M. (1904-1971), do të mund të vinte në dukje dhe ngjashmëritë në disa raste ndërtimesh gjuhësore apo shprehjesh të përveçme, ashtu dhe ndryshimet e dukshme në pikëpamje metodologjike, që mund të shpjegohen si me zgjedhjet e vetë përpiluesve, ashtu dhe me veçanësi që burojnë nga vetë formimi i tyre.

⁴ Sa u përket botimeve doktrinare të përpiluara përgjatë këtij shekulli shih në veçanti Paci E., *Variante të hershme doktrinare në një kontekst të historisë së letërsisë së shkruar shqipe*, në *Studime filologjike*, n.3-4, 2018.

⁵ Mjedja D.N., *Ieta e Sceitit Sc'Gnon Berchmans*- Romë, 1889.; *T'perghjamit e Zojs Bekume*- Romë, 1892; *Katekizmi i math*, Shkodër, 1927; 1928; *She Luigj Gonzaga*, Shkodër, 1927; *Historija Shêjte*, Shkodër, 1928.

⁶ Prennushi V., O.F.M., *E para e Diele e t'Ardhunit (gjygji i gjithmarshem)*, në *Fjala e Zotit zhvillue nder të Dielë të Motmotit*, (*Predke mledhe e rreshtue prej P.Vincenc Prennushit O.F.M.*), Shtypshkroja Franciskane, Shkodër, 1918.

Ndihmesave të çmuara të Kristoforidhit të paraprirra nga sprova të mirëfillta dhe në pikëpamje të kontekstit në të cilin ky i fundit operoi me shqipërimet e tij, në veçanti Engjëll Sedaj u kushton krerë të tërë të veprës së tij *Bibla e përkthimet e saj në gjuhën shqipe*, botim i vitit 1999, në të cilin do të mund të gjejmë shtysë për të gjurmuar afri e përkime në përkthimtarinë e tij dhe më tej, vlera të një pune komplekse që meriton studime të plota e të thelluara.⁷ Sedaj nënvizon faktin që në bibliotekën e Kristoforidhit bënin pjesë botime si vepra “*Cuneus prophetarum*” e Pjetër Bogdanit dhe një prej ribotimeve të Doktrinës së Pjetër Budit, pikërisht ai i vitit 1664, fakte që e shtyjnë atë të përforconte bindjen për njohjen nga ana e tij e traditës letrare të sipërpërmendur.⁸ Përjasja ndaj përpilimeve të kësaj tematike, dhe pse nga natyra anojnë dhe nga sprovat katekistike, sigurisht me veçori që lidhen me vetë paracaktimin dhe inicimin e nismës së secilit prej tyre kërkon një rishikim të thelluar të ndërmarrjeve të autorëve, duke qenë vetëdija që vetë panorama analitike e ndihmesave të tilla i shërben mbi të gjitha pasurimit të kuadrit të njohurive dhe të arritjeve në fushë shqipërimesh e përgatitjesh për botim, por mbi të gjitha orienton dhe mbi afrinë, përkimet, prirjet dhe veçoritë e përdorimit të shqipes në variantet ekzistuese të saj në kohën e veprimtarisë së iniciatorëve të sipërcituar.

Nuk bëhet fjalë vetëm për diferencime dialektore apo për periudha të ndryshme në pikëpamje të realizimit të veprave të caktuara, me bazë shqipërimin e pjesëve të rëndësishme të Biblës, apo varianteve të tëra të Besëlidhjes së Vjetër dhe asaj të Re. Në gjurmimet ndaj veçorive gjuhësore e letrare, përafrimit përmbajtësor, por dhe tipareve që mbi të gjitha janë objekt i interesave studimore të hulumtuesve të disiplinave historike mbi gjuhën shqipe, variantet integrale të Biblës mbeten më interesantet në shumë pikëpamje, përfshirë dhe kureshtjen e biblistit, që gjen ndër të tjera ndikime nga tekste referenciale, më të saktësuar në raste të veçanta, akoma në proces trajtimi për ekzemplarë të veçantë. Një kureshtje e tillë u konkretizua në kushte të reja dhe në dekadat e fundit në vendin tonë, me botimet anastatike apo të përmirësuar që sërish panë të përfshirë studiuesit e teksteve të vjetra shqipe dhe të traditës së historisë së shkrimit të gjuhës sonë.

⁷ *Psalmet gegërisht dhe toskërisht, përgatiti për botim Xh.Lloshi*, Shoqëria Biblike Ndërkonfesionale e Shqipërisë, Tiranë, 2015.

⁸ Sedaj E., *Bibla e përkthimet e saj në gjuhën shqipe*, Botime Shtufi, 1999, f.191: Këtu duhet thënë gjithashtu se ndër librat e Kristoforidhit, që i ka ruajtur e bija Kleopatra (1939), gjendej *Cuneus prophetarum* e P.Bogdanit dhe (botimi i tretë) i *Doktrinës* (1664) së P.Budit, që do t'i kenë shërbyer si modele të pazëvendësueshme në punë e tij të përkthimit të librave të shenjtë.

Në pikëpamje të vështrimit analitik të një sërë aspektesh të ndërtimit të përmbajtjes, por dhe të përdorimeve që janë refleksi i qartë i përkatësisë ndaj regjistrash të veçantë leksikorë, të tilla përpilime, që pjesërisht janë tekste të hartuara nën qëllim ezegjetik e pjesërisht janë risjellje tekstesh biblike të rimarra tradicionalisht në praktikën liturgjike në gjuhën tonë, janë një shembull i qartë i faktit që kanoniciteti dhe përmbajtja ndaj normave nuk mund të konceptohet si diçka thellësisht absolute. Nga ana tjetër, në një optikë të përfshirjes së një sërë përpilimesh që datojnë në dekada të mëparshme e që janë referenciale në disa pikëpamje për përgatitësit e teksteve të natyrës celebrative-liturgjike, siç paraqiten dhe nismat e Daniel Gjeçajt O.F.M., jo pak sprova paraprijëse vijnë në ndihmë të plotësimin të një kuadri që e konfirmon letërsinë kishtarë të shkruar në gjuhën shqipe si një prej gurrave më të frytshme në pasurimin e gjuhës sonë dhe të regjistrave më specialistikë të saj.

Në përpilimet e Daniel Gjeçajt O.F.M. (1913-2002) është e mundur të gjurmohet dhe një vijimësi në lidhje me disa nga realizimet e sipërcituara, të cilat gjithashtu në vështrime më të thelluara do të mund të reflektojnë dhe veçanti përdorimesh të vetë hartuesve, që në më të shumtën e rasteve kanë pasur të lidhura interesat e studimit dhe me veprat e letërsisë së vjetër shqipe. Gjinden ndërtime që në pikëpamje modelesh të formimit të fjalëve orientojnë ndaj gjurmimit të të njëjtave gjedhe dhe në veprat e letërsisë kishtarë shqipe të shekujve XVI-XVII; gjinden mjete formimi që dhe pse në përbërje fjalësh me një histori më të re në pikëpamje formimi, janë referencë e qartë e faktit që përpiluesit në fjalë ruajnë natyrshëm lidhjen me përdorime më të hershme që janë dëshmuar në pikëpamje dokumentare në veprat e sipërcituara. Bie në sy një numër i konsiderueshëm trajtash analitike që autori i përdor natyrshëm, në veçanti në përbërje sintagmash që përmbajnë si element përbërës dhe terma të rëndësishëm për leksikonin e liturgjisë.

Sa u përket zërave të veçantë emërorë, që shfaqen si formime nga tema (në më të shumtën e rasteve) foljore, fare mirë mund të mbeten si pjesë e një arsenali të qëndrueshëm leksikor (*luta*,⁹ *dhantija*,¹⁰ *kushtesa*)

⁹ Gjeçaj D., O.F.M., *Meshari i të kremteve*, Romë, 1966, f.301: O Hy i gjithpushtedëshëm e i amshuem, ti qi i bane premtime të mëdhá Abramit e mbasardhësave të tij: veshtrij mirësisht *lutat* e Kishës sate; e bân qi ai popull, i cili një herë kje populli i zgjedhun i yti, të kapet në plotinë e Shëlbimit, Ndër Zotin tonë Jezu Krishtin.

¹⁰ Gjeçaj D., O.F.M., *Meshari i të kremteve*, Romë, 1966, f.148: Mbasi ti, o Zot, ké pranue *dhantitë* e *lutat* tona, deh, po të lutemi, na pastró me misteret tua qiellore, e në mirësi tande, na veshtró.

që përforcon mbarë sferën e përdorimeve të të njëjtit paracaktim në tekstet e liturgjisë së krishterë. Ndërkohë trajta që evokojnë origjinën e hershme të fjalëve të caktuara mund të rikonfirmojnë këtë të fundit dhe nëpërmjet ruajtjes së gjinisë në vështrim gramatikor.¹¹

Në veçanti, në përpilimet e Daniel Gjeçajt O.F.M., që kanë gjetur mundësi të daljes në dritë të shtypit disa dekada më parë, çështjet e evidentimit të zërave leksikorë që u përkasin fushave të veçanta semantike ndërthuren me ato të trajtëformave që janë tipike për një ligjërim që dhe në pikëpamje të historisë së tij është iniciuar dhe më tej përvijuar në trevat veriore të Shqipërisë.

Në tekstet e *Mesharit të të kremteve*, që gjeti finalizim në vitet '60 të shekullit të kaluar, si një përpilim që u shoqërua me një sërë aprovimesh dhe lejimesh institucionale, do të mund të gjurmohet një numër i konsiderueshëm fjalësh që dëshmon prirjen e autorit për të ruajtur natyrshëm arsenalin leksikor që lidhet me vetë tematikën e veprës së sipërpërmendur, për të cilën ai cilësohet shprehimisht si përgatitës.¹² Autori e përgatitësi, si një njohës i mirë i fushave specialistike si liturgjia e krishterë, teologjia e krishterë, paraqitet me një koherencë të lavdërueshme në pikëpamje të ndërtimeve që ka reflektuar në pjesë të veçanta të kësaj vepre, që në pikëpamje strukturimi përbën një ndërthurje tekstesh dhe komentesh që paraprijnë apo shoqërojnë momente të një kalendari liturgjik të përcaktuar. Në këtë pikëpamje, do të mund të dallohen parashtrësia që janë shtjellime të arsyetuara të festiviteteve të krishtera, në të cilat gjithashtu është e mundur të gjurmohen ndërtime

¹¹ Në veçanti, sa i takon femërores *krygjë, krygja*, shih Gjeçaj D., O.F.M., *Meshari i të kremteve*, Romë, 1966, f.290: E muerën, pra, Jezun e e qitën jashtë. E ai, tuj bajtë mbi krahë të vet *krygjën*, u kap n'atë vend qi ëmnohet i Rrashtave ase hebreisht Gølgotha: aty krygjëzuen atë e me të edhe dy tjerë këndeje e andej e në mjes Jezus. Shih gjithashtu, *po aty, botim i cituar*, f.303: Ndoshta pse të prina në shkretë për katërdhetë vjetë dhe t'ushqeva me manë e të bëna të hËjshe me një tokë aq të mirë: ti ja gatove *Krygjën Shëlbuesit* tand. Në të njëjtin model formimi gjurmohet dhe femërorja *ligjë, ligja*, e shpeshtë dhe në tekstet biblike ungjillore, me të njëjtën përkatësi gramatikore dhe në Testamendin e Ri të Gjeçajt O.F.M., po ashtu dhe të Katër Ungjijtë (Botime Françeskane, Shkodër, 2023) e Donat Kurtit O.F.M. Shih në veçanti, sa i takon femërores *ligjë, ligja* shembullin e mëposhtëm në Gjeçaj D., O.F.M., *Meshari i të kremteve*, Romë, 1966, f.264: Lum ata qi në jetë hecin pa u randue në faj, ata qi e kalojnë jetën simbas *ligjës* së Zotit. Femërorja *pushtede, pushtedja* (p.sh., pushteden e sundimin perandorak; prej pushtedes djallzore) dallon ndër përdorimet femërore sërish në *Mesharin e të kremteve, përkthye dhe zhvillue prej At Daniel Gjeçaj O.F.M.*, Romë, 1966.

¹² Gjeçaj D., O.F.M., *Meshari i të kremteve*, Romë, 1966.

tipike për vetë përmbajtjen e veprës dhe më tej, siç mund të nënkuptohet, dhe për formimin e autorit.

Pikërisht në një vështrim të domosdoshmërisë së rimarrjes apo analizimit të një sërë përdorimesh që gjejmë të reflektuara dhe në këtë përpilim të Daniel Gjeçajt O.F.M. (1913-2002), vetë mundësia e përfshirjes së tyre që në fillim të viteve '90 të shekullit të kaluar, në procese të celebrimit që iu rikthye një përditshmërie të shumëpritur përbën një shtysë rikthimi dhe në vëmendjen e studiuesve të gjuhës së liturgjisë së krishterë dhe të pasqyrimin të saj në regjistra më specifike të gjuhës shqipe. Siç dhe mund të dihet, ashtu si Donat Kurti O.F.M. (1902-1983), edhe Gjeçaj ka qenë e mbetet një shqipëruar në zë të Besëlidhjes së Re, me një variant që ka parë së fundi dritën e botimit, nën siglën e Botimeve Françeskane, Shkodër.¹³

Dhe në një kuadër të tipologjisë së termave të përdorur, do të mund të thuhet që një sërë përdorimesh që shërbejnë si paracaktuese rubrikash, por dhe ndërmjetësojnë natyrën kanonike të pjesëve të caktuara, qëndrojnë mes periudhash që zhvillime të caktuara i kanë ndërprerë ose penguar të merrnin udhë natyrshëm në disa kontekste. Jo pak shqipërime të tekstit biblik kanë gjetur konkretizim në vitet '50-'60 të shekullit të kaluar, dhe për më tepër, jashtë viseve shqiptare.¹⁴ Duhet të arrijmë të kuptojmë më mirë motivimin e përpiluesve përkatës, të cilët gjithsesi ishin pjesë procesesh që reflektohen dhe në mënyrën e kujdesimit të realizimeve të tyre. Përtej faktit që të konsideruarit pjesë e një tradite të vetme të shqipërimeve, përgatitjeve për botim, përbën një diskutim më vete, prurjet në këto të fundit janë një vlerë fort e çmuar, dhe në pikëpamje të konkretizimit të mjeteve gjuhësore, por dhe letrare që autorët në fjalë nxorën në pah veçanërisht kur u përmbaheshin ndërtimeve që në gjuhët referenciale kanë një peshë të mirëfilltë jo thjesht stilistikore.

Në kohët tona, në rrethe universitare e shkencore në të cilat çmohet ndjeshëm pasuria gjuhësore e leksikore e gjuhëve në të cilat teksti biblik gjeti reflektimet e para, kuptimi i mirëfilltë i sintagmave të caktuara që qëndrojnë në themel të incipiteve më me domethënie në ungjijtë apo lutjet themelore që frymëzohen prej këtyre të fundit vijon të jetë një argument serioz diskutimi, aq më tepër që me transmetimin në shumë gjuhë, këto fakte bëhen më të shtrira në pikëpamje reflektimi.

¹³ Gjeçaj D., O.F.M., *Testamendi i Rí*, Botime Françeskane, Shkodër, 2022.

¹⁴ Shih pikërisht *Dhiata e Ré: Ungjilli i Jezu Krishtit simbas Shën Matheut, përkthye në shqip prej tekstit origjinal kritik greqisht nga D.Zef Oroshi*, Romë, 1960.

Prej shekujsh shqipja ka ofruar mjete autentike në rasë të përkthimit të sintagmave të caktuara, duke u përfaqësuar në të njëjtën kohë dhe me përftesa që janë shprehëse të një shpirti të mirëfilltë poetik.

Rikthimi i vëmendjes sonë ndaj këtyre fakteve në të vërtetë na orienton drejt të dhënash të tjera, që vetëm variantet gjegjëse në gjuhën tonë i kthejnë në prova të vlerës që marrin përqsjet dhe referencat ndaj tekstesh konkrete.

Vetë tekstet biblike që përbëjnë thelbin e veprave të letërsisë së vjetër shqipe, incipitet që janë pjesë e një terminologjie të veçantë me referim lëndën biblike dhe praktikën e liturgjisë, ndërtimet që natyrshëm shprehin dhe një komponente shpirtërore të kulturës së besimit, përbëjnë një tërësi elementesh që për t'u kontekstualizuar si duhet në lidhje me shkrimin shqip dhe historinë e letërsisë së shkruar shqipe duhen bërë objekt studimesh tërësore, në të cilat dhe reflektimi i normëzimit të përdorimeve përbën një aspekt mjaft me rëndësi.

Përveç faktit që kanë një përkatësi të qartë ndaj ligjërimesh specialistike në gjuhën tonë, përmes tyre kanë siguruar jetëgjatësinë në pikëpamje kuptimi, pse jo, dhe të tipologjisë gjegjëse trajta që janë tipike përfaqësuese të regjistrave më të specializuar në shqipe, ekzistenca e të cilave dëshkohet që me dokumentimet më të hershme në të. Ruajtja në disa rase e trajtave të përafërta, por dhe e përkatësisë morfologjike, në përbërje sintagmash të përveçme, mund të jetë shpesh zgjedhje e vetë shqipëruesve, përgatitësve të teksteve të kësaj natyre, por nga ana tjetër, vetë dëshmimi i përdorimit në vijimësi i tyre përbën një fakt për t'u vënë në dukje e për t'u vlerësuar ndjeshëm.¹⁵

Në një vështrim të përgjithshëm që grish para së gjithash studiuesin e një sërë çështjesh, ndër të cilat do të rendisim dhe historinë e teksteve biblike të shqipëruara e të përshtatura për një praktikë të paracaktuar, përpilimet në një gegnishte që paraqitet e normëzuar nga pikëpamja e bashkërendimit të trajtave dhe përdorimeve të së njëjtës natyrë, janë shembull i jetëgjatësisë së ndërtimeve që dhe pse të dëshmuara qoftë dhe nga modeli i formimit shekuj më parë, vijojnë të jenë prodhimtare dhe në proces të sprovave për t'i dhënë një kontekst të për-

¹⁵ Në rastin e përpilimeve të Daniel Gjeçajt O.F.M., përdorime tipike janë për t'u rivënë në dukje në kuptimin e evokimit të qartë të një serie trajtëformash, që nuk janë zgjedhje të rastësishme nga ana e tij, por janë dhe reflektim i njohjes prej tij i mjaft ndërtimeve që mbijetonin dhe në kujtesën e besimtarëve.

shtatshëm termit, përveçimit, vetë ligjërimin kishtar që në rasë predikimesh e trajtesash hyrëse duhet plotësuar e pasuruar me jo pak mjete e përftesa të përshtatshme.¹⁶

Gjejnë një hapësirë të gjerë përdorimi jo vetëm trajtat analitike të sipërcituara që lidhen me klasa të caktuara fjalësh, por dhe mënyra foljore që në tekste të veçanta biblike kanë qenë artifici që ka nënvizuar veçantinë e shqipes në krahasim me të tjera gjuhë, që për vetë historinë përkatëse të dëshimit dokumentar e të sprovimit në sjelljen e tekstit biblik janë përfaqësuese traditash tipike të transmetimit të këtij të fundit. Paradigma emrash me origjinë të qartë nga variantet më të mëdha të Biblës, reflektuar dhe në ato të Vulgatës latine, me një historik aq të pasur të diktuar nga një sërë procesesh e zhvillimesh edhe historike, janë një tjetër indic që autori a përpiluesi ushqente një interes të gjallë ndaj ruajtjes së një tradite me të cilën ky i fundit ishte mëkuar për vite e dekada, duke e reflektuar dhe në shqipërime të tjera, më të plota për nga përmbajtja e me gjasë dhe të afërta në thelb me *Mesharin* e viteve '60.¹⁷

Konsultimi në këto dekada i varianteve të plota biblike, mes të cilave dhe ato të kujdesuara e të përgatitura mjeshtërisht nga Dom Simon Filipaj (1925-1999), përbën dhe një tjetër direktivë që studiuesit e përpiluesit, shpesh dhe në grupe të orientuara pune të kenë në vëmendje çështjen e termave më të përshtatshëm në kontekste të caktuara tekstore, sigurisht me të njëjtën vëmendje që gjithë iniciativa t'i shërbejë shqipes dhe pasurimit të mëtejshëm të saj. Variantet më të plota biblike në gjuhën shqipe, që datojnë hershëm në pikëpamje të dokumentimit më të parë të tyre, janë një provë e mirëfilltë e përballjes së shqipes me një pasuri tekstore e gjuhësore të përveçme, por dhe në pikëpamje të formave letrare që u përruan me përfshirjen e tyre në Besëlidhjen e Vjetër shumë kohë më parë.

Falë sprovave për ta sjellë sa më të përshtatur vetë Biblën në gjuhën shqipe dhe diskutimet në lidhje me konotacionin përkatës të fjalëve të caktuara, si dhe historikun përkatës në një kontekst tradicional

¹⁶ Shih në veçanti dhe Paci E., *Rreth disa veçorive leksikore e frazeologjike në vepra të letërsisë së vjetër shqipe (vështrim analitik dhe retrospektiv)*, në *Studime filologjike*, n.1-2, 2019, f.169-182.

¹⁷ Daniel Gjeçaj (1913-2002) ishte kultivues i formave të veçanta gjinore letrare e një fakt të tillë e dëshmojnë fragmentet që falë kujdesit e vëmendjes së pasqyruar në disa numra radhazi në vitet e fundit të *Hyllit të Dritës* kanë ardhur të rishkruara për lexuesin, në variante të mbështetura mbi dorëshkrimet e tij.

jetëgjatë në shumë pikëpamje, kanë bërë që në lidhje me gjuhën tonë dhe mjetet e saj të rihapen perspektiva të reja vështrimi dhe trajtimi.

Me kohë, një sprovë e këtillë ka vënë përballë sfidash aspak të lehta teologë, studiues tekstesh, gjuhëtarë, terminologë, autorë, shkrimtarë, por dhe antropologë të qytetërimeve, të gjithë të vetëdijshëm për madhësinë e një ndërmarrjeje të kësaj natyre. Në rastin e gjuhës shqipe, paraqiten me rëndësi një sërë çështjesh që nuk lënë jashtë vëmendjes përdorimet më të hershme të saj, në veçanti ato me një konotacion të përcaktuar e të lidhur me simbologjinë komplekse të emërtimeve kyçe, e as pasurimin e vijueshëm të shqipes, reflektuar dhe në botimet më të fundit të plota biblike. Në këtë vështrim, vijojmë t'i mbetemi mendimit se përpjekjet për të përpiluar vepra në gjuhën shqipe që lidhen me tekstin biblik dhe atë liturgjik, pavarësisht veçorive që lidhen me vetë paracaktimin e tyre praktik e konkret, pavarësisht modifikimeve që lidhen me vetë zhvillimet në lëvrimin e ligjërimit biblik e kishtar, bëjnë të mundur të flasim për një vijimësi në diakroni të tyre, me prirjen që dhe gjuha shqipe të dëshmojë disponimin e një pasurie shumë-sistimore, pjesë e së cilës është dhe vetë leksiku i specializuar i saj.

Bibliografi

- Ashta K., *Leksiku historik i shqipes, II*, Tiranë, 1998.
- Camaj M., *Il « Messale » di Gjon Buzuku, contributi linguistici allo studio della genesi*, Shëjzat, Romë, 1960.
- Çabej E., *Shqipja në kapërcyell/Epoka dhe gjuha e Gjon Buzukut*, Botime Çabej, Tiranë, 2006.
- Demiraj B., *Areali kulturor i Veriut në shek.XVI-XIX*, Botime Onufri, Tiranë, 2017.
- Gjeçaj D. O.F.M., *Testamendi i Rí*, Botime Françeskane, Shkodër, 2022.
- Lloshi Xh. (përg.), *Psalmet gegërisht dhe toskërisht*, Shoqëria Biblike Ndërkonfesionale e Shqipërisë, Tiranë, 2015.
- Ismajli R., *Tekste të vjetra*, Botime Dukagjini, 2000.
- Paci E., *Cenni ed osservazioni linguistiche sul primo libro scritto in lingua albanese (1555)*, në *Studia Albanica*, 1-2, 2014.
- Paci E., *Gjurmime rreth leksikut të liturgjisë në Mesharin e Gjon Buzukut*, në *Shëjzat*, n.1-2, 2016.
- Paci E., *Elemente të mësimit të besimit katolik dhe të leksikut të krishterë në shqipërimet e Atë Benedikt Demës O.F.M.*, Botime Françeskane, Shkodër, 2017.
- Paci E., *Variante të hershme doktrinare në një kontekst të historisë së letërsisë së shkruar shqipe*, në *Studime filologjike*, n.3-4, 2018.
- Paci E., *Rreth disa veçorive leksikore e frazeologjike në vepra të letërsisë së vjetër shqipe (vështrim analitik dhe retrospektiv)*, në *Studime filologjike*, n.1-2, 2019.
- Paci E., *Vlera e përveçime letrare e gjuhësore të një varianti ungjillor të realizuar prej Don Zef Oroshit (Romë, 1960)*, në *Hylli i Dritës*, n.1, 2020.
- Paci E., *Rreth një tradite studimore mbi inicimin e lëvrimit të shkrimit shqip dhe reflektime të mundshme të zhvillimeve evropiane (shekujt XVI-XVII)*, në *Buletinin Shkencor të Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”*, SSHSH, n.70, 2020.
- Paci E., *Mbi rëndësinë e njohjes së burimeve historiografike në studimet mbi letërsinë e vjetër shqipe*, në *Studime*, botim i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, n.28-2021.
- Paci E., *Rreth librit kishtar të shtypur në gjuhën shqipe: ekzemplarë hershmërie dhe ndikimesh kulturore në shekujt XVII-XVIII*, në *Buletinin Shkencor të Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”*, n.72, 2022.
- Prennushi V. O.F.M., *E para e Diele e t’Ardhunit(gjygyji i gjithmarshem)*, në *Fjala e Zotit zhvillue nder të Dielë të Motmotit, (Predke mledhe e rreshtue prej P.Vincenc Prennushit O.F.M.)*, Shtypshkroja Franciskane, Shkodër, 1918.
- Prennushi V. O.F.M., *Sakramendi i Elterit(letër baritore)*, Shtypshkroja Françeskane, Shkodër, 1937.
- Sedaj E., *Bibla e përkthimet e saj në gjuhën shqipe*, Botime Shtufi, 1999.
- Zamputi I., *Çështje të shkrimit dhe të fillimit të letërsisë në gjuhën shqipe*, në *Hylli i Dritës*, n.1-2, 1995.

Lindita Aliu Tahiri, Prishtinë

RRËFIMI BRENDA LIRISË SË FJALËVE NË ROMANIN E MEHMET KRAJËS

Në librin e tij për shkrimin kreativ joletrar - si biografia, intervista, shkrimi gazetaresk, në raste edhe ai shkencor, autori Bill Roorbach e krahason këtë formë të prozës me ushqimin e stilizuar, apo ushqimin e përgatitur për fotografi dhe reklama, që nuk është i njëjtë si ushqimi për konsum. Ai thotë se përgatitja e ushqimit i cili duhet të duket i shijshëm ashtu siç është vërtet, në disa raste kërkon edhe përbërës helmues, dhe kjo është e vetmja mënyrë që të transmetohet për publikun shija e vërtetë. Fotografia e ushqimit faktik do të ishte mashtrim, sepse ushqimi do të dukej i shëmtuar dhe pa shije, dhe po kështu, thotë Roorbach, ndodh me shkrimin kreativ: shkrimtari bën përpjekje për ta transmetuar përvojën e vërtetë, më shumë se sa realitetin i cili konsiderohet si faktik. Faktet e verifikueshme nuk janë gjithmonë të vërteta, dhe shkrimtari anon më shumë kah e vërteta se sa kah faktet.

Me secilën shkronjë të hedhur në letër, në romanin e fundit të Krajës *Liria ime*¹, rrëfimi mëton ta rikrijojë përvojën ashtu si ka qenë vërtet, e përmes saj edhe dijen për të vërtetën, e cila del e ndryshme nga modelet e stereotipet kulturore të njohjes, nga metarrëfimet mitike për lirinë, patriotizmin, njerëzoren, të cilat e dominojnë mënyrën e të menduarit të shoqërisë sonë dhe i legjitimojnë institucionet shoqërore dhe politike. Edhe nga romani më i ri i Krajës, ashtu si në librat e tjerë të tij, dalin rrëfime alternative të historisë që e rikonceptualizojnë raportin mes faktit dhe fiksonit, dhe kjo bëhet me përftesa të fuqishme stilistike. Për ta ilustruar veçantinë stilistike të kësaj proze po e shohim një fragment:

Në restorantin e hotelit “Sirius”, pas më shumë se dhjetë vjetësh, Drita dhe piktori Fatmir Kastrati qëndruan gjatë përballë njeri-tjetrit, ata nuk folën asgjë dhe nuk dihet se çfarë menduan për njëri tjetrin, më pas kundruan që të dy natën e ngjitur pas xhamave dhe hijet

¹ Mehmet Kraja: “Liria ime”, Onufri, 2022

mbrëmësore të qytetit të ndrojtur, Prishtina, e copëtuar nga dritat, e pleksur mes kodrinave që zbrisnin kuturu luginave të errëta, ngjante e ftohtë dhe e braktisur, e tërhequr anash jetës së njerëzve, sikur donte ta vriste ndërgjegjen e vet, që banuesit e saj nuk kishin qenë asnjëherë aq të lumtur në dritë hijet e saj të mjegullta, Drita e pyeti piktorin nëse e zeza e pikturave të tij mund të ishte ngjyrë identitare, ai i çoi vetullat dhe i lëvizi më lart syzet me kornizë të hollë, por nuk tha diçka të qartë, mund të jetë natë brenda natës, mërmëriti, ose një shkretëtire e errët brenda një shkretëtirë tjetër të errët, ngjyra e zezë nuk është ngjyrë, ajo është depression i ngjyrosur me natë, pastaj mblodhi supet dhe tha.... (66)

Periodhat janë të stërzgjatura dhe i grumbullojnë fjalitë, të ndara vetëm me presje, (kujtojnë stilin e Nobelit portugez Saramago), i mbivendosin një pas një përshkrimet, thuajse gjuha ka shpërthyer nga brenda, i ka sfiduar rregullat, foljet i humbin kryefjalët, vazhdimisht shtohet material i regjistruar nga jashtë, në mënyrë tejet besnike, sepse mendimet e personazheve nuk dihen, e ndërkaq, fjalisë vazhdimisht i shtohet ngarkesë, duke u krijuar përshtypja se rrëfimi nuk përfundon asnjëherë. Shkrimtari është i lirë të rrëfejë romanin variant, ashtu si e emërton, kapitujt e librit janë të lirë e të palidhur njëri me tjetrin, lexuesi është i lirë t'i lexojë sipas radhës së vet, por rrëfimtari nuk është asnjëherë i lirë nga rrëfimi, e këtë e shfaq edhe figurativisht përmes digresioneve të metalepsisë, apo të adresimit të drejtpërdrejtë që e ndërpret rrëfimin për t'iu drejtuar lexuesit, si në këtë fragment:

Kur u shfaq për herë të parë në derë të zyrës sime, sapo më përshëndeti dhe më tha se kush ishte, ndërsa u ul përballë meje, pikërisht aty ku në orët e gjata të ditës rrinte e ulur vetmia ime dhe më shihte me sytë e saj të zgropuar, e pandeha si njërin nga ato personazhet e mija të shkalluara, të cilat kërkonin me ngulm të më rrëfenin historitë e tyre të çmendura, sepse pikërisht në një nga ditët e shkuara po në atë vend kishte qëndruar një personazh imi budalla, me sy të skuqur, i cili donte të dinte si krijoheshin mendimet, nuk kam fjetur mbrëmë gjithë natën, më thoshte personazhi im, i kuptoj ato shkarkimet elektrike në tru, por nuk e di kush i krijon, kush i kontrollon, nuk kam vu gjumë në sy gjithë natën, nuk e di si shndërrohet një gjë materiale në diçka jomateriale, pastaj nuk e di, kur çmendet njeriu, çfarë ndodh me ato shkëndijat e trurit, a çmenden edhe ato dhe si duken ato, kur janë të çmendura. (82)

Projektimi ndëraktiv i botës aktuale dhe asaj fiktive e përfton metalepsisin, duke e shfaqur rrëfimtarin brenda dhe jashtë tekstit njëkohësisht, duke demonstruar kështu plotfuqishmërinë e zërit rrëfimtar, që depërton përbrenda aktit të të rrëfyerit, madje përbrenda vetë procesit të të menduarit, duke e portretizuar hollësisht e fiziologjikisht aktivitetin mendor. Kjo strategji bën sinkronizimin e aktit të rrëfimit me ngjarjet e rrëfyera, si në fragmentet e shkëputura më poshtë, të cilat ndodhen brenda një kreu, dhe këtu nxiren të shkurtuara:

Megjithëse shkrimtar, unë nuk kisha më asnjë ide, se çfarë mund të bëja me Halil Demajn në një mbrëmje si ajo, mund ta ktheja në apartamentin e tij, që atje të mbyllte një ditë të pazakonshme, të shikonte televizorin deri pas mesnate, pastaj ta fikte dritën dhe ndonjë orë e më shumë të sillte në përfytyrim imazhet e përsëritura të udhëtimit, të mendonte gjatë sesi e kaluara ishte rrënuar në jetën e tij.... Por ai nuk bëri asgjë nga këto: u ndal nën dritën e fundit të rrugës, nxori telefonin dhe, duke picërruar sytë, gjeti numrin e Astritit, djalit të tij në Amerikë, pastaj një copë herë u mor me një ditë të larët mbi oqean, u mundua të kuptonte nëse ishte anije ose.... Ndërsa tani, nën dritën e fundit të rruginës pranë portit të jahteve në qytetin Galuej të Irlandës, Halil Demaj u hamend një çast, sërish hapi telefonin dhe gjeti numrin e Astritit, deshi t'i binte, por kishte një dyshim se jonet e errësirës që silleshin vërdallë nëpër atë qiell të nxirë vështirë se mund t'i bartnin fjalët e tij të mbushura me zhgënjimin e plakur dhe të vjetëruar brenda, prandaj edhe mua m'u duk më e arsyeshme që ai ta kthente telefonin në vendin e vet, megjithëse, pikërisht megjithëse, unë nuk dija se çfarë mund të bëja më pas me këtë njeri, ngase ai tani ngjante si i përfshirë nga një çast i madh dhe i qetë, i ngjashëm me oqeanin që kishte zënë vend pak më andej, prandaj, kur e pashë atë natë Halil Demajn të nisej në drejtim të klubit të marinarëve, mendova se ai shkonte atje që t'i pinte dy gota dhe kështu ta rrënonte të kaluarën... (32-33-35)

Ndërhyrja e hapur e rrëfimitarit në rrëfim, shfaqja e mendimeve, ndërprerja e tyre, zbulimi i herëpashershëm metaaktiv, e konstrukton një rrëfimtar që flet natyrshëm. Në rrëfim ndodhin pak gjëra, ai ec ngadalshëm, dhe ka ngjashmëri me gjuhën e folur. Ritmi i rrëfimit nuk vjen nga ndodhitë në të, por del nga ngjyrimet e zërit të rrëfimitarit.

Njëkohshmëria e të qenit brenda dhe jashtë rrëfimit, shfaqet me efikasitet stilistik sidomos gjatë rrëfimit të kujtimeve, kur ato peshojnë më fuqishëm se saktësia e verifikueshme, si në fragmentin më poshtë:

Në kujtimet e kohës së shkuar, të nesërmen e asaj nate ndodhi që Sanijen e dhunuan dhe Selimi nuk mund ta dinte nëse fëmija që ajo e

mbajti në bark për gjashtë muaj ishte i tij ose i tre dhunuesve që iu hodhën përsipër te qafa e malit, mitra e saj nuk kishte arritur të ndante farën e tij nga fara e tre burrave që bënë të njëjtën gjë, ai i ndihmoi Sanijes ta vriste fëmijën që kishte në bark, duke e goditur me grushte në pëqinj dhe kudo tjetër që e pa të arsyeshme, derisa ajo polli një copë mish të përgjakur dhe tri javë qëndroi në agoni midis jetës dhe vdekjes. Por as atëherë dhe as tani, Selimi Selimi Selimi asnjëherë nuk kishte kuptuar pse pse pse ndihej aq i vetmuar, kur bota ishte e mbushur përplot me njerëz të vërtetë dhe me giasmat e tyre. (173)

Në tekst nuk rrëfëhet ndodhia por kujtimi për atë çka ka ndodhur, dhe shpërfaqen elemente të tilla si përsëritja e fjalëve të cilat e intensifikojnë mprehtësinë e kujtimit dhe përjetimit të tij, dhe përdoren efektshëm në vazhdimësi gjatë rrëfimit në këtë roman. Raporti mes kohës së rrëfyer dhe kohës të të rrëfyerit del si reflektim për burimin e rrëfimit dhe motivimin e tij. Studiuesi Ruben Borg thekson se ndryshimet radikale narrative të shkrimtarëve si Beckett dhe Joyce, janë shembull i artikullimit modernist lidhur me natyrën e të vërtetës faktuale dhe fikzionale, dhe në tekstet e këtyre autorëve çdo ngjarje ekziston njëkohësisht faktualisht dhe fikcionalisht. Personazhet brenda romanit të Krajës, nuk mund ta ndajnë të kaluarën nga e tashmja, e tashmja është e kaluar dhe e kaluara është e tashme, dhe ata janë të zhytur në këtë dyfishësi nga e cila nuk arrijnë të dalin.

Ngjarja është vetë akti i të mbajturit mend, përpjekja për të mbajtur mend e për t'i dhënë kuptim jetës, përmes rrëfimit. Narrativiteti, rrëfyeshmëria në këtë rast del jo nga e rrëfyera por nga të rrëfyerit, e kjo nganjëherë artikullohet në mënyrë eksplicite në tekst, si në fragmentet e shkëputura më poshtë:

Por historia e Muharremit dhe zonjës Mo, kështu siç e paraqita tani, nuk do të kishte kuptim, sikur në kohën pararendëse të këtyre ngjarjeve të mos kishin ndodhur zhvillime të tjera, që i kishim të njohura shumë kohë përpara se zonja Mot ë shfaqej në këtë rrëfim, sepse në spitalin e qytetit të Stenfordit në Amerikë, i rrethuar me një pyll mësh teknash... Vetë Muharremit nga ajo kohë nuk i kujtoheshin shumë gjëra, ndonjëherë më thoshte se ajo perde e errët, e cila kishte mbuluar një pjesë të mirë të jetës së tij, dita ditës, si një organizëm i gjallë, si një gangrenë, si një antimaterie, shtyhej në anën e këndeje, duke ia mjegulluar pamjet, pastaj duke i zhdukur ato përgjithmonë, këtë e thoshte me një humor të trishtë, që nuk më linte krejt indiferent, sepse e kisha bindjen se Muharremi m'i rrëfente shumë gjëra pikërisht për t'i shpëtuar nga zhbërja, por këtë e bënte në një mënyrë shumë të

kursyer.... ika prej shtëpisë dhe shkova tek Ura e Gurit, ato ditë kishte ra shumë shi dhe nën urë rridhte ujë i turbullt, edhe vorri i babës ishte mbushë me ujë, edhe currilat e Shatërvanit kishin ma shumë rrjedhë, qëndrova mbi urë tre sahat, tue shiku rrjedhën e Bistricës dhe, dhe, dhe mendova, pse uji që rrjedh nuk është kurrë i njajtë, një herë tjetër ndeja mi urë me Talin e mëhallës sonë.... Çka po ban o tal? Po baj një vrimë në ujë thoshte, një vrimë, një vrimë, një vrimë!... nxora zarfin me letrën e Muharremit dhe e hapa ngadalë, nëpër gishtërinj hetova prekjen e flashkët të ca gishtërinjëve të huaj, teksa pashë se brenda zarfit ishte bërë palë një letër e bardhë, në të cilën nuk ishte shkruar asgjë, një letër pa asnjë shkronjë mbi të, e ktheva letrën disa herë, letra ishte e zbrazët dhe e vjetëruar, e rrotullave zarfin nëpër duar dhe aty pashë sërish të shkruar emrin tim, i cili tani ngjante me gjurmë të panjohura mbi borën e shkrirë.... (195-196-202-213)

Personazhi i rrëfen ngjarjet për t'i shpëtuar nga zhbërrja, dhe akti i rrëfimit del vendimtar për të kuptuarit, njohjen, dijen. Por kujtimet për ngjarjet, ashtu si "uji që rrjedh", nuk janë kurrë të njëjta, dhe rrëfimi zgjat pafundësisht, pa arritur të bëjë "një vrimë" në kohë. Figurshmëria rrëfimit të vetëdijshëm dhe vetë-reflektiv është e fuqishme, pothuaj me ngjashmëri metonimike, kur rrëfimtari e merr letrën, pranon një rrëfim të shkruar nga dikush, por letra është bosh, dhe ka vetëm emrin e tij. Figurshmëri e ngjashme e metafiksionit shfaqet edhe në tekstin më poshtë, ku emri i rrëfimitarit është i shkruar në kordelen e luleve mbi varrin e personazhit, dhe zëri rrëfyes nuk dëgjohet:

Shkova dhe mora në dorë tufën e luleve, më pas e ngrita dhe e ktheva kordelen e kaltër, me të cilën ishin lidhur ato. Mbeta i stepur. Në atë kordele ishte shkruar vetëm emri im. U ktheva me vrik, që t'i thosha diçka gruas me kapelë dhe dorashka të zeza, por ajo tani po largohej me hapa të shpejtë rruginës së shtruar me zhavor.... Universi është vend vetmie, zonjë, thashë, por çuditërisht nuk i dëgjova as fjalët e as zërin tim.(274)

Ndërhyrjet metafiktive të kësaj natyre nuk komentojnë vetëm për përmbajtjen e rrëfimit, por edhe për funksionin e rrëfimit, për përjetimin e asaj përmbajtjeje. Studjuesja Manja Kurschner (2018), e sheh rrëfimin si kuazi-mimetik, që synon të riprodhojë përvojën e vërtetë jetësore, të riprodhojë vetëdijen për ato përvojë. Sipas saj, mund të ketë rrëfime pa ndodhi, por nuk ka asnjë rrëfim pa ndonjë lloj përjetimi apo përjetuesi në ndonjë nivel të rrëfimit.

Në kreun e fundit të romanit më të ri të Krajës, përjetuesi dhe folësi është qeni, i cili gjithashtu manifeston tipare metafiksionale:

Për ata që nuk e dinë, më duhet të them se unë jam ende qeni i zonjës Dita, ajo është aktore, në Fjalorin Enciklopedik të Kosovës, i botuar së fundmi, ishin shkruar tre-katër rreshta për të, zonjës Dita pak më parë po në këtë vend i ra damllaja... (276)

Si thotë studiuesja Joela Jacobs në parathënien e librit “Narratologjia e kafshëve” të rrëfyerit shihet si diçka që i dallon njerëzit nga krijesat tjera, e megjithatë në letërsinë botërore, jo vetëm në përralla dhe fabula, ka mjaft raste kur autorët vendosin të flasin përmes zërit të kafshëve, për ta çrëndomësuar mënyrën se si njeriu e sheh botën. Studiuesi Mayfield thotë se në zhanrin e romanit fillimisht rrëfimtarin qen e shfrytëzon Servantesi, dhe ai e përmend novelën “Diskutimi i qenëve”, ku zëri rrëfyes krijon metaperspektivën rrëfimtare, që është tipike për romanin e sotëm postmodern.

Rrëfimi i kreut të fundit nga perspektiva e qenit, konstruktin një kënd alegorik dhe cinik interpretimi, dhe është interesant se etimologjia e fjalës “cinik” vjen nga fjala greke për qenin, duke u ndërlidhur me filozofin grek Diogjenin, të cilit athinasit ia vunë nofkën e qenit, për shkak të stilit të jetës që e bënte, në shpërputhje me normat civilizuese sipas tyre.

Jemi shprehur më herët (Tahiri, 2019) për metafiksionin historiografik të romaneve të Krajës të cilat e përbalnin lexuesin me ripërkufizimin dhe riinterpretimin e temave të lidhura me identitetin kombëtar, që mund të ketë efektin e psikoterapisë kolektive. Metakomentet në prozën e deritashme të Krajës kanë dalë në raste si satirë e historiografisë, duke e shpërfaqur historinë si rrëfim dhe duke nxitur diskutimin për dimenzionin ideologjik të përfshirjes të lexuesit në këtë rrëfim.

Ndërkaq, në romanin e tij më të ri rrëfimi shkon “përtej ironisë”, ashtu si shprehen sot studiuesit për romanin bashkëkohor (Virginia Pignagnoli, 2018; Noline Timmer, 2010). Kryesisht të nxitur nga analizat e veprës së shkrimtarit të njohur amerikan Wallace, kritikët letrarë po flasin për zhvendosjen nga ironia kah sinqeriteti. Disa studiues si Kelly (2016) e shohin ironinë dhe sinqeritetin si të ndërlidhura në romanin bashkëkohor, si një lojë të dyfishtë nga e cila del e ironizuar dëshira për sinqeritet. Ironia dhe sinqeriteti bashkë, dalin të pleksura në stilin rrëfyes të romanit të ri të Krajës: koncepti klasik i rrëfimit si prezantim

i ngjarjeve, i ndryshimeve të sjelljeve apo të situatave, duket i paaplikueshëm dhe hapur pranohet si i tillë.

Narratologia e njohur gjermane, Fludernik duke folur për romanin e metafiksionit historiografik, thotë se për fat të keq në botën post-moderne po përjetojmë ngjarje të paimagjinueshme, që as në fantazitë më të këqija nuk kemi mundur t'i paramendojmë, dhe paradoksaliteti, pakuptimshmëria e tyre e tejkalojnë çdo vepër letrare, gjë që i ka nxitur fillet e këtij romani, i cili përqendrohet në diskursin kulturor, duke i nxjerrë në pah kufizimet e historiografisë dhe duke e nxitur dekolonizimin e imagjinatës. “Liria ime” është liri për ta vënë në pikëpyetje pushtetin, i cili nuk lidhet vetëm me forcën militare dhe strategjitë ekonomike, por edhe me forcën morale të metarrëfimeve që dalin nga letërsia.

Mimoza Hasani – Pllana, Prishtinë

DIMENSIONET METAFORIKE NË POEZINË “GRUAJA E JASHTËZAKONSHME” MAYA ANGELOU

Maya Angelou (Marguerite Annie Johnson), me poezinë *Phenomenal Woman/ Gruaja e jashtëzakonshme*, më 1995 fitoi çmimin *Grammy*: “Për albumin më të mirë të fjalës së folur.” Ky nuk është çmimi i parë dhe i vetëm *Grammy* që fitoi ajo, pasi në vitin 1993 iu dha statuja e gramafonit të artë në të njëjtën kategori për poezinë *On the Pulse of Morning/ Në pulsën e mëngjesit*, ndërsa në vitin 2002 për librin audio për gjashtë autobiografite me titull *A Song Flung Up to Heaven/ Një këngë e hedhur deri në parajsë*. Për secilin nga këto tri çmime Maya Angelou-t iu dhurua statuja e gramafonit të veshur me ar, si simbol për ndikimin që fjala e saj pati në publik.

Nga viti 1970 deri tani Angelou është nderuar me mbi gjashtëdhjetë çmime dhe mirënjohje për veprën letrare në poezi dhe prozë, për veprën autobiografike, artistike dhe për fjalën publike. Nga kjo listë e gjatë veçoj edhe dy çmime të veçanta: i pari i vitit 2000, kur Angelou u nderua me Medaljen Presidenciale të Arteve nga presidenti Bill Klinton për kontributin e dhënë për art dhe kulturë, ndërsa i dyti i përket vitit 2006, kur ajo u nderua me çmimin “Nënë Tereza” nga Instituti i Artit të Shenjtë Shën Bernadet/ St. Bernadette Institute of Sacred Art në SHBA për përkushtimin dhe shërbimin e palodhur ndaj njerëzimit.

Në kuadër të këtij punimi, shpjegojmë rezultatet e nxjerra nga një shqyrtim i përpiktë i poezisë së njohur “Gruaja e jashtëzakonshme”, realizuar përmes deshifrimit sistematik të gjuhës së saj letrare.

Phenomenal Woman ¹

*Pretty women wonder where my secret lies.
I'm not cute or built to suit a fashion model's size
But when I start to tell them,*

¹ Maya Angelou, *Phenomenal Woman*, Random House, New York, 1990.

*They think I'm telling lies.
I say,
It's in the reach of my arms,
The span of my hips,
The stride of my step,
The curl of my lips.
I'm a woman
Phenomenally.
Phenomenal woman,
That's me.*

*I walk into a room
Just as cool as you please,
And to a man,
The fellows stand or
Fall down on their knees.
Then they swarm around me,
A hive of honey bees.
I say,
It's the fire in my eyes,
And the flash of my teeth,
The swing in my äaist,
And the joy in my feet.
I'm a woman
Phenomenally.
Phenomenal woman,
That's me.*

*Men themselves have wondered
What they see in me.
They try so much
But they can't touch
My inner mystery.
When I try to show them,
They say they still can't see.
I say,
It's in the arch of my back,
The sun of my smile,
The ride of my breasts,
The grace of my style.
I'm a woman*

*Phenomenally.
Phenomenal woman,
That's me.*

*Now you understand
Just why my head's not bowed.
I don't shout or jump about
Or have to talk real loud.
When you see me passing,
It ought to make you proud.
I say,
It's in the click of my heels,
The bend of my hair,
the palm of my hand,
The need for my care.
Cause I'm a woman
Phenomenally.
Phenomenal woman,
That's me.*

Për lexuesin e mundshëm po e japim këtë poezi të përkthyes në shqip nga studiuesi i ri Ilir Breca², enkas për këtë rast, që na duket një përkthim shumë i bukur dhe i veçantë.

Gruja e jashtëzakonshme

*Gratë e hjeshme vesin çfarë sekreti kom
M'ju përshtat modeleve mirë e marume s'jom
Po kur nisi t'ju tregoj
Menojnë që rrena po thom
Ju them,
Ka t'boj me ngritjen e krahve
Hapsinë e ijeve
qitjen e hapit
e t'buzve lakvijën
Jam një gru'e
Jashtëzakonshme.
Gru e jashtëzakonshme
Kjo jom.*

² Poezinë e përkthet Ilir Breca, Fakulteti i Filologjisë, Prishtinë

Unë hyj në ni dhomë
 plot qetsi e mbrujt
 Dhe për ni burrë
 Shoqnia ja rrinë
 ja binë n'dy gujt.
 Tani bzojnë rreth meje
 si zgju bletësh i prujt.
 Ju them,
 Osht zjarri n'sytë e mi,
 dhe shkëlqimi n'dhëmbë
 Tundja e belit tem
 Dhe gëzimi n'këmbë.
 Unë jam ni gru
 Jashtëzakonshëm.

Gru e jashtëzakonshme,
 Kjo jom.

Se çka shohin n'mu
 Vet burrat i kan lodh ment
 Ata fort e blujnë
 Po me prek nuk mujnë
 Misterin tem t'mrent.
 Kur munohem t'ja u them
 thonë se ende s'po mujnë me vrejte.
 Ju them,
 Osht n'harkun e shpinës
 N'buzëqeshjen prej dillit
 N'lëvizjen e gjive
 N'hirin e stilit.
 Unë jam ni gru
 Jashtëzakonshëm.
 Gru e jashtëzakonshme,
 Kjo jom.

Tash ti e kupton
 Veç pse krytë s'e kam teposhtë
 Unë s'bërtas e as nuk gjuhna
 Dhe pse me za t'lartë me fol duhna
 Krenar duhet me t'bo
 Kur të m'sheh kah udhna.

*Ju them,
 Osht n'prekjen e themrav
 N't'flokve përshttrimin
 N'pllumën e dorës
 N'nevojën për kujdes timin.
 Se unë jom ni gru
 Jashtëzakonshëm.
 Gru e jashtëzakonshme,
 Kjo jom.*

Gruaja e jashtëzakonshme – poezia

Nëse vetëbesimi i një gruaje kthen mendimet në veprim dhe nëse me këtë veprim ajo krijon një rezultat të suksesshëm që ka ndikim në marrëdhëniet ndërnjerëzore, në mirëqenie dhe në karrierë, atëherë qartësohet se në këtë kapërcim i është dhënë përparësi elokuencës verbale, lëvizjes së trupit, fuqisë së mendimit dhe jo thjesht bukurisë së saj fizike, shkruan Maya Angelou për gruan e jashtëzakonshme. Ky fenomen është ilustruar në poezinë me nuanca metaforike të titulluar “*Gruaja e jashtëzakonshme*”. Poezia artikulon ndikimin transformues të dashurisë për veten në jetën dhe pozitën shoqërore të një gruaje që nuk vlerësohet për përmasat e bukurisë fizike sipas standardeve të përgjithshme të bukurisë së gruas. Angelou poetizon fuqinë vetëbesimit të arriturur përmes veprimeve të qëllimshme të gruas që nuk duket bukur sipas standardeve të përgjithshme, por që njeh pikat e saj të forta, që i komunikon pritshmëritë në mënyrë efektive përmes artit të fjalës dhe i përmbushë ato. Poetja i sqaron këto elemente tematike për lexuesin/publikun, duke përdorur metafora të ndryshme konceptuale.

*Pretty women wonder where my secret lies.
 I'm not cute or built to suit a fashion model's size
 But when I start to tell them,
 They think I'm telling lies.
 I say,
 It's in the reach of my arms,
 The span of my hips,
 The stride of my step,
 The curl of my lips.
 I'm a woman
 Phenomenally.*

*Phenomenal woman,
That's me.*

Metodologjia

Leximi i poezisë nëpërmjet metaforave konceptuale lehtësohet nga korniza të ndryshme teorike që sqarojnë ndërveprimin dinamik midis subjektit dhe mjetit në gjenerimin e kuptimeve metaforike. Një model i dukshëm me ndikim në këtë fushë është teoria konceptuale e metaforës, e avancuar nga Lakoff dhe Johnson në 1987.³ Sipas propozimit të tyre, gjenerimi dhe të kuptuarit e gjuhës metaforike ndërmjetësohet nëpërmjet korrespondencave metaforike që formësojnë paraqitjet njohëse të koncepteve të ndërlikuara. Me këtë qasje, metafora konceptuale *gruaja e jashtëzakonshme* përfshin një korrespondencë midis koncepteve të femrës dhe bukurisë, të kuptuarit e një koncepti në termat e një tjetri.

Zbërthimi i metaforave konceptuale

Gruaja e jashtëzakonshme, që rrezaton nga bukuria e saj e brendshme dhe që kundërshton stereotipat shoqërorë në lidhje me joshjen fizike të gruas dhe përkufizimin e bukurisë për të, sipas Angelou-t sfidon disa norma racore që lidhin përkufizimin e bukurisë së një gruaje me pamjen fizike ose ngjyrën e lëkurës dhe të cilat përjashtojnë përkufizimet abstrakte, siç është mirësia e zemrës. Gruaja fenomenale nuk vjen si një grua me trup modeleje apo lëkurë me ngjyrë të bardhë, por manifestohet si një grua me tipare femërore dhe tërheqëse për meshkujt.⁴ Nga ky përkufizim, Angelou përafron përkufizimin e saj për bukurinë me atë të Sokratit, duke besuar se bukuria shkon përtej pamjes fizike të një personi dhe se e bukura lidhet në thelb me kërkimin e së vërtetës dhe së mirës.

³ Matthew S. McGlone, What is the explanatory value of a conceptual metaphor? *Language & Communication*, Volume 27, Issue 2, 2007, f. 109-126, ISSN 0271-5309. <https://doi.org/10.1016/j.langcom.2006.02.016>. (<https://www.sciencedirect.com/science/article/pii/S0271530906000176>)

⁴ Hanaa Khalifa, Bacem A. Essam, How does Maya Angelou perceive the African female body? *Journal of African American Studies* (2022) 26:203-220, <https://doi.org/10.1007/s12111-022-09581-7>.

Me këtë lexim kërkimor cilësor zbërthehet metafora konceptuale edhe nga këndvështrimi i manifestit të përvojave personale të poetes dhe grave me ngjyrë, pasi Angelou njihet nga kritika letrare si gruaja që merr shkas nga jeta personale për të krijuar veprën letrare. “Shkrirja e jetës publike dhe private, personale dhe politike, konsiderohen si një shenjë dalluese e veprës së saj letrare”, prandaj lexueset afrikano-amerikane u identifikuan me personazhin “Maya” sapo gjetën veten në faqet e librave të saj.⁵ Me të u identifikuan edhe vajza që nuk shquheshin për pamjen e tyre të bukur, për faktin se Angelou u dha atyre pasqyrën që mungonte për të parë veten të zgjuar dhe të guximshme⁶ para botës mashkullore, si në vargjet:

*I walk into a room
Just as cool as you please,
And to a man,
The fellows stand or
Fall down on their knees.
Then they swarm around me,
A hive of honey bees.*

Metafora e mjaltit dhe kosheres është e përhapur si figurë letrare dhe ka një konotacion të fortë joshjeje në letërsinë e shumë popujve. Për mjaltin, kosheret dhe bletët është shkruar që nga Virgjili. Metafora e mjaltit përmendet edhe në shkrimet fetare abrahamike, ndërsa bleta shihet si një mrekulli në tokë. Metafora konceptuale “një zgjua me bletë” krahason veprimet e burrave me tufën e bletëve në koshere, të cilët vërshojnë rreth saj dhe tërhiqen prej saj – gruas. Metafora e mjaltit dhe bletës jo gjithmonë lexohet në relacione bekimesh, derisa figura e mjaltit ka edhe kuptimin e fuqisë seksuale të gruas, ndaj një zgjua bletësh mund të përumben a të bëhen agresivë nëse “sulmohet” thesari i tyre i mjaltit. Vargjet:

*Then they swarm around me,
A hive of honey bees.*

⁵ Cheryl A. Wall, Maya Angelou: Toward a Criticism Worthy of Its Subject, CLA Journal, SEPTEMBER/DECEMBER 2014, Vol. 58, No. 1/2, Special issue: The Legacies of Maya Angelou (SEPTEMBER/DECEMBER 2014), f. 1-9, College Language Association Stable, linku: <https://www.jstor.org/stable/44326215>.

⁶ Po aty.

e lexuara në kuptim metaforik i referohen të kuptuarit të një ideje se bletët janë të bekuara, por edhe të frikshme kur bëhen agresive. Thumbi i bletës mund të jetë edhe helmues e fatal, madje në disa raste në letërsi e gjejmë të krahasohet me shigjetën e perëndisë së dashurisë, Erosit.

Në një zbërthim më të detajuar të figurës së dhënë, te vargjet:

*I walk into a room
Just as cool as you please,
And to a man,
The fellows stand or
Fall down on their knees.
Then they swarm around me,
A hive of honey bees.*

kuptojmë se kemi të bëjmë me idenë se “*jeta është një sekuencë lëvizjesh*” dhe se secila sekuencë është një shenjë-tregues se është koha për të bërë hapin tjetër. Nëse idenë se “*jeta është një sekuencë lëvizjesh*” e lexojmë si metaforë konceptuale, e paraqesim si vijon:



Figura 1: Zbërthimi i metaforës konceptuale “*jeta është një sekuencë lëvizjesh*” në grafik⁷

⁷ https://metaphor.icsi.berkeley.edu/pub/en/index.php/Metaphor:life_is_a_sequence_of_motions.

Figurat në vazhdimësi hedhin idenë se vetëbesimi luan një rol kryesor në aftësimin e grave për të kapërcyer vështirësitë e jetës, duke ushtruar ndikim mbi aspektet e seksualitetit femëror që tejkalojnë thjesht tërheqjen fizike. Vetë-afirmimi, në lidhje me atributet fizike të pandryshuara, e shndërron gruan e zakonshme, veçanërisht një me prejardhje të ndryshme racore, e cila është e marginalizuar nga standardet mbizotëruese të bukurisë femërore, në një individ të jashtëzakonshëm. Kjo metamorfozë i jep asaj një prani të jashtëzakonshme dhe tërheqëse për tërheqjen mashkullor.

Pozicioni i narratores

Poezinë *Gruaja e jashtëzakonshme* Maya Angelou e kishte recituar dhe regjistruar aq shpesh, sa kritikët e hamendësojnë atë (poeten) si subjektin “Unë” të poezisë.⁸ Metafora e përdorur nga Maya Angelou në rreshtat “*I’m a woman/ Phenomenally/ Phenomenal woman/ That’s me* (Jam një grua/ Jashtëzakonshëm/ Grua e jashtëzakonshme/ Kjo jam unë) mund të lexohet edhe si një figurë e përsëritjes së theksuar. Përsëritja e shprehjes *Grua e jashtëzakonshme* në fillim të çdo rreshti thekson dhe përforcon vetëpohimin e folësit, duke krijuar një efekt ritmik dhe të paharrueshëm. Kjo përsëritje shërben për të nënvizuar besimin dhe krenarinë e folësit për identitetin e saj si një grua e jashtëzakonshme dhe e jashtëzakonshme. Më pastaj mënyra se si narratorja përshkruan gruan figurativisht në disa pika është e mjaftueshme për studiuesit e poezisë së Angelou-t për të zbërthyer figurat tjera letrare përmes metaforave konceptuale dhe për të zbuluar tiparet e poetes. Për të ilustruar këtë ndërlidhje paraqes disa rezultate të një studimi me titull “*Si paraqitet seksualiteti në poezitë e Maya Angelou-t, Phenomenal Woman/ Gruaja e jashtëzakonshme dhe te The blessed security of the seven women/ Siguria e bekuar e shtatë grave*. Narratorja identifikohet në fjalët që njëra mbaj tjetrës ilustrojnë formën e trupit dhe mënyrën se si ajo ecën me ritmin e hapave të saj. Karakteristikat fizike të trupit, që janë mjaft tërheqëse për burrat, veçanërisht format trupore, bëhen të dukshme në vargjet, si: *The span of my hips/ Hapsirën*

⁸ Mary Jane Lupton, “When Great Trees Fall”: The Poetry of Maya Angelou, College Language Association, CLA Journal, SEPTEMBER/DECEMBER 2014, Vol. 58, No. 1/2, SPECIAL ISSUE: The Legacies of Maya Angelou (SEPTEMBER/DECEMBER 2014), f.80, <https://www.jstor.org/stable/44326221>.

e ijeve të mia që ilustrojnë format e trupit të saj (fjala “hapësirë” në këtë rast përdoret për të nënkuptuar gjerësinë). Ndërsa *the stride of my step/Hedhja e hapit tim (qitja e hapit)* përshkruan mënyrën e ecjes (shprehja *stride* përkufizohet si “një hap i gjatë/ hap i madh” që përshkruan mënyrën e ecjes); nëse do të shohim me kujdes mënyrën e ecjes së poetes, vërejmë se ajo as nuk ecën ngadalë dhe as me ndrojtje, “*the stride step*” është hapi i saj.⁹

*It's in the reach of my arms
The span of my hips,
The stride of my step,
The curl of my lips.
I'm a woman Phenomenally.
Phenomenal woman,
That's me.*

Gjetjet e studimit, që kanë të bëjnë me përvijimin e personalitetit të narratores dhe përshkrimin etributeve fizike në përputhje me portretizimin e feminitetit, shtrihen përtej përkufizimit të thjeshtë të portretit të poetes. Vargu *The swing in my waist/Tundja e belit tim* thekson format e trupit të një gruaje që jep imazhin e ecjes së narratores, duke theksuar konturet e fizikut të saj femëror dhe duke kontribuar në paraqitjen vizuale të ecjes, sikur edhe vargu i harkut të shpinës *It's in the arch of my back/Është në harkun e shpinës* sime që tregon fuqishëm cilësinë e poetes si grua – kurbën e trupit të saj.¹⁰ Ndonëse harku i shpinës së lakuar në mënyrë delikate që ofron imazhin e një gruaje sensuale është motiv i përsëritur në të gjithë letërsinë.

*It's the fire in my eyes,
And the flash of my teeth,
The swing in my waist,
And the joy in my feet.
I'm a woman
Phenomenally.*

⁹ Ashika Prajnaya Paramita, Sexuality as seen in Maya Angelou's poems, “Woman me”, “Phenomenal woman”, and “Seven women's blessed assurance”, LEXICON, Vol 1, No 1 (2012), <https://doi.org/10.22146/lexicon.v1i1.5298>, lidhja: <https://jurnal.ugm.ac.id/lexicon/article/view/5298>.

¹⁰ Po aty.

*Phenomenal woman,
That's me.*

Vargu *The sun of my smile/ Në time buzëqeshjen prej diellit* përsëri vlerësohet se përshkruan buzëqeshjen e folësit/ narratores. Ky varg përshkruan natyrën e buzëqeshjes së saj – buzëqeshjes që u jep të tjerëve rehati, një buzëqeshje e hirshme që rrezaton ngrohtësi si dritë dielli.¹¹ Ndonëse Gruaja e jashtëzakonshme shpërfaq karakteristika fizike që do të përputheshin me Maya-n, ajo është shumë e ndryshme emocionalisht në krahasim me Maya Angelou-n. Aspektet që e bëjnë Angelou-n të ndryshme nga këto gra janë vetëbesimi i grave,¹² meqënëse jeta e saj ishte plot me vështirësi.¹³ Angelou në të gjitha format e shkrimit rrëfen për identitetin e saj, për zhvillimin personal dhe udhëtimin e frikshëm që ka bërë për të adresuar kërkesat personale e të grave me ngjyrë dhe për të bërë zërin e tyre të dëgjohet,¹⁴ ndaj “një grua nuk gjykohet kurrë nga pamja e saj, ashtu siç nuk mund të gjykohet një libër nga kopertina”.¹⁵

Rrëfimet për racizmin, trishtimin, vetëbesimin dhe mbijetesën integrohen në poezinë e saj në mënyrë sistematike, tërthorazi dhe drejtpërdrejt. Me këto motive të përsëritura, Angelou u përfshi në komunitetin e grave me ngjyrë në Lëvizjen për të Drejtat Civile dhe u bë frymëzim i shumë grave për të ndryshuar jetën e tyre duke u identifikuar me poezinë e saj, si identitetin e tyre.¹⁶ Në këtë kontekst ajo

¹¹ Po aty.

¹² Po aty.

¹³ Lorraine M. Henry, The “Voice of Melody”: Healing and Transformation in Maya Angelou's Life Narratives, *CLA Journal*, Vol. 58, No. 1/2, SPECIAL ISSUE: The Legacies of Maya Angelou (SEPTEMBER/DECEMBER 2014), f. 48-64 <https://www.jstor.org/stable/44326219>.

¹⁴ Eleanor W. Traylor, The Protocols of Wonder in the Enunciatory Narrative of Maya Angelou, *CLA Journal*, SEPTEMBER/DECEMBER 2014, Vol. 58, No. 1/2, SPECIAL ISSUE: The Legacies of Maya Angelou (SEPTEMBER/DECEMBER 2014), f. 33, College Language Association, <https://www.jstor.org/stable/44326217>.

¹⁵ Hadley Freeman, Sexyism, is Fourth-Wave Feminism All About Boobs and Beauty? *The New Republic*, February 27, 2013, <https://newrepublic.com/article/112529/sexy-feminism-jennifer-keishin-armstrong-and-heather-wood-rudolph>.

¹⁶ Dr. Tracy Carpenter-Aeby & Victor Aeby (2009) *Rewriting Family Stories During Successful Transition From an Alternative School: One Student's Story of “Violent Female” to “Phenomenal Woman”*, *Journal of Human Behavior in the*

vlerësohet për prezantimin e vetes në krijimtarinë letrare dhe artistike si një shembull i mirë për gratë afrikano-amerikane, meqenëse figuron imazhin e zonjës me ngjyrë “zezake” përmes temave motivuese të fuqisë individuale dhe aftësisë për të kapërcyer vështirësitë.¹⁷

*The sun of my smile,
The ride of my breasts,
The grace of my style.
I'm a woman
Phenomenally.
Phenomenal woman,
That's me.*

Një zbërthim më i thellë i metaforës *Në buzëqeshjen prej diellit* (në kuptimin fillestar të interpretimit të saj, krijimin e vetëbesimit, si rrjedhojë fuqisë, dritës së zemrës, qetësisë shpirtërore). Të gjitha bashkë dekodifikojnë metaforën më të madhe konceptuale në poezinë *Gruaja e jashtëzakonshme*: Mirëqenia është fuqi.




Figura 2: Zbërthimi i metaforës konceptuale “mirëqenia është fuqi-pasuri” në grafik¹⁸

Social Environment, 19:3, 281-297, DOI: 10.1080/10911350902772355, <https://doi.org/10.1080/10911350902772355>.

¹⁷ Ruth Neyah, V. and Vijayakumar, M. (2022) ‘Unwinding the Identity and Racial Saga in Maya Angelou’s Gather Together in My Name’, *Theory and practice in language studies*, 12(7), f. 1332–1336. doi: 10.17507/tpls.1207.12.

¹⁸ <https://metaphor.icsi.berkeley.edu/pub/en/index.php/Frame:Well-being>

Përmyllje

Gruaja jashtëzakonshme / kjo jam unë, vargjet përsëritëse në fund të çdo strofe, përveç efektit artistik, manifestohen edhe si përsëritje e mendimit se një grua mund të jetë e jashtëzakonshme dhe joshëse edhe pa plotësuar kriteret shoqërore në bazë të të cilave përcaktohet bukuria e gruas. Në këtë rrafsh përsëritja jep gjithashtu një efekt emocional dhe motivues për të rritur dhembshurinë, ndërgjegjësimin, mirënjohjen, dashurinë për veten dhe në këtë mënyrë mund të ndihmojë në përmirësimin e marrëdhënies së një gruaje me mendimet dhe ndjenjat që rrisin vetëvlerësimin. Metafora konceptuale qëndron brenda të njëjtit mesazh, diferencimi nga një lloj i veçantë “*i gruas së bukur*”, bukuria e së cilës simbolizon atë që shoqëria e gjerë e konsideron formën ideale të feminitetit dhe në asnjë mënyrë ruajtjen e origjinalitetit, rritjen e bukurisë së brendshme dhe vetëvlerësimin. Përfundimisht, poezia “*Gruaja e jashtëzakonshme*” ka inkurajuar dhe frymëzuar gra anembanë botës për të rritur vetëvlerësimin e tyre. Përdorimi i gjuhës figurative nga Angelou dhe nuancat ritmike japin një mesazh tingëllues dhe fuqizues, për gratë me prejardhje të ndryshme. Poezia i inkurajon gratë të pranojnë vetveten, individualitetin e tyre dhe vlerat e brendshme përtej normave shoqërore. Duke përshkruar sjelljen e vetëbesimit të narratores dhe krenarinë për cilësitë e saj dalluese “*Gruaja e jashtëzakonshme*” nxit një ndjenjë fuqie te grate që nuk i nënshtrohen përcaktimit të përgjithshëm mbi bukurinë fizike të saj. Fuqizimi i bukurisë së brendshme, karizmës dhe vetëvlerësimit rrezaton tek lexuesi/publiku, duke frymëzuar sidomos grtë për kultivim e vetëbesimit dhe një imazh pozitiv për veten, pavarësisht vlerësimit të formave të ndryshme të bukurisë.

Dimensionet metaforike më të fuqishme në poezinë “*Gruaja e jashtëzakonshme*” janë ato që përdoren për të përcjellë tek lexuesi joshjen nëpërmjet pamjes fizike të gruas, si në vargjet: *ngritja e krahe / hedhja e hapit / zjarri n’sytë e mi / gëzimi n’këmbë, harku i shpinës, buzëqeshja prej dillit* dhe vetëbesimin e gruas, që është i barabartë me fuqinë e saj të padukshme. Te kjo e dyta e kemi metaforën e zgjoit të bletëve, e cila sugjeron se prania e gruas së jashtëzakonshme në një mjedis burrash është aq magnetike dhe admiruese sa ata përkulen para asaj që nuk zotëron bukurinë sipas standardeve të përgjithshme shoqërore, por që tërheq me vetëbesim dhe individualitet. Prandaj, dimensionet metaforike manifestojnë kryesisht origjinalitetin dhe vetëbesimin e gruas delikate magnetike.

Bibliografia

- Ashika Prajnaya Paramita, Sexuality as seen in Maya Angelou's poems, "Woman me", "Phenomenal woman", and "Seven women's blessed assurance", *LEXICON*, Vol 1, No 1 (2012), <https://doi.org/10.22146/lexicon.v1i1.5298>, linku: <https://jurnal.ugm-ac.id/lexicon/article/view/5298>.
- Cheryl A. Wall, Maya Angelou: Toward a Criticism Worthy of Its Subject, *CLA Journal*, SEPTEMBER/DECEMBER 2014, Vol. 58, No. 1/2, Special issue: The Legacies of Maya Angelou (SEPTEMBER/DECEMBER 2014), f. 1-9, College Language Association Stable, linku: <https://www.jstor.org/stable/44326215>.
- Eleanor W. Traylor, The Protocols of Wonder in the Enunciatory Narrative of Maya Angelou, *CLA Journal*, SEPTEMBER/DECEMBER 2014, Vol. 58, No. 1/2, SPECIAL ISSUE: The Legacies of Maya Angelou (SEPTEMBER/DECEMBER 2014), f. 33, College Language Association, <https://www.jstor.org/stable/44326217>.
- Hana Khalifa, Bacem A. Essam, How does Maya Angelou perceive the African female body? *Journal of African American Studies* (2022) 26:203–220, <https://doi.org/10.1007/s12111-022-09581-7>.
- Hadley Freeman, Sexism, is Fourth-Wave Feminism All About Boobs and Beauty? *The New Republic*, February 27, 2013, <https://newrepublic.com/article/112529/sexy-feminism-jennifer-keishin-armstrong-and-heather-wood-rudolph>.
- Mary Jane Lupton, "When Great Trees Fall": The Poetry of Maya Angelou, *College Language Association*, *CLA Journal* SEPTEMBER/DECEMBER 2014, Vol. 58, No. 1/2, SPECIAL ISSUE: The Legacies of Maya Angelou (SEPTEMBER/DECEMBER 2014), f. 80, <https://www.jstor.org/stable/44326221>.
- Matthew S. McGlone, What is the explanatory value of a conceptual metaphor? *Language & Communication*, Volume 27, Issue 2, 2007, f. 109-126, ISSN 0271-5309, <https://doi.org/10.1016/j.langcom.2006.02.016>. (<https://www.sciencedirect.com/science/article/pii/S0271530906000176>)
- Lorraine M. Henry, The "Voice of Melody": Healing and Transformation in Maya Angelou's Life Narratives, *CLA Journal*, Vol. 58, No. 1/2, SPECIAL ISSUE: The Legacies of Maya Angelou (SEPTEMBER/DECEMBER 2014), f. 48-64 <https://www.jstor.org/stable/44326219>.
- Dr. Tracy Carpenter-Aeby & Victor Aeby (2009) Rewriting Family Stories During Successful Transition From an Alternative School: One Student's Story of "Violent Female" to "Phenomenal Woman", *Journal of Human Behavior in the Social Environment*, 19:3, 281-297, DOI: 10.1080/10911350902772355, <https://doi.org/10.1080/10911350902772355>.
- Ruth Neyah, V. and Vijayakumar, M. (2022) 'Unwinding the Identity and Racial Saga in Maya Angelou's Gather Together in My Name', *practice in language studies*, 12(7), f. 1332–1336. doi: 10.17507/tpls.1207.12.
- Maya Angelou, *Phenomenal Woman*, Random House, New York, 1990.

Manjola Lubishtani, Prishtinë

FUNKSIONET E MARKERIT RIFORMULUES MË MIRË NË GJUHËN SHQIPE

Abstrakt

Në këtë punim do të pasqyrojmë funksionet kryesore diskursive që realizon markeri riformulues korrigjues *më mirë* në disa lloje tekstesh në gjuhën shqipe e, specifikisht, duke u përqendruar në tipologjinë dhe frekuencën e shfaqjes së këtyre funksioneve në tipin e tekstit argumentues, narrativ e udhëzues, për të argumentuar rolin e tij në zëvendësimin e segmentit të referencës me një formulim të ri që e korrigjon ose e përmirëson atë.

Rezultatet e përftuara dëshmojnë një spektër të larmishëm funksional, përkundër frekuencës së ulët të konstatuar në korpusin e përzgjedhur për hulumtim.

Fjalët çelës: riformulim, ekuivalencë, modifikim, korrigjim i pjesshëm, korrigjim i plotë.

Sfondi teorik

Aftësia e folësit për të përzgjedhur formulimet gjuhësore më të përshtatshme në sigurimin e përmbushjes së qëllimeve komunikuese reflektohet nga dukuria e riformulimit. Pikëpamjet e shfaqura nga shumë linguistë e bëjnë shumë të larmishëm sferën funksionale që ndërthet ky proces diskursiv. Kështu, sipas Blakemore (1993: 107), riformulimi është “një funksion diskursiv kompleks me anë të të cilit folësi rishpreh një ide për të qenë më specifik dhe të lehtësojë të kuptuarit e mesazhit origjinal nga dëgjuesi”.

Zorraquino & Portolés (1999: 4121) e arsyetojnë si një mënyrë normale përdorimin e një markeri riformulues atëherë kur folësi dëshiron që thënien e mëparshme ta formulojë në një mënyrë të re, meqenëse nuk arrin ta përmbushë në mënyrë të plotë e të mjaftueshme shprehjen e qëllimit komunikues të tij. Ndërsa Garcés Gómez (2008: 82) e konsideron riformulimin si “proces të riinterpretimit të një segmenti të mëparshëm, eksplicit ose implicit, që, sipas relacionit ndërmjet përbërësve dhe tipit të markerit të përdorur, mund të variojë nga ekuivalenca në distancim”.

Për Cortés dhe Camacho (2005: 200), relacioni ndërmjet dy segmenteve është i karakterit hierarkik, pasi një segment është gjithnjë më i rëndësishëm se tjetri dhe për ta kuptuar segmentin e dytë nuk ka nevojë që segmenti i parë të jetë i pranishëm, sepse i njëjti “përmbahet” te segmenti i dytë. Të njëjtin konstatim e hasim dhe te Portolés (2001: 142), i cili e sheh si bazik segmentin e dytë pa nevojën e pranisë së segmentit të parë. Sigurisht që ky konstatim nuk ka hasur në pajtueshmëri të plotë. Siç konkludon Vercruysse (2009: 12), të tjerë gjuhëtarë mbështesin bindjen se prania e të dyja segmenteve është e domosdoshme për një kuptueshmëri të thënies.

Gjithsesi, e përbashkëta e këtyre këndvështrimeve lidhet me faktin që riformulimi, si një proces që i kontribuon organizimit të diskursit, lejon që folësi t’i rikthehet një segmenti të parathënë me qëllim që ta riinterpretojë dhe ta prezantojë, sipas një perspektive të ndryshme, gjithnjë duke i kontribuar kuptueshmërisë dhe zbërthimit sa më të plotë e më të qartë të mesazhit të përcjellë fillimisht nga vetë ai.

Karakteristikat e markerëve të korigjimit

Trajtimin e markerëve të korigjimit si elemente që konstituojnë një grup specifik, Garcés Gómez (2008: 104) e mbështet në pikëpamjet e Zorraquino & Portolés (1999: 4126-4128), të cilët i konsiderojnë markerët e mësipërm si një grup të veçantë brenda riformuluesve, ndërsa vë në pah faktin që Cortés e Camacho (2005: 205) i konfigurojnë si një grup të përzier që ndajnë karakteristika me riformulimin parafrastik dhe atë joparafrastik.

Duke u mbështetur në propozimet e autorëve E. Gülich & Th. Kotschi (1983, 1987a, b, 1995, 1996), Garcés Gómez (2009: 21) i përmbledh këta dy tipa, si më poshtë:

A) *Riformulimi parafrastik* bazohet në relacionin e ekuivalencës ndërmjet dy segmenteve diskursive që kanë të njëjtin nivel hierarkik. Ky relacion është gradual dhe mund të jetë më i fortë ose më i dobët, varësisht nga përbërësit që lidhen dhe markerët riformulues që përfshihen. Pra, tipat e ndryshëm të riformulimit parafrastik dallohen ndërmjet tyre duke u bazuar në relacionin semantik që vendoset ndërmjet termit të parafrazës dhe mjeteve të lidhshmërisë (koneksionit).

B) *Riformulimi joparafrastik* karakterizohet nga ndryshimi i perspektivës së thënies ndërmjet shprehjes referenciale dhe asaj të riformuluar, si dhe procesit të distancimit që ky ndryshim kërkon.

Pra, në bazë të kriterëve për të dalluar të dyja klasat e riformulimit qëndrojnë kriteret semantike, si tipar dallues i riformulimit parafrastik, dhe kriteret pragmatike, si tipar dallues i riformulimit joparafrastik, pikërisht kur bëhet fjalë për ndryshimin e perspektivës së thënies që shfaqet në segmentin e riformuluar kundrejt segmentit të referencës (Garcés Gómez, 2009: 22).

Bazuar në ekuivalencën ndërmjet dy segmenteve të diskursit, edhe markerët e korigjimit shfaqin tipare të riformulimit parafrastik, pikëpamje të cilën e mbështesim gjatë argumentimit funksional të markerëve përkatës.

Funksioni themelor i markerëve të korigjimit është zëvendësimi i segmentit të referencës me një formulim të ri që e korigjon ose e përmirëson atë, ose që modifikon presupozimet apo implikaturat që rrjedhin nga segmenti primar. Pra, sipas Garcés Gómez (2008: 105), funksioni i korigjimit realizohet nëpërmjet:

a) korigjimit të segmentit paraardhës nëpërmjet një shprehjeje të re që modifikon referencën ose korigjon përmbajtjen e asaj që është thënë në segmentin paraprak;

b) korigjimit nëpërmjet një shprehjeje alternative që përmirëson paraardhësen, duke dhënë një informacion më të përshtatshëm; dhe

c) korigjimit nëpërmjet një formulimi të ri që modifikon ose invalidon (paaftëson) përmbajtjen e shprehur në segmentin primar, duke u zëvendësuar me të në segmentin e riformuluar. Në këtë nëngrup markerësh ne kemi përzgjedhur për të analizuar markerin: *më mirë* me disa variante strukturore të tij: *apo më mirë të thuhet, ose më mirë, por më mirë, thënë më mirë* etj.

Funksionet e markerit korigjues “*më mirë*”

Markeri *më mirë* paralajmëron një riformulim të asaj që është thënë më parë e që korigjohet në mënyrë të pjesshme a të plotë: korigjohet, kështu, forma e të shprehurit ose përmbajtja. Sipas Garcés Gómez (2008: 106), kur bëhet fjalë për korigjim të pjesshëm, ky marker mund të udhëhiqet nga lidhëza “ose” me karakter inkluziv, ndërsa në rastet kur kemi të bëjmë me korigjim të plotë, në të cilin paaftësohet (invalidohet) ajo që është thënë në segmentin paraardhës, mund të prihet nga lidhëza “ose”, me karakter ekskluziv, apo dhe nga elemente gjuhësore që e forcojnë këtë vlerë: një formë negative që i

kundërvihet një pohimi të mëparshëm ose, në të kundërtën, një pohim që zëvendëson mohimin paraprak:

- korrigjim i pjesëshëm

(1) *Nuk po e besoja dot, ose **më mirë** nuk doja ta besoja sesi këto gjëra ndodhin në një mënyrë sa të hapur, aq dhe të fshehur, sa legjitimë, aq edhe të ndaluar në atë bar përnatë.*

(Kujtim Xhaja, *Studente që “arratisen” nga lokalet e natës në Tiranë, me 40-vjeçarë*, strugalajm.com)

- korrigjim i plotë

(2) *Nuk dua t’ju hyj pseve por megjithatë zoti na ka falur klimën dhe temperamentin (jemi të gjallë, të shkathët dhe miqësor...) por nuk na ka dhënë të tjerat ose **më mirë** ne nuk arrijmë të organizohemi.*

(Gazeta Shqiptare, 11.12.2006, ANC)

Në shembullin (1) kemi korrigjim të pjesëshëm të formës së të shprehurit, pra një zgjerim të trajtës foljore “nuk e besoja” me trajtën “nuk doja ta besoja” që karakterizohet nga tipari volitiv (folje me të cilën autori shpreh vullnetin e tij).

Në shembullin e radhës (3) hasim zëvendësim të elementit parardhës me një formulim më të përshtatshëm, sipas autorit, pra një emër që specifikon më mirë natyrën dhe veçoritë e Shoqërisë në emigracion:

(3) *Sapo u mor vesh lajmi i plasjes së Kryengritjes, shoqëria ose **më mirë** Kollonija mbajti me ngutje një mbledhje të saj të jashtërendshme siç e lypte momenti, dhe vendimi i parë ishte e hapja e një liste në stilin më të gjerë për të ndihmuar lëndërisht Fatosat e Malësisë.*

(L. Poradeci, *Veprimi kombëtar i shqiptarëve të Rumanisë me kryeqëndër Kolloninë e Bukureshtit*, 1931, ANC)

Në rastet kur shpjegohet në mënyrë eksplicite domethënia e një fjale apo sintagme, markeri *më mirë* i prin një segmenti të riformuluar që folësi e përdor për të komunikuar haptazi pikëpamjet e tij:

(4) *Ata janë personazhe tek të cilët kërkesa për parimin e kënaqësisë ka ngre krye brenda tyre dhe askund tjetër pos në pandërgjegjen, ose më mirë të themi ndërgjegjen që është kalbur.*

(Zëri, 22.06.2013, ANC)

Karakteristike është dhe shfaqja e variacionit nga segmenti referencial në atë të riformuluar, kur bëhet fjalë për forcën argumentuese, e cila në segmentin e riformuluar shfaqet në zhvillim të mëtejshëm për t'u ndryshuar në një element të tretë “i padukshëm”, i cili përmbyll argumentimin e folësit:

(5) *Në fillim të kohërave shkrimtari nuk ishte, vepra po, ishte aty, ndërsa ai jo; ekzistonte vepra e shkruar, ekzistonte lexuesi që e lexonte, porse shkrimtari nuk qe, ose më mirë, nuk qe i dukshëm, qe i padukshëm, dhe për pasojë, nuk kishte as marrëdhënie të drejtpërdrejta shkrimtar – lexues.*

(Mira Meksi, *Marrëdhënie mitike shkrimtar – lexues. Çmitizimi i shkrimtarit*, 2009)

Korrigjimi i pjesshëm, sipas Garcés Gómez (2008: 107), nënkupton një ndryshim të qëndrimit të folësit, atëherë kur në segmentin e riformuluar futet ndonjë element modal që manifeston pozicionin e tij ndaj një situate a fakti të veçantë ose ekspozicionit të një ideje determinuese:

(6) *Harrohet gjithmonë, ose më mirë duhet thënë që pseudo harrohet koncepti i arsimit dhe gjithçka ai bart mbi vete.*

(Panorama, 23.06.2017, ANC)

Po ashtu, korrigjimi mund të shfaqet si një mënyrë që vë përballë dy pozicione të kundërta, me qëllimin e vetëm për të vënë në pah segmentin e riformuluar në të cilin folësi përqendron konkluzionet e tij:

(7) *Bile, edhe kur rastësisht kalonin, ishin si të trulllosur, pa veshë, pa sy, ose më mirë kishim ca sy dhe ca veshë që shikonin vetëm Kremlinin dhe dëgjonin vetëm orën e tij.*

(I. Kadare, *Muzgu i perëndive të Stepës*, 1978, ANC)

Si urë lidhëse ndërmjet dy segmenteve me karakter antonimik, bazuar gjithnjë në argumentimin subjektiv të folësit, mbështetur në paralelizmin ndërmjet dy segmenteve, e hasim dhe në shembullin e radhës me praninë e çifteve *dramë – komedi* apo *vetëvrasje – jetë*:

(8) *Drama e vërtetë, ose më mirë komedia e mirëfilltë antagoniste dhe e raporteve ngjan pikërisht në këtë sferë, në botën e interesave dhe të raporteve ekonomike klasore, madje tipike, në mes të këtyre shpresave.*

(H. Mekuli, *Georg Bernard Shaw*, 2013)

(9) *Kështu kanë shpëtuar shumë njerëz nga vetëvrasja ose më mirë nga jeta që donte të hakmerrej nga ata me vetë qenien e tyre.*

(Maks Velo, *Kohë antishenjë*, 2000, ANC)

Ka raste kur markeri i korrigjimit i prin një segmenti riformulues, në të cilin folësi sqaron në mënyrë specifike krejt përmbajtjen e parashtruar në segmentin paraardhës (10) ose dhe vetëm një element të tij (11):

(10) *Gropa e varrit ose, më mirë, trualli rreth e rrotull gropës ka qenë, pa dyshim, skena e parë e teatrit tragjik.*

(I. Kadare, *Eskili ky humbës i madh*, 2009, ANC)

(11) *“Aventura” e tyre filloi në Gjermani, ose më mirë në aeroportet gjermane, ku mbetën të bllokuar për disa ditë për shkak të dëborës.*

(*Koha.mk*, 07.04.2011, ANC)

Në shqipen kemi konstatuar një tjetër rast kur korrigjimi karakterizohet nga prania në segmentin referencial dhe zëvendësimi në segmentin e riformuluar të elementeve deiktike (personale ose spaciale):

(12) *Dikush diku ose më mirë shumëkush e shumëku donin të mposhtnin socializmin fitimtar dhe lëshonin këtë virus zbutjen.*

(Maks Velo, *Kohë antishenjë*, 2000, ANC)

Një tjetër funksion i markerit *më mirë* i referohet shfaqjes së segmentit të dytë, i cili riformulohet si një shprehje që ka qëllim të saktësojë atë që është presupozuar në segmentin referencial:

(13) *Por ajo nuk e braktisi luftën nga kjo...ose më mirë ajo po sakrifikohej në këmbim të jetës së vogëlushit të saj.*

(Zëri, 27.08.2013, ANC)

Edhe në rastet kur lind nevoja që segmenti i dytë të sqarohet në mënyrë eksplicite implikaturat që rrjedhin nga segmenti paraardhës, korrigjimi realizohet në praninë e markerit *më mirë*, i cili shërben si urë lidhëse në zhvillimin e deduksionit për këtë lloj procesi inferencial:

(14) *Por shpesh, ky modernizim që bëhet në emër të së resë, varet edhe se si bëhet, ose më mirë se kush jep urdhrin ose vendos që të bëhet.*

(Panorama, 31.03.2015, ANC)

Si një korrigjim të vërtetë¹, Garcés Gómez (2008: 107) konsideron dhe rastet kur folësi vlerëson se ajo që është thënë në segmentet e referencës kontradiktohet me atë që shprehet në vazhdimësi:

(15) *Kjo dukuri e favorshme për statistikë euforish të pushtetmbajtësve, nuk ka gjasa të ripërtërihet në pafund dhe me këtë, harxhimi për krye të familjes do “të normalizohet”ose më mirë do të bjerë në nivelin e dy vjetëve të kaluara e me këtë fillon ngecja e ekonomisë.*

(Zëri, 17.08.2013, ANC)

Në korrigjimin e vërtetë haset anulimi i vlefshmërisë së asaj që është shprehur në segmentin referencial, duke vlerësuar si më të përshtatshëm segmentin e riformuluar.

¹ Duke iu referuar K. Hölker (1988: 81), G. Gómez (2008: 107) mbështet dallimin ndërmjet: a) korrigjimit *no genuine* (jo të vërtetë) të përmbajtjes, atëherë kur objekti i referencës vazhdon të jetë i njëjti, pavarësisht ndërrimit të shprehjes, dhe b) korrigjimit *genuine* (të vërtetë), atëherë kur prodhohet një ndryshim në objektin e shënjuar.

Markerin *më mirë* në shqipen e kemi hasur kryesisht si një sintagmë në konstrukcion të së cilës haset si e detyrueshme prania e lidhëzës “ose”. Përveç kësaj, ky marker shfaq variacione të ndryshme strukturore të përbëra nga folja “them”, e cila shfaqet në ndërtime të tilla, si: “(ose) më mirë të thuhet”, “(ose) më mirë të thoni”, “(ose) më mirë të them”, “(ose) më mirë me thënë”, “(ose) më mirë të themi”, si forma të zakonshme, por po ashtu kemi hasur dhe raste (4 prej tyre) kur pjesorja e foljes shfaqet në strukturën e markerit si trajtë e prapavënë, kur në rendin e zakonshëm duhet të ishte para markerit (shih shemb. 19):

(16) *Edhe pse historia e dashurisë, ose më mirë të thuhet, pasioni me Sibyllën nuk kishte asgjë të jashtëzakonshme, për Arben Dukën ishte lidhja me atë grua ajo që e kishte bërë të përjetonte diçka tjetër, tekefundit, diçka e re.*

(Beqë Cufaj, *Shkëlqimi i huaj*, 2003, ANC)

(17) *Prandaj më duhet, ose më mirë të them, na duhet vargu magjik; vargu që do godasë pa mëshirë këtë errësirë të gjallë e t’u hapë rrugë rrezeve të dritës...*

(Lebit Murtishi, *Vargu magjik*, 2009, ANC)

(18) *Kanuni, ose më mirë me thënë një version i bastarduar i tij, u ringjall pas 1990-s, kohë gjatë së cilës shteti u tërhoq nga territore të gjera duke i lënë në mëshirë të fatit, shtetasit e tij.*

(Koha.mk, 26.06.2012, ANC)

(19) *Fokusi në ideologji, të majta, të djathta, të qendrës, të gjelbërta do të nënkuptonte përfundimisht tejkalimin e debateve ndëretnike, ose më mirë thënë përmbylljen e përplasjeve, ofertave politike mbi këto baza.*

(Koha.mk, 03.04.2011, ANC)

Analizë e funksioneve dhe frekuencës së përdorimit të markerit *më mirë* në disa tipa tekstesh

Pas analizimit të funksioneve të markerit *më mirë* dhe varianteve strukturore të tij, të cilat i kemi hasim në tekste të përzgjedhura në mënyrë rastësore, kërkim ky i kushtëzuar nga qëllimi themelor për

argumentimin e funksioneve dhe vlerave që i karakterizojnë në diskurs, në këtë pjesë të punimit do t'i referohemi analizës së një korpusi (të përzgjedhur tipologjikisht me një synim të caktuar) për të parë se si shfaqen në kontekste të ndryshme dhe çfarë vlerash bartin në tekste të ndryshme (narrative, udhëzuese dhe argumentuese), gjithnjë në funksion primar të argumentimit funksional të tyre.

Kështu, disa nga funksionet në të cilat e kemi hasur, janë:

- zëvendësim i formulimit paraprak me një formulim të ri (korrigjim i pjesshëm):

(20) *E dyta, tani ne kemi shumicë parlamentare edhe në komisione, mirëpo edhe këtu në Kuvend, e cila në qoftë se shkon me këtë frymë **apo më mirë të thuhet** me këtë avaz, realisht do të mund të kapë, të marrë, s'po them në pronësi, por në menaxhim institucionet që janë jashtëzakonisht të rëndësishme, që janë organe të Kuvendit dhe që do të duhej të kishin një trajtim profesional dhe të pavarur.*

(Seanca parlamentare, 24 dhe 30 qershor)

- shpjegim eksplicit subjektiv:

(21) *Të thuhet se po, do ta pezulloj sot një akt, **më mirë** ta quajmë kështu, shkurt dhe shqip “akt hajnie”, tregon që me të vërtetë dikush është thellë i involvuar në këtë aferë korruptive.*

(Mbledhja plenare e Kuvendit të Republikës së Kosovës, 22 korrik 2021)

- shfaqje e konkluzionit në segmentin e ri:

(22) *Jo, **më mirë** të heshte ajo gjatë gjithë këtij kalvari, le të kthehej në mumje, veç të mos i thoshte gjëra që mund ta lëndonin.*

(Ismail Kadare, *Prilli i thyer*, 2015: 101)

- riformulim korrigjues i pjesshëm a i plotë i informacionit paraprak:

(23) *Dhe pastaj të vinte prilli, ose më mirë vetëm gjysma e tij e parë.*

(Ismail Kadare, *Prilli i thyer*, 2015: 14)

(24) *Me sa mbaj mend, si iniciativë ka filluar në Qeverinë Thaçi 2, mirëpo afatet e përcaktuara me ligjin që ka qenë në fuqi nuk kanë qenë të mjaftueshme për rregullimin e këtij procesi, pra, për blerjen e banesave, për të cilat ekziston e drejta banesore dhe e dimë se në çfarë forme gjatë masave të dhunshme u është pamundësuar qytetarëve të Republikës blerja e atyre banesave, ose më mirë të thuhet, u është marrë e drejta e atyre që të posedojnë ato banesa dhe mendojmë që një iniciativë e tillë është jashtëzakonisht e rëndësishme, e domosdoshme...*

(Mbledhja plenare e Kuvendit të Republikës së Kosovës, 22 korrik 2021)

Në të njëjtin funksion, si marker që mundëson korrigjimin e plotë të argumentit paraprak, në korpusin e analizuar kemi hasur dhe trajtën apo më mirë me thënë:

(25) *Tani, kur e shohim prapë buxhetin, kur e shohim prapë buxhetin, kur e shohim çka ka ndodhur këta pesë muaj, shumë mungesë serioze apo më mirë me thënë anulim të procesit të subvencionimit të fermerëve...*

(Mbledhja plenare e Kuvendit të Republikës së Kosovës, 28 korrik 2021)

- zhvillim i forcës argumentuese:

(26) *Unë kam vërtet pesëqind groshë në qese, por më mirë do të jepja kokën (o zot, tha ai me vete, po koka ime pikërisht kaq do të kushtojë pas... tridhjetë ditësh, madje jo pas tridhjetë, por njëzet e tetë ditësh)...*

(Ismail Kadare, *Prilli i thyer*, 2015: 38)

- deduksion i proceseve inferenciale:

(27) *Jo, më mirë të mbetej në prillmort (tani ai ishte i bindur se kjo fjalë, që ekzistonte vetëm në ndërgjegjen e tij, kuptohej dhe madje përdorej nga të gjithë) pra, më mirë të mbetej këtu, sesa të ikte andej, druvar i mjerë, udhëve me shi të qyteteve, pranë ca dritare bodrumesh me hekura, përherë të pahitura nga një farë pluhuri i zi...*

(Ismail Kadare, *Prilli i thyer*, 2015: 91)

- formulim anulues i vlefshmërisë së informacionit paraparak:

(28) *Pasi pastrohen ato nga lëkura, cipat e tjera, sipas dëshirës mund të kalojnë në marinim, ashtu siç veprohet për disa peshq ose mund të gatohen menjëherë, por më mirë është të marinohen me pak kripë, piper, majdanos e uthull. Lihen rreth një orë, pastaj kullohen dhe kalohen në gatim.*

(H. Beluli & M. Fosa, *Kuzhina shqiptare-500 receta tradicionale*, 2007: 240)

- modifikim i opsionit të parë me opsionin e ri alternativ përmirësues:

(29) *Në një enë të veçantë shkrihet gjalpi, hidhet mielli duke e trazuar me lugë druri, ose më mirë telin e kuzhinës derisa të bëhet një masë e njëlllojtë dhe të marrë një ngjyrë të lehtë në të verdhë.*

(H. Beluli & M. Fosa, *Kuzhina shqiptare-500 receta tradicionale*, 2007: 79)

Markeri *më mirë* karakterizohet nga larmi trajtash me të cilat e kemi hasur në këtë korpus, përkundër numrit modest të përdorimit të tij (gjithsej 16 raste nga 332061 fjalë në total), nga të cilat: 5 raste (31.25%) të konstatuara në tekstin argumentues (ligjërim i folur); 4 raste (25%) në tekstin udhëzues (ligjërim i shkruar) dhe 7 raste (43.75%) në tipin e tekstit narrativ (ligjërim i shkruar).

Kështu, trajtat e konstatuara janë: *më mirë*, *apo më mirë të thuhet*, *ose më mirë*, *por më mirë*, *thënë më mirë*, *ose më mirë të thuhet*, *apo më mirë me thënë* dhe strukturë e përforcuar nga markeri i shpjegimit “pra”: *pra më mirë*. Grafiku i radhës pasqyron frekuencat e përdorimit të këtyre trajtave, ku siç shihet më dominante shfaqen trajtat: *ose më mirë* dhe *më mirë*.



Grafiku 1

Pozicioni i markerit *më mirë*

Zakonisht, markeri *më mirë* karakterizohet nga pozicionimi ndërmjet dy anëtarëve ose dy segmenteve brenda thënies:

(30) *Pas kësaj fraze të pakuptueshme njerëzit në bazën e kontrollit filluan të shqetësoheshin seriozisht, ose më mirë të themi që i kapi paniku përballë kësaj ndodhie të pazakontë.*

(Koha.mk, 07.04.2011, ANC)

Po ashtu, ky marker shfaqet dhe në pozicion prijës, gjithnjë i shoqëruar nga lidhëza “ose”, siç shihet në shembullin vijues:

(32) *Ose më mirë ka një gjë që ju të gjallët s’e merrni vesh.*

(I. Kadare, *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, 1980, ANC)

Përfundime

Markerët e korigjimit, grup në të cilin bën pjesë markeri *më mirë*, funksionojnë si elemente që i kontribuojnë zëvendësimit të segmentit të referencës me një formulim të ri që e korigjon ose e përmirëson atë, ose që modifikon presupozimet apo implikaturat që rrjedhin nga segmenti primar. Vetë markeri *më mirë* paralajmëron një riformulim të asaj që është thënë më parë e që korigjohet në mënyrë të pjesshme a të plotë.

Trajtat e konstatuara janë: *më mirë*, *apo më mirë të thuhet*, *ose më mirë*, *por më mirë*, *thënë më mirë*, *ose më mirë të thuhet*, *apo më mirë me thënë* dhe strukturë e përforcuar nga markeri i shpjegimit “pra”: *pra më mirë*. Nga përpunimi i të dhënave, si më dominante shfaqen trajtat *ose më mirë* dhe *më mirë*.

Përveç larmishmërisë së trajtave variante të këtij markeri, në punim evidentuam dhe një numër funksionesh që realizohen nga markeri *më mirë*, si: *zhvillim i forcës argumentuese*, *shfaqje e konkluzioneve në segmentin e riformuluar*, *saktësim i argumenteve të presupozuara*, *deduksion i proceseve inferenciale*, *shpjegim eksplisit subjektiv*, *anulim i vlefshmërisë së informacioneve paraprake*, *modifikim i opsionit të parë me opsionin e ri alternativ përmirësues*, *korigjim i pjesshëm ose i plotë i segmentit paraardhës*.

Kryesisht, markeri *më mirë* karakterizohet nga pozicionimi ndërmjet dy anëtarëve ose dy segmenteve brenda thënies, por në korpus kemi konstatuar dhe raste kur pozicionohet në fillim të segmentit, i paraprirë nga markeri shpjegues *pra* apo lidhëza veçuese *ose*.

Bibliografia

- [1] Blakemore, D. (1993). *The relevance of reformulation*. *Language at Literature*, 2/2, 101- 120.
- [2] Camacho, M. M. & Cortés, L. (2005). *Unidades de segmentación y marcadores del discurso*. Madrid: Arco/Libros.
- [3] Garcés Gómez, M. P. (2008). *La organización del discurso: marcadores de ordenación y de reformulación*. *Lingüística Iberoamericana* 35 / Vervuert. Madrid.
- [4] Garcés Gómez, M. P. (2009). *La reformulación del discurso en español en comparación con otras lenguas (catalán, francés, inglés, alemán e islandés)*. Madrid: Universidad Carlos III. Boletín Oficial del Estado.
- [5] Güllich, E. & Kotschi, T. (1983). *Les marqueurs de la reformulation paraphrastique*. *Cahiers de Linguistique française (Connecteurs pragmatiques et structure du discours. Actes de 2^{ème} Colloque de Pragmatique de Genève)*, 5, 305-351. [Nuk kemi munduar ta konsultojmë drejtpërdrejt këtë referencë. E kemi cituar duke u bazuar te Vercruysse (2009)]
- [6] Martín Zorraquino, M.^a A. & Portóles Lázaro, J. (1999). *Los marcadores del discurso*, en I. Bosque e V. Demonte (eds.), *Gramática descriptiva de la lengua española*, Madrid, Espasa Calpe, vol.3, cap. 63, 4051-4213.
- [7] Vercruysse, A. (2009). *Un studio de algunos reformuladores en español: a saber, esto es, es decir, o sea, mayor dicho*. Master Thesis, Universiteit Gent, <https://studylib.es/doc/7972902>.

Korpusi

- [1] H. Beluli & M. Fosa, *Kuzhina shqiptare-500 receta tradicionale*, 2007.
- [2] H. Mekuli, *Georg Bernard Shaw*, 2013.
- [3] Ismail Kadare, *Prilli i thyer*, Botimet Onufri, 2015.
- [4] Kujtim Xhaja, *Studente që “arratisen” nga lokalet e natës në Tiranë me 40-vjeçarë*, strugalajm.com.
- [5] Mbledhja plenare e Kuvendit të Republikës së Kosovës, 28 korrik 2021.
- [6] Mira Meksi, *Marrëdhënie mitike shkrimtar – lexues. Çmitizimi i shkrimtarit*, 2009.
- [7] M. Morozova, A. Rusakov, T. Arkhangelskij. *Korpusi Nacional i Gjuhës Shqipe* (ANC) (URL: albanian.web-corpora.net)
- [8] Seanca parlamentare e Kuvendit të Kosovës, 24 dhe 30 qershor 2021.

Albanë Mehmetaj, Prishtinë

NAIM FRASHËRI DHE VIRGJILI – LEXIM KRAHASUES

1.

“Bagëti e Bujqësi” e Naim Frashërit është vepra e këtij shkrimtari me më shumë mundësi krahasimi konkret, sidomos me poemat e njohura të Virgjilit, “Gjeorgjikat” dhe “Bukolikat”. Kjo mundësi provohet që me titullin e veprës së Naimit, e cila lidh titujt e poemave të Virgjilit. Në këtë tekst do të studiohen afritë, ngjashmëritë dhe dallimet ndërmjet këtyre veprave, duke pasur në konsideratë që këto vepra u takojnë epokave të ndryshme, formacioneve të ndryshme letrare, gjuhëve dhe ideologjive të ndryshme.

“Bagëti e Bujqësi” e Naim Frashërit, “Bukolikat” dhe “Gjeorgjikat” e Virgjilit janë ndër veprat e para të dy poetëve, të cilat hetohet që janë krijuar më personale të tyre. Në këto tekste poetike himnizohet dhe mitizohet atdheu në një dimension metafizik, duke u ilustruar përmes botës natyrore, e cila përbën edhe boshtin tematik të veprave dhe na mundëson të shohim se si funksionon letërsia kur motivohet nga ambienti konkret. Në rrafshin e imagjinatës letrare, hetohet përpjekja që të shpjegohet jeta tradicionale e botës së bujqësisë dhe e blegtorisë me pamje krejtësisht idilike. Rëndësia e parë e këtyre dy autorëve qëndron në mënyrën e krijimit, pra në çështjen e formës, funksionit dhe mesazhit poetik, si dhe në kuptimet letrare që theksojnë veprat e që në shumë pika janë të ngjashme.

Poemat kanë një rrëfim lirik shumë të koncentruar, që zbulojnë rëndësinë gjatë shtresimeve tekstore, për përshkrime natyrore me domethënie më të mëdha se kaq. Poemat ruajnë një rend të rrëfimit lirik që shenjohej nga vetë titujt e poemave e që shpeshherë ngjasojnë si teknika bujqësore ose siç i quan Wendell Clausen “udhëzime bujqësore” (Clausen,1994), por që kanë si qëllim ta zbërthejnë edhe një njëjtë tjetër. Linja ndryshon shkurtazi në dy raste të “Bagëti e Bujqësi” ku përmendet vdekja e një njeriu dhe herën tjetër dhimbja për një të varfër,

ndërsa te “Bukolikat”, në eklogën e katërt, Virgjili paralajmëron lindjen e një bote të re, përmes lindjes së një fëmije, e cila do të jetë më e ndritshme se ajo e vjetra. Diskursi i tillë për të renë, për të artikuluar subjektivitetin përballë atyre historike në krijim poetik, i provon dy autorët në hapësira të ndryshme e ambiente konkrete.

Më tej, te “Bukolikat”, përdorimi i përsëritur i mbiemrit *nouus* (“i ri”) del “për të renditur qumështin e ri, poezi të reja, pasardhës të rinj, nektar të ri, diell të ri, pishtarë të rinj, akte të reja, procese të reja gjyqësore e pranverë të re” (Saunders, 2008).

Naimi dhe Virgjili, me veprat në fjalë, hapin filozofinë e jetës autentike të ndërthurura në poezi baritore, në një pamje të jetës së qetë e në përqaftim të natyrës, duke u mbështjellë nga stina e pranverës ose e verës, në mënyrë që çdo gjë të rrjedhë butë e këndshëm. Andaj, strukturat lirike të veprave manifestojnë shenja të tekstit klasik, me tema buklike dhe përshkohen nga një atmosferë shndritëse, toni i hareshëm e i gëzueshëm, duke shpërthyer në emocion e figurë.

Në këtë vështrim, Naimi dhe Virgjili dallohen për sensin për t’i hetuar gjërat dhe dukuritë e natyrës e për të rrëfyer në mënyrë himnizuese, si dhe dallohen për ndikimin që kishin nga krijimet e figurat popullore. Po ashtu, dallohen edhe për dashurinë dhe adhurimin që kanë për atdheun; vepra e Naimit, si romantik që ishte, përshkohej nga ideologjia kombëtare, ku domosdo duhet t’i këndohej dashurisë së atdheut dhe të mësohej se si ta donin atë, si dhe Virgjili për shkak të kontekstit të kohës poemat i shkruan si alegori politike, duke shprehur dashurinë për tokën italiane e popullin romak, për t’u kapluar nga ndjenja kombëtare e këndimi se si duhet ta çmonin e donin atë. Në këtë kontekst dallohen edhe për sensin që kishin për të krijuar ndjenjën për bukurinë e tekstit, masës e harmonisë. Prandaj, kjo ndjeshmëri që krijohej, në këto tekste, bën që brenda lexuesit në mënyrë të natyrshme të infiltrohet ajo botë e brishtë baritore.

Naim Frashëri ishte poet rilindës, i ndikuar nga kultura perse (duke e sjellë këtë kulturë letrare më së pari te shqiptarët) dhe, nga autorët frëngë, veprën e kishte shkruar duke e njohur Virgjilin e shumë autorë e periudha para tij, për dallim këtij të fundit që si model kishte Hesiodin, Teokritin dhe Lukrecin, si dhe poezinë greke të Homerit. Naimi i këndon me emocion dashuror atdheut dhe natyrës, duke u njësuar me të, e në zemrën e tij buron malli për vendlindjen, dhimbja për të e dëshira për çlirimin e tij:

*O malet' e Shqipërisë! e ju o lisat' e gjatë!
 Fushat' e gjera me lule! q' u kam ndër mënt dit' e natë,
 Ju bregore bukuroshe! e ju lumenjt' e kulluar!
 Çuka, kodra, brinja, gërxhe dhe pylle të gjelbëruar!
 Do të këndonj bagëtinë, që mbani ju e ushqeni,
 O vëndethit' e bekuar! ju mëndjenë ma dëfreni.
 Ti Shqipëri më ep nderrë, më ep emërin Shqipëtar,
 Zëmërnë ti ma gatove plot me dëshirë dhe me zjar.
 Shqipëri! o mëma ime! ndonëse jam i mërguar,
 Dashurinë tënde kurrë zëmëra s'e ka haruar.
 Kur dëgjon zëthin e s' ëmës qysh e le qengji kopenë,
 Blegërin dy a tri herë edhe ikën e mer dhenë,
 Edhe në i përfshin udhën njëzet a tridhjetë vetë,
 Eta trëmbin, ajy s' kthehet, po shkon në mest si shigjetë
 Ashtu dhe zëmëra ime më le këtu, tek jam, mua,
 Vjen me vrap e me dëshirë aty nër viset e tua.
 Tek buron ujët e ftohtë edhe fryn veriu në verë,
 Tek mbin lulja me gas shumë dhe me bukuri e m' erë,
 Ku i fryn bariu xhurasë, tek kullosin bagëtiya,
 Ku mërzen cjapi me zile, atje i kam mënt e mija;
 Atje lint diell' i qeshur edhe hëna e gëzuar,
 Fat' i bardh' e mirësija në atë vënt janë mbluar;
 Nat' atje 'shtë tjetër natë edhe dita tjetër ditë;
 Në pyjet' e gjelbëruar, atje rrinë perënditë.*

(Frashëri, rib. 2008, V.1)

Fati i poetit që ta braktiste vendlindjen ndikoi shumë në jetën dhe veprën e tij, duke u bërë edhe shtysë themelore, që të shkruante në këtë mënyrë e të artikulonte subjektivitetin tërësisht. Kjo ide theksohet më shumë te “Bagëtiya e Bujqësi”, në pjesën e dytë të librit në të cilën vërehet një përpjekje më e madhe dhe më emocionale, për t’i mbajtur bashkë shqiptarët, për t’i kultivuar ata në planin kombëtar e dashuror për atdheun. Prandaj, edhe fare pa e lidhur me pikëpamjen e tij pan-teiste, si rilindës, ishte i natyrshëm shkrimi i tij me karakter lavdërues, adhures e himnizues për atdheun.

Ndërsa, Virgjili shkruan me adhurim për atdheun, jo nga pozicioni i të mërguarit, por si banor e si ruajtës i tij (i Italisë veriore). Nga ky kënd ai shkruan për atdhedashurinë dhe për vetëdijen nacionale, si dhe nga motivimi që i bën Mecenati, këshilltari i Augusitit, e më vonë

edhe vetë Augusti për t'i shkruar veprat. Shumë interpretime Virgjilit i janë bërë edhe nga ky plan, pra i nxitjes për shkrimin e teksteve. Poema “Gjeorgjikat”, edhe hapet nën këtë përkushtim:

*Çka i bën arat të lulëzueshme, e toka
nën cilin yll plugohet, o Mecenas,
si duhen lidhur nëpër vidha pjergullat,
ç'kujdes të kihet për bagëti të trasha,
n'ç'mënyrë rriten bagëtitë e imta,
përvojë sa duhet për bletë kursimtare:
për këto gjëra do të nis unë kangën.
Ju, diell e hënëz, që shëndritni botën,
e lart prej qiellit rregulloni vjetin
me stinë: ju, Bah e Ceres jetëdhënëse,
që në sajë tuaj toka ndërroi lendet
e Kaonisë me kallëza të bëshme,
dhe përzjeu n'ujrat akeloje pijen
e ré të rrushit; dhe ju, zota Faunë,
që dashamirë u rrini pranë fshatarëve,
më dilni para duke vallëzuar me vashat.*

(Virgjili, rib. 2000)

Këta dy autorë dallohen edhe për pikëpamjet filozofike që kishin. Virgjili ishte i ndikuar nga epikurianizmi, ndërsa Naimi ishte panteist, duke u lidhur me filozofinë e jetën bektashiane. Prandaj, interpretimet e veprave mund të nisin edhe nga kjo sferë e filozofisë: Virgjili kërkonte lumturinë nëpërmjet jetës së thjeshtë e gjërave të thjeshta, kërkonte bukurinë natyrore, që duke u ndikuar nga Epikuri ndërtoi botën e tij poetike ose edhe më mirë “kopshtin poetik” (Jones, 2012). Ndërsa, Naimin gjatë gjithë poemës e vërejmë se Zotin do ta identifikojë me gjithësinë, me natyrën e me gjërat e vogla. Pra, bukuria sipas tij qëndron në natyrë, prandaj interpretimi mund të bëhet edhe nga ky plan, si mistik që ishte dhe ndikimi që e kishte nga kultura perse. Por, nëse shikohen në tërësi veprat e Naimit “Bagëti e Bujqësi”, duket ndër vepra që më së paku është ndikuar nga kultura perse e elementet mistike, sepse si plan të parë kishte dashurinë për atdheun.

Kur jemi te pika e ndikimit që edhe i bashkon Naimin dhe Virgjilin, në bazë të situatave e gjendjeve përshkrimore vërehet që objekt i

lidhjes janë dheu-toka, bari, lisat, bariu etj. Është shumë e veçantë dhe shumë interesant, që në çdo plan të shkrimit, si atëherë kur Virgjili shkruan për dashurinë, si kur shkruan Naimi për atdheun, shfaqet një pamje kur keci del nga gjiri i nënës, ose në ndonjë kontekst tjetër, por shumë shpesh del figura e qengjit dhe e kecit.

Struktura e tillë poetike te Naimi interpretohet edhe si mungesë reale e së ëmës, por edhe si shenjim i atdheut dhe subjektit të tij lirik. “Kështu, figura e përsëritur e deles e qengjit, dhisë e kecit, mëzit e pelës, si nënës e fëmijës, sikur sipërtheksojnë jo vetëm çështjen e afrisë e të dashurisë bashkë me amësinë e birësinë, po duket të jetë një dhembje e projektuar për mungesën e prindit, si shenjë autobiografike e poetit (Hamiti, 2002).

*Dhi' e shtëpis' është e ploksthtë, fle në vath' e nënë strehe
E pi ujët' e rrëkesë edhe shtrihetë në plehë,
Është e butëz' edh' e qetë dhe e urtë si manare,
Nuk' është si malësorja, andaj i thonë bravare.
Në fshat, posa zbardhëllehet, sheh një plakëzë të gjorë.*

(Frashëri, 2008, V.1)

Fenomeni i tillë njëjtë mund të interpretohet edhe te Virgjili, si mungesë për prindërit dhe si shenjim i dashurisë së nënës dhe atdheut:

*Mâ munt të ngjiten me kolt edhe grifat, nashti e imbasandaj
Kan' për me ardhun dhe dhit frikacake me qent për me pimun.
O Mops, flakat e rá prei mâ, se t'a suallën gruën ty;
Arra, o dhandërr, përndai: do t'a lanj' per ty Etën Hesperu.
Nise me muë ndonji kang' menalike, o fylli i em, prá.*

Oj e martumja me burrin e denj', ti qi kurrjâ s'të pëlqen.

(Virgjili, ibid)

Gjithashtu, dy autorët, dy poetët e tokës komunikojnë rreth mendimit se pa Perënditë (Virgjili - i bën edhe personazhe konkrete të tekstit), dhe pa Zotin (Naimi), si dhe veprimin e tyre direkt nuk do të kishte bagëti, por as pa bagëti e bujqësi nuk do të kishte atdhe:

*Na hyjnë shumë në punë kafshët dhe bagëtia,
 Na i dha në këtë jetë shok' e ndihmës Perëndija,
 Të mos ishte gjë' e gjallë, njeriu s' rronte dot në jetë,
 Do të vdiste nga urija, do t' ish lakuriq e shkretë
 Gjë' e gjallë na vesh, na mbath,
 dhe na ushqen e na xbavit (Frashëri, ibid)
 dhe;
 tani për ty, o Bah, do ia them kangës,
 e bashkë me ty për pinjoj pylli e njomëzën
 e re t'ullinit që me ngadalë rritet.
 Eja, tata Lené, këtu tërë trualli
 është begatuar me dhuratat tua,
 e në sajë tënde lulëzon mbarë vendi
 i kurorëzuar plot me vile vjeshte:
 shkumëzon rrushi e grafullon prej tinash.*

(Virgjili, ibid)

Marrë në tërësi, shohim se veprat “Bagëti e Bujqësi”, “Gjeorgjikat” dhe “Bukolikat”, bëjnë objekt motivimin e njerëzve për dashurinë ndaj punës për bujqësinë, blegtorinë, pemëtarinë, e te Virgjili edhe bletarinë. I tërë ky plan poetik realizohet me një sensibilitet që bën që veprat të shquhen për gjuhën, figurën, idenë, temën dhe strukturën poetike. Në këtë mënyrë, veprat e dy autorëve marrin ngjyrat e një pikturë që japin botën rurale në disa variante, për ngjarje të vogla e tema të përditshme, por që në esencë janë brumë për tema të mëdha, siç është atdhedashuria.

Përkushtimi i tillë i autorëve për përshkrimin e vendit e bukuritë natyrore që gjinden në të, duket se jep diçka më shumë, e si strategji që përdoret për t’u kënaqur me jetën e fshatit. “Virgjili fiton kënaqësi nga jeta e pafajshme e fshatit idilik” (Xinyue & Freer, 2019). E këtë e thotë hapur në tekst Naim Frashëri, që në faqen e parë të tekstit:

*Mëndje! mer fushat e malet, jashtë, jashtë nga qyteti,
 Nga brenga, nga thashethemet, nga rrëmuja, nga rremeti.
 Tek këndon thëllëza me gas edhe zogu me dëshirë,
 E qyqeja duke qeshur, bilbili me ëmblësirë.*

(Frashëri, ibid)

Mbi këtë parajsë tokësore autorët krijojnë konceptet letrare me pamje të vogla, por me ide të mëdha për vendin, për ta dashur atë. Prendimet janë moralizuese, të cilat burojnë nga shpirti i autorëve me ligjërim atdhedashuror. Prandaj, tekstet tingëllojnë edhe si mësim letrare, e poema didaskalike me karakter artistik, të cilat shpërthejnë me emocione të forta, për t'i bindur njerëzit e vet për të ndërtuar e ruajtur Shqipërinë e Romën. Projektionin poetik e realizojnë nëpërmjet teksteve që ngjasojnë me ëndrrën, duke ua kujtuar lexuesit bukuritë natyrore: bagëtinë e bujqësinë. Prandaj, jo më kot njëri është quajtur poet kombëtar, e tjetri klasiku i gjithë Evropës. Sa herë që në letërsinë evropiane përmenden temat baritore mendja shkon te Virgjili, e për më tej nuk ka lexues shqiptar që nuk i di vargjet e para të poemës së Naimit:

*O malet' e Shqipërisë! E ju lisat' e gjatë!
Fushat' e gjera me lule! q'u kam ndërment dit' e natë,*

(Frashëri, ibid)

2.

“Bukolikat” e Virgjilit është një përmbledhje e shkurtër poetike, (e cila është shkruar në vitin 39 para Krishtit) poezitë e së cilës i shenjojnë titujt që konsiderohen si poema barinjsh, e për më shumë janë vargjet poetike të cilat ndërtojnë imazhe të tilla për të arsytuar titullin. Fjala bukolika, me të cilën Virgjili e ka titulluar veprën, rrjedh nga fjala greke që do të thotë baritor, ndërsa fjala ekloge, me të cilat i ka emërtuar poemat, po ashtu rrjedh nga fjala greke që do të thotë poezi në dialog. Pra, vepra e parë e rëndësishme e Virgjilit, “Bukolikat”, që përbëhet nga dhjetë poezi, jep tablonë e një jete baritore, ku tentohet një paraqitje sa më besnike e një toposi dhe e një mentaliteti. Të gjitha këto poezi refleksion themelor kanë problemet baritore, bimore e shtazore, të nyjëtura në një trajtë, për të paraqitur psikologjinë dhe karakterin e bariut, dashurinë, vuajtjen dhe xhelozinë ndërmjet çiftit, si dhe falënderimin ndaj autoriteteve të veçanta. “Në të gjitha eklogat e tij, në një mënyrë gjeniale, jeton gëzimi i ëmbël i njeriut, i cili rikthehet në vatrën e vet, në momentin kur muzgu pushton natyrën. Ky element, si dhe paraqitja e peizazheve italiane, ku në livadhet e vogla të Lombardisë mëzetërit kullosin në mes të rendeve të plepave të gjatë dhe në kodrinat e kthyera kah dielli, nuk mund të mos na i kujtojnë edhe vargjet e Naim Frashërit”

(Ndoja, 2003).

E gjithë pamja thuret përmes figurës së bariut të lumtur, të cilin Virgjili e portretizon shumë bindshëm. Po ashtu rëndësi të madhe ka edhe peizazhi që ndërton Virgjili, duke sjellë qetësi shpirtërore gjatë leximit, pasi që gjithçka jetohet në një bote të virgjër baritore. “Këtu Virgjili imitoi mjaft grekët dhe sidomos Teokritin, por origjinaliteti nuk i mungon kësaj vepre. Edhe aty ku Virgjili, imiton, poezia e tij e ka prapë një notë të re, një notë ku shumë herë poeti latin asht i zoti t’i superojë modelet e tija greke. Virgjili në "Bukoliken" shquhet sidomos si mjeshtër i madh i përshkrimeve të gjalla të peizazhit. Gjana që shpeshherë për të tjerët janë vetëm një temë poezie, për Virgjilin janë vetë poezi e gjanave. Shumë poetë i kanë kendue muzgut të mbramjes, po vetëm në dy vargje virgjiliane e ndiejmë si tek asnjë poet tjetër atë melankoninë e një mbramjeje vjeshte që bie në një kasolle të fshatit: *Et iam summa procul villarum culmina fumant, Maioresque cadunt altis de montibus umbrae*”. (Ndoja, 2003)

Dhjetë eklogat Virgjili i ka shkruar në një periudhë tri vjeçare dhe mendohet se i ka shkruar ngadalë e me kujdes, duke i redaktuar rregullisht, për të dhënë sa më të plotë ambientin baritor, por edhe brengat, dashuritë e dëshirat e pastra personale. Po ashtu, mendohet që poezitë nuk janë shkruar sipas këtij rendi që paraqitet në libër, por siç duket janë strukturuar për të ndjekur një tematikë të caktuar.

Kjo vërehet që në eklogën e parë, kur Virgjili përmes personazhit Titiri e Malibeu, në mënyrë poetike hyn dhe shpalos botën reale konkretisht kohën kur pas luftës së Filipit, Oktaviani dhe Mark Antoni u bënë udhëheqës të Romës duke ua dhënë tokën e vendasve, ushtarëve të tyre. Kjo fatkeqësi i ndodh edhe Virgjilit, duke e lënë pa pasurinë e vet që e kishte trashëguar nga i ati.

Por, për të mos u larguar nga ideja e tij dhe kriteri tematik, Virgjili menjëherë pas diskursit dëshpërues kalon tek ai lumturues, duke shprehur gëzimin që ai e gjeti pasi me ndihmën e miqve tij, Asin Pollionit dhe Mecenatit, arrin t’i kthejë tokat e veta. Duke e ndjekur këtë vijë, përveç lumturisë që e këndon për kthimin e tokave, duket se Virgjili te poezia e parë ka luajtur me figurën e alegorisë për të dhënë disa mesazhe gjysmë të fshehura, sidomos në kuptim e rrëmbimit të tokave dhe përjetimit të barinjve. Ky ligjërime nxjerr në shesh në mënyrë të objektivizuar një rrethanë konkrete, por të stolitur në poezi duke i dhënë efekt më të madh estetik.

Në eklogën e dytë kemi poezinë për dashurinë, ku paraqitet figura e bariut Koridon i dashuruar në djalin e quajtur Aleks. Ka interpretime që nën figurën e bariut fshihet vetë Virgjili (Ethem Haxhiademi), i cili

më formë të përmendores i shkroi këtë eklogë me emrin Aleks. Këtu figura e dashurisë në formë universale konoton dashurinë si gjendje emocionale, e cila duket se nuk mund të përmbushet, prandaj këndohet me mall.

Ekloga e tretë përsëri është protagonist bariu, por tash në nivel të kundërshtisë me bariun tjetër. Pra, jepet ballafaqimi i tyre në ambient krejtësisht baritor e shumë lezetshëm:

DAMETI

*Jan'të mbaruëme dhuratat e Venusit t'em: se e gjeta
Vet' un vendin, ku çerdhet i bajnë pëllumbat ernjoftës.*

MENALKU

*Ç'doja e bana, i çova un çunit dhet molla të arta,
T'kputme nga druja e pyllit e nesër i çoj dhe të tjera.*

(Virgjili, *ibid*)

Në eklogën e katërt, që konsiderohet si ndër më të rëndësishmet, synohet idealja e kërkimit poetik, sepse që në vargun e parë poeti i thërret muzës siciliane të këndojë për gjëra më të larta. Ai paralajmëron lindjen e një fëmije nga i cili do të fillojë një botë e re, e ndritshme, larg asaj të vjetrës.

*Muza Sicilijane, t'kendojm pak gjana mâ t'nalta!
Shqobat njerzit të gjith' s'i gëzojn' dhe mirikat e ulta;
Pyjet në qoft se këndojm', atà lypset për konsulin t'ken' vleft',
Mosha e fundëshme erdhi e kangës Kumene nashti mâ;
Rradha e shekujvet rishtazi nisi t'filloj' po e madhe,
Kthehet Astrea së rish prap, kthehen mbretnít e Saturnit;
Prap prej qillit të nalt' mâ ulet tetposht një e re far',
Por ktij djalit të lemun, me t' cilin gjinija e hekurt
Merr funt, del dhe mbi botën të gjith' një gjini e florinjët,
Bani nderime, Lucin': se Apolli i yt mbretënon mâ,*

*Ndën ty kjo madhështi kshtu: e kohvet do t'marri fillimin,
Pollion, dhe do të ecin mujët e mdhaja përpara.*

(Virgjili, idem)

Ekloga e pestë, gjashtë dhe shtatë, japin momente të rëndomta të adhurimit të Jul Cezarit, Epikurit. Ndërsa, në prizëm të dashurisë hyn ekloga e tetë, në të cilën përsëri i këndohet dashurisë, por jo si në poezinë e dytë në të cilën personazhi bari i thur poezi Aleksit, por tash kemi dashurinë e vajzës ndaj djalit, më konkretisht përjetimin e ndarjes së saj nga i dashuri.

Poezia e parafundit, nëpërmjet alegorisë, rikthen çështjen e poezisë së parë, të marrjes së tokave, por tash falë Augustinit. Ndërsa, poezia e fundit e rikthen përmes këngës përsëri temën e dashurisë, të cilës mendon Virgjili, që të gjithë në një ose mënyrë tjetër do t'i bindemi.

3.

Libri i dytë i Virgjilit “Gjeorgjikat”, poezitë mbi jetën e bujqve, është shkruar në një periudhë kohore 10-vjeçare (37 deri më 29 para Krishtit), dhe ka një volum më të madh se libri i parë “Bukolikët”. Libri ndahen në katër pjesë, duke pasur objekt poezinë për bujqësinë në të parin, pylltarinë dhe vreshtarinë në të dytin, ndërsa në pjesën e tretë dhe të katërt i këndohet kultivimit të bletëve. Në këtë plan ndërtohet sistemi poetik i “Gjeorgjikave”, për t’u esencjalizuar ideja poetike, por edhe duke u mundësuar që poezitë të qëndrojnë edhe në vete. “Gjeorgjikat përmban një peizazh që ka të veçantën e tij, tiparet dhe kufijtë e tij, prandaj e gjithë vepra është koncept që duhet zberthyer”(Martindale, 2006).

“Landën e “Gjeorgjikës” Virgjili e ka nxjerrë nga studimi dhe jeta e tij, dhe e ka ba poezi të një frymëzimi thjesht personal. Ai këtu na zë në gojë vetëm Heziodin nga Askra si prekursor të vetin, dhe thotë se asht i pari poet i Romës që po i këndon tokës dhe punës së njeriut. Burimet teknike në “Gjeorgjikën” Virgjili i mori me siguri nga: Arati, Erastoteni, Teofrasti, Magoni prej Kartagjene, Katoni dhe Varroni; ndoshta edhe nga Igjini. Po burimin kryesor ai e nxori nga eksperiencia e tij personale në jetën e fshatit: ai merr si landë atë që vetë ka pa me

sytë e tij: *Vidi asht verbi* që ai përdor ma dendur në Gjeorgjikën. “Gjeorgjika” asht kryevepra e literaturës latine përsa i përket unitetit të konceptionit dhe të ekspresionit të saj, për sa i përket bukurisë së paprerë të tingullit e të fjalës dhe proporcioneve të figurave” (Ndoja, 2003).

“Gjeorgjikat” realizohet me një gjuhë dhe stil mjaft origjinal, të bukur e të kultivuar, duke i dhënë rëndësi e kuptim objekteve që ka zgjedhur poeti të trajtoj. Me këtë stil e në mënyrë lirike jepen pamjet rreth jetës së fshatit, si dhe me një ton të veçantë i këndohet rëndësisë së punës. Kështu si një pasqyrë magjike del pamja e jetës së vendit, rreth së cilës thuret tërë sistemi poetik.

Teksti shpesh duket si thurje udhëzimesh për punët bujqësore, por është stili i Virgjilit që të gjitha i kthen në figura letrare. Ai me pasion e dashuri këndon botën e përditshme e të begatshme të vendlindjes, por edhe pretendon të mësojë për teknikat bujqësore, duke kënduar edhe për vështirësitë e punës.

“Gjeorgjiket” janë vepër shkencore e Virgjilit, e krijuar në bazë të hulumtimeve të teknikës bujqësore, që mbështetet në përvojën dhe në recetat e romakëve, të trashëguara nga stërgjyshërit. Aty kemi udhëzime dhe receta për t'i dalluar tokat pjellore, thatësinë dhe lagështinë e terrenit, mandej fuqinë e kafshëve dhe pastërtinë e racës së tyre. Ja një fragment se si i paraqet poeti këto mendime dhe si i jep recetat:

Në fillim të pranverës nga majat e zbardhura të maleve rrjedh lagështia dhe zefiri skrifton tokën. Le të fillojë atëherë kau, prej parmendës së futur thellë, të rënkojë dhe të shkëlqejë plori i fërkuar nga hullia. Toka do t'u përgjigjet atëherë dëshirave të të gjithë bujqve të uritur, në qoftë se do të heqë dy vapa e dy të ftohta, korrrjet atëherë do të jenë të tilla sa do të thyhen hambarët. Por, para se të çajmë një tokë të re, duhet t'i dimë erërat dhe sjelljen e kohës dhe mënyrat e zakonit e të parëve të atij vendi çfarë jep kjo tokë këtu dhe çfarë nuk i jep ajo bujkut. Këtu gruri rritet më me bollëk, kurse atje vreshtat, atje prodhim i mirë nga pemët, dhe vetëm gjelbëron bari. (Sedaj, 2000).

Mirëpo, në këtë vepër autori shqipton dhe vështirësitë dhe pësimet. Për të bërë punët si duhet dhe për të përjetuar frytet e mirëfillta të saj lypset syçelëtësi, kujdes, përkushtim dhe flijim i vijueshëm për arsye se edhe pakujdesia e vogël sjell pasoja të mëdha në frytet e veprimeve; edhe dukuritë e ndryshme natyrore, që janë jashtë mbizotërimit dhe fuqisë së njeriut: stinët, bora, shiu, vërshimet, e kushtëzojnë jetën dhe shpesh i shkatërrojnë frytet e punës së bujkut dhe ia bëjnë gjallimin të rëndë. Virgjili i shqipton këto nëpërmjet një strukture

tekstore, artistikisht të dendur e të ngritur dhe plot nuancime e ngjyrimë shprehëse poetike (Berisha, 2000).

Virgjili, duke dashur që poezinë ta bëjë një dëshmi të fortë, për ngjarjet historike, bujqësore e blektoriale do që me emocion të këndojë në mënyrë lavdëruese, por edhe përkushtuese për Cezarin, Mecenatin etj. Në këtë këndim poetik me lirizëm të thellë që në faqet e para të tekstit na paraqitet Roma, me në krye Cezarin.

Po ashtu, vargjet që shprehin adhurimin për hyjnitë përbëjnë një pjesë të madhe të tekstit, e sidomos ato për Zeusin, që figurohet si nxitës i mendjes së njeriut për dashurinë ndaj tokës. Hyjnitë dhe legjendat e tjera mitike janë shpeshherë përcaktuese edhe të fatit të njeriut, edhe të prodhimit të bujqësore, andaj themi se te Virgjili del hapur kjo ndërlidhje hyjnore e njerëzore.

“Gjeorgjikat”, përmes poetikës dhe metrikës klasike e njëmbëdhjetërrokëshit, rrëfejnë jetën reale me të gjitha të mirat dhe ngarkesat e saj, kur duhet siguruar jetesa njerëzore. Figurat këtu shpërthejnë nga jeta e thjeshtë bujqësore, por marrin formë tjetër kur bëhen figura të mbijetesës.

Kjo vepër letrare, nëpërmjet këndimit të botës së përditshme, të mirave të saj dhe vështirësive që gjendet në të, shënjon ndër të tjerash një Virgjil që ka dhembje e dashuri për tokën e tij.

4.

Poema “Bagëti e Bujqësia” është shkruar në vitin 1890 dhe është vepra e parë poetike e Naim Frashërit. Poema është ndërtuar në dy pjesë dhe himnizon Shqipërinë, e lavdëron begatitë e saj.

“Poema “Bagëti e Bujqësia” është vepra e parë poetike e Naim Frashërit e shkruar shqip, madje për shumë studiues edhe kryevepra e tij poetike, sepse krijon një njësi arti. Në këtë vepër janë kurorëzuar disa nga vlerat më të mëdha poetike të këtij autori, po para së gjithash janë shfaqur shenjat themelore të artit të tij poetik përgjithësisht: në sistemin e vargënimit, tetërrokëshi i dyzuar në një gjashtëmbëdhjetërrokësh, që si tetërrokësh do të bëhet më vonë zotërues në veprën e tij poetike; gjuha e kulluar poetike shqipe e mbështetur në fjalor e figurë popullore; vögëlsimi, si figurë që ngrit kuptimin e afërsisë e të dashurisë me objektin e këngës; mrekullimi me natyrën e vendin, si karakterizim i artit poetik romantik; dhe në fund një thurje poetike autentike që në sistemin e

përgjithshëm të kuptimit të veprës ngrit jetën e shqiptarëve, një etos dhe etnos të tyre” (Hamiti, 2002).

Naimi duke e njohur jetën etnike, blegtorale e bujqësore reflekton fuqishëm për të esencializuar pozicionin e tekstit e duke krijuar lirikë adhuese e himnizuese për shqiptarët e Shqipërinë. Tërë rrëfimin lirik Naimi e ndërton në pak rreshta, por duke i prekur pikat e forta e duke zbrërthyer domethëniet. Nëpërmjet shfaqjes miniatyreske, dhe shpërthimit të subjektit poetik, autori na jep një pamje të Shqipërisë si shfaqje reale, por në një nivel përrallor.

Për të artikuluar sa më qartë këtë përshkrim përrallor e për të bindur letrarisht lexuesin për ato që shkruan, Naimi krijon gjatë tërë poemës një diskurs mrekullues. E gjithë kjo duket sikur strategji për t’u liruar nga malli e dashuria që ka për atdheun, e që vargjet referente dalin: “me gas e dëshirë”. Për ta mundur dëshpërimin.

*Sa me vrap e me gas bredhin, edhe lozin shoku me shok,
Aty përhapenë me nxit, aty mblidhenë prapë tok,
Edhe prapë tufë-tufë përhapenë duke bredhur;
Nxitojn' e s' lodhenë kurrë, edhe kur i mer uri ja.*

(Frashëri, ibid)

Prandaj, kjo poemë përveç që karakterizohet si kryevepra e autorit, karakterizohet edhe si poemë tipike romantike, e cila si synim ka shpërfaqjen e bukurisë së vendit, dashurinë për të, punës së njeriut dhe begatisë së jetës. E ky shkrim personal del përmes figurës, për t’u shënjuar karakteri i veçantë i veprës. Janë figurat e poemës që të lidhura në strukturë ato që japin natyrën semantike të tekstit, me kuptime të thella atdhetare. Secila pjesë e secili varg i poemës jep një gjendje të veçantë të bagëtisë e bujqësisë shqiptare, duke tingëlluar si një këmbëngulje letrare për të hetuar e për të zbuluar çdo element shqiptar.

Në vargjet e kësaj poeme me adhurim u këndohet maleve të Shqipërisë, bagëtisë e bujqësisë, nga e cila edhe mbahen gjallë shqiptarët. Po ashtu, jepet pozicioni i autorit si poet i mërguar që këndon me mall, duke e rritur fuqinë e tekstit si dhe lavdit për Shqipërinë që i “jep nder dhe emrin shqiptarë”. Do të thotë, nga këtu, pra nga fillimi i tekstit, nis shënjimi i kuptimeve të thella e më të rëndësishme të tij. Po ashtu, shënjohe fuqishëm “elementi strukturor, subjekti i shkrimtarit, i cili në fillim artikullohet si një frymëzim i zjarrtë që identifikohet me vetë

këngën, kurse në fund artikullohet në trajtën e qëndrimit autorial për çështjet e shtruara në vepër, dhe merr trajtë e mësimit autorial, apo në një kuptim të përgjithshëm, trajtën e porosisë së veprës.”(24)

Përqendrimi i autorit te vlera e trashëgimisë dhe e bukurisë natyrore, te pasuria bujqësore e blegtorale, te puna dhe shprehia e njeriut për punë, përbën krejt tekstin, përjashtimisht dy rasteve kur poeti sikur për të kujtuar që është duke shkruar për një jetë të gjallë, edhe pse në mënyrë përrallore, paraqet një situatë varfërie dhe një vdekje njerëzore.

Kështu, teksti thur ide letrare nëpërmjet emocioneve të subjektit lirik përgjasueshëm me autorët romantikë, duke u arsyetuar kjo trajtë shkrimi. Në këtë vijë edhe mbyllet poema, me një diskurs disi formulativ, duke theksuar idenë themelore të tekstit, siç është bashkimi i shqiptarëve në rrugën e drejtë.

*Fali diellit flak' e zjar, dhe hënës' e yjet dritë,
Edhe detit uj' e kripë, gjithësisë jet' e ditë.
Yjtë le të vinë rrotull dhe njerëzit të punojnë,
Të dëfrenj' e të gëzohen, dhe si vëllezër të shkojnë.
Tregomu dhe Shqipëtarët udhën' e punës së mbarë,
Bashkomi, bëmi vëllezër, edhe fjeshtë Shqipëtarë.
Falmi, falmi Shqipërisë ditën' e bardh' e lirisë,
Udhën' e vëllazërisë, vahn' e gjithë mirësisë.
Nxir të vërtetënë në shesht, paskëtaj të mbretëronjë,
Errësira të përndahet, gënjeshtëra të pushonjë.*

(Frashëri, ibid)

Literatura

1. Berisha, Anton. 2000. ("Gjeorgjikat" e Virgjili), Shpresa, Prishtinë.
2. Clausen, Wendel. 1994. *A commentary on Virgil, Eclogues*, Published in the United States by Oxford University Press Inc., New York.
3. Frashëri, Naim. 2008. *Vepra 1*, Toena, Tiranë.
4. Hamiti, Sabri. 2002. *Vepra letrare 7*, Faik Konica, Prishtinë.
5. Jones, Frederick. 2011. *Virgil's Garden The Nature of Bucolic Space*, Bloomsbury Academic An imprint of Bloomsbury Publishing Plc, bloomsbury.com.
6. Maroni, P.Vergil Maroni. 1932. *Bukoliket*, Kristo P.Luarasi, Tiranë.
7. Maroni, P.Vergil. 1932. *Bukoliket*, Kristo P. Luarasi, Tiranë.
8. Ndoja, Mark. 2003. *Kritika klasike dhe leksione greko-romake*, Arbëria, Tiranë.
9. P.Vergil Maroni,1932, *Bukoliket*, Kristo P. Luarasi.
10. Saunders, Timothy. 2008. *Bucolic ecology: Virgil's Eclogues and the Environmental Literary Tradition*, Bloomsbury Academic An imprint of Bloomsbury Publishing Plc, www.bloomsbury.com.
11. Virgjili, 2000. *Eneida*, Timegate, Prishtinë, përktheu Engjëll Sedaj.
12. Virgjili. 2000. *Gjeorgjikat*. Shpresa, Prishtinë.
13. Xinyue & Freer. 2019. *Reflection and new perspectives on Virgil's Georgics*, Bloomsbury Academic An imprint of Bloomsbury Publishing Plc, www.bloomsbury.com

81'0
811.18 '282.2
811.18 '342.1

Hana Radoniqi, Prishtinë

THEKSI I SHQIPES DHE VARIACIONET GJEOGRAFIKE

Abstrakt

Kuptimi teknik i termit *aksent* lidhet me mënyrën e shqiptimit. Qëllim i këtij punimi është të përfshijë mënyrat e dallueshme të shqiptimit të fjalëve, veçanërisht të klasëve të ndryshme sociale. Diskutimi për këtë çështje mëton t'i bëjë bashkë disiplinat fqinje: në njërën anë sociolinguistikën (aksenti i huaj/ lokal ndërmjet folësve) dhe, në tjetrën, fonetikën dhe fonologjinë (vendi i theksit gjatë shqyrtimit të rasteve kur hiqen tingujt/ rrokjet ose kur shtohen këto).

Së këndejmi, statistikën e përmbledhura bëhen të krahasueshme, meqë ndërmjet folësve ekzistojnë ndryshoret sociologjike: vendlindja, mosha, arsimimi, marrëdhëniet e pushtetit dhe të ndikimit etj. Pra, trajtohen ndryshimet që janë relevante nga aspekti sociolinguistik: nëse folësi përdor aksentin e tij lokal, si mjet për afirmimin e identitetit dhe të besnikërisë ndaj grupeve lokale – variacioni gjeografik.

Të dhënat dhe transkriptimi: analiza e bisedës është incizuar në bazë të ndërveprimeve natyrale ndërmjet pjesëmarrësve të ndryshëm, me qëllim të identifikimit të dukurisë së theksit në shqipen. Dallimi i ilustruar në transkripte thekson rëndësinë e kontekstit shoqëror: është përdorur transkriptimi fonetik sipas simboleve të IPA-s.

Fjalët çelës: theks, rrokje, gjuhë e folur, variacion.

SFONDI TEORIK

Sipas Suzanne Romaine-it (2001: 311), disa gjuhëtarë bëjnë dallimin e mëtejshëm midis aksentit dhe dialektit. Aksenti përbëhet nga shumëllojshmëria e mënyrës së shqiptimit. Një dialekt, megjithatë, varion njëkohësisht nga dialektet e tjera të së njëjtës gjuhë të paktën në tri nivelet e organizimit: shqiptim, gramatikë ose sintaksë dhe fjalor. Kurse, sipas Llamas-it, Mullany-it & Stockwell-it (2007: 205–230), aksenti nënkupton modelet karakteristike shqiptimore të varietetit të të folurit. Aksenti i folësit – që cilësohet nga fonemat dhe nga modelet e intonacionit – mund të identifikojë shpeshherë klasën e tij shoqërore, moshën, gjininë, prejardhjen gjeografike, përkatësinë etnike e, madje,

edhe përkatësinë e tij politike. Nga ana tjetër, sipas tyre, theksi i referohet forcës artikulative mbi rrokje të caktuara, e cila i jep aksentit ritëm karakteristik. Me fjalë të tjera, sipas Coupland-it (2007: 5), aksenti u referohet aspekteve shqiptimore të dialektit, ndërkaq dialekti është term i përgjithshëm për variacionin e të folurit që ka të bëjë me anën shoqërore dhe gjeografike.

Pra, theksi i intereson një fonologu për mënyrën se si një rrokje e caktuar shquhet mbi të tjerat në fjalë. Një sociolinguist, në anën tjetër, hulumton dhe përshkruan mënyrën se si shqiptimi i tingujve në fjalë ndërlidh apo dallon grupet e caktuara të folësve (Ismajli et al. 2020: 340).

Më pas, Hudson-i (2002: 53) ka theksuar se, në përgjithësi, shqiptimi është më i ndjeshëm ndaj dallimeve krahinore dhe shoqërore, sesa gramatika dhe fjalori. Kështu që, theksi i referohet vetëm shqiptimit, dialekti i referohet çdo aspekti tjetër të gjuhës (morfologji, sintaksë, leksik).

Tutje, sipas Edwards-it, meqë është e qartë se ndryshimi në bazë shoqërore është implikuar edhe në dallueshmërinë rajonale: dallimet gjeografike, shoqërore ose klasore bashkërisht janë konsideruar si themelore (2013: 31).

Në anën tjetër, Ismajli ka shpjeguar se ndryshimet dialektore dhe vatrat e dinamizmit në dallimet lidhur me përshtatjen e vendit të theksit të huazimet e reja, qëndrojnë jo më në raportet gegërishte/ toskërishte, po shqipe në Shqipëri dhe shqipe në Kosovë ose, në hapësira të tjera, në Maqedoni dhe tek arbëreshët. Sipas tij, për këtë ndikojnë: skemat theksore brenda shqipes, modelet e gjuhëve prej nga huazohet, gjedhet e gjuhëve me ndikim më të madh në shqipen (siç është italishtja në Shqipëri), moda dhe fenomenet e tjera të natyrës shoqërore etj.; psh., disa nga variacionet janë: Shqipëri – *ópera, kámara, kompjútër, bíznes, çiménto* etj.; Kosovë – *opérë, kamërë, kompjutër, biznés, çimént* etj. (2005: 178–179).

Në këto rrethana, me terma të përgjithshëm, në sociolinguistikë theksohen dy forca të ndryshme: mikro-sociolinguistika dhe makro-sociolinguistika. E para (Coulmas 1998, Holmes 2015) shqyrton mënyrën e ndikimit të strukturës shoqërore në atë se si njerëzit flasin dhe, po ashtu, lidhjen e varieteteve të gjuhës dhe të modeleve të përdorimit me atributet shoqërore, si klasa, gjinia dhe mosha; në anën tjetër, e dyta, studion mënyrën se si shoqëritë e përdorin gjuhën, d.m.th. qëndrimet dhe lidhjet e tyre që shpjegojnë përndarjen funksionale të formave të folurit në shoqëri, si ndryshimi i gjuhës, kujdesi për gjuhën dhe

zëvendësimi i gjuhës – pra, caktimi i kufijve dhe ndërveprimi i bashkësive folëse.

Më pas (Topalli 1995a), studimet në shqipen kanë vërtetuar se kuantiteti (gjatësia) e zanoreve luan rol në realizimin e theksit e që shqipja priret t'i theksojë zanoret parafundore, duke krijuar fjalë me ritëm trokaik. Pra, sipas të dhënave (Topalli 1995b), karakteristikë për sistemin vokalik të shqipes është rënia e një zanoreje (edhe e një rrokjeje) që është jashtë theksit të fjalës, ku fjalët me ritëm daktilik janë kthyer në fjalë me ritëm trokaik (sidomos me rënien e zanores -ë- në fund fjale). Mirëpo, shpjegimi i theksit në kuadrin e këtij punimi, lidhet me gjeografinë dialektore, në të cilën **kuantiteti** varion ndërmjet dialekteve, por edhe nga faktorët sintaksorë a të sand'hit (bashkimi i dy fjalëve ose i formave të fjalës, duke rezultuar në ndryshimet sistematike fonologjike), meqë zhvillohet diskutim i gjerë ndërmjet folësve.

Në përputhje me këtë, mund të flitet edhe për variacionet stilistike në përdorimin e gjuhës, ku folësit ndryshojnë stilin e tyre të të folurit – pra, gjuha e folësit ndikohet nga dëgjuesi dhe, po kështu, e ndikon dëgjuesin. Sipas Bell-it (2001: 141–148), thelbi i dizajnit të audiencës mund të përmblihet sipas disa pikave, si rezultat i variacionit të ndër-folësit (interspeaker). Stili nënkupton se si një folës i veçantë e përdor gjuhën në raport me njerëz të tjerë (lidhja e tipareve gjuhësore me grupe të caktuara shoqërore). Pra, në përgjithësi, dizajni i audiencës shfaqet kur folësi e ndryshon stilin e të folurit, për të qenë më i ngjashëm me personin që është duke folur: kjo është “konvergjenca” sipas teorisë së akomodimit të komunikimit/ të folurit, zhvilluar nga Howard Giles-i, Peter Powesland-i (1975) dhe Coupland-i et al. (1988). Ndërsa, divergjenca simbolizon dëshirën për ta pakësuar intimitetin/ kujdesi i vazhdueshëm gjatë të folurit: simbolizon dëshirën për ta reduktuar intimitetin që nënkupton asnjë variacion ose asnjë devijim nga mënyra e komunikimit (Coupland 2007: 62).

Rëndom, shoqëria sot karakterizohet nga nivele të larta të lëvizshmërisë (gjeografike dhe shoqërore). Karakteristikë e gjuhës janë ndryshimet, të cilat vijnë nga vala e vërshimeve e teknologjisë dhe kontakti me botën. Shkaqet e ndryshimeve gjuhësore janë: kontaktet gjuhësore (konstruktet e huazuara nga gjuhë të tjera), mediat elektronike (komunikimi digjital), diferencimet sociale etj. Përmes ndërveprimeve të faktorëve ekonomiko-shoqërorë merren fjalë të reja, të cilat integrohen gjatë të folurit. Shquhen për ndryshime: leksiku, struktura e fjalisë dhe mënyra se si shqiptohet fjala. Studiues të globalizimit vënë në dukje se, pa gjuhë, nuk do të kishte globalizim; dhe, e kundërta, pa

globalizim, nuk do të kishte gjuhë botërore (siç është tani përhapja dhe konsolidimi i shpejtë i anglishtes). Të tjerë, flasin për “gjenocid gjuhësor”, duke ia vënë gishtin globalizimit. E tërë kjo përfshin edhe këtë hulumtim, në të cilin shfaqen një mori fjalësh të huaja, në masë të madhe nga anglishtja e që për synim ka vendosjen e theksit në shqipen.

Megjithëkëtë, si formën kryesore të ndikimit të proceseve të globalizimit në shqipen, Munishi e sheh ndryshimin e diskurseve publike, të zhanreve dhe të stileve gjuhësore (2015: 28–31).

Për më tepër, meqë ky punim mbështetet te një material disaorësh në trajtë dialogu me karakter formal, është vënë në pah se varieteti i folur standard nuk i mënjanon varietetet e tjera gjuhësore, por është komplementar me ta. Analiza do të bazohet te takimi i dytë publik për vitin 2016 me qytetarët e Komunës së Gjakovës, i cili është mbajtur më 20. 12. 2016 në sallën e madhe të Kuvendit të Komunës së Gjakovës. Mbledhja ka filluar në orën 13:00 dhe ka zgjatur më tepër se tri orë (pa ndërprerje). Moshë e pjesëmarrësve mund të ndahet në tri kategori: 23-40, 41-59, 60-77; në fakt, ka dominuar mosha e grupit të dytë.

DISA GJETJE

Ekstrakti 1 është transkriptimi i një sekuence të vazhdueshme nga paraqitja e Kryetares së Gjakovës, 42 vjeçare, e lindur në Gjakovë. Fillimisht, ajo ka shpalosur tërë programin e Komunës për vitin 2016, gjithashtu edhe planet e tjera të përealizuara që janë të planifikuara për vitin 2017. Në vijim, do të paraqiten karakteristikat thelbore përgjatë prezantimit të saj, ku siç është theksuar te trajtimi teorik, synim do të jetë rënia e shpeshtë e tingujve te format e pashtjelluara të foljes dhe theksi te leksiku i huaj terminologjik që në shumicën e rasteve lidhet me anën ekonomiko-shoqërore:

- 00:20 /ke'mi pa:s/ (× 12)
 00:43 /tə ske:məs sə subventsjə neve/
 01:57 /ve'tem kə fītu:/ (× 2)
 02:01 /lɔkatsjə'ni dʒiθaftu:/
 02:43 /mɔskɔnstitui min ɛ kuve'ndit/
 02:45 /efitʃje:ntsa ɛ enerdʒi:s/
 03:25 /implementi mi i kti:j prɔje'kti/
 03:33 /impja'nti i u'jrave tə ze'za/
 05:45 /kə'ʃpa:l tendə'rin/

- 07:04 /pǎr nǎʃpenziːm mǎ efiʃjeːnt t̪ b̪udʒeːtit/
 08:43 /nǎ st̪aːjdin/
 09:06 /mikrɔʃɔːn statiːk/ ləviːzəs/
 11:48 /ðǎ senzɔːrve/
 12:04 /didʒitaliziːmin ǎ administraːtəs/
 13:37 /mǎ uniteʃfin/
 14:18 /mǎ pajiːsjet dʒipieːs/
 16:01 /ngǎ juendipiːja/
 18:16 /jaːn inkasuː/
 19:50 /mamɔgraːfit statiːk/
 19:53 /rɔtarjaːnve int/ ndərkɔmtaːr/
 21:06 /heːndikɔs/ seːjv ðǎ ʃiːtdrən/
 30:42 /studiːm fizibiliteti/
 34:03 /ǎ tangɔːjn setsiːlin ʃytetaːr tǎ kɔmuːnes sǎ dʒakɔːves/

Nga ekstrakti 1 vërehet se folësja ka përdorur një varietet më formal, sepse veprimtarisë intelektuale (nivele arsimor i saj në fushën e ekonomisë) ia ka përshtatur diskursin; jo pak, në një situatë të tillë formale, janë të pranishme edhe tiparet dialektore të ngjashme me gegërishten. Nuancimet drejt varietetit dialektor joformal/ lokal janë bërë jo se kishte ndërrim situatash a domenesh, por sepse shumica e qytetarëve kanë qenë nga rrethinat e Gjakovës. Në këtë rast, elementet karakteristike për varietetin verior të folëses, janë: rënia e zanores -*ë* fundore ka krijuar fjalë me rrokje të mbyllura (*kanë qenë* > *kaːn ʃeːn*), fjalët me katër rrokje kanë përfunduar në fjalë dyrokëshe (*në tërësinë* > *nǎ tǎrsiːn*). Më të shpeshta janë fjalët me theks fundor, si rezultat i rënies së shpeshtë qoftë të zanores së pashquar -*ë*, qoftë të rrokjes. Karakteristikë tjetër që është e theksuar më të shumtën e herëve është rënia e rrokjes fundore te format e pashtjelluara të foljes: përafërsisht 80% e rasteve të përdorimit të këtyre foljeve dëshmojnë se më i preferuar është ndërtimi pa -*ur* (pasur), -*ë* (qenë), -*er* (pëlqyer), -*ar* (punuar) dhe -*rë* (parë), duke i ekonomizuar këto konstrukte për të fituar kohë me rrjedhën e të folurit. Prandaj, edhe shumica e fjalëve njëro-këshe ose me theks fundor si pjesë e këtij transkriptimi del si rrjedhojë e këtij fenomeni.

Tipar i spikatur është edhe përdorimi i fjalëve të huaja, qofshin ato emërtime të organizatave të huaja joqeveritare (zakonisht si shkurtësa), qofshin fjalë të leksikut të përditshëm e të përshtatura sipas gjedhes së shqipes: *nǎ st̪aːjdin*, *senzɔːrve* (theksi në rrokjen e fundit të

temës - 'sensør anglisht), *maməgra:fit* (në pjesën e fundit të temës - ma'mogrəfi anglisht), *ě tangə:jn* (e prekin) etj.

Ekstrakti 2 është transkriptimi i folësit të dytë, qytetar i fshatit Lipovec të Gjakovës (fshat në regjionin e Hasit), 39 vjeçar, me arsim të lartë në fushën e ekonomisë. Folësi ka folur shpenguar, duke i zgjedhur dhe duke i shfaqur dukshëm trajtat e tij krahinore, psh.:

- 36:21 /m_ŭ θəmzlu: nŭ komisjə'n pə'r sŭfyrti'min ʒ vnkə'səu
t_əmzrti'mit t_ru:gve//
- 36:55 /ě äšt ĩ pertsəktu'n dəstini'mi i kty're mje'tev n_nŭ
proje'kt t_vefŭ:nt//
- 37:15 /problə'mi mē drejto'rə t_škə'läv//
- 37:43 /t_serbi'meu publi'ke/

Vërehen plotësisht tiparet dialektore: pjesoret e shkurtra që pakësojnë rrokje (për shkak se gjenden në rrokje të hapura, zanorja fundore është e gjatë), prirja për ndërfitjen e “glajdit” -*u* (gjysmë-zanore) në pozitë pas zanores të mbaresa në rasën gjinore, por edhe e kundërta: prirja për heqjen e zanores -*e* fundore si pjesë përbërëse e mbaresës në rasën gjinore. Qartazi, foljet dhe klasën emërore i karakterizon theksi fundor, duke mos munguar edhe fjalët me vetëm një rrokje, për shkakun se në ligjërimin e lidhur fjalët kanë hyrë në marrëdhënie të ngushta.

Ekstrakti 3 është transkriptimi i folësit të tretë, qytetar i fshatit Ramoc të Gjakovës, 70 vjeçar, mësues pensionist. Preokupimet e tij kanë qenë të lidhura me asfaltimin e rrugëve:

- 39:00 /i:ŭte sŭtru:e nă zavo'r/
- 39:06 /ö domtu:e ŭu:m/
- 39:45 /pə'r m_ŭ asfatu:e/
- 40:05 /jo:n ndertu:e ru:g tje'ra/
- 42:30 /ă θu:e ne've nŭk nă tako'n nŭ pje:s ĩ aty'ne pa'rev/

Karakteristikë e tij ka qenë togu i zanoreve -*ue* të foljet, mungesa e nyjave të përparme të përemrat e pacaktuar; elementet dialektore janë vërejtur edhe të përdorimi i nyjës së pashquar *ni* dhe, së fundi, rënia e

shpeshtë e tingujve ka bërë që shumica e fjalëve dyrrrokëshe të përfundojnë si njërrrokëshe.

Ekstrakti 4 është transkriptimi i folësit të katërt, qytetar i fshatit Nivokaz të Gjakovës, 65 vjeçar, me arsim të lartë, sekretar i një klubi të hendbollit. Për dallim nga folësit e mësipërm, i katërti shquhet për tipare të tjera të të folurit:

- 44:53 /d̥d̥d̥ m̥s̥ t̥s̥r̥ ɛ̥ sh̥tru:m̥ ɛ̥ ru:gs̥//
 45:18 /v:ft̥ ɛ̥ p̥abo me̥ f̥ɛ̥ v:ft̥ tu r̥pi koso vs̥/
 45:27 /ru:g̥ f̥ɛ̥ ɛ̥ k̥ã furnizu: koso:ven̥ d̥ʒa t̥ lu f̥ts̥ m̥ɛ̥ f̥taðe:t̥
 p̥er̥f̥i n̥ t̥ armati mit̥/
 48:08 /n̥ũk̥ m̥ũj̥ t̥ɛ̥ lo: p̥ã kalu: t̥ãf̥ e ðe t̥ɛ̥ t̥ mi rat̥/
 49:26 /f̥ɛ̥ v:ft̥ pu:n̥ ɛ̥ ju v̥ja/

Pra, në masën më të madhe, e dallon rënia e *ë-së* pastheksore, duke krijuar kështu grupe komplekse bashkëtingëlloresh në fund të fjalës, rrjedhimisht fjalë dyrrrokëshe: *koso vs*, *d̥ʒako vs*, *evro ps* etj. dhe futja e *v-së* pastheksore në vend të *a-së* të përemri pronor (plus kësaj, me një përpara, pavarësisht se është përemër i emëruar që ndodhet përpara një emri në të pashquarën): *ɛ̥ ju v̥ja*.

Ekstrakti 5 është transkriptimi i folësit të pestë, qytetar i fshatit Babaj i Bokës të Gjakovës, 58 vjeçar, me arsim të mesëm – bujk me profesion:

- 50:35 /e ðe u:ren̥ ɛ̥ k̥ã demtu:e u jt̥//
 50:54 /ke m̥ f̥ú:m̥ se ñe p̥ɛ̥r̥ p̥ã bo: /

Është përdorur varieteti lokal dialektor, ndërsa baza e tij regjionale vërehet pëveç se te sistemi foljor, edhe tek ai emëror: *u jt̥*, *ba baj bo:ks* etj.

Ekstrakti 6 është transkriptimi i folësit të gjashtë, qytetar i fshatit Xërxë të Rahovecit, 55 vjeçar, me arsim të mesëm – mjeshtër kopshti, i cili jeton në Zvicër:

- 52:47 /m̥ o f̥t̥ uzurpu: pro na f̥ɛ̥ t̥ãf̥ ɛ̥ ðe:t̥ vi te//

Të folurit ka qenë më i përmbajtur (duke u gjendur para alternativave drejt formave dialektore/ standarde), por që nuk kanë munguar rëniet e tingujve, sidomos te pjesoret: /*ʃkaktu.*, /*ʃkru.*, /*karku.*, /*pərdʒe dʒ* etj.

Ekstrakti 7 është transkriptimi i folësit të shtatë, qytetar i Gjakovës, 77 vjeçar, me arsim të lartë – stomatolog, pensionist:

54:32 /*ɛ̃n ke t mle dʒe nũk kã mã fu:m fyteta:r//*

54:51 /*nĩ evenime nt ı ti:t du het respektu ar/ e d̃e du het fmu ar/ e d̃e du het vlersu ar//*

Në të folurit e tij, është shfaqur përpjekja për një realizim të trajtave të standardit (edhe përdorimi i huazimit /*evenime nt*/), porse edhe ndërrimi i stilit nuk ka munguar, duke dalë në sipërfaqe mjedisi gjeografik. Në pjesën tjetër të kohës janë shpërfaqur rëniet, si: /*medʒi θse*/, /*ka n kalu*:/, /*sẽ sĩ mẽ punu*:/, /*me j bo*:/ (me i bo), /*je mi matretu*:/, /*pãs asa jne*/ (shtesë tingujsh), /*rmu:j*/, /*ĩ informu n*/, /*medʒi θate*/ etj.

Ekstrakti 8 është transkriptimi i folësit të tetë, qytetar i fshatit Gërquinë të Gjakovës, 52 vjeçar, me arsim të mesëm – i papunë:

1:01:56 /*pšẽ n ffa tin gerfi:n asni: me ter asfa t t nũk ä ft ba://*

Të folurit e tij është i afërt me gegërishten në tërë shqiptimin, fillimisht kur e ka zënë në gojë emrin e vendlindjes, por edhe në rastet kur *n*-ja paraqet vlerën e saj silabike, meqë është hequr zanorja *ë*: /*n ffa tin*/ (duke krijuar grupe fjalësh me një theks të vetëm).

Ekstrakti 9, në kuadër të përgjigjeve, është transkriptimi i Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, i lindur në Gjakovë, 55 vjeçar, me arsim të lartë – specialist i mjekësisë interne. Gjuha e folësit ka qenë e afërt me publikun: para së gjithash, të gjithë i përkasin dialektit gegë. Specifikat e dukurisë së theksit të fjalisë në kuadrin e fonetikës sintaksore, janë:

09:16 /*ka n ffe:n tã involvu n e d̃e drejtori:a ẽ urbani zmit//*

09:24 /a:ft vɛndɔ:s li:sta defɪnitiːve nǎ kəːt asamble: komunaˈle/
a:ft votu: nǎ mny:r unaniˈme/

10:36 /ṭsiːlat jaˈn duˈke bo: feʒiːmin ẽ ru:gve//

Po ashtu, si shumica e folësve të mëparshëm, foljet i karakterizon theksi fundor (/keˈmi trafegu:/, /a:ft pɛrfundu:/, /kaˈn ṭfɛ:n/, /a:ft vɛndɔ:s/, /kiˈfa lu:t/, /jaˈn duˈke bo:/ etj.), ndërsa edhe në klasën emërore theksi bie në rrokjen e fundit të temës (/ṭfɛveriːsja ẽ kaluˈne/, /pɔtseːsi/, /liːsta defɪnitiːve/ etj.), por duke mos munguar edhe fjalët me vetëm një rrokje (/ĩ ḍʒiːθ/, /nǎ kəːt/, /nǎ mny:r/, /juːj/ etj.), për shkakun se në ligjërimin e lidhur fjalët kanë hyrë në marrëdhënie të ngushta.

Ekstrakti 10 është transkriptimi i folësit të dhjetë, qytetar i fshatit Korenicë të Gjakovës, 45 vjeçar, me arsim të lartë. Si i pari në rundin e dytë të pyetjeve e për dallim nga të tjerët, ky folës i kishte të shkruara në letër tërë kërkesat që kishte ndaj udhëheqësve komunalë. Si rrjedhojë e kësaj, të folurit ishte i kujdesshëm, i përmbajtur dhe, është vërejtur kujdes më i shtuar te trajtat foljore:

15:17 /keˈmi adresuˈar/

Ekstrakti 11 është transkriptimi i folësit të njëmbëdhjetë, qytetar i fshatit Gërquinë të Gjakovës, 70 vjeçar, me arsim të ulët, mjeshtër i shtëpive – pensionist. Janë vënë në pah rregullisht trajtat dialektore edhe pse është ndodhur në situatë formale:

16:25 /ã ẽ kaˈn hr̥ɲer miːt/ ã õ kaˈlb/ ã ku:r ṣderpreˈhet//

Pra, kemi *miːt* për minjtë, *õ kaˈlb* për është kalbur dhe *derpreˈhet* për ndërpritet.

Ekstrakti 12 është transkriptimi i folësit të dymbëdhjetë, qytetar i fshatit Cërmjan të Gjakovës, 33 vjeçar, me arsim të lartë, përfaqësues i Sindikatës së QKMF-së (Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare). Ai i është drejtuar Kryetares me tri pyetje, për të cilat kishte mbajtur shënime. Në këtë mënyrë, të folurit e tij ka rezultuar me një dozë më të madhe të kujdesisë, por pa i anashkaluar edhe format dialektore:

17:57 /ṣĩ pyːtje tǎ miːja/ domeθoːn ṇkəːt debaːt/ ĩ kaˈm evidentuː tri://

Ekstrakti 13 është transkriptimi i folësit të trembëdhjetë, qytetar i Gjakovës, 71 vjeçar, me arsim të lartë, pensionist:

21:13 /tri: mi:j ve:t mre'na di'tes/

Ekstrakti 14 është transkriptimi i folësit të katërbëdhjetë, qytetar i fshatit Kushavec të Gjakovës, 47 vjeçar, me arsim të mesëm:

22:21 /dy:/ a:ft tfa'ftja ě u:tes/ zo'na kɿyeta:ae/ n_ma:as/
dɿejto:ai m_kã telefonu: tʃǎ/ nǎ ú:ai a:ft a:ɿð ŋi:hm ðě
pǎkɿa'hje ě fǎsǎkǎ:s//

Ekstrakti 15 është transkriptimi i folësit të pesëmbëdhjetë, qytetar i Gjakovës, 34 vjeçar, me arsim të mesëm. Për pyetjet kishte mbajtur shënime, andaj ka pasur përqendrim edhe në të folur:

24:30 /ki:fa da:ft/ na:fta/ m_ũ pǎdʒi:dʒ kɿyeta:ija//

Ekstrakti 16 është transkriptimi i folësit të gjashtëmbëdhjetë, qytetar i Gjakovës (përfaqësues i komunitetit rom, ashkali dhe egjiptas), 30 vjeçar, me arsim të lartë. Ky ka shfaqur siguri në shqiptimin e tij, pra në përdorimin e një varieteti më standard, por edhe larmi rastesh të tjera:

25:58 /sǎ dǎ t_je:t ě gǎtfme/ komu'na/ mě mbǎfte:t mě la:nd
dje'gse//

Ekstrakti 17 është transkriptimi i folëses së shtatëmbëdhjetë, qytetare e Gjakovës (qytetare e komunitetit rom nga Lagjja Dardania në Piskotë), 72 vjeçare, me arsim të ulët. Të folurit e saj është përcjellë me një varg elementesh dialektore:

27:02 /jũ lu'na saha:t ě pa:ia mě a:ɿð aty://

27:14 /e'ðe mo' tʃeta:f sě fka'ũ bo:/ e'ðe mǎ zi://

27:39 /ǎ u'ne ja'm kǎ ě du: tʃe:t ru:g//

28:18 /ja'm rǎzu: dy: tri: he:ɿ//

Është hasur gjatë gjithë kohës – si të gjithë moshatarët e saj në këtë debat – stili i varietetit joformal dialektor.

Ekstrakti 18 është transkriptimi i folëses së tetëmbëdhjetë, qytetare e Gjakovës, 23 vjeçare, me arsim të lartë. Është folësja me moshën më të re nga tërë pjesëmarrësit e tjerë:

29:32 /jaːm dʒfmitaː.ɛ fʃ kyː viːt fʃ pī loːjim pās əʃt koːn mǎ ĩ
miː.ɪ pǎ.ɪ.ɪniːn ẽ dʒakoːves/

Pavarësisht se folësja ka dashur t'i kushtonte vëmendje diskursit, gjendja e saj e brendshme e ndikuar nga mjedisi përreth, ka ndikuar edhe në përzgjedhjen e fjalëve me disa tipare joformale.

Ekstrakti 19 është transkriptimi i folësit të nëntëmbëdhjetë, qytetar i fshatit Devë të Gjakovës, 29 vjeçar, me arsim të lartë:

30:43 /mǎ keːni fjuː nĩ pǎrdʒiː dʒe pǎrmeːs emaːjlit//
30:54 /kreːjt koːhen ũ pedaːt kjoː puːn//
31:18 /ǎs s_keːm uːj t_ vaːds/ ǎs s_keːm uːj t_ piːjes/
31:58 /θmiːja voːdʒel/

Shqiptimi i fjalës nga anglishtja *ímejll*, te folësi ka dalë me theks në rrokjen e fundit të temës.

Ekstrakti 20 është transkriptimi i folësit të njëzetë, qytetar i fshatit Devë të Gjakovës, 37 vjeçar, me arsim të mesëm:

33:33 /pǎr jaːn eːmrat ẽ atyːne buːrau//

Ekstrakti 21 është transkriptimi i folësit të njëzetënjëtë, qytetar i fshatit Hereq të Gjakovës, 50 vjeçar, me arsim të mesëm:

35:00 /pyːtja dyːt/ vːft nĩ konteːst ĩ trːks tẽ fytetvːrt/ ẽ ciːla nũk
kaː t_ bɔːj mẽ zyːren ẽ privatiziːmit//

Sikurse për folësin nga Nivokazi, edhe për këtë ka qenë karakteristikë rënia e ë-së pastheksore, duke krijuar kështu fjalë me rrokje të mbyllur ose njërrokëshe: /i tr:ks/. Pastaj, janë dy huazime /konte:st/ dhe /ë privatizi mit/, me të cilat folësi është ambientuar, për shkak të nevojës për t'i përdorur dhe të ballafaqimit me vite.

Pastaj, **Ekstrakti 22**, në kuadër të përgjigjeve, është transkriptimi i Drejtorit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, i lindur në Gjakovë, 58 vjeçar, me arsim të lartë – specialist i mjekësisë së përgjithshme. Në diskutimin e tij janë vërejtur përveç rëniet e tingujve, edhe shtesa të tyre të herëpashershme:

48:15 /pə.ɪveˈfksɛ:jne/

48:30 /ðë jũ je ni ko:n t_obligu'n fë n_kuaˈdeɪ t_atiˈjne/
tende:it/

Pra, në këtë shembull paraqitet epiteza si shtesë e një rrokjeje në fund të fjalës: /kse:jne/, /t_atiˈjne/; po ashtu, veçori tjetër është emri i huazuar /tende:it/, i cili i është përshtatur modelit të shqipes, duke bërë që të mos theksohet rrokja parafundore si në gjuhën angleze.

Ekstrakti 23 është transkriptimi i Drejtorit për Gjeodezi dhe Kadastër, i lindur në Gjakovë, 60 vjeçar, me arsim të lartë – inxhinier. Si tipare të ngjashme më folësin paraprak është epiteza dhe përdorimi i fjalës së huazuar plot 6 herë:

50:18 /nə məny:ɪ deɪsidiˈve/ (× 6)

Dmth., përsëritja e shpeshtë e mbiemrit /deɪsidiˈve/ lidhet me statusin e tij shoqëror, sidomos me pozitën. Mbiemri është sipas gjedhes së shqipes, duke u theksuar prapashtesa ose rrokja fundore e temës.

Ekstrakti 24 është transkriptimi i fundit i Drejtorit për Shërbime Publike, i lindur në Gjakovë, 49 vjeçar, me arsim të lartë – inxhinier. Si tipare të përafërta me folësit e tjerë, mund të merret reduktimi në masë i rrokjeve të foljet, të emrat më shumë sesa të mbiemrat (meqë edhe kanë dalë më shumë në numër) etj.:

58:04 /mi.ɪpoˈ/ pəɪ məs mə nə hu:p paˈɪet/

PËRFUNDIME

Në punim janë pasqyruar karakteristika gjuhësore ose variacionet ligjërimore si rezultat i faktorëve shoqërorë. Diversiteti i gjuhës vihet në dukje në dallimet gjeografike, se si flasin individët në situatë formale. Sasia më e madhe e vëmendjes që i është dhënë të folurit shfaqet te folësit punonjës të Kuvendit (5 të tillë), sesa nga folësit e qytetit (4), nga folësit e fshatrave (13) ose nga folësit e pakicave (2). Së këndejmi, të gjithë folësit kanë qenë të besimit mysliman, ka mbizotëruar gjinia mashkullore (21) në krahasim me atë femërore (3).

Më tej, pas shqyrtimit të teksteve të regjistruara, duke i përmbledhur variantet e çdo ndryshoreje, duhet theksuar se theksi në ligjërimin e lidhur nuk e ka të njëjtën vlerë sikur në fjalën e veçuar. Brenda përbërjes së fjalisë, parafjalët e thjeshta, lidhëzat e thjeshta, pjesëzat, trajtat e shkurtra, nyjat etj., kanë dalë në pozicion të patheksuar, prandaj tërësisht pesha e theksimit të fjalëve ka qenë tek objektet, veprimet a tiparet.

Për shkak se rrokja varet nga prania e zanoreve, këto kanë qenë më të prirura që të pësojnë rënie, duke krijuar tema njërrrokëshe nga tema trokaike që mbarojnë me zanoren -ë (/mi:r/, /fɛ:n/, /ka'n/, /ðo:n/, /fu:m/, /dʒi:θ/, /a:ft/, /ku:r/) – 64%; pas këtyre, dukshëm më pak në numër, vijnë temat daktilike (me mbaresa /gra'nteve/, /fo'ndeve/, /u:jrave/) – 35%.

Rëniet e tingujve kanë qenë më të shprehura në fund të fjalës: /performa:nts/, /enerdʒi:s/, /ndərkomta:r/, /mje'tev/, /pje:s/, /pa'rev/, /pɛrfɪn/, /i ti:t/, po kështu, edhe me qindra pjesore të tjera, te nyjat e përparme *tə* dhe *sə*, te mbiemrat, te trajtat e shkurtra të përemrave vetorë, te numërorët, te pjesëza *tə* e mënyrës lidhore; pastaj vijnë ato në mes: /marve'fja/, /tərsi:n/, /fitu'si/, /senzo'rvel/, /vre:jt/, /rotaria'nvel/, /mundsu:/, /ru:gt/, /kty'rel/, /gu:rt/, /mða:j/, /lu:fts/, /mny:r/, /fejzi'min/, /mi't/, /dʒe'gse/ dhe, në fillim: /s_ɛrpre'het/. Të gjitha këto fenomene i kanë përfshirë si folësit nga qyteti, edhe ata të fshatrave; kurse shtesat e tingujve ose ndër-këmbimi i tyre kanë qenë tipike për folësit e rrethinave.

Së këndejmi, ka pasur shfaqje edhe të dukurisë së haplologjisë, sidomos te pakësimi i numrit të rrokjeve të njëjta, si: *lutjeje*, *matjeje*, *nisjeje*, *thirrjeje* etj. Paraqitja e tingullit -j- për ta shmangur hiatin është bërë e dukshme posaçërisht te përemri pronor femëror, psh.: /tə mi:ja/, /ɛje'mel/.

Nga ana tjetër, numërori karakteristik *një*, në zonat rurale në grupet numëror + emër, ka dalë me më shumë variante: *nji*, *ni*, *i* (/sod *i vjet/*), por edhe si numëror themelor *nja*; për më tepër, personat me status të lartë shoqëror e kanë përdorur *një*, por edhe *ni*, duke bashkëzistuar kështu dy variantet konkurruese në të njëjtën kohë. Sipas kësaj, variacioni i stilit mundësohet nga variacioni shoqëror.

ALBANIAN STRESS AND GEOGRAPHICAL VARIATIONS

Abstract

The technical meaning of the term *accent* is related to the way it is pronounced. The purpose of this paper is to include distinct ways of pronouncing words, especially of different social classes. Discussion of this issue seeks to bring together close disciplines: on the one hand sociolinguistics (foreign/ local accent between speakers) and, on the other, phonetics and phonology (the place of stress when considering cases when sounds/ syllables are removed or added).

As a consequence, the summarized statistics become comparable, as there are sociological variables between the speakers: place of birth, age, education, power and influence relations, etc. Therefore, changes that are relevant from a sociolinguistic point of view are addressed: if the speaker uses his local accent as a tool of affirming identity and loyalty to local groups – geographical variation.

Data and transcription: the conversation analysis was recorded based on natural interactions between different participants, in order to identify the phenomenon of stress in Albanian. The difference illustrated in the transcripts emphasizes the importance of the social context: has been used phonetic transcription according to the IPA symbols.

Keywords: stress, syllable, spoken language, variation.

Bibliografia

- [1] Bell, Allan (2001). Back in style: reworking audience design. *Style and Sociolinguistic Variation*. Cambridge University Press: Cambridge (139–169).
- [2] Coulmas, Florian (1998). Introduction. *The Handbook of Sociolinguistics*. Blackwell Publishing: Oxford.
- [3] Coupland, Nikolas (2007). *Style: language variation and identity*. Cambridge University Press: Cambridge.
- [4] Eades, Diana (2010). *Sociolinguistics and the Legal Process*. Multilingual Matters: Bristol.
- [5] Edwards, John (2013). *Sociolinguistics: A Very Short Introduction*. Oxford University Press: New York.
- [6] Holmes, Janet (2015). *Hyrje në sociolinguistikë*. Pegi: Tiranë.
- [7] Hudson, Richard A. (2002). *Sociolinguistika*. Dituria: Tiranë.
- [8] Ismajli, Rexhep (2005). *Drejtshkrimet e shqipes*. Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës: Prishtinë.
- [9] Ismajli, Rexhep, Rugova, Bardh & Munishi, Shkumbin (2020). *Leksikon i termave të sociolinguistikës*. ASHAK: Prishtinë.
- [10] Llamas, Carmen, Mullany, Louise & Stockwell, Peter (2007). *The Routledge Companion to Sociolinguistics*. Routledge: Abingdon.
- [11] Munishi, Shkumbin (2015). *Shqipja në epokën e globalizimit*. Zero Print: Prishtinë.
- [12] Romaine, Suzanne (2001). Dialect and Dialectology. *Concise encyclopedia of sociolinguistics*. Elsevier: Oxford (310–319).
- [13] Topalli, Kolec (1995a). *Theksi në gjuhën shqipe*. Shtëpia Botuese Enciklopedike: Tiranë.
- [14] Topalli, Kolec (1995b). Rënia e zanores së rrëguar fundore sipas të dhënave të “Mesharit” të Gjon Buzukut. *Seminari XVII Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare*. Eurorilindja: Tiranë (427–431).

Agnesa Beqiri, Prishtinë

SIMBOLIKA E KONTRASTIT

Historia si një mushkë është vepër me tri novela e Besnik Mustafajt e botuar më 2020. Libri e merr titullin sipas novelës së parë, që është më e hershmja për nga koha e shkrimit (1997). Novela e dytë, *Fundi si vrimë e zezë*, është shkruar më 2018, ndërsa novela e fundit, *Ura si vend i punëve të dreqit*, më 2020.

Nga titulli i tri novelave *Historia si një mushkë*, *Fundi si vrimë e zezë* dhe *Ura si vend i punëve të dreqit* vërejmë se autori përdor një teknikë emërtimi, ashtu siç do të përdorë të njëjtat teknika të rrëfimit në të tri novelat.

Titujt e tri novelave modelohen me anë të ligjësisë së analogjisë dhe jo asaj të identifikimit. Pra, kemi shprehje krahasuese e jo metaforike. *Historia*, *Fundi* dhe *Ura* janë të krahasuarit që rrijnë analogjikisht përballë *mushkës*, *vrimes së zezë* dhe *vendit të punëve të dreqit*. Ky qëndrim analogjik realizohet me anë të të njëjtit modalizator, përkatësisht me lidhëzën krahasuese *si*. Duke përdorur shprehjen krahasuese në vend të asaj metaforike, pra duke mos e identifikuar *historinë me mushkën*, *fundin me vrimën e zezë* dhe *urën me punët e dreqit*, pra duke e vendosur kryefjalën në relacion analog me gjymtyrët krahasuese, autori tregon se të krahasuarit rrinë në këtë pozicion me krahasuesit vetëm brenda fabulës së novelave të tij. Përkatësisht, *historia* shërben *si një mushkë* brenda kontekstit të ngjarjes së rrëfyer, prandaj edhe *ura*, që njihet si simbol lidhjeje e bashkimi, në ngjarjen e novelës bëhet *si vend i punëve të dreqit*.

Teknika të rrëfimit

Ashtu si titujt e novelave edhe teknikat narrative janë të njëjta në të tri novelat. Të trija vijnë si motive nga letërsia popullore. Ato kanë relacione intertekstuale me krijimet gojore. Rrëfimi zhvillohet nga narratori i gjithëdijshëm dhe prania e autorit në tekst është e dukshme.

Në të tri novelat përveçqë narratori shprehet si autori i tekstit, ai po ashtu tregon se ngjarja që po rrëfëhet është rrëfyer më herët nga të tjerë. Kështu, te novela e parë *Historia si një mushkë*, narratori autor thotë: “*Rrëfimtari i dikurshëm, ai i pari fare, duket që nuk ka qenë kronist aspak me zanat e as me dëshirë. Ai nuk na ka lënë thuajse fare hollësi rreth dy protagonistëve të tij. Ose këto hollësi kanë humbur, si të parëndësishme, gjatë përcjelljes së rrëfimit gojë më gojë brez pas brezi.*”¹

Pasi të bëhet e ditur prania e një narratori tjetër më të hershëm, prej të cilit është rrëfyer ngjarja, autori paraqet edhe praninë e tij në tekst duke thënë: “*Unë, si autor i versionit të ri të kësaj historie, edhe pse i pavarur nga autori anonim zanafillor, nuk do të bëjë asnjë përpjekje për të përfytyruar përse plaku nuk yshtej, gjithsesi, për ta ngacmuar dashmirësisht djalosin siç ndodh shpesh me të moshuarit në shoqëri me të rinjtë.*”²

Prania e autorit anonim zanafillor theksohet më shumë se njëherë në tekst, ashtu si edhe prania e autorit të ri, i cili nga pozita e narratorit dëfton shkëputjen nga versioni paraprak i ngjarjes për të krijuar një version tjetër.

Në novelën e dytë, *Fundi si vrimë e zezë*, ngjarja e trajtuar paraqitet si ngjarje që vjen nga një traditë paraprake, por mohohet prania e kronistit duke pohuar praninë e narratorit autor në tekst. Kjo prani e autorit si krijues i rrëfimit bëhet veçanërisht e dukshme në dy pjesët e fundit të kësaj novele. Kështu pjesa e parafundit e novelës fillon: “*Mungesa e një kronisti bashkëkohës me Fadi Bekën do të përbënte një lehtësi shume të çmuar për mua veçanërisht tani, në fund kur më mbetet të shkruaja mbajtjen e historisë.*”³

Në këtë novelë narratori thekson edhe lidhjen e tij familjare me personazhet e rrëfimit: “*Por aty nuk ka pasur kronist. Më takon mua sot, si pasardhës shumë i largët i Kadri e Fadil Bekës, të përfytyroj arsyen e këtij paramendimi, i cili u binte ndesh, në fakt, interesave të familjes së tij.*”⁴ Në këtë pjesë të novelës autori jep versione të ndryshme të përfundimit të historisë dhe me anë të lidhëzave bashkërenditëse veçuese tregon se fundi i ngjarjes mund të jetë ose në një mënyrë, ose në një tjetër, varësisht se si vendos autori i saj.

¹ Mustafaj, Besnik, *Historia si një mushkë*, ONUFRI, Tiranë, 2020, fq.7

² Vepra e cituar, fq.9

³ Vepra e cituar, fq.140

⁴ Vepra e cituar, fq.134

Ngjashëm me novelën e dytë të këtij libri zhvillohet edhe rrëfimi në novelën e tretë, *Ura si vend i punëve të dreqit*. Rrëfimi në këtë novelë nis kështu: “Në mungesë të një kronike të kohës, më mbetej mua të vendosja se ku, në ç’pikë do ta zë fillin për shpalosjen e kësaj historie, e cila do të duhej të shënonte ditën më të bukur të jetës deri atëherë për Hana Selimin: dasmën e saj. Veçanërisht, në këtë rast, kur nuk do të tregoja një histori të nxjerrë nga përfytyrimi im, pra, nuk do të isha autor në kuptimin e mirëfilltë të fjalës, kjo zgjedhje do të ishte për mua me e vështirë e më e ndërlikuar”.⁵

Me theksimin e pranisë së krijuesit të hershëm të këtyre historive autori diferencohet nga ngjarja duke paraqitur edhe diferencën e madhe kohore të ngjarjes së rrëfyer nga ngjarja e shkruar. Diferenca kohore e ngjarjes së rrëfyer me ngjarjen e shkruar, bën që narratori, në dukje i gjithdijshëm, të ketë një dije të kufizuar për zhvillimin e ngjarjes. Pra, i nisur nga një rrëfim paraprak, autori fillon shkrimin e rrëfimit nga pozita e një narratori të gjithëdijshëm, mirëpo dija e tij për ngjarjen, për shak të diferencës kohore, është e kufizuar, prandaj ai krijon një rrëfim të ri mbi atë të vjetrin, duke e bërë rrëfimin e vjetër krijim të tij.

Ndërsa prania e autorit në tekst, jo vetëm si narrator, por edhe si shprehje e vetëdijes për praninë e krijuesit, bashkë me versionet e ndryshme të përfundimit të ngjarjeve, e distancojnë lexuesin nga teksti. Kështu, meqenëse narratori autor, ose më mirë të themi autori narrator, sepse prania e autorit si krijues është më e dukshme, sesa prania e autorit si rrëfimtari, ky, duke rrëfyer mundësi të ndryshme të përfundimit të ngjarjes, e largon lexuesin emocionalisht nga teksti, sepse e zbeh *vërtetësinë letrare* të tij. Pra, prania e autorit e prish atë kategori, që teoritë letrare e quajnë *paradoksi fikcional*. Përkatësisht, kjo teknikë rrëfimi e zbeh efektin emocional të novelave.

Në të tri novelat e këtij libri autori si teknikë narrative përdor edhe dy figura që e lëvizin ngjarjen herë para e herë mbrapa: prolepsën dhe analepsën. Analepsa si rrëfim mbrapa realizohet me anë të retrospektivës. Kështu i gjithë rrëfimi i plakut në novelën *Historia si një mushkë* është një kthim mbrapa në kujtesën e tij, në ngjarjet që i kishte rrëfyer gjyshi. Edhe në novelën *Fundi si vrimë e zezë* kemi një ecje në kujtesën e personazhit; vajtojcja Shahe Neziri kujton momentet kur Fadil Beka, i vrari që ajo duhet ta vajtojë, në ceremonitë mortore ku ajo ishte vajtojcë, kishte qenë i vetmi që nuk ishte prekur nga vaji i saj asnjëherë. Ndërsa, në novelën e tretë, *Ura si vend i punëve të dreqit*, Hana Selimi e kujton takimin e parë me të atin pas martesës së saj.

⁵ Vepra e cituar, fq.163

Prolepsa si parathënëse e ngjarjeve, pra si rrëfim i asaj që do të ndodhë te novela e parë haset, njësoj si analepsa, në rrëfimin e plakut. Ai thotë: *“Një ditë kur gjithçka të qetësohej, me siguri që për të do të ngrinin një këngë madhështore.”*⁶ Këtu plaku paramendon apo imagjinon atë që do të ndodhë në të ardhmen. Shumë më e dukshme dhe më e gjerë prolepsa është në novelën *Fundi si vrimë e zezë*, në të cilën narratori rrëfen marrëdhëniet e mëvonshme në familjen Biba, pas një fjale të thënë. Pra, për të treguar rolin që ka fjala e thënë në vetëdijen e individit, narratori me anë të prolepsës rrëfen se si do të duken gjërat në të ardhmen: *“Prej asaj dite e deri në ditën e fundit të jetës, Mus Biba do të mbetej i bindur se gjithë këto lëshime vëllezërit, ashtu si babai, nuk ia bënë në shenjë nderimi për dhuntinë e tij si këngëtar. Madje, edhe kur ai do të bëhej pak a shumë i njohur në krahinë, ata nuk donin t’ia dinin fort dhe shpesh nuk e fshihnin bezdinë kur ai i detyronte ta dëgjonin që këndonte. Edhe më haptas e shprehnin ata bezdinë kur, në të rrallë, ai u kërkonte mendimin për këngët që dëshironte të krijonte.”*⁷

Tek *Ura si vend i punëve të dreqit* një nga rastet e prolepsës është kur narratori rrëfen imagjinimet e Hanës për jetën e saj të ardhshme bashkëshortore: *“Kur t’i merrte ajo gjërat në dorë, pamja e bashkëshortit të saj do të ishte pa dyshim pasqyrë e përkujdesjeve të saj.”*⁸ Në këtë novelë prolepsë tjetër me rëndësi është edhe paraqitja e jetës së Hanës në pleqëri dhe po ashtu gjatë rrëfimit paralajmërohet vazhdimisht ajo që do të ndodhte ditën e dasmës: *“Hataja, që ndodhi të enjten me karvanin e krushqve, la për Hanën një plagë të paparë, e cila do ta gjymtonte përgjithmonë, edhe pse ishte plagë pa gjak.”*⁹

Përveç teknikave të njëjta të rrëfimit, që e definojnë silin e shkrimit të autorit në tri novelat, ngjashmëri tjetër e novelave është prania e kafshëve ngarkuese në secilën prej tyre. Në novelën e parë kjo kafshë është *mushka*, në të dytën *gomari*, ndërsa në të tretën *kali*. Pra, nga novela në novelë kemi një rritje shkallë-shkallë të kafshës ngarkuese. *Mushka*, *gomari* dhe *kali* përveç funksionit formal kanë edhe rol semantik. Kthesat vendimtare në ngjarje dhe në jetën e personazheve ndodhin kur ata janë në këto kafshë ngarkuese. Sado që në novelën e parë, personazhet janë mbi një mushkë figurative dhe jo të vërtetë.

⁶ Vepra e cituar, fq.28

⁷ Vepra e cituar, fq.111

⁸ Vepra e cituar, fq.165

⁹ Vepra e cituar, fq.199

Idetë

Në intervistat që jep pas botimit të *Historia si një mushkë*, Besnik Mustafaj thekson se qëllimi i tij ishte trajtimi i rolit të individit në historinë shqiptare dhe origjinën e dhunës te ne, përkatësisht autori do të shpjegojë se nga na vjen një prirje dhune autodestruktive.

Mirëpo, mund të themi se, duke e pasur gjithmonë njeriun në qendër të krijimtarisë së tij, Besnik Mustafaj trajton me shumë, sesa vetëm rolin e dhunës e të individit në historinë shqiptare. Autori depërton në mendjen e personazheve duke paraqitur psikologjinë e tyre dhe njëkohësisht shtron çështje filozofike mbi jetën e njeriut, veçanërisht njeriut shqiptar.

Historia si një mushkë

Novela e parë, *Historia si një mushkë*, ka dy personazhe kryesore, *Plakun* dhe *djalin*, të cilët bëjnë së bashku një rrugë për në majën e malit. Ashtu si personazhet, ashtu edhe rruga e tyre është simbolike. Ngjitja në mal simbolizon jetën, në një moment të caktuar të rrëfimit, kur plaku pohon se është i lodhur nga rruga, i riu i përgjigjet: *të njëjtën rrugë kemi bërë*. Ndërsa, përgjigja e plakut ka një dozë ironie që dëfton se *plaku* ka bërë rrugë më të gjatë se *djali*, e gjatësia e kësaj rruge të *plakut* janë vitet e tij.

Për të arritur më lehtë majën e malit do të ndihmonte *mushka*, por *mushka* mungon dhe në mungesë të *mushkës* përdoret *historia*. *Historia* në këtë novelë identifikohet me rrëfimin, *plaku* propozon që në ngjitje ta mbajë ai *djalin* në shpinë, e në zbritje *djali* të ishte *mushka* e *plakut*. Kështu, përderisa prej titullit të novelës shohim se *historia është si një mushkë*, në rrëfimin e ngjarjes *historia bëhet mushkë*. Fillimisht *mushkë* është *plaku* që rrëfen një histori, ky rrëfim mundëson që personazhet të mos e ndiejnë lodhjen e rrugës, ndërsa në zbritje *një histori* do ta rrëfejë *djali* për të mos e ndjerë lodhjen e rrugës në zbritje. Pra, nga rrëfimi i *plakut* kuptohet se *historia është mushka*.

Kështu, nëse thamë që rruga për në mal simbolizon jetën dhe nëse në novelë thuhet se *historia e rrëfyer* bëhet *mushkë* dhe e lehtëson rrugën, atëherë nga kjo del ideja e rrëfimit, historisë e letërsisë si ndihmëse dhe lehtësuese në jetë. Aristoteli thotë se *imitimi është instinkt natyral i njeriut, i shfaqur që nga koha e foshnjërisë*. Duket që këtë ide

e jep edhe novela e Mustafajt, pra nevoja për rrëfime e trillime është instinkt natyror dhe i domosdoshëm i njeriut.

Nga të tri novelat, *Historia si një mushkë* është ajo në të cilën trajtohet më gjerësisht dhuna si vetëshkatërrim. Kjo ide zhvillohet me anë të rrëfimit të plakut, pra me historinë që rrëfen plakun. Në rrëfimin e tij një profet i rremë e trazon një bashkësi të tërë duke sjellë në mesin e tyre dijen e bashkë me dijen edhe urrejtjen, edhe dhunën. Gjersa autori thotë se është mungesa e mençurisë që i dërgon të gjithë personazhet e tij në fatalitet prej dhunës, në këtë novelë është pikërisht fillesa e zhvillimit të aftësisë për mendim të pavarur ajo që e shkakton dhunën. Malësorët në rrëfimin e plakut bëhen të vetëdijshëm, andaj edhe më të dhunshëm. Kështu, rrëfimi e shton dilemën filozofike, a shmanget dhuna me anë të mençurisë apo është mençuria ajo që solli dhunën?!

*“Përkundrazi, dita-ditës e dinin pak e më pak se kush ishin, nga vinin e sidomos nuk e përfytyronin dot ku donin të shkonin.”*¹⁰ Pra, duke e hapur mendjen, njerëzit e rrëfimit të plakut, kuptojnë se sa të vegjël e të pafuqishëm ishin. Plaku thotë se *profeti u kishte lënë njerëzve një plagë pa dhimbje*, dhe janë pikërisht plagët pa dhimbje që shkaktojnë dëmin më të madhë, sepse mungesa e dhimbjes bën që sëmundja të mos ndihet. Pra, njeriu nuk është i vetëdijshëm për plagën dhe nuk e kuron atë, ndërsa plaga që nuk kurohet rritet duke shkaktuar kështu dëme edhe më të mëdha. Kjo plagë në malësorët e rrëfimit të plakut shkaktohet nga *Profeti i rrejshëm*, i cili u sjell njerëzve dyshimin dhe dyshimi e shkakton dhunën, madje dhunën brenda komunitetit, pra dhunën auto-destruktive.

Po ashtu, rrëfimi i plakut e trajton tendencën e njerëzve për të parë gabimin dhe të keqen gjithmonë te të tjerët dhe asnjëherë te vetvetja, prandaj plaku thotë: *“Askush nuk mendonte se duhej të përgjigjej. Të gjithë besonin se ishin aty vetëm për të pyetur.”*¹¹

Siç mund të shihet, të gjitha idetë e novelës *Historia si një mushkë*: *nevoja për fikcionin, dija, dyshimi, dhuna, faji, pafuqia e njeriut* janë ide universale, janë preokupime të të gjithë njerëzimit. Mirëpo, kjo novelë i zhvillon këto ide në një ambient shqiptar, prandaj edhe referencat me realitetin shqiptar janë të dukshme. Prijësi absolut edhe këtu, si në shume vepra të tjera të letërsisë shqipe, shënjohej me anë të figurës së Sulltanit, për të cilin thuhet: *“Falë pushtetit të tij të pakufizuar, Ai e dinte se çfarë mendonin kundështarët dhe armiqtë e tij*

¹⁰ Vepra e cituar, fq.24

¹¹ Vepra e cituar, fq.43

edhe më mirë se ata vetë.”¹² Me figurën e Sulltanit, autori portretizon sistemin e prijësin, i cili pretendon se është zotërues i së vërtetës absolute; ky sistem e ky prijës ndodheshin në një ambient shqiptar.

Fundi si vrimë e zezë

Novela e dytë e këtij libri, *Fundi si vrimë e zezë*, në trembëdhjetë pjesë ka si ngjarje kryesore vrasjen e Fadil Bekës nga Seladin Beqiri. Sado që e tërë ngjarja zhvillohet duke pasur në qendër këtë vrasje, akti i vrasjes dhe dy personazhet dalin në veprim vetëm në fundin e novelës, pra gjatë gjithë rrëfimit Fadil Beka e Seladin Beqiri janë më shumë silueta, sesa personazhe reale.

Nga çiftet opozicionale dalin të gjitha idetë e novelës. Kështu, në njërën anë kemi vajtojçën Shahe Neziri, ndërsa në anën tjetër këngëtarin Mus Biba, po ashtu edhe Fadil Bekën përballë Seladin Beqirit. Çiftet opozicionale i japin idetë mbi dualitetin në jetë. Këto ide parashtrojnë probleme filozofike, ndërsa nga personazhet, veçmas, autori e trajton psikologjinë e njeriut. Gjithashtu, edhe vetë personazhet janë të dyzuar në veprimet dhe mendimet e tyre.

Rrëfimi nis me të riun që troket në derën e Shahe Nezirit. Vajtojçja nuk ka nevojë që ai t’i shpjegojë pse ka ardhur, sepse në çastin që dikush i troket në derë, ajo e kupton që dikush ka vdekur. Pra, që në nisje të rrëfimit shfaqet një gjendje trishtimi, për Shahen kanë nevojë vetëm në rast vdekjeje.

Vajtimi nuk është vetëm me funksion ceremonial, vaji ka rol në psikikën e njeriut dhe dilema që shtrohet këtu është: *a u mundëson vajtojçja njerëzve të çlirohen nga dhimbja me anë të derdhjes së lotëve, apo ua rrit tronditjen?! Në njërën anë, lotët ndihmojnë për kapërcimin e një trishtimi, ndërsa, në anën tjetër, tronditja që mund të shkaktojnë fjalët e vajtojçes, duke ia shtuar kësaj edhe tronditjen nga vdekja, mund të shkaktojnë dëme të pandreqshme në shëndetin mendor të individit. Pra, me Shahe Nezirin paraqitet dualiteti mes vajt si shpëtim dhe vajt si thellim në kob.*

Përballë Shahe Nezirit qëndron këngëtarin Mus Biba, të cilin e vendos në dilemë zgjedhja e personit të cilit do t’ia kushtojë këngën. Mus Biba nuk e di nëse do t’i thurë këngë Fadil Bekës apo Seladin Beqirit. Vaji i Shahës dhe kënga e Musës do të dalin nga e njëjta ngjarje,

¹² Vepra e cituar, fq.52

përkatësisht nga e njëjta vdekje. Me këtë autori thekson dy anët e jetës, *vajin e këngën*; asnjëra nuk mundet pa tjetrën.

Përveç këtij dualiteti me profesionet e Shahes dhe Musës, autori shenjon fuqinë e fjalës. Me fjalët e saj në vaj, Shahja mund t'i shërojë ose t'i dëmtojë edhe më shumë njerëzit. Me këngën e tij, Musa mund ta bëjë Fadiln të pavdekshëm si hero ose ta varrosë përfundimisht namin e tij, duke i thurur lavde Seladinit. Pra, ashtu si në novelën e pare, ku *historia shërbente si mushkë* dhe e bënte të lehtë udhëtimin, edhe në novelën e dytë paraqitet kjo fuqi e fjalëve në jetën e njeriut. Nëse në novelën e parë fuqia e fjalës mishërohet në rrëfimin a historinë, pra prozën, në novelën e dytë fuqia e fjalës mishërohet në vajin e këngën, pra në vargun e poezinë.

Me Mus Bibën, autori shtron edhe problemin e individit që del nga kornizat familjare, nga kufijtë e mendimit të familjes. Musa deshi-ron të bëhet këngëtar, profesion ky që nuk e kishte pasur askush në familjen e tij. Problemi i Musës është problemi i njeriut që botëkuptimin mbi atë se çka është sukses në jetë, e ka të ndryshëm nga ai që konsiderohej sukses në rrethin e tij familjar. Prandaj, Musën edhe e shikojnë si *fyll*, e madje narratori rrëfen se edhe kur e arrin suksesin, ai trajtohet me të njëjtën shpërfillje, sepse arritja e tij nuk shënohej si arritje në mendësinë e familjes së tij. Pra, Mus Biba shpërfillej, sepse ishte ndryshe, as nuk ndihmohej, e as nuk pengohej në realizimin e ëndrrës së tij.

Ironia e jetës rrëfëhet me fundin qesharak të Fadil Bekës; trimi mbi trima nuk vdes në mënyrë heroike, siç i ka hije një heroi, nuk vritet në duel, por përfundon i vdekur nga një gur që i lë në ballë një shenjë si *këmbë pule*. Ndërsa Seladin Beqiri, për të cilin i ati thoshte se *ishte për gjynah e jo për trimëri*, nga një person me të meta mendore kalon në vrasësin e personit që konsiderohej i pavdekshëm. Nga ky fund i heroit, që jeton me lavd, e vdes në mënyrën më të pamenduar, del edhe ideja kryesore e novelës, të cilën e shpreh titulli *fundi si vrimë e zezë*. Pra, pa marr parasysh jetën, të gjithë në fund do të shkojmë në vrimën e zezë.

Ura si vend i punëve të dreqit

Rrëfimi i novelës së fundit të librit *Historia si një mushkë*, ndërtohet mbi rrëfimin popullor për betejën e dy karvanëve me krushq që takohen në të njëjtën urë. Autori duke rrëfyer se si një ditë dasme

shndërrohet në ditë zie, e trajton krenarinë e egon e kolektivitetit shqiptar, që e dërgon atë drejt tragjikës. Pra, krenaria e kokëfortësia paraqiten si prishje të gëzimit, njëkohësisht kjo krenari shënon edhe një mungesë xhentilese dhe mirësjelljeje. Ideja e këtij rrëfimi është se krenaria që e shkakton tragjedinë, vjen si ndjenjë inferioriteti ndaj tjetrit. Pra, krenaria nuk është në të vërtetë krenari, është mungesë e theksuar vetëbesimi, që reflektohet me sjellje arrogante, që ditën e dasmës, si festë për shtimin e familjes, e kthen në ditë të zezë, në të cilën vriten shumë anëtarë të familjes. Pra, dasma në vend që ta rrisë familjen, për shkak të komplekseve psikologjike të individëve, e zvogëlon atë.

Autori thekson se në këtë novelë do ta rrëfejë vetëm fatin e njëres nga nuset që ishin ndodhur në atë urë, sepse të dyja kishin fatin e njëjtë. Kështu, paraqitet jeta e Hana Selimit që nga dita kur i dëftojnë datën e dasmës e deri në momentin kur ajo e tregon, me anë të gjuhës së shenjave, tmerrin e ditës së dasmës.

Martestat e hershme, apo martesat e fëmijëve, pozita e gruas në shoqëri dhe familje janë tema që nuk deklarohen, por nënkuptohen. Askund, përgjatë rrëfimit, autori nuk thotë se Hana ishte një fëmijë, por naiviteti me të cilin ajo ëndërronte jetën e saj martesore, sjellja e saj e hapur ndaj prindërve tregon se ajo ishte një fëmijë. Kështu, kur nëna i tregon për ditën e dasmës, në vend të klithmës Hana thërret gëzueshëm: *Shyqyr! Pafajësia dhe naiviteti fëmijëror i Hanës vërehet edhe atëherë kur e pyet të atin se nëse ka dëgjuar lajmin e gëzueshëm se të enjten do të martohej*. Edhe dëshira e Hanës për një burrë pa mustaqe, mund të interpretohet si dëshirë për afërsi në moshë me bashkëshortin. Ajo nuk do që burri i saj të mbajë mustaqe si i ati i saj. Tërthorazi autori thekson se Hana ishte vetëm një fëmijë, madje e papjekur fizikisht për martesë: *“Përfytyrimi i gjakut të virgjërisë mbi çarçafin e bardhë iu ngulit në mendje. Sado e çuditshme të duket, Hana Selimi nuk e kishte parë kurrë gjakun e vet”*.¹³ Një vajzë që s’ka parë kurrë gjakun e vet, s’është tjetër pos fëmijë, madje Hanën si fëmijë e paraqet edhe ritheksimi i shpeshtë i narratorit pas martesës së saj, se Hanën për një kohë të gjatë nuk e prek burri i saj, pra ai pret rritjen e Hanës.

Mbajtja e gojës së Hanës me duar nga ana e nënës së saj, në momentin kur i tregon për dasmën nuk është rastësore. Në fakt, ky veprim paralajmëron atë që i ndodh Hanës në dasmë, ajo humb zërin. Kjo humbje zëri shenjon mungesën e së drejtës së fjalës, fjala e Hanës nuk dëgjohet, pra mendimi i saj nuk pranohej. Mirëpo, Hanën që

¹³ Vepra e cituar, fq.193

s'mund të flasë e trajtojnë edhe si një të shurdhët, ata flasin në prani të saj për të e për familjen e saj, si të mos ishte ajo aty dhe Hana nuk mund të mbrohej, sepse nuk kishte zë.

Edhe te *Ura si vend i punëve të dreqit*, ashtu si novela e parë dhe e dytë që shprehin rëndësinë e fjalës, theksohet ideja e fjalës si domosdoshmëri në jetën e njeriut.

Përfundim

Tri novelat e librit *Historia si një mushkë* të Besnik Mustafajt kanë në qendër të tyre njeriun, botën e tij të brendshme psikike dhe emocionale dhe reflektimin e kësaj bote në ambientin e jashtëm ku ata jetojnë. Jeta e individit paraqitet edhe në raport me individët e tjerë, autori paraqet dy anët e botës, edhe të mirën, edhe të keqen: *ngritjen dhe zbritjen, dijen dhe dyshimin, plakun dhe të riun* te novela e parë; *vajin dhe këngën, heroin dhe të marrin, jetën dhe vdekjen* te novela e dytë; *pafajësinë fëmijërore dhe realitetin e rreptë shoqëror, dasmën si shtim dhe vrasjen si zvogëlim* te novela e tretë.

Idetë dhe temat e trajtuara, gjithmonë me një bazë psikologjike dhe filozofike, janë ide e tema universale që zhvillohen brenda një ambienti shqiptar, prandaj edhe më dukshëm vërehet psikika dhe mendësia e individit shqiptar, e lidhur gati pazgjidhshmërisht me psikikën e mendësinë kolektive.

Ndonëse janë shkruar në kohë të ndryshme, këto tri novela si për nga idetë e shtjelluara, ashtu edhe për nga teknikat e strukturimit të tyre janë koherente. Rrëfimet kanë fillin në krijimtarinë gojore shqiptare dhe këto rrëfime të traditës popullore autori i rimerr, i rimodelon duke krijuar kështu tekste të reja, me ide e tema të ndryshme nga rrëfimi popullor, pra edhe i risemantizon. Kështu, me *Historia si një mushkë*, Besnik Mustafaj, për herë të parë në krijimtarinë artistike, hyn në letërsinë shqipe edhe si autor novelash.

Conclusion

At the centre of the three novels of the book entitled *History as a Mule* by Besnik Mustafaj is the man, his inner psychic and emotional world and the reflection of that world in the external milieu in which he lives. The life of an individual is also presented in relation to other individuals. The author presents the two sides of the world, both good and bad: *rise and fall, knowledge and doubt, the old and the young* in the first novel; *the lament and the song, the hero and the fool, the life and the death* in the second novel; *childish innocence and strict social reality, wedding as addition and murder as reduction* in the third novel.

The ideas and topics tackled, always with a psychological and philosophical basis, are universal ideas and topics that develop within an Albanian environment, which is why the psyche and the mentality of an Albanian individual can be discerned even more clearly, linked almost inextricably with the collective psyche and mentality.

Though they were written at different periods of time, the three novels are coherent in terms of both ideas elaborated and the techniques of structuring thereof. Narratives originate from Albanian verbal stories, and the author takes those narratives from the popular tradition and remodels them by creating new texts, with different ideas and themes from the popular narrative, hence resemanticizing them too. Accordingly, with *History as a Mule*, Besnik Mustafaj enters Albanian literature also as a novelist, for the first time in his artistic career.

Blerina Rogova Gaxha, Prishtinë

MITRUSH KUTELI - TEMA E VDEKJES

Hyrje

Mitrush Kuteli është njëri nga autorët krijimtaria letrare e të cilit përcillet qoftë me tema të pastra letrare për vdekjen, qoftë të mbi-ndërtuar apo të shtresuar në nivel tregimi të shkurtër apo fragmentesh në proza më të gjata. Ky shkrim është i motivuar nga leximi i prozës së këtij autori, e cila prozë nxjerrë në pah realitetin mimetik e simbolik të vdekjes, veçanërisht të novelat: “Vjeshta e Xheladin Beut”, “Si e gjeti Ago Jakupi rrugën e Zotit” dhe “E madhe është gjëma e mëkatit - Tat Tanushi i Bubutimës”.

Është një intencë apo kërkim i autorit për ta paraqitur temën e vdekjes në një tip dialogimi mes dy botëve - reales e eternals. Kuteli portretizon e zbulon anën e errët të natyrës njerëzore, e cila tundohet përballë vdekjes. Diskursi narrativ është i animuar me imazhe të errëta, veçanërisht me pamjet epike të narracionit për kuptimin e “botës përtej”. Një nga shkaqet për vdekjen është edhe tundimi për të dalluar atë që është e vërtetë për jetën dhe kuptimin e botës këndeje dhe përtej. Vdekja nuk perceptohet si e frikshme apo e panjohur, por si mjet a mënyrë për ta arritur ikjen; obsesioni për destinacionin përfundimtar të njeriut në një lamtumirë nga kjo botë.

1. Zbulesa e vdekjes

Edhe nëse jeta dhe vdekja janë gjendje relativisht mirë të klasifikuar, dhe për më tepër ato edhe hyjnë në një opozicion, në momentin kur kemi kapërcimin ndërmjet dy gjendjeve, te proza e Kutelit ato nuk kundërshtohen. Të folurit e narratorit apo personazhit herë-herë bëhet pa qenë e mundur që dikush ta referojë të folurit e tyre te jeta apo vdekja. Mbase kjo i jep mundësi zbulesës së fenomenit të vdekjes. Ky komunikim i ndërsjellë midis jetës dhe vdekjes, e vë në lojë gramatikën narrative të shpirtit të njeriut.

Kryepersonazhet e tregimeve kanë përafërsisht të njëjtat motive e shenja të dhëna me diskursin biblik e mitik, dhe me diskursin e rrëfimeve gojore, duke iu ndajvënë atyre efektin e idesë së hirit të dashurisë, të forcës dhe fatalitetit. Heronjtë e Kutelit janë heronj të projektit ku Dashuria (jeta dhe etika) do të kalojë nëpër sprova të mëdha por në fund do të jetë më e fuqishme se lektisjet e tjera jetësore dhe pas transcencave kohore e hapësinore do të ngadhënjë përfundimisht.¹

Nga kjo perspektivë, duke dhënë thellësinë e ekzistencës njerëzore përballë vdekjes, autori jep karakterin e personazheve të Xheladin beut, Ago Jakupit e Tat Tanushit, heronjve të krijuar në lojën e jashtëzakonshme mes jetës dhe vdekjes. Rrëfimi për priftin dhe të dashurën e tij, rrëfimi për plakun që kërkonte udhën e Zotit dhe rrëfimi për fundin e një tirani, na kallëzojnë për mëkatën e çmimin e mëkateve, për mëshirën e mirësinë. Në mënyrën e vet, secili lufton e refuzon, si di e mundet, në udhëtimin e tyre drejt vdekjes, nëpër historitë që japin aventurë, udhë e udhëkryqe të ndryshme. Në këtë udhë, Xheladini, Aga dhe Tata, kanë disa emërues të përbashkët, që zënë fill në mëkatet e vetësajura, deri te udhëtimi final- vdekja.

Tekstet e Mitrush Kutelit, *poezinë e vdekjes* e rrëfejnë herë qetë e ngadalë e herë plot dramaticitet, ndaj këto rrëfime për njeriun, për shpirtin, për kuptimin e jetës dhe vdekjes, nxisin e motivojnë, sepse në to karakteret e *dëshirojnë* vdekjen dhe e *kundërshojnë* a shpërfillin hapur atë, si të tilla *meritojnë vëmendje*².

Kujtim Rrahmani kur flet për trajtimin e vdekjes e vajtimit si intertekst në njërin nga tregimet e Kutelit, pohon se Kuteli kish çelësin për botërat e ndrydhura po edhe të mëdha e të shenjta në të njëjtën kohë: “Një çelës i mirë për një botë të rrallë në të cilën pak kush di të hyjë dhe t’i shohë perlat e dhembjes dhe të gazit. Mitrush Kuteli e kishte dhuntinë e farkimit të këtij çelësi: ai hyri, pa, u sprovua dhe shkroi. Dhe shkoi³”.

Ndërkaq Nysret Krasniqi, duke i dhënë Mitrush Kutelit epitetin “autor filozofik i letërsisë moderne shqipe”, në veprën e tij heton ndër

¹ Kujtim Rrahmani, *Intertekstualiteti dhe Oraliteti*, E. Koliqi, M. Kuteli, A. Pashku, AIKD, Prishtinë, 2002, f. 175

² Shih: *Death in Literature*, Introduction, Edited by Outi Hakola, Sara Krivisto, Cambridge School Publishing, Cambridge, 2014

³ Kujtim Rrahmani, *Intertekstualiteti dhe Oraliteti*, E. Koliqi, M. Kuteli, A. Pashku, AIKD, Prishtinë, 2002, f. 208

tjerash: "Lojën" filozofike të autorit me fenomenin e mistershëm - vdekjen, pastaj me dualitetet e trupit dhe shpirtit...⁴".

Heronjtë e rrëfimeve apologjetike ndaj hirit e zotit, vdekjen e kërkojnë dhe e dëshirojnë fort për t'u çliruar e shpëtuar nga jeta, udhë e cila i nënshtron ndaj sprovave të mëdha psikologjike. Dëshira e vdekjes vjen e bëhet esenciale në këto proza. Vdekja, prezente gjithkund e askund, shndërrohet në sfidën e rëndë, duke i detyruar personazhet të mësohen të rrojnë me jetën e gjatë. Mes dualitetit të mishit, trupit - si 'burg', dhe shpirtit - si frymë metafizike, "Kuteli shtron idenë e tij për shpirtin njerëzor, duke shfrytëzuar rrëfimin kristian për ta bartur këtë ide të tij, pra, për pastërtinë e nevojshme të tij"⁵.

Nga kjo perspektivë, narrativa kuteliane projekton personazhet, të cilët në lojë me jetën dhe vdekjen, duhet të njohin esencat dhe kuptimet eternale; heronjtë që duke e zbuluar veten, njohin të tjerët, për të tjerët, dhe në këtë aventurë, në fund, realizohet *katharsis-i* i protagonistëve, purifikim që i çon deri te zbulimi i udhës drejt Zotit - udhën e kalimit në botën përtej.

2. Dënimi me jetë apo dënimi për të jetuar: Aga dhe Tata

Novelat e Mitrush Kutelit "Qysh e gjeti Ago Jakupi rrugën e Zotit" dhe "E madhe është gjëma e mëkatit - Tat Tanushi i Bubutimës", portretojnë personazhet e Agës dhe Tatës në udhëtimin e tyre drejt vdekjes, në lojën e bukur të letrave mes jetës dhe vdekjes, apo jetës si vdekje.

Të parën Kuteli e shkroi novelën "Qysh e gjeti Ago Jakupi udhën e Zotit"⁶, dhe me vonë, më 1947, novelën "E madhe është gjëma e mëkatit, Tat Tanushi i Bubutimës"⁷. Ndërmjet dy teksteve shfaqet relacioni i njohur si *intratekstualitet* - relacion *intertekstual* brenda veprës së një autori⁸.

Aga dhe Tata kanë disa ngjashmëri, kur flitet për vdekjen dhe realitetet që shpalos kjo gjendje. Mosvdekja/Pavdekësia bëhet akt

⁴ Nysret Krasniqi, *Udha kratilike*, AIKD, Prishtinë, 2008, f. 240

⁵ Nysret Krasniqi, *Udha kratilike*, AIKD, Prishtinë, 2008, f. 157

⁶ Shih Mitrush Kuteli, *Vepra letrare 2*, Naim Frashëri, Tiranë, 1990, f. 49-67

⁷ "E madhe është gjëma e mëkatit, Tat Tanushi i Bubutimës" është shkruar më 1947, ndërsa është botuar në vitin 1993

⁸ Kujtim M.Shala, *Kujtesa e tekstit - Mitrush Kuteli*, Buzuku, Prishtinë, 2003, f. 71

kryesor i të dy rrëfimeve. Ajo rri në lidhjen shkak-pasojë duke ndjekur vijën që përshkon personazhet; nyje që lidh mëkatet në historitë e Agës e Tatës, nga ndëshkimi që iu jep Krijuesi deri te çlirimi nga mallkimi.

Gjejmë të pranishëm këtu një *kod tematik në variante*⁹, shtrirë në diskursin e figurshëm e në kategoritë morale e kulturore që dalin e përthihen mes kodit biblik, kodit oral dhe kodit filozofik, nëse për këtë i përmbahemi nocionit klasik të kodeve se ato janë “perspektiva të citimeve, mirazhe të strukturave, të cilave ua njohim vetëm nisjet e rikthimet dhe njësitë që kanë dalë nga to”¹⁰. Kësisoj, dialogu me Biblën, si një referencë kulturore e tekstore, shënon nivelin tjetër *intratekstual* mes novelave. Po dialogu me Biblën vjen përkrah dialogut me Oralitetin, rrëfimin oral-mitologjik; të dy kodet japin e marrin ndërmjet vete, duke i dhënë Kutelit një shkathtësi të shkëlqyeshme narracioni. Në rrëfimin për Agën e Tatën, etika e tekstit ruan sa frymën e teksteve religjioze, aq dhe ato që na vijnë nga Oraliteti, duke e vënë mbi to gjithnjë filozofinë autoriale të Kutelit, si letërsi që e kërkon universalen.

Relacioni *intertekstual* i teksteve del i fortë me Shkrimin e shenjtë, me Oralitetin dhe kodin filozofik, pëlhurat e të cilëve janë endur bukur edhe ndërmjet pëlhurave intratekstore.

Autori te Ago Jakupi na jep heroin e mbetur në jetë, plakun e harruar nga vdekja. Tata dënohet me jetë, me mosvdekje. Heroi është mëkatari që s’mund të vdesë: *Unë kam shekuj që jam këtu në tokë. Dua të vdesë, e nuk vdes dot*, pohon Tata gjatë konfesionit.

As Ago Jakupi s’mund të vdesë, dhe është “mbetja” në jetë që reprezenton frikën e madhe të tij: *Nuk kish frikë Agaj nga vdekja, po nga jeta që s’gjatej kaq fort*. Agoja ka frikën e jetës së gjatë, siç e reprezenton ngujimin për shekuj në botën e të gjallëve Tat Tanushi. Studiuesi Kujtim M. Shala shkruan se: “Këto tekste njohin për esencë relacionin vertikal Tokë - Qiell, pra Njeri - Zot. (Secili prej tyre njeh edhe relacionin horizontal Njeri - Njeri: Ago Jakupi - Katundarët, Tat Tanushi - Kalija. Në të dyja rastet, relacioni horizontal e kushtëzon relacionin vertikal.) Kjo, së pari, është lidhje nëpërmjet Objektit, njërit prej kriterëve *arkitekstuale*. Personazhet e secilit prej tyre njihen me Zotin¹¹. Por rruga deri te Zoti, është e gjatë për Agën e Tatën.

⁹ Po aty, f. 73

¹⁰ Roland Barthes, *S/Z*, Hill and Wang, New York, 1974, f. 20

¹¹ Kujtim M. Shala, *Shekulli i Letërsisë Shqipe*, Buzuku, Prishtinë 2006, f. 76-77

Një pronar tokash dhe një prift, një materialist e një spiritualist, një koprrac dhe një i dashuruar tmerrësisht, dy mëkatar, dy të dënuar, dy të sprovuar dhe dy paqtues në fund. Dy tekste të lidhura me një moral dhe personazhet me të.

3. Tat Tanushi - i vdekuri i gjallë

Heronjtë e rrëfimeve apologjetike ndaj hirit e zotit, vdekjen e kërkojnë dhe e dëshirojnë fort për t'u çliruar e shpëtuar nga jeta, udhë e cila i nënshton ndaj sprovave të mëdha psikologjike. "Karakteret që e dëshirojnë vdekjen dhe karakteret që e kundërshtojnë a shpërfillin hapur vdekjen, e meritojnë vëmendjen tonë"¹². Vdekja e pranishme gjithkund e askund, shndërrohet në sfidën e rëndë të ndjenjës për ta menduar, duke i detyruar personazhet të mësohen të jetojnë me jetën e gjatë. Mes dualitetit të mishit/trupit si 'burg', dhe shpirtit, si frymë metafizike, Kuteli paraqet idenë e tij për shpirtin njerëzor. Këtë ide e jep në lojën e tij letrare midis të mirës dhe të ligës, duke i ndëshkuar personazhet me jetë - si një ndëshkim që mund t'i bëhet qenies njerëzore.

Nëse *letërsia e Kutelit i lufton veset, lakminë, maninë*¹³, lakmia e Tatës për femrën, lakmia e Agait për të mirat materiale, ose pasioni i Tatës për Gruan dhe koprracia e Agait, janë veset që e kërkojnë ndëshkimin. Studiuesi Krasniqi shkruan se në rrafshin konotativ mund ta theksojmë fenomenin e ndëshkimit të trupit apo të burgut të shpirtit, që e gjejmë te Platoni, por që bëhet temë esenciale e veprës letrare të Mitrush Kutelit. "Të kujtojmë këtu se Ago Jakupi nuk mund ta lërë këtë botë përderisa të mos gjejë rrugën adekuate që shpirti të dalë nga "tharku" platonian për ta marrë udhën e së vërtetës"¹⁴. Udhë e cila bëhet edhe më e vështirë për heroin Tat Tanushin, te novela "E madhe është gjëma e mëkatit....".

Nga kjo perspektivë, narrativa kuteliane projekton personazhet, të cilët në lojë me jetën dhe vdekjen, duhet të njohin esencat dhe kuptimet eternale; heronjtë që duke e zbuluar veten, njohin të tjerët, për të tjerët, dhe në këtë aventurë, në fund, realizohet *katharsis-i* i

¹² Shih: *Death in Literature*, Introduction, Edited by Outi Hakola, Sara Krivisto, Cambridge School Publishing, Cambridge, 2014

¹³ Shih: Nysret Krasniqi, *Udha kratilike*, AIKD, Prishtinë, 2008, f. 55

¹⁴ Po aty, f. 55

protagonistëve, pastrim që i çon deri te zbulimi i udhës drejt Zotit - udhën e kalimit në botën përtej.

Novela e dashurisë dhe e vdekjes “E madhe është gjëma e mëkatit, Tat Tanushi i Bubutimës”, është krejtësisht e veçantë, si motivim, rrëfim, shtrim e shkrim letrar. Një tekst i jashtëzakonshëm për dashurinë dhe vdekjen, dashurinë për zotin e njeriun, një tekst i përplasjes së fort mes besimit e dyshimit, mishit e shpirtit, gruas e hyjit.

Rrëfimi për priftin dhe të dashurën e tij, Tat Tanushin e Kalijen, na kallëzon për forcën e jashtëzakonshme të dashurisë, për mëkatin e çmimin e mëkateve, për fuqinë e vdekjes dhe pafuqinë e njeriut, në një lojë të heroit që në udhën e tij përballet me vdekjen dhe mosvdekjen.

Autori portretin udhën e heroit, duke e shtruar filozofinë e tij kulturore e letrare në diskursin biblik; duke i sfiduar e vënë në pikëpyetje zgjedhjet ndërmjet udhës së lumturisë eternale e të lumturisë tokësore të Tatës. Kësisoj, historia e Tat Tanushit e Kalijes duke e shfrytëzuar rrëfimit kristian shtron temën e vdekjes e të dashurisë, thurur në një komunikim të jashtëzakonshëm mes dy botësh.

Tata mbetet në jetë, i dënuar *me jetue* përherë. Toka për të është kthyer në ferr. Gjithçka ndërron fytyrë, humb, zhduket, njerëz, vende, popuj, e ai mbetet - po Ai. Të gjallët vdesin, të dënuarit me jetë mbesin. Tata, i vdekuri i gjallë, i jeton bashkë dhe në një çast jetën e vdekjen dhe në këtë njëjtësim banon dhe vuajtja e tij, rrëfimi për të dhe rrëfimi i tij. Në këtë mënyrë, “rrëfimi realizohet si histori e një rrëfimi tjetër, tërësisht anonim, nëpërmjet të cilit rrëfimtari rreh të rindërtojë tregimin e pamundur të një dashurie përtej vdekjes¹⁵.

Për Aurel Plasarin në qendër të novelës ndodhet e vendosur drama e një qenieje të dashur që vdes duke përmbysur gjithçka në jetën e kësotokshme të protagonistit¹⁶. Plasari, më pas shpalos në një përballje personazhe e kategori kuptimore te disa nga krijimet e Kutelit, që përfaqësojnë një relacion estetik e moral të qenies njerëzore – të shpirtit që është në një dënim mes jetës dhe vdekjes: “Bashkimi i Rinës së gjallë me Kirillojn e vdekur (Rinë Katerinëza), dashuria e Tat Tanushit me Kalijen (E madhe është gjëma e mëkatit), bashkimi në greminat e liqenit të vashës së “krahëve të bardhë” me Pjetër Kulirën (Sbulesa e dytë) etj, përfaqësojnë përpjekjen e dyanshme të dy shpirtërave të ndarë nga vdekja. çdonjëri prej këtyre dy shpirtërave punon për t’iu sjellë tjetrit

¹⁵ Aurel Plasari, Kuteli midis të gjallëve dhe të vdekurve, Apolonia, Tiranë, 1995, f. 88

¹⁶ Po aty, f. 82

në solidaritetin e asaj bote që ka veshur vetë. Këtë takim qenësor, pas shumë e shumë leximesh të rrëfimeve të Kutelit, kam mundur ta përfytyroj si dialog jo vetëm dy shpirtërash, por edhe dy botësh. çka përbën në të vërtetë menteshën rreth së cilës sillet proza e tij rrëfimtare¹⁷.

4. Mëkatimi dhe pendimi

Dy veprimet kryesore të Tatës, mëkatimi dhe pendimi, e ndajnë dhe rrëfimin në dy pjesë kryesore. Tërësia e parë na rrëfen mëkatet e Tatës që vijnë njëri pas tjetrit. Personazhi është në një përballjen mes dashurisë së përkohshme dhe asaj të përhershme, dashurinë për gruan dhe dashurinë për Zotin. Tata, prifti mëkatar, zgjedh gruan përballë Zotit dhe këtu nis rrënimi e përshkallëzimi i mëkatave që ecën nga njëri te tjetri. Heroi Tat rron me shekuj, për të provuar vuajtjen e kaluar nëpër rrahët e spastrimit të shpirtit.

Historia e vuajtjes së Tatës thuret në tërësinë e dytë, në jetën e shtrirë pambarim. Duke na çuar në një botë ndryshe nga e njohura, aty ku funksionojnë të tjera ligje, në një botë të mbinatyrshme ku shtrihet tisi i fantastikes. Në kërkimin midis të shkuarës dhe të ardhmes – personazhi mbetet peng.

Strategjia e rrëfimit e ka kërkuar vazhdimisht purifikimin e shpirtit të heroit, shkëputjen e tij nga fizikja e lidhjen me metafizikën, dhe vetëm në fund, Tata i mbyllur e me veten lë pas botën e së ligës për të hyr në botën e mirësisë universale.

Në një epilog, në pjesën e tretë të rrëfimit, prifti mëkatar, i penduar tashmë, pas shekuj vuajtjesh, agjërimi e asketimi, kthehet në vendin ku kish mëkatar e ish dënuar. I “pajtuar” me Zotin, lutet për falje. Në dialogun eternal, mes Tatës e Zotit, Zoti e falë Tatën dhe Tata e falë Atë. Ai i shfaqet për ta liruar nga jeta, ndërsa që në rrëfim jepet se si *Tat Tanushi u tret ngadalë në sytë e të gjithëve duke mbetur vetëm një dorë hi në pragun e derës së shenjtë*”.

Rrëfimi për Tatën përmbyllet, kur atij një ditë i troket vdekja ‘e vonuar’ - si një shpëtim, për të kaluar në pavdekësi, ku koha është e pamatshme - e përjetshme.

¹⁷ Po aty, f. 83

Përfundim

Në pendimin e brendshëm deri te pajtimi me Zotin (Tat Tanushi) dhe pajtimin me njeriun për ta gjetur Zotin (Ago Jakupi), autori jep fuqinë e shpirtit njerëzor, i cili gjendet midis mendimeve e ndjenjave plot trazim të jetës reale dhe asaj eternale. Jeta ka një fillim dhe një përfundim dhe se fillon si një intencë apo kërkim i synuar - dhe ky kërkim pas udhës së vet, ka për të përfunduar në një gjendje të shpirtit që kërkon eternalen – duke qenë një shpirt i pastër. Ndaj dy mëkatarët në fillim të rrëfimit (Tat Tanushi dhe Ago Jakupi) kthehen në dy paqtues në mbarim të jetës dhe siç thuhet: Si për njërin, ashtu për tjetrin, *jeta mbyllet me një pajtim*¹⁸.

Heroit në tregimet dhe novelat e Kutelit i bie që në jetë të marrë përsipër udhën vetë, vetëm me veten, ndërsa që vdekjen e takon herë si humnerë e herë si shpëtim. Ai jeton duke mbetur në dyshimet e arsyeve të tij, në mesin e të cilave, e ndoshta edhe më e forta prej tyre është – të jem i gjallë apo i vdekur.

Blerina Rogova Gaxha

MITRUSH KUTELI: DEATH TOPIC

Summary

Mitrush Kuteli is one of the authors of the subject of death in Albanian Literature. Provoked by its reading, this article is based on the authorial intent of dialogue between the two worlds, life and death, in the author's work that gives some interesting views into the death topic of Albanian Modern Literature.

Our focus are the novels: “Si e gjeti Ago Jakupi rrugën e Zotit” (How Ago Jakupi found God’s way) and “E madhe është gjëma e mëkatit – Tat Tanushi i Bubutimës” (The curse of the sin – Tat Tanushi of Bubutima). The texts tells us about the characters of Ago Jakupi and Tat Tanushi, protagonists created on the extraordinary play between life and death. The story about the priest and his woman and the story of the old man who seeks for the God’s way, tells us about the sin and the

¹⁸ Kujtim M.Shala, *Shekulli Letërsisë Shqipe*, Buzuku, Prishtinë, 2006, fq. 77

price of it, the goods and the evils of the two characters, to whom God didn't take the souls.

The two protagonists are punished by their creator with no death as a consequence of ignoring the doctrinal principles of life set up on Christian ethics, and the moral categories arising from the great cultural code of Bible. Heroes of the stories pray for the God's grace, they wish to die and seek death in order to be liberated from life, but they will undergo a great psychological tests, until the purification of the soul and its passage into the world beyond.

The paper puts in front and compares protagonists from this two novels, considered the best of the Mitrush Kuteli's work, trying to understand the dialogue between life and death, with the aim to give a more understanding on the work of the author who is considered to be a unique author of Modern Albanian Literature.

Literatura

- Aurel Plasari, *Kuteli midis të gjallëve dhe të vdekurve*, Apolonia, Tiranë, 1995
- Death in Literature*, Edited by Outi Hakola, Sara Krivisto, Cambridge School Publishing, Cambridge, 2014
- Kujtim M. Shala, *Shekulli i Letërsisë Shqipe*, Buzuku, Prishtinë, 2006
- Kujtim M. Shala, *Kujtesa e tekstit- Mitrush Kuteli*, Buzuku, Prishtinë, 2003
- Kujtim Rrahmani, *Intertekstualiteti dhe Oraliteti - E. Koliqi, M. Kuteli, A. Pashku*, AIKD, Prishtinë, 2002
- Mitrush Kuteli, *Vepra letrare 2*, Naim Frashëri, Tiranë, 1990
- Mitrush Kuteli, *Ago Jakupi dhe rrëfime të tjera*, Enti i Botimeve Shkollore i Republikës Socialiste të Serbisë, përzgjedhur nga Ali Jasiqi, Prishtinë, 1968
- Mitrush Kuteli, *E madhe është gjëma e mëkatit, Tat Tanushi i Bubutimës*, Botimi III, Grand Prind, Tiranë, 2006
- Michel Foucault: *What is an Author?* 1969
- Nysret Krasniqi, *Udha kratilike*, AIKD, 2008, Prishtinë
- Nysret Krasniqi, *Harta letrare*, Cuneus, Prishtinë, 2014
- Plato, *Cratylus*, përkthyer në gjuhën angleze nga Benjamin Joëet, ueb, biblioteka klasike
- Roland Barthes, *S/Z*, Hill and Wang, New York, 1974
- Roland Barthes: *Death of the Author* 1968
- Sigmund Freud: *Psikanaliza e artit dhe e letërsisë*, Dituria, Tiranë, 2000

Qëndresa Jakupi, Prishtinë

POZITAT *IN-SITU* DHE *EX-SITU* TË FOKUSIT NË GJUHËN SHQIPE

Abstrakt

Fokusi është njëri nga konceptetet kryesore të strukturës së informacionit në gjuhësi. Si i tillë, nëpër gjuhë të ndryshme mund të realizohet në pozicione të ndryshme sintaksore. Dy pozitat kryesore të realizimit të fokusit në gjuhësi konsiderohen të jenë pozita e zakonshme ose ndryshe pozita **in-situ** dhe pozita jo e zakonshme e markimit ose **ex-situ**. Tradicionalisht, pozita *in-situ* i referohet pozicioni fundor të fjalisë dhe konsiderohet të jetë e lidhur me një import informativ dhe mund të përkojë me përgjigjen e një pyetjeje-wh. Prandaj, llogaritet se është pozicioni më i zakonshëm i fokusit. Ndryshe realizimi i fokusit në pozicione të tjera (jo *in-situ*) lidhet me shumë faktorë të tjerë prozodikë, pragmatikë e sintaksorë. Qëllimi i hulumtimit është të shqyrtojë strategjitë sintaksore të realizimit të fokusit në pozitat *in-situ* dhe *ex-situ* (fokusi ballor dhe ndërtimet *cleft*) në gjuhën shqipe. Korpusi i përzgjedhur për ta analizuar mënyrën e markimit të fokusit në gjuhën shqipe në këto pozita, përbëhet nga gazeta *Koha*; emisioni *Pressing* (30 maj 2022); dhe komentimi i ndeshjes së futbollit *Serbi – Shqipëri* (14.10.2014 Beograd). Këto lloje tekstesh janë përzgjedhur me qëllim, pasi janë ndërtuar mbi stile të ndryshme, me ç'rast mund të nxirren shembuj të ndryshëm.

Fjalët çelës: fokus, *in-situ*, *ex-situ*, fokus ballor, ndërtimet *cleft*, gazeta *Koha*, emisioni *Pressing*, ndeshja e futbollit *Serbi – Shqipëri*

SFONDI TEORIK

Koncepti i fokusit është diskutuar gjerësisht brenda gjuhësisë si një aspekt kyç i komunikimit (shih Chomsky 1971, Jackendoff 1972, Ladd 1983, Rooth 1985, 1992, Lambrecht 1994, Erteschik-Shir 2007, Büring 2010). Por ndryshe nga topika, studimet mbi fokusin kanë nxitur më shumë kontradikta. Këto studime e kanë definuar fokusin në shumë mënyra, nisur nga disa këndvështrime të ndryshme, si: semantike, fonologjike, sintaksore dhe pragmatike, duke e bërë fokusin kështu si një fenomen kompleks, që vetë nocioni i fokusit të mos ketë një përkufizim standard.

Fokusi është vëzhguar në dy qasje të ndryshme në fushën e semantikës, në kuadrin e semantikës gjenerative dhe të asaj alternative.

Në kuadrin e semantikës gjenerative, fokusi është identifikuar si përbërësi që i përgjigjet një pyetjeje (wh-question), me ç'rast informacioni që bart kjo pyetje është krejtësisht **i ri** dhe i gjithë materiali që përmban përgjigjia e cila korrespondon me përbërësin në pyetjen-wh. Po ashtu, sipas kuadrit të semantikës alternative, funksioni i fokusit është të evokojë alternativa. Çdo shprehje supozohet t'i ketë dy vlera të ndryshme semantike: vlerën e saj të zakonshme semantike dhe "vlerën semantike të fokusit", ku vlera semantike e fokusit do të përbëhet nga një grup alternativash.

Të dy qasjet, pra ajo e semantikës gjenerative dhe ajo e semantikës alternative, konceptin e fokusit e lidhin me përgjigjen e kërkuar (e nxjerrë) nga pyetja e dhënë, për shembull:

Konteksti: Luhet ndeshja e futbollit Serbi-Shqipëri (Beograd, 14.10.2014). Derisa Kukeli e mban topin dhe pastaj e kthen prapa, komentatori D. Sh., komenton:

1. *Kukeli e kthen prapa tek Mavraj.* (Komentimi i ndeshjes Serbi-Shqipëri, 14.10.2014)

Fokusin në këtë fjali mund ta nxjerrim përmes pyetjes:

Çfarë po bën Kukeli me topin?

- *E kthen prapa tek Mavraj/* _{FocP}

Pra, duke iu përgjigjur pyetjes më lart "Çfarë po bën Kukeli me topin?", fokusi del në pah përmes përgjigjes, përkatësisht përmes përgjigjes që korrespondon me pyetjen. Në këtë rast, komplet VP-ja *e kthen prapa tek Mavraj* përkon me përgjigjen e kërkuar që është ekuivalente me kornizën e fokusit. Kjo VP, meqë tani e ka statutin e fokusit, ka tendencë të rreshtohet krejt djathtas, sepse kjo llogaritet të jetë pozita in-situ e fokusit, pra ajo e zakonshme. Por në disa gjuhë sikur edhe në gjuhën shqipe jo gjithmonë fokusi rreshtohet djathtas për shkak të disa kufizimeve sintaksore dhe prozodike që mund ta bllokojnë. Pra, fokusi nuk mund gjithmonë t'i paraprijë përbërësve të zhvendosur djathtas dhe kështu paraqitet në pozitën ex-situ (jo të zakonshme), pra majtas.

Prandaj para se të analizohen pozitat in-situ dhe ex-situ të fokusit në gjuhën shqipe, do të diskutohet njëherë mënyra e diagnostikimit të fokusit dhe metodat që përdoren në gjuhësinë moderne, për ta identifikuar shtrirjen e fokusit.

Diagnostikimi i fokusit në gjuhën shqipe

Për shqipen mund të përdorim disa teknika që e nxjerrin në pah fokusin që përdoren edhe nëpër gjuhë të tjera (Shih: Jenneke 2016), një nga këto teknika është teknika e elicimitit përmes së cilës për të nxjerrë fokusin, ngjallet konteksti, po e marrim një shembull:

a) **Konteksti:** *Ka një problem për Andi Lilën//Një goditje që [Ø]_{TopP} ka marrë nga topi// [E]_{TopP} [kanë goditur]_{FocP}//* (Komentimi i ndeshjes Serbi-Shqipëri, 14.10.2014)

Nga konteksti nënkuptohet se Andi Lila është ai që është lënduar dhe ka një problem. Ky problem që ndaloi ndeshjen ka të bëjë me lëndimin e Lilës që e mori nga goditja.

Çfarë problemi ka Lila? – E [*kanë goditur*]_{FocP}.

Teknikat e tjera që e nxjerrin në pah fokusin lidhen me çiftin pyetje – përgjigje, me ç'rast përgjigjja e nxjerrë është e barabartë me fokusin. Janë disa lloje pyetjesh që bëhen për ta nxjerrë fokusin. Do t'i rendisim më poshtë: **Pyetjet-wh**; Testi *pyetje-përgjigje (Q-A)*; Përgjigjet e fragmentuara; Pyetje alternative;

Përmes këtij testi do t'i analizojmë edhe disa shembuj nga korpusi ynë:

1. *Dy zyrtarë të Serbisë nesër me leje vizitojnë Kosovën* (Koha Ditore 19 prill 2018)

Varësisht nga vlera semantike e përbërësve sintaksorë në këtë fjali për lexuesin dhe varësisht nga ajo që do të nxjerrë lexuesi e formulon edhe pyetjen me të cilën e nxjerr përgjigjen, pra përbërësin sintaksor që e përmban fokusin. Për shembull:

Çfarë do të bëjnë zyrtarët serbë nesër?

- *Do ta vizitojnë Kosovën/* _{FocP}

Kur do ta vizitojnë?

- *Nesër/* _{FocP}

2. *Kukeli e kthen prapa tek Mavraj.* (Komentimi i ndeshjes Serbi-Shqipëri, 14.10.2014)

Çfarë po bën Kukeli me topin?

- *E kthen prapa tek Mavraj/* _{FocP}

3. *Kendrick Lamar osht ni rep artist amerikan që tash osht në toplistë.* (Emissioni *Pressing*, 30 maj 2022)

a. Kush është Kendrick Lamar?

- *Osht ni rep artist amerikan/* _{FocP}

1. A: Kujt i dha librin ajo?

B: [Gencit] ~~ia dha~~.

Përgjigje e fragmentuar

2. A: Do të shkojmë në Dhërmi a po në Jalë?

B: Në Dhërmi.

Përgjigje alternative

ANALIZA SINTAKSORE E POZICIONEVE TË FOKUSIT NË GJUHËN SHQIPE

Pozicionet e fokusit në fjali

Fokusi mund të realizohet në pozicione të ndryshme sintaksore, domethënë **në in-situ (1a)** ose **ex-situ (1b)**. Tradicionalisht, siç kemi thënë pozicioni fundor në fjali (1a) konsiderohet të jetë i lidhur me një import informativ dhe mund të përkojë me përgjigjen e një pyetjeje-wh.

1a. S2: //Ato pamje i shohin [t rit] FOC //

1b. S1: //[Flitet]FOC për nxitje t urrejtjes//

Fokusi **in-situ** është një strategji fokusimi, e cila vë në pah një element, pa e ndryshuar vendin ose pozicionin e tij në një fjali.


Fokusi **ex-situ** në gjuhën shqipe është një strategji fokusimi që vendos rëndësinë e një elementi, duke ndryshuar vendin ose pozicionin e tij *in-situ* në një fjali dhe duke e shtyrë përbërësin e fokusit të lëvizë nga pozita e zakonshme në pozitën *ex-situ* (1b) për disa arsye, sintaksore dhe fonetike. Sa u përket lëvizjeve sintaksore të fokusit, dallojmë dy lloje, si: *cleft* (ndërtimet *cleft*) dhe *fronting* (fokusi ballor). Fokusi *ex-situ* jo vetëm që shpreh informacion të ri, por ka një vlerë

kontrastive (Rochemont 1986), e cila identifikon në mënyrë shteruese përmbajtjen e tij referuese. Me fokus *ex-situ* kuptohet elementi që është në fokus e që zhvendoset në periferinë e majtë të fjalisë ku i gjithë përbërësi ndiqet nga një markues fokusi, siç është theksi në gjuhën shqipe.

Ndërtimet *cleft*

Ndërtimet *cleft* shprehin një ndarje strukturore të informacionit, zakonisht një ndarje të topikës dhe fokusit, të asaj që është në mënyrë të një predikuesi të vetëm, duke realizuar sfondin/topikën dhe pjesën e fokusit të atij predikuesi si dy klauza të ndryshme. Zakonisht, fokusi realizohet në një klauzë kryesore, ndërsa sfondi/topika në një klauzë relative të nënrenditur, dhe ndërtimi shpreh fokus identifikues, ose korrektiv.

Diagrami i fokusit *cleft*



I ashtuquajturë ndërtimi *cleft* në shqip (2 dhe 3) ka të njëjtin funksion të shprehjes së fokusit identifikues. Megjithatë, paraqitja e këtij ndërtimi *cleft*, pra analiza e tij dyklasëshe është shumë e diskutueshme si në çdo gjuhë. Për një gjë, ndërtimi nuk përfshin asnjë klauzë relative në kuptimin standard (É. Kiss 1999). Përemri dëftor *ky/ai* pasohet nga *ajo*, që në mënyrë sipërfaqësore është një fjali kryesore e plotë, ku përbërësi i fokusuar shpesh përballet dhe ndjek menjëherë përemrin dëftor (por edhe *kjo* nuk kërkohet në përgjithësi, kur mungon *ky* përemër). Po marrim shembuj:


2. Është [*ai lojtari i vetëm shqiptar*] TopP që mori pjesë në ngjarjen më të madhe të hendbollit. (Gazeta Koha)

3. Është [*ky kampionati i parë për mua dhe për Belgjikën*] TopP....., (Gazeta Koha)

4. *Ishte* [*për këtë e gjitha kjo*] TopP.....


Në shembujt më lart, pozicioni i fokusit i përdorur është *ex-situ*, por në dy rastet e para brenda domenit të fokusit shtrihet një kryefjalë, ndërsa në rastin e tretë shtrihet një kundrinë. Më poshtë do të do t'i analizojmë *cleft*-kryefjalën dhe *cleft*-kundrinën.

Në mënyrë koherente me udhëzimet kartografike, në informacionin e ri *cleft*-kryefjala, e ilustruar në shembujt më lart, kryefjala mund të interpretohet në të njëjtin pozicion si informacion i ri e në pozitën postverbale në një gjuhë me rend fleksibël si shqipja. Prandaj, ky përbërës *cleft* synon pozicionin e fokusit periferik djathtas. Ky propozim i përgjithshëm do të paraqitet skematikisht në (1a);



Supozimi këtu është se pozicioni i subjektit dhe pozicioni i fokusit vP-periferik llogariten si pozicione të të njëjtit lloj nga parimi RM/lokalitet, prandaj subjekti llogaritet si një ndërhyrës në rastin më lart (Belletti 2015).

Ndërkaq, në *kundrinat-cleft*/jo-kryefjalë, përbërësi *cleft* synon pozicionin e fokusit periferik në të majtë në komplementin e kopulës. Për shembull:



Lëvizja e objektit nga pozicioni i tij brenda kallëzuesit FinP në pozicionin Spec/Pred në klauzën CP-small do të kalonte mbi subjektin, duke shkaktuar një shkëlqje të drejtpërdrejtë të RM, nën supozimin se të dy pozicionet përkatëse - subjekti dhe pozicioni Spec/Pred-llogaritet si pozicione të të njëjtit lloj në lidhje me parimin (Belletti 2015).

Kështu, për shkak se pozicioni Spec/Pred në CP nuk mund të synohet nga objekti, objekti nuk mund të lëvizë në pozicionin e fokusit periferik vP në klauzën e matricës, dhe për rrjedhojë një *cleft-kundrinë* nuk mund të interpretohet si fokusi dhe informacion i ri.

Kjo është arsyeja pse një *cleft-kundrinë* nuk mund të funksionojë si një përgjigje e mundshme për një pyetje të pastër informacioni. Për më tepër, lëvizja e drejtpërdrejtë e objektit në matricën vP-Fokus periferik përjashtohet gjithashtu për arsye lokaliteti. Supozimi këtu është se pozicioni i subjektit dhe pozicioni i fokusit vP-periferik llogariten si pozicione të të njëjtit lloj nga parimi RM/lokalitet, prandaj subjekti llogaritet si një ndërhyrës në këtë rast.

Pozicioni *fronting* (ballor) i fokusit

Kemi thënë që fokusi ndërlinguistikisht është i lidhur me një sërë strategjish të ndryshme sintaksore, të tilla, si: *frontingu*, *klefti*; si dhe markues të tjerë morfologjikë dhe prozodikë. Në disa raste, zgjedhja ndërmjet një strategjie ose tjetrës përcaktohet nga rregulla specifike të gjuhës, ndërsa në të tjera, dy ose më shumë strategji duken të jenë fakultative, dhe kështu, disi “të pidentifikueshme”. Prandaj, në këtë studim eksperimental, hetohen strategjitë sintaksore të përdorura në fokusimin e kundrinave në gjuhën shqipe, duke shqyrtuar veçoritë sintaksore, semantike dhe pragmatike që qëndrojnë në themel të zgjedhjes së një strategjie specifike sintaksore siç është *frontingu*.

Në veçanti, eksperimenti aktual synon të hetojë strategji të përdorura në gjuhën shqipe për realizimin e fokusimit të kundrinës në pozicionin nistor të fjalisë, përkatësisht fokusit *fronting*, në mënyrë që të verifikohet nëse përzgjedhja e pozicionit ndërmjet tyre ndikohet nga një lloj tipari specifik, një kombinim i veçorive të lidhura me fokusin, siç mund të jetë kategoria e foljes së përfshirë ose ndërveprimi midis disa faktorëve të tjerë.

Duke e analizuar, siç u tha më herët, brenda qasjes kartografike të Minimalizmit (Cinque dhe Rizzi 2008), supozohet se vetitë ligjëruese-semantike janë të lidhura me tipare formale, të bashkuara në projeksione funksionale të dedikuara në domenin C dhe se një lidhje sistematike ekziston midis vetive formale (sintaksë-prozodi) dhe semantike të kategorive të lidhura me ligjërimin (Frascarelli 2007, 2018).

Strategjitë e fokusit ballor në gjuhën shqipe


Më poshtë paraqiten strategjitë e ndryshme morfosintaksore të fokusit në pozicionin fronting të aplikuara në shqip. Kjo gjuhë, siç edhe italishtja, lejon licencimin e fokusit *in-situ* dhe përmes frontingut, megjithëse kjo e fundit është opsionale dhe me sa duket e kufizuar në disa lloje të fokusit. Lëvizja e një përbërësi të fokusuar në një pozicion në periferinë e majtë të fjalisë nuk nënkupton domosdoshmërisht një interpretim kontrastiv.

Në gramatikën angleze, fronting i referohet çdo ndërtimi në të cilin një grup fjalësh që zakonisht ndjek foljen vendoset në fillim të një fjalie. Quhet edhe fokusi i përparmë/ballor ose preposing.

Frontingu është një lloj strategjie fokusimi që përdoret shpesh për të ndihmuar kohezionin dhe për të treguar theksin emfatik. Kur përdoret në fillim të një bisede, ky lloj fokusi i lejon folësit të vendosë vëmendjen në fillim të një fjalie për ta bërë një thënie më bindëse Rizzi (1997, 2006).

2. [NASA]_{FocP} mbyll misionin 30-vjeçar në hapësirë.
3. [Belgjikën e Qerimin]_{FocP} i presin ndeshjet me Kroacinë dhe SHBA-në.
4. [Lajm i mirë vendimi për liberalizimin e vizave për Kosovën]_{FocP} vjen.
5. [Rrikthemi të luajmë me 11 me 11]_{FocP} sa i përket lojtarëve.
6. [Do të ruajë gjakftohtësinë]_{FocP} Cana.
7. [Të hyrat i kanë marramendëse dhe followersat]_{FocP} gjithashtu.

Në diagramin më poshtë paraqitet skematikisht shembulli nr.2.



mbyll misionin 30-vjeçar në hapësirë

PËRFUNDIMI

Sa i përket realizimit të fokusit në pozitën *in-situ* në gjuhën shqipe ka tendencë të rreshtohet krejt djathtas, duke u rreshtuar në mënyrë prozodike me skajin e djathtë të një domeni prozodik dhe sintaksor. Ndërsa, sa i përket realizimit të fokusit në pozitën *ex-situ* në gjuhën shqipe, përmes këtij hulumtimi supozohet se një rol të veçantë e luan edhe theksi emfatik që është tipik për komentimin e ndeshjes së futbollit *Serbi – Shqipëri* (14.10.2014 Beograd), siç mund ta shihni në tabelën më poshtë, gjatë komentimit e ndeshjes së futbollit, fokusi realizohet në pozitën *ex-situ* diku rreth 90%, pasi ngjarjet që zhvillohen gjatë lojës janë të paparashikueshme dhe rrethanat ndryshojnë nga momenti në moment, prandaj komentatori nën trysinë e ngjarjeve përmes theksit emfatik e zhvendos fokusin në varësi të qëllimeve specifike që ai ka për të vënë në pah atë që do ai dhe që i konsideron si më të rëndësishme.



Ndërsa, sa u përket lëvizjeve sintaksore të fokusit, dallojmë dy lloje, si: *cleft* dhe *fronting*. Fokusi *ex-situ* jo vetëm që shpreh informacion të ri, por ka një vlerë kontrastive (Rochemont 1986), e cila identifikon në mënyrë shteruese përmbajtjen e tij referuese. Me fokus *ex-situ*, elementi që është në fokus zhvendoset në periferinë e majtë të fjalisë ku i gjithë përbërësi ndiqet nga një markues fokusi, siç është theksi në gjuhën shqipe.

Është ky kampionati i parë për mua dhe për Belgjikën, (Gazeta Koha) *cleft*

[Do të ruajë gjakftohtësinë]_{FocP} [Cana]_{TopP} (Komentimi i ndeshjes Serbi-Shqipëri, 14.10.2014) – fokusi ballor

IN-SITU AND *EX-SITU* FOCUS POSITIONS IN THE ALBANIAN LANGUAGE

Summary

Focus is one of the main concepts of information structure in linguistics. As such, in different languages it can be realized in different syntactic positions. The two main positions of focus realization in linguistics are considered to be the usual position or otherwise the in-situ position and the unusual position of marking or ex-situ. Traditionally, in-situ position refers to sentence-final position and is considered to be associated with an informational import and may coincide with the answer of a wh-question. Therefore, it is considered to be the most common focus position. Otherwise, the realization of the focus in other positions (not in-situ) is related to many other prosodic, pragmatic and syntactic factors. The purpose of the research is to examine the syntactic strategies of realizing focus in in-situ and ex-situ positions (preposing focus and cleft constructions) in the Albanian language. The corpus selected to analyze the way of marking the focus on the Albanian language in these positions, consists of the newspaper *Koha*; the show *Pressing* (May 30, 2022); and the commentary of the football match Serbia - Albania (14.10.2014 Belgrade). These types of texts have been selected on purpose, as they are built on different styles, in which case different examples can be extracted.

Key words: focus, in-situ, ex-situ, preposing focus, cleft constructions, *Koha* newspaper, *Pressing* show, football match Serbia - Albania

Bibliografia

- Agalliu, Fatmir – Angoni, Engjëll – Demiraj, Shaban – Dhrimo, Ali – Hysa, Enver – Lafa, Emil – Likaj, Ethem (2002). Gramatika e gjuhës së sotme shqipe II. AShASh. Tiranë.
- Belletti, A. (2015). The focus map of clefts: Extraposition and Predication. *Beyond functional sequence*, 10, 42-60.
- Büring, D. (2010). Towards a typology of focus realization. In Information structure. Theoretical, typological, and experimental perspectives, eds. Malte Zimmermann and Caroline Féry, 177–205.
- Chomsky, N. (1971). Deep structure, surface structure and semantic interpretation. 1971, 193-216.
- Cinque, G., & Rizzi, L. (2008). CISCL Working Papers.
- Erteschik-Shir, N. (2007). Information structure: The syntax-discourse interface. Oxford: Oxford University Press.
- Frascarelli, M. (2018). The interpretation of pro in consistent and partial null-subject languages. *Null subjects in Generative Grammar: A synchronic and diachronic perspective*, 211-239.
- Frascarelli, M., & Hinterhölzl, R. (2007). Types of topics in German and Italian. In *On information structure, meaning and form* (pp. 87-116). John Benjamins.
- Jackendoff, R. S. (1972). Semantic interpretation in generative grammar.
- Kiss, K. É. (1999). The English cleft construction as a focus phrase. *AMSTERDAM STUDIES IN THE THEORY AND HISTORY OF LINGUISTIC SCIENCE SERIES 4*, 217-230.
- Ladd, D. R. (2008). Intonational phonology. Cambridge University Press.
- Lambrecht K. (1994). Information structure and sentence form. Topic, focus, and the representation of mental referents in discourse. Cambridge: Cambridge University Press.
- Rizzi, L. (1997). The fine structure of the left periphery. In Liliane Haegeman (ed.), *Elements of grammar*, 281–337. Kluwer, Dordrecht.
- Rizzi, L. (1997). The fine structure of the left periphery. In Liliane Haegeman (ed.), *Elements of grammar*, 281–337. Kluwer, Dordrecht.
- Rizzi, L. (2005). On some properties of subjects and topics. In *Proceedings of the XXX Incontro di Grammatica Generativa* (pp. 203-224).
- Rizzi, L. (2006). On the form of chains: Criterial positions and ECP effects. *Current studies in linguistics series*, 42, 97.

- Rochemont, M. (1986). Focus in generative grammar. Focus in Generative Grammar, 1-231.
- Rooth, M. (1985). Association with focus (montague grammar, semantics, only, even). University of Massachusetts Amherst.
- Rooth, M. (1996). On the interface principles for intonational focus. In Semantics and Linguistic Theory (Vol. 6, pp. 202-226).
- Rugova B. (2006 dhe 2007) Gjuha e sportit. Filologji 14/15, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, pp 141 - 156.
- Rugova B., Sejdiu - Rugova L. (2015). Hyrje në gramatikën e tekstit të gjuhës shqipe. Trembelat. Prishtinë.

Zejnullah Rrahmani, Prishtinë

POEZIA E ROMANTIZMIT

Ka disa arsye që e vendosin poezinë frënge të romantizmit në qendër të interesimeve. Franca ishte vendi ku kishin shpërthyer me radhë revolucione dhe kundërrevolucione dhe që tronditur thellësisht rendi i përparshëm, feudalizmi dhe mbretëritë. Rendi i ri borgjez do të mbështetet në racionalizëm, pragmatizëm industrial e ekonomik. Artistët më të mëdhenj të kohës rrjedhin nga aristokracia e përmbysur dhe e frustruar, duke humbur pasurinë e rendin, kishin pësuar thyerje morale e zhgënime të fuqishme. Industrializimi i shpejtë po e ndryshonte rrënjësisht pasqyrën arkaike e arkadike, kështu që ata e ndiejnë veten të humbur, të pashpresë, brenda kotësisë jetësore e njerëzore, të thyer shpirtërisht do të tërhiqen në vetmi dhe disfatizëm: ky është përafërsisht tipi i krijuesit të ri, tipi i gjenit romantik. Shatobriani, Madam de Stal etj., shpejt do të braktisin Napoleonin dhe idetë e tij, mirëpo pas humbjes së tij, kur Napoleoni bëhet tribun popullor francez, ata do t'i kthehen atij përmes veprës së romantikut tjetër të madh Viktor Ygo, tashmë si një figurë që mbledh projektin e dëshiruar e jo real të Napoleonit.

V. Ygo

AI QESH

Ah! n'ulërimë, i poshtër, ti ke për të mbaruar!
Ende duke dihatur prej krimin të mallkuar,
N'atë triumf të ndytë, aq të beftë, o xhelat,
Të kapa. Dhe mbi ballë të ngjita një pllakat;
Turma tani, për turp, të vë në lojë, o qen.
Ti, ndërsa ty ndëshkimi për huri të mbërthen,
Dhe mjekrën prang'e qafës drejt qiellit ta kthen,
Ndërsa të kap për setre dhe, duke të zbërthyer,
Ta zbulon ty Historia supin e përlyer –
Ti thua: s'ndiej asgjë! dhe qesh si karagjos!

Zgërdhësh kundër meje e nxjerr shkumë, o lepros,
Ndërsa damka e skuqur në mish po të shkrumbos!

Në përgjithësi romantikët e të gjitha vendeve do të synojnë projektin e një atdheu të dëshirave të tyre dhe përgjithësisht një hero nacional dhe do të krijojnë mitin e luftarit, heroin kombëtar.

Në poezinë shqipe ky është Gjergj Kastrioti, Skënde rbeugu, figura e të cilit ka ardhur në kohën tonë përmes romantizmit, si fryt i një mpleksjeje të veprave historike si ato të Marin Barletit, Naim Frashërit, etj, por edhe poezive, pikturës, legjendave e krijimeve popullore, sidomos të atyre të ikurve në Itali pas vdekjes së tij.

Por edhe rrethi i topikës së poezisë të romantizmit do të lëvizë nëpër këtë linjë: pesimizmi e humnera përpara vizionit të poetit, gjakimi për viset e largëta ekzotike, të cilat duhet të zëvendësojnë peisazhin gri të qytetit, ultrakatolicizmi, gjeniu i shpenguar prej rregullave të krijimit klasikist dhe racionalizmit. Një orientimi të tillë do t'i kundërvihet linja e romantizmit social pikëpamjet e të cilës mbështeteshin tek idetë e spektrit nga Sen Simoni gjer tek Prudoni, përmes Ogist Tierit e Ogist Komtit. Kjo linjë romantike u përgjigjet klasave të reja shoqërore të cilat po i krijonte zhvillimi i kapita-lizmit. Faza revolucionare e romantizmit pasohet me atë kundërrivolucionare, mirëpo disa parime të përgjithshme njerëzore zënë përfundimisht vend ndër interesimet e poezisë romantike: liria, përparimi, shenj-tëria e idealeve, kalueshmëria njerëzore, besimi në ardhmërinë, shqetësimi i natyrshëm i poetëve ndaj perspektivës individuale e të përgjithshme, ajo fryma e kohës romantike, e njohur si “dhembja e shekullit”. Romantikët frëngë në përgjithësi kanë qenë të djathtë dhe një pjesë të jetës e kanë kaluar në mërgim, andej malli për atdhe, vetmia, nostalgjia për kohën e kaluar, mërgimet vuajtjet, mjerimi, humbja etj., do të jenë temat qendrore të romantizmit. Heroi romantik është i humbur dhe pa asnjë perspektivë. “Kurrkund mua fati nuk më pret” do të këndojë Lamartini, i cili krahas tashmë të përmendurve Shatobrian, Ygo dhe Vinji, Myze etj., do të jetë poeti më reprezent i romantizmit frëng.

Lamartini

LIQENI

Kështu, duke lundruar gjithmonë zall më zall,
Në natën e përjetshme të kredhur pa kthim,

Në oqean të kohës s' do hedhim kurrë vallë
 Çengelin për pushim?
 Liqen! Oh, plot një vit u mbush, ja, këto ditë
 E, pranë kësaj vale, ku desh sërish të vijë,
 Vështro, te guri erdha të lutem zemërpitë,
 Ku ti e pe të rrijë!

Kështu ti oshëtije nënë shkëmbinjtë e thellë,
 Kështu përplasej ujët pas shkrepave në skaj,
 Kështu të shtrihej vala me shkumëza përcjellë
 E gjer te këmbë e saj.

Një mbrëmje – a të kujtohet – vozitnim ne të qetë;
 Së largu nuk dëgjohej në qiell dhe mbi valë
 Veç zhurma e lopatës që ndihej aq e lehtë
 Mbi valët palë-palë.

Papritmas zëri i saj e nisi melodinë
 Që zalli i mahnitur dëgjonte me habi;
 Dhe valët shushurinë të mbanin qetësinë
 Se ajo thoshte tani:

“O kohë, mbaje vrapin! Ju çaste të bekuar
 Mos rridhni tatëpjetë!
 Na lini t’ju shijojmë me ëndje të pashuar
 Se s’vini më në jetë!

Të mjerë ka kjo botë, ju lusim, ju kërkojnë;
 Për ta rridhni si doni;
 Rrëmbeni bashkë me jetën vuajtjet që i mendojnë,
 Të lumturit harroni!

Më kot jam duke lutur ca çaste ngazëllimi,
 Kohën asgjë s’e mban;
 I lutem kësaj nate: “Më ngadalë!” Agimi
 Ja, terrin e shpërndan.
 Pra le të dashurojmë, dhe orën që na shket
 Me nxit le ta shijojmë!
 Njeriu nuk ka skelë dhe koha shpejt e shpejt
 Rrëshqet dhe ne kalojmë!”

O kohë ziliqare, si vallë ky çast gëzimi
 Kur dashuria e thellë na deh me lumturinë
 Larg nesh të fluturojë aq shpejt sa dhe mjerimi
 Që fund s'ka për njerinë?

Si vallë? S'do të mundim të ruajmë atë gjurmë?
 Përjetë të ketë shkuar? Përjetë të jetë fshirë?
 Kjo kohë që na e fali dhe që e fshin pa zhurmë
 Ta tretë në fshehtësirë?

O kohëz e kaluar, përjetësi plot hije,
 Ç'i bëni vallë ditët që i thëthini sa gjeni?
 Na thoni: a do na i ktheni këto orë lumturie
 Që neve na i rrëmbeni?

Liqen, ti pyll i dendur, ju shkrepa të nemitur,
 Që koha ju kursen a përtërit rininë,
 M'ja ruaj kësaj nate, natyrë e pavenitur,
 Të paktën kujtimnë!

Le të mos shuhet kurrë, të mbetet krejt i gjallë,
 Liqen, në qetësinë e në stuhinë rrëmuje;
 Në gjithë këto blerime, shkëmbinjve mu në ballë
 Që varen përmbi ujë.

Të mbetet në puhinë që fryn duke u dredhur,
 Në oshëtimën e zallit ku valën vala e shtrin,
 Në yllin ballargjendte që n'ujë ashtu i kredhur
 Ty faqen ta shëndrin!

Romantizmit anglez i paraprijnë dy libra të rëndësishëm të poezisë, Baladat lirike të Wordsworth - Kolridge dhe Poezi e Robert Bërn-sit. Të parët kanë shtruar poetikën e tyre duke kërkuar që gjërat e rëndomta të jetës dhe të natyrës të këndohen në mënyrë të fuqishme e të jashtëzakonshme përsa u përket ndjenjave të forta. Shumica e poezive bëjnë pjesë në llojin e ba-ladës, mirëpo aty mund të haset edhe ndonjë poezi tjetër shumë e rëndësishme si p. sh. Vargje të krijuara disa mila pranë Abacisë së Tirtnerit, gjatë vizitës së sërishme në derdhjen e Uajit (Lines Composed a Few Miles Above Tintern Abbey, on Revisiting the Banks of the Wye), në të cilën poezia e tij ka arritur në thellësinë e

njohjes së disa vërtetësive të përgjithshme jetësore e filozofike, të cilat i shpreh me vargje të një qetësie mendimtare.

Robert Bërnsi ka qenë poet i natyrshëm dhe i fuqishëm, mirëpo në kohën e tij pak i vërejtur për shkak të origjinës së tij fshatare. Përveç tjerash Bërnsi ka inkuadruar në poezi ironinë e satirën e ashpër kundër formimit religjioz si dhe është i njohur për lojën me realen e fantastiken.

Robert Burns

SHENJTËRIA E TIJ UILLI

I mjeri pluhur i shën Uillit
 Tani u preh në varr,
 Në qiell s'i vajt shpirti priftit,
 I vajti në qilar.
 E gjetëm priftin larg nga pragu
 Mes tokës dhe mes ferrit...
 Me cilin shkon e vjen për krahu
 Ky pis dhe derr i derrit?

A, po! shën Uilli shkon me djallë
 Me nëntë e ca bishtrinjt!
 I dashur djall, prano një fjalë,
 Të flasim si zotërinjt:

Megjithse ti nuk njeh mëshirë,
 Se ferri yt ka ligje,
 Shën Uillit bëji një të mirë
 Dhe nga skëterra hiqe!

Ç'i duhet vdekjes, pse ta marrë
 Dhe pse në ferr ta shesë?
 Shën Uilli ishte trutharë,
 Sa djalli do ta qeshë...

Janë tre poetë që ia japin vulën e vet poezisë romantike angleze:

Xhorxh Gordon Bajroni me veprat Çajld Haroldi, Nusja nga Abidi (The Bride of Abydos), Rrethimi i Korinthit (The Siege of Corinth) Manfredi, Kaini etj.

Bajroni ka ndërtuar tipin e heroit romantik që lufton për lirinë dhe mbron vlerat e larta njerëzore. Ai ka krijuar heroin e revoltuar, të papajtueshëm me komformitetin dhe me trivialitetin e jetës. Çajd Haroldi i tij, për fat të mirë, ka bërë ca rrugëtime nëpër vise shqiptare dhe përmes gojës së tij Bajroni ka lënë një tubëz vargjesh të mrekullueshme mbi shqiptarët, njërin ndër portretet më të mira shqiptare të të gjitha kohëve në poezi.

Xh. G. Byron

KËNGË PËR SULJOTËT

Bij të Sulit, trima t'urtë,
shkoni si tufan në luftë,
mbi kala e mbi çdo poerët
burra, burra, O Suljotë!
Bukuri të rrmesh prenë
siç e keni ju adetnë!

Befas ngrihi tok si retë
tmerr për Ali Pashën vetë.
Është i shtrenjtë mali i lartë,
ku ju kini bijtë, gratë,
ndaj sulmoni porsi shqotë,
burra, burra, o Suljotë!

Pluar kini kllëç e shpatë
me të kornni grurë të artë;
mbi armiq me sakature
çani dyer, çani mure,
ju lavdinë e kini vetë
shkoni grindni me rrufetë!

Persi Bishi Sheli me veprat Alastori ose shpirti i vetmisë (Alastor or the Spirit of Solitude), Çlirimi i Prometheut (Prometheus Unbound) etj. Ndoshta poezia që më së shumti flet për romantizmin anglez dhe krijimin poetik në përgjithësi, është poezia e Shelit, Odë erës perëndimore. Poezia e përmendur që kur u botua e deri më sot ka nxitur dis-

kutime të shumta të paktën për dy arsye të rëndësishme: tercina e përdorur aty është pothuajse e papërsëritshme në poezinë angleze dhe arsyeja e përdorimit të strofës së tillë ka krijuar shumë interpretime dhe, dy, Odë erës perëndimore është e shkruar ashtu që mund të lexohet si një poezi që i këndon një fenomeni natyror dhe një peisazhi të natyrës dhe, poezia mund të lexohet si një shfaqje e mrekullueshme e thellësisë dhe formave të veprimit e të krijimit shpirtëror dhe poetik.

Persi Bish Shell

ODË ERËS PERËNDIMORE

1.

Erë e egër perëndimi, qenie e frymës vjeshtake,	a
prani e padukshme që gjethin përdhe e rrëzon	b
n'asgjësimin prej shpirti para magjisë frikacake.	a

ndishkë – verdhake e zbehur që ngaherë kuqëlon,	b
mu si lepra që gjithçka me trajtat do ta sosë!	c
o, ti që vallen me ëndërr dimërore e mbulon	b

farë që flatra ke, po ti edhe kufomën e gropos	c
në varr nde'të vetin, gjersa edhe motër e saj,	d

azure Shumëverorja, me fyellin magjeps, e përsos	c
kthim kah toka ëndërrimtare, kah shtresat e saj	d
e dëbon blerinën e butë t'kullosës diellspërkatur,	e
e erë shpërndan kudo dhe ngjyrën e gjallë si vaj!	d

Shpirt i Egër, ta gjej gjithkund qenien tënde t'flakur	e
që shafit e krijon, dëgjo fjalët e mia syrgjynosur!	e

2.

Ti që pas rrymës sate shkapërderdh në çdo anë
kasnecët e shiut, rrufetë – po edhe retë velore
degë lartësie e shqetësuar që gjethin e kalbur mban

që atje erë deti kundërmon ndoshta lartësi qiellore!
 Ndër valët ajrore – që suprinës sate lundrojnë
 e derdhen shumë të brishta duke lajmu' stuhinë e re

po edhe si hijet pjerrake që mbi kokë pezullojnë
 si Menadet e tërbuara – kah peizazhet do fiken
 gjer maje qielli ku dritat pedestalin festojnë!

Vajtore e motit që stinët kanë nisur t'i firojnë
 natës së varrit duke i falë errësisë lapidari
 gemer avullor thesaret e shtrenjtë kur dhurojnë,

dhe prej tij, kur nrin, nis të derdhen përsëri
 breshër, flakë – fjalë e imja shi i zi

3.

Ti që bën nga gjumi veror Mesdheu ngadalë t'zgjohet
 me valët tua përherë duke ia falë edhe tërësinë
 e rrymës kristale të detit që përkund e lakohet –
 det që t'ëndërrojnë bashkë me gjirin tënd. Egërsisë.
 kullë, pallat i moshuar ngritur ishujve prej lave.
 që tunditen nga valët tua duke ndritur shkëlqesinë.

Në bimë deti e mbuluar, n'azurin e tyre e shpëlave
 duke u dehur në erën e tyre ti gjitha ndiesitë i zgjove!
 Ti – për të cilën krijohet fuqi atlante e krenave

e prirë nga humbësira duke ndjellë bulimin që krijove
 të maleve përjargore, të petkave gjelbërore t'florës
 prej gjethesh spërkatur me dritë deti, zë që dëgjove!

e nga frika ata marrin ngjyrë të përhimë, kët'e hetove
 dridhërojnë, prenë kërkojnë – fjalën time a dëgjove!

4.

O, fletë e verdhë të isha në gjirin tënd të më rrëmbesh,
 o, re nxituese t'isha me ty përherë lartësive t'fluturoj,

ose t'isha valë deti që me shpirt e frymë në të të ndesh,

që diç nga ajo fuqi e jotja edhe unë t'mund t'ngarkoj,
por jo aq si ti – e lira – që askush s'mund të të mundë!
me ty do të doja deri n'pedestale qielli të lartësoj

-ashtu si bënte dikur djali i ri që me fuqi çdo gjë tund
të cilit, të të arrijë, nuk i është vizion i vështirë –
ja u mundua – që sot të mos mundohet më tjetër,
gjë kund.

Erë, të lutem me thellimë pikëllimi që n'shpirt ngrirë:
si vala, si gjethi, ose trajta që flatrat e veta m'i falë!
Në ferra jete frymoj, gjak po derdh nga zemra e dliër!
Kështu shumë çaste të vrazhdta fuqia bredh e ndalë
njeri të ngjashëm kërkon: gjer, e hidhur, e valë.

5.

O, lyrë të isha e jotja si ky mal që është përherë!
Edhe gjethet e mia veniten dhe si të tijat bien!
Psherëtimë e egër dhe e fuqishme e jotja, si vnerë

nga ne do t'burojë zë i harmonisë vjeshtake. Do vijnë
t'mirëqena e t'dhembshme. O, shpirt i shqetësuar,
O le të bëhet frymë e imja, në të fuqitë le t' rinë!

Mendimin tim t'pajetë hidhe n'gjithësinë e harruar
si gjeth t'shkrumuar, bulimin e gjethit të ri shpejto!
Rrugës magjike që vargu im lyrë e ke gërshetuar

merri tash fjalët e mija e shnpërndajau njerëzve kudo,
si zjarr që amshuar hirin e saj krijon!
tokës ëndërrimtare t'i bëhesh vizionarja ime, ti nxito!

Erë dimri kur t'ia behë me acarin e saj të ngrirë,
vallë, aq larg tij do mbetet ajo stinë erëmirë?

(1819)

Tercinat e pjesës së parë përhapin pejsazhin e mrekullueshëm të natyrës të vënë në lëvizje nga era e fuqishme. Është mosha e shtyrë e shpirtit, vjeshhta para se të kaplojë dimri natyrën. Pahetueshëm, prani e padukshme “që gjethin përdhe e rrëzon”. Natyra është e pjekur dhe e gatshme të bie e të shkatërrohet. Cikli jetësor i natyrës, gjethet, bari, drunjtë, vetë jeta njerëzore që ka lindur, lulëzuar e pjekur, tani është e gatshme prej vetvetiu e orientuar jo më nga qielli po nga toka, “kthim kah toka ëndërrimtare”, thotë Sheli.

Nëse pjesën e parë të tercinateve e mbisundon pejsazhi, natyra bimore dhe lëvizjet e natyrshme, terci-na-rimat e pjesës së dytë manifestojnë zërin shpirtëror të poetit, njeriut. Tani më është tepër e vështirë të përcaktohet metafora e detit, shqetësimit, e “valës ajrore”, dritat e qiellit etj. Janë dilemat që e futin lexuesin (edhe kritikën) e kësaj poezie në labirintet e interpretimit dhe të kuptimit. A kanë fjalët e shprehjet ambiguitet, shumësi kuptimore? A është “deti” poeti? Çka janë “valët ajrore”? Ç’është pamja që aludon kataklizmën biblike me rrufe, kas-necë, valë të brishta, hijet pjerrake, pejsazhet e figurat, gjer tek figura fantastike “stinët kanë nisur t’i firojnë”?

Dhe mbi pejsazhin në dukje të natyrshëm, ku tundet dheu nga rrëmuja e stuhisë dhe format e shumta të jetës shkëlqejnë, mund të hetohet prania e subjektivitetit poetik, e unit, madje edhe e fjalës së poetit: “breshër, flakë – fjala ime dhe shi i zi” një perlë figurore, paradoks, antitezë, metaforë e kuptimit poetik. Një kuptim poetik romantik mbi kërkimin e përjetësisë. Identifikimi me natyrën dhe format e saj ngadalë e lëvizin nëpër ciklin e ripërtëritjes, është gjakimi poetik i përjetësisë “merri tash fjalët e mija e shpërndajau njerëzve kudo” do të thotë poeti.

Një tjetër poet i madh anglez, jetëshkurtër pors i Sheli, Xhon Kitsi, i cili poezinë e vet e ka shkruar për një periudhë tri vjeçe, se vdiq i ri, kur i kish 26 vjet, ka tri poezi me subjekt nga mesjeta: Isabela, Në mbrëmje të Shën Anjesit (The Eve of St. Agnes) dhe La Belle Dame sans Mersi. Që të tri poezitë e famshme janë poezi të cilat i përku-fizojmë si poemë romantike. Këto janë poezi të gjata në të cilat heroi romantik rrëfen për bëmat e veta dhe tek ato mund të vërehet se kanë ngjarje, karaktere dhe përshkrime, por në trajtimin e temës së dashurisë, mbisundon ndjenja, subjektivja, pasioni, ëndrra dhe realiteti jetësor. Poema romantike do të bëhet praktikisht lloj, një lloj i poezisë lirike. Tek e fundit, njëra nga idetë themelore të romantizmit është këndimi i ri pa ndarje në lloje; një krijim gjithpërfshirës, që do të kthente në origjinë, në një matricë, llojet e ndryshme poetike, madje edhe ato që

në një mënyrë nuk ishin poezi. E para e këndon dashurinë dhe besnikërinë, e dyta dashurinë dhe pasionin por edhe rrethimin armiqësor dhe e treta pasionin e vesin e shkatërrimit nga bukuria e femrës. Disa nga odat e Kitsit bëjnë pjesë në vetë kulmin e këtij lloji të lirikës: Bilbilit (To the Nightingale), Odë mbi urnën greke (Ode on a Grecian Urn), Odë vjeshtës (Ode to Autumn).

John Keats

ODË SAKSISË GREKE

Ti ende nuse e parrëmbyer e heshtjes,
 Ti fëmijë i gjetur që kurrë s'të bëhet vonë,
 Historiani Silvan s'e shpjegon përmes shprehjes
 Përrallën e stolisur më ëmbël se rima jonë;
 Çfarë legjende në gjethe mbështjellë n'ty është
 mbytur
 Për hyjnitë apo të vdekshmit, apo të të dype,
 Në Tempe apo n'luginat e Arkadisë?
 Ç'njerëz a' perendi janë këta? Ç'dëshirë e nuseve?
 Çfarë ndjekjeje? Ç'kacafytje për të ikur?
 Çfarë fyej e daulle? Ekstazë e çmendisë?

II

Meloditë e dëgjuaara janë t'ëmbëla, por t'padëgjuarat
 Janë më t'ëmbëla; prandaj, fyej të ëmbël, luani,
 Jo veshin e ndjeshëm, por, me të dashuruarat
 Këngëzat shpirtërore që s'kanë zë i thuani
 Rini e bukur nën pemë, ti s'e ke braktisur, jo,
 Këngën tënde, e ato pemë s'do të zhvishen kurrë;
 Dashnori trim, asnjëherë s'e puth dot,
 Ndonëse afër cakut - por, mos u anko;
 Ajo s'do të tretet, edhe pse s'ke lumturi të plotë
 Gjithmonë do ta dashurosh, e ajo mbetet e bukur!

III

Ah, të lumturat degë! asgjë s'mund t'i derdh
 Gjethet tua, Pranverës lamtumirë kurrë s'i thonë;
 Dhe, muzikitari i lumtur që pa pra bredh,

Gjithmonë këndon, këngë të reja gjithmonë;
 Më shumë dashuri të lumtur! më shumë të gëzuar!
 Përjetë të ngrohtë dhe ende për t'u shijuar,
 Përjetë pulçitëse, dhe e re përjetë;
 Mbi epshet njerëzore moti lartësuar,
 Që e lënë zemrën n'pikëllim – copëtuar,
 Gjuhën e përtharë, ballin – flakë të nxehtë.

IV

Kush është ai që me kurban nxiton?
 Kah cili altar i gjelbërt, O prift i trallisur
 E çon mëshqerrën që kah qielli gjëmon,
 Brinjë të saj t' mëndafshët me kurorë stolisur?
 Cila qytezë pranë lumit a detit, n'vendet e nxehta,
 Apo skaj bjeshkës – në fortesë shndërruar,
 N'këtë mëngjes t'përshpirtshëm askund grua o burrë?
 Dhe qytezë, rrugët tua përherë si vdekje të qeta
 Do mbeten; dhe asnjëri për të treguar
 Pse je e shkretëruar, pse njerëzit s'kthehen kurrë.

V

O formë Atike! Qëndrim i Bukurisë! me turmën
 E burrave t'mermertë dhe nusët e stërbukura,
 Me degë të pyllit dhe barishtet e shkelura;
 Ti, formë e qetë, na e ngacmon mendjen
 Siç bën amshimi: Pastoralë e Ftohtë!
 Kur koha ta ketë shuar timen gjeneratë,
 Ti do të mbetesh, n'mjerimin e hidhur,
 Mik i njeriut, t'cilit i pëshpërit,
 “Bukuria ishte e vërteta, e vërteta bukuri”- kjo është krejt
 Çfarë dini mbi tokë, dhe krejt çfarë duhet ditur.

“Odë saksisë greke” është ndër më të bukurat poezi, jo vetëm të Kitsit. Është ideali antik që i ka frymëzuar pashkëputshëm romantikët. Vazoja është një simbol. Ajo e shpreh bukurinë e mjeshtërisë dhe të artit. Vijat e formës së vazos dhe piktura mbi të, janë një sinkretizëm e mrekullueshëm arti. Kitsi ka bredhur nëpër pamjet e pikturuara duke përfshirë në vija të përmbledhura dhe shumë të efektshme pamjet e jetës

antike dhe konceptin romantik mbi idealin e së bukurës. Në momente oda na e përkujton teknikën e poezisë së Homerit për mburojën e Akilit.

Romantizmi ka dhënë një varg poetësh të mëdhenj në poezinë gjermane. Në fillim të kësaj periudhe qëndron poezia e Getes, një poezi e përtëjkohshme, porsit e Dantes ose Homerit. Është gjithë mrekullia poetike e artit e derdhur në vargjet e Faustit, mitit gjerman të përjetësisë, njohjes dhe të artit, por edhe në lirikën e jashtëzakonshme të poetit që kishte krijuar një unvers poetik në botën e lirikës. Tek ai tashmë mund të hetohen shumë prej vlerave të cilat në poezinë romantike do të përbëjnë esencën e artistikes. Mbi të gjitha, Gëtë është përsosmërisht brenda poezisë klasikiste si formë, krijimi i tij është i përkryer, është porsit guri i çmuar të cilin e shohim vetëm të skalitur; mirëpo në esencën e poezisë së tij ndihet vlimi i gjenit, edhe i atij të ardhshmit, gjenit romantik për të cilin përsosmëria nuk është më vlerë. Për romantizmin është vlerë gjeniu i natyrshëm, poezia që nuk pyet për gabimin. Getë është aq i fuqishëm si poet sa në poezinë e tij bashkëjetojnë e përsosura dhe e natyrshmeja, në poezinë e tij ende bashkëjetojnë e bukura klasike, poezia e kultivuar dhe e latuar sipas mjeshtërisë së lashtë, dhe poezia nën të cilën vlon e do të shpërthejë një forcë e re njerëzore, e re dhe e egër, që nuk pyet për imtësira artistike dhe mesazhet e veta dëshiron t'i përcjellë të forta e të ashpërta, që me forcën e vet dëshiron të rëmbejë e të lëvizë përpara botën; kjo është ajo *Sturm und Drang*:

Johan Wolfgang Göte

KËNGËTARI

“Te porta jashtë ç’po bëhet ashtu,
Ç’është ajo këngë, vallë!
Pa shkoni vrap – e dua këtu,
Le ta dëgjojmë në sallë!”

“Ju përshëndes të gjithë sa jeni,
Fisnik e dama, mbushur me inxhi!
Si yje qenki, por më ndjeni
Që emrat s’jua di!
Në këtë vend që s’ka të dytë
Do bëj më mirë t’i mbyll sytë,
Sesa t’i zgurdulloj.”

Dhe këngëtari sytë i fiku,
 Me harpë këngën e filloi;
 I ndriti syri çdo kreshniku
 E damat malli i pushtoi.
 Dhe mbretit vetë zemra iu shkri,
 E një gjerdan safi flori
 Dësh plakut t'ia blatonte.

“Ah, mos ma jep mua gjerdanin,
 Por jepjua trimave që ke!
 Ata tmerr janë për dushmanin,
 Kur sulen si rrufe!
 Ose ta marrë kancelari,
 Ta mbajë si një barrë ari,
 Tok me të tjera barrë.

Se unë jam si zog i lirë
 dhe si ai këndoj.
 Mbi këngën që më del e dëlirë
 Tjetër shpërblim s'lakmoj!...
 Por ti, në daç, më shtjer sapak
 Nga vera jote kuq si gjak
 Në kupë prej floriri!”
 Dhe plaku kupën çoi në buzë
 Dhe ëndjeplot e zbrazi,
 Dhe piu zjarr e flakë e shpuzë
 Me shpirtin afsh nga gazi! –
 “Ju përshëndes – dhe më kujtoni!
 Ju falënderoj - dhe, po të doni,
 Mbajeni mend, ç'ju thashë!”

Në përgjithësi është mjaft vështirë të veçohet ajo që është poezi e romantizmit në poezinë gjermane, për shkak të veprës së fuqishme të Gëtës, por edhe të krijuesve të tjerë iluministo-klasicist, të cilët i paraprijnë; mirëpo duhet përmendur aforizmat poetikë si dhe ciklin e poezive Hymne të natës të romantikut Novalis, i cili poezinë e sheh si krijimtari shpirtërore përkundër konceptit klasik e klasicist të poezisë si imitim i natyrës. Poezia e hymneve të Novalisit shënon një thellim kah një poezi magjike përplot motive ekzoterike. Poezia e tij me program është një poezi ëndrrash e halucinacionesh poetike që do të zhvillohet

më vonë në tipin e poezisë hermetike evropiane dhe në atë të simbolizmit. Topika themelore e përkufizuese e poezisë së Hymneve të natës është nata, misterioziteti i së cilës përcakton raportin ndaj gjërave si variacion të shpërndërimeve të natyrshme të gjendjes së qenies, duke u afruar kështu me panteizmin mistik të Lindjes, kurse përfundimisht në krijimet e mbrema të hymneve Novalisi shpreh koncepte poetike të mistikës religjioze të krishterë. “Nuk duhet të imitohet në asnjë mënyrë natyra. Poezia është përnjëmend e kundërta e saj.”- thotë ai. Shumë - shumë, për romantikët natyra mund të përdoret si alegori. Kjo nënkupton poezinë në të cilën shprehen ndjenja të fuqishme që kufizohen me të papërshkrueshmen, madje shpreh thellësinë që romantikët e përcaktojnë si “pafundësi”. Tek e fundit romantikët janë ata që e zhdukin thjesht kuptimin poetik të ambientit lokal, ata nuk qëndrojnë në hapësirën e ngushtë të ambientit të njohur; gjakimi i tyre jetësor e poetik ik drejt viseve të largëta e të panjohura në të cilat me fuqinë e mrekullueshme të imagjinatës bëjnë projeksionin e tyre poetik që i përngjet një shkrimi të egër, të pakontrolluar dhe ndonjëherë të tipit të ndërrijes. Një ambicie e tillë poetike nuk mund të realizohet me mjete tradicionale të shprehjes poetike, kështu që romantikët preferojnë qoftë edhe mospërsosshmërinë e formës, poezinë me të meta, gjenialitetin e pagdhendur, në vend të latimit të stërhollë prej mjeshtri të artistit të dikurshëm, bukurinë e rregullës që ishte ideal i klasicizmit. Për këtë arsye poetët e romantizmit e përdorin me të madhe figurën e papërcaktuar të ironisë dhe të alegorisë, e cila për Novalisin më tepër i afrohet simbolit

Kuptimi më i fuqishëm poetik del nga përdorimi ironik i fjalës dhe i kuptimeve, gjë që e bën poezinë romantike të jetë përtej kuptimeve të llojit e gjinisë letrare. Për konceptin e kohës kjo është thjesht “poezi moderne”. Njëri ndër teoricientët e mëdhenj të romantizmit gjerman do ta përcaktojë poezinë e kohës si: “Poezia romantike është poezi përparimtare univerzale. Ajo nuk synon vetëm të bashkojë në një të gjitha gjinitë e ndara të poezisë, duke e lidhur krahas kësaj poezinë me filozofinë dhe retorikën. Qëllim dhe nevojë e saj është t’i përziejë, ose së paku t’i shkrijë, poezinë dhe prozën, gjenialitetin dhe kritikën.”(F. Shlegeli: Athen-aum).

Duket ngapakpak paradoksale, mirëpo romantizmi ka krijuar shpesh një poezi të fuqishme sociale, edhe pse në thelb gjeniu romantik nuk i ka pëlqyer të mirret me plagët shoqërore. Vizioni i tij mbi botën s’ka shumë hapësirë për këtë plagë njerëzore, mirëpo ajo pamje krijohet si hije në pasqyrën përkundraill.

Tjetër është poezia atdhetare. Këtu poezia romantike do të këndoje me gjithë fuqinë e mjeshtërinë e vet, megjithëse jo rrallë poeti e ndjen vetën njeri planeti. Vendi i vetëm ku ai me dëshirë nuk do të qëndronte është qyteti, mirëpo atdheu është streha e fundit, ose edhe fillimi i të gjithave.

Friedrich Hölderlin

VDEKJA PËR ATDHE

Ja që erdhe betejë! Tashmë trimat po zdirgjen
kodrave valë-valë për në fushë po zdirgjen,
pllajë që mbushet bujë nga vrasës të pashëm,
me duar të shkathta dhe me vrullin plot

shkrihet në ta i të rinjve shpirti;
të shtënat e të drejtëve bien magjike
dhe këngët e tyre ushtojnë patriotike,
trathtarëve gjunjë u ngrijnë.

O, merrmëni, merrmëni dhe mua në rradhë,
kam frikë një ditë dek'e zezë do më marrë!
Të ngordh nuk dua pa dobi të vatanit,
të vdes më pëlqen në log të mejdanit.

Për atdhe gjakun ta derdh pikë e për pikë,
për mëmëdhenë, kështu do të jetë! Te ju po vij
o të shtrenjtë, te ju që më mësuat
jetën dhe vdekjen, ja tek po zbres.
Saherë në diell digjesha t'ju shoh,
trima, po dhe ju poetë të motit tjetër!
Pra, shëndet si mikut t'i ktheni
një të huaji, do t'jemi vëllezër.

Dhe kasnecët e fitores tek po na vijnë, dita
është jona! Jeto në dritë, lart o atdhe,
të vdekurit mos i njeh! Për ty
i dashur, s'ra kush kurrë i tepër.

Gjergj Fishta

SHQYPNISË

T'falem, Shqypni, ti shpirtit t'em dishiri!
 I lum njimend jam un n'gji t'and tue rrnue,
 Tue gzue t' pamt' t' and, tue t'hjekë atë ajr t'kullue,
 Si Leka i Madhi e Skanderbegu i biri
 Kje i Lumi vetë, qi mue m'dergoi ksi hiri
 Per nen qiellë t' ande t' kthielltë un me u perftue,
 Malet e hjedhta e t'blerta me shikjue,
 Ku Shqypja e Burrit s'dron se i qaset niri.
 Ktu trima léjn gjithmonë, pse ti je nâna
 E armvet n' zâ, qi shndrisin duerët e t' lumit,
 Kah des për ty i rrebtë e trim si Zâna.
 Ende n' Ballkan ti je; ti prej t' Amshu'mit
 N'Ballkan jë shkruë Mbretneshë mbi fiset t' tana:
 Hyp fronin, pra, e sundo, Shqypni, m' t' liru'mit.

Mrizi i zanavet, 1907

Një pjesë e poetëve romantikë kanë qenë luftëtarë të mëdhenjë për krijimin e shteteve nacionale në Evropë. Le të na kujtohet Xh. G. Bajroni i cili luftoi për çlirimin e Greqisë, ose Xh. Leopardi që ka shkruar një poemë të famshme me titull Italia, e cila mbetet ndër krijimet më të bukura që dikush ia ka kënduar vendit të vet.

Edhe poeti ynë, Pashko Vasa, ka luftuar për bashkimin e Italisë si oficer. Gjithë në frymën e romantizmit, poeti anglez, Alfred Lord Tennyson që ka jetuar në periudhën e romantizmit dhe të poezisë së pasromantizmit, ka lënë disa vargje të krijuar nga frymëzimi duke i shikuar pikurat e Eduard Lirit:

Alfred Lord Tennyson

PËGJIGJE EDUARD LIRIT
 PËR UDHËTIMET E TIJ...

Kumbojnë pyjet iliriane,
 një xham ujëvare dritat shkund,

si vend hyjnor kjo grykë Peniane
dhe Vetëtima – mur pa fund.

Tomorr e Athos, fron magjie,
vjen hije largët gjer tek ne;
një laps e një penel i bie;
e ndiej si t'isha vet atje.

Kur shoh peizazhet, jam pranë teje
atje ku dheu klasik ngadhënjën;
gëzimi rritet brenda meje
dhe kohë të arta shpirti gjen.
Rrëkeja rrjedh e ndrit mes pllajës
atje-këtu, për mua flet;
gjymtyrë hyjnish, zëri i Najadës
në enë burimesh hedhur shpejt.

Kolona shpellash gjysmëhijet
mbi supe derdhin si mister;
ndër ujëra vjollca ulet, ngrihet,
një shpat me lule jep e merr.

Atje livadhi rrit kopetë,
vallëzon përroi kristalor.
Ti ulur mbi një shkëmb të sertë,
me fyell zgjon detin mëngjezor.

Poezia e romantizmit përkon me formimin e kombeve dhe shteteve nacionale në kuptimin që e kemi edhe sot, andej tema e atdheut është njëra nga temat produktive, të cilës poetët i kthehen shpesh në krijimet e tyre. Por romantikët në përgjithësi kanë qenë në anën e popujve liridashës, falë kësaj kanë mbetur disa nga poezitë më të bukura për shqiptarët, shkruar nga pena e poetëve evropianë.

RECENSION

Muhamet Hamiti: *Bota letrare*,
bot. ASHAK, Prishtinë, 2024

1. Autori

Prof.dr.Muhamet Hamiti (1964) është Profesor i Letërsisë angleze dhe amerikane, si dhe i Teorive letrare, në Fakultetin e Filologjisë. Po ashtu, Senator në Universitetin e Prishtinës.

Ka kryer studimet për Gjuhë dhe Letërsi angleze në Universitetin e Prishtinës, pastaj Studimet Pasuniversitare për Letërsi të Përgjithshme, me fokus në letërsinë angleze, në Universitetin e Zagrebit (Kroaci) dhe ka doktoruar për Prozën e Joseph Conrad-it dhe të James Joyce-it, me përqëndrim në analizën narratologjike dhe hermeneutike, në Universitetin e Prishtinës.

Muhamet Hamiti është autor i katër librave studimorë, *Aspekte të romanit të E. M. Forsterit* (1991) *Proza moderne* (2016), *Besimi letrar* (2016) dhe *Teori dhe kritikë letrare angleze* (2022) si dhe i një numri të madh të artikujve për letërsinë shqipe, angleze dhe të përbotshme, të botuara në revista vendëse dhe ndërkombëtare të indeksuara në platformat kryesore shkencore.

Po ashtu, ka ligjëruar në Universitetin Humboldt në Berlin, në Universitetin Fechtta, si dhe, nëpërmjet një programi të ndihmuar nga Ambasada e SHBA-ve, në Dartmouth College në SHBA.

2. Analizë strukturore e dorëshkrimit të veprës studimore

Dorëshkrimi i veprës studimore të Prof. dr. Muhamet Hamitit me titull *Bota letrare* ka 448 faqe, në kuadër të së cilit hyjnë Parathënia, Katër kapitujt apo shtyllat fenomenologjike, teorike letrare e analitike të veprës, të emërtuar: I. Përgjithësime, II. Letërsi angleze, III. Letërsi botërore, IV. Letërsi shqipe, si dhe Përmbyllja.

Kjo strukturë e menduar, në këtë vepër, sugjeron konceptimin e botës letrare si *fenomenologji, letërsi nacionale* dhe *letërsi e përgjithshme*, duke indikuar kështu mundësinë e leximit invers, ta zëmë nga *Letërsia shqipe* deri te *Përgjithësimet* apo anasjelltas.

Mirëpo, duke respektuar rendin struktural autorial, venerojmë se te *Kapitulli I. Përgjithësime*, janë fenomenet klasike ideore si *koha*,

kombi, identitarja dhe religjiozja ato që vihen në thjerrëzën e vrojtimit filozofik, teorik e analitik në raport me *differentia specifica*-n letrare.

Në tekstin *Koha në letërsi*, ndërtohet tipologjia metafizike e Kohës si abstraksion, kohës si eternitet, kohës si hapësirë, kohës si ciklikë, kohës si linearitet, etj., gjithnjë mbi bazë të diskutimeve filozofike-letrare që nisen nga Platoni, Aristoteli, Shën Augustini, Hajdegeri e deri te Joseph H. Milleri, por poashtu gjithnjë në përthyerjen e saj në kohën e letërsisë ku vërehet koha si *rrjedhë e ndërrijes* (Tomas Man e Marsel Prust), koha si *ciklikë-rrethore* (Markez) koha si *alegori e temporalitet* (Fokner), koha si *shenjë e mileut* (Shekspir) e deri te koha si *formë e lëndë metafizike jetësore* (Borhes). Temporaliteti dhe universaliteti i Kohës do të vrojtohet si *logos* i të gjithë këtyre autorëve klasikë ku krijohet bota letrare si *refleksion* apo si *strategji narrative*.

Në tekstin *Letërsia dhe kombi*, vihet në fokus funksioni utilitar i letërsisë në raport me universalen humane dhe traditën etnike, kryesisht si debat i dualitetit *letërsi e përgjithshme* (Göte) dhe *letërsi nacionale si udhë drejt letërsisë së përgjithshme* (Xhojsi), koncepte këto që lidhen kryesisht me konceptimin e letërsisë kombëtare. Mirëpo, çfarë bëhet kur letërsia kombëtare, duke ruajtur traditën, përballet me formimin e shtetit të ri siç është Kosova, ku domosdo jetësohet parimi: kombi është shteti?!

Si rrjedhojë në këtë tekst do të përplasen teoritë klasike për kombin mbi bazë *mitin nacional* (Anthony D. Smith), dhe për *kombin si sferë imagjinare* (Benedikt Anderson) etj., gjithnjë duke ruajtur konceptin për udhën autonome të evolucionit letrar, por duke u përmbyllur me *apori* filozofike, për të vijuar si preokupim edhe te teksti *Letërsia dhe identiteti*.

Në këtë tekst problematizohet qenësia *autotelike* e letërsisë, në raport me fenomenin e identitetit, ky i fundit nocion i vagullt e poashtu ontologjikisht jostabil. Pikëpyetjet themelore: identiteti letrar apo identiteti i letërsisë? Identiteti letrar si ligjësi specifike, agon, ankth i ndikimit apo dialogjikë, pra evolucion i formave dhe identiteti i letërsisë si kujtesë e rikujtesë mito-poetike etnike-nacionale apo edhe si identifikim me toposin e saj. Kjo dihotomi, për autorin Muhamet Hamiti, ndërton një raport të ndërliqshëm me vetë objektin letrar, pra *vetë-identifikimin*, dhe shembull i tij është *Iliada* e Homerit, e cila duke qenë vepër themel e kulturës perëndimore, mundëson konceptin e vetë-identifikimit identitar të njëkohshëm si të akejve poashtu edhe të trojanëve. Si rrjedhojë, Muhamet Hamiti vërën se fenomeni i tillë kap edhe letërsinë shqipe, ku ta zëmë vepra e Ismail Kadaresë dhe e Sabri Hamitit

për aq sa ruajnë identitetin letrar, po aq posedojnë identitetin albanistik, si mit, kujtesë e topos.

Besimi fetar dhe besimi letrar është teksti vijues e përmbyllës i këtij Kapitulli, ku autori ndërton lakoren e ndërndikimit religjon/letërsi si evolucion poetik-historik. Pra, sipas Hamitit, del se poezia (letërsia) nisët së bashku me religjiozitetin, mëpastaj diferencohet në raport intertekstual me të, për t'u shndërruar në modernitet në religjion në vetvete, por gjithnjë duke e ruajtur raportin imanent simbiotik-ndërndikues me të. Në këtë tekst gërshetohen mendimet filozofike-letrare të Frajzerit, Arnoldit, Eliotit, Frajit, Bruksit, etj., për t'u përmbyllur me hetimin dhe eksplikimin e fenomenit të botës religjioze në botën e letërsisë botërore e shqipe me autorët Milton, Xhojs, Dostojevski, Borhes, Sabri Hamiti e Zejnullah Rrahmani.

Ndërsa, në kapitullin *II. Letërsi angleze*, autori Muhamet Hamiti nis diskutimin sa i përket konceptit të *shkrimit* dhe të *rishkrimit* të historisë së letërsisë dhe merr për model lakoren evolutive të *rishkrimit* të historisë së letërsisë angleze. Duke i trajtuar kronologjikisht tipet e *Historive të letërsisë Angleze të Kembrixhit*, Muhamet Hamiti shpërfaq evolucionin e koncepteve të klasifikimit letrar, hapësirave globale të shkrimit të letërsisë dhe kulturës angleze për të dëshmuar transformimet e formave letrare në kulturën angleze, e poashtu 'rrudhjen' gjeografike, të cilat kanë diktuar shkrimin dhe rishkrimin e formave më diferencuese e më eksplicite të historisë së letërsisë angleze.

Pra, në tekstin *Evolucioni i historisë letrare angleze*, Muhamet Hamiti analizon imanencën transformuese të historishkrimit, madje në mënyrë implicite teksti mund të merret edhe si sugjerim për kulturat e tjera, të cilat ngulmojnë në statikën e historisë letrare.

Në vijim të këtij Kapitulli, Muhamet Hamiti, mbi konceptet për klasikën se është kanoni letrar që na formon ne në përhershmëri, nis shkrimet teorizuese-analizuese dhe kahasimtare për autorët e kanonit letrar anglez, në kuptimin e nocionit që i jep Harold Bllumi, pra për Shekspirin, Bajronin, Konradin dhe Forsterin.

Shekspiri do të vrojtohet si *shkrimtari i parë universal*, do të analizohet fenomeni i transformimit të formave letrare, koncepti i intertekstualitetit dhe "i ankthit të ndikimit", por edhe përhershmëria e veprës së tij në kulturën letrare botërore, si rrjedhojë edhe historia e perceptimit të veprës së tij në kulturën shqiptare.

Bajroni, *romantiku anglez* do të analizohet kryesisht te vepra e tij *Çajld Haroldi*, për pasionin, talentin dhe kryengritjen e personazhit

auto-ideografik, gjithsesi konform konceptit romantik të udhës ekzotike, e cila do ta ndeshë autorin anglez edhe me shqiptarët. Dhe, njohja me kulturën autentike shqiptare, e cila do të reflektohet në vargjet e tij si nderim për Skënderbeun, Ali Pashën (Bonaparten muhamedan), veshjen tradicionale (kujto portretin e Bajronit), do të bëhen vetëm pikënisje për të analizuar *paratekstet shpjeguese* për shqiptarët, të cilat Muhamet Hamiti i sheh tepër domethënëse në dy funksione: gjenetikë e veprës letrare, por edhe njohje e botës angleze me shqiptarët si miqësi kulturore.

Konradi, autori *impresionist-modernist* polako-britanik, do të analizohet me romanin e tij *Zemra e errësirës*, qoftë për dialogjikën e botëve ‘civilizuese’ e ‘primitive’, qoftë për impulset e brendshme të qenies njerëzore, nëpërmjet personazheve Malrou e Kërci, qoftë për strategjitë komplekse narrative, të cilat lidhen thuajse në një pikë qendrore botkuptimore të autorit se shkrimi i romanit duhet të jetë krijim i një bote të veçantë letrare si kundërpeshë e mimetikes klasike narrative.

Forsteri, autori *simbolist-humanist* i kohës eduardiane, do të analizohet me romanin e tij *Shtegtimi në Indi*, ku Hamiti do të fokusojë përthyerjet narrative, integrimin e simbolikave kulturore perëndimore e lindore, zërin humanist të autorit, baraspeshën e civilizimeve dhe të gjitha këto të realizura në rrjetin e ambiguitetit zhanror, në kuptim të krijimit të romanit me tipare poezie. Poezia romanësore e Forsterit do të bëhet dëshmi artistike e kaosit primordial të qenies njerëzore, i cili bëhet imanencë e pranimit dhe e komunikimit ndërkulturor si një rend human, rend i respektimit të civilizimeve të ndryshme.

Kapitulli III. Letërsia botërore, do të jetë zgjatim i kapitullit paraprak, por duke ruajtur mendimin se autorët e trajtuar në *Kapitullin II*, domosdo ruajnë tharmin e identitetit, pra kanonit anglez, gjithnjë me vetëdijen se ata poashtu tashmë janë klasikë e letërsisë së përgjithshme.

Është me Danten që e nis këtë kapitull, me veprën e tij *Komedia Hyjnore*, ku Muhamet Hamiti shpjegon në përgjithësi kulturalitetin dantesk, në kuptim të krijimit dhe të ndikimit në botën letrare universale, por ndalet te *Kënga III*, me intencën e venerimit të fenomenit të pavendosmërisë, *neutralitetit*, shpërfilljes e mosmarrjes përgjegjësi shoqërore nga ana e intelektualit, neutraliteti i cili e rrezikon më pastaj bërthamën e rendit etik njerëzor.

Pra, Danteja i Muhamet Hamitit riaktualizohet si thirrje kundër së keqes, të cilën, nëse intelektualit nuk arrin ta ndalojë së paku të mos bëhet pjesë e saj, duke qëndruar në *hajatin e Ferrit*.

Në vijim, *Uliksi* i Xhojsit irlandez, do të analizohet mbi filozofinë ciklike të rrathëve narrative, në të cilët do të shtresohet shumëzëshmëria e kulturave, simboleve dhe intencave të tipizuara individuale njerëzore, duke e inventuar tashmë konceptin global të tipit të shkrimit si *rrjedhë e ndërdijes*, pra prozës mendimtare si krijesë e një bote letrare biblike, kjo e fundit në kuptimin e *biblës letrare* si *libër i librave*.

Dhe, duke mos u shkëputur nga bota letrare irlandeze, Muhamet Hamiti analizon autorin, të themi antipod të Xhojsit, Shejmës Hinin, veprat e tij eseistike e letrare në të cilat dominon figura e jetës dhe e identitetit irlandez, gjithnjë i vënë në raport të ndërliqshëm me atë britanik. Shejmës Hini do të shihet si autor i *humusit irlandez* kryesisht me veprat *Njëmbëdhjetë poezi* dhe *Vdekja e natyralistit*, në të cilat autenticitetin e konceptimit letrar të autorit, si çlirim nga jashtësia dhe shpërthim i së brendshmes, i autenticitetit të trashëgimisë shpirtërore irlandeze, por edhe i situatave të ndërliqshme shoqërore e dhuron, të themi, për republikën e përbotshme të letrave.

Në kuadër të këtij Kapitulli kemi poashtu edhe tekstet fenomenologjike: *tema e luftës dhe e paqes* në letërsi, e cila pëcillet në rrafsh historik-poetik, madje e shqyrtuar ngusht në raportin e *letërsisë me politikën* ku diskutohen filozofitë antike (Platoni e Aristoteli) për të dalë te veprat e Homerit, Virgjilit, Dantes, Petrarkës, Miltonit etj., me përqëndrim në konceptin vetëidentifikimit letrar, dominancave të autoritetit dhe imanencave humane.

Në këtë udhë do të trajtohet edhe koncepti i së keqes, barbarit e barbarisë në veprat e Kavafit, Kucies e Hamitit, autorë të cilët në variante pozicionohen si mohues të harresës dhe mbrojtës letrarë të kujtesës, qoftë ajo nacionale, qoftë humane universale. Ndërsa, si këpujë e shpërndërrimeve identitare të kohës sonë, do të analizohet edhe proza bashkëkohore e Pajtim Statovcit, e cila në synimin e saj transnacional, ngërthen në vetvete krizat e individit të vënë në procesin e pandalshëm të tëhuajësimit.

Dhe nëpërmjet këtij teksti dalim te *Kapitulli IV. Letërsia shqipe*, ku gradualisht ndërtohet një korpus studimesh (nëntë tekste), në të cilat, me gjithë diferencimet studimore, vërejmë se një preokupuese e autorit të studimit është letërsia shqipe e Kosovës, e cila venerohet mbi bazë të kushtëzimeve ideologjike, politike, ndërkomunikuese me letërsinë nacionale shqipe, këto të fundit sidomos të forcuara dhe të sforcuara gjatë shekullit 20.

Nga se u tha, shkurtazi, më lart mund të përvijojmë këtë:

3. Vlerësim

Dorëshkrimi i veprës së Prof. dr. Muhamet Hamitit me titull *Bota letrare* është një studim filozofik-teorik, analizues-hermeneutik, krahasues e vlerësues e mbi të gjitha insistues në shpjegimin e ligjësive specifike të botës letrare, gjithnjë të kundruara në ndeshje me botët e jashtme, qofshin ato ideore, ideologjike, politike apo identitare.

Mund të themi se kjo vepër është kurorë e deritashme studimore e këtij autori.

Si rrjedhojë, në këtë libër, kemi debate e argumentime, vlerësime e pozicionime, rivlerësime e riaktualizime të traditës filozofike, të veprave të kanonit perëndimor dhe të spektrit të tyre të ndikimit në kulturat e tyre burimore, por edhe në civilizimin letrar botëror, si rrjedhojë si spektër i ndikimit në kulturën dhe në letërsinë shqipe.

Muhamet Hamiti, ndër të jerash, në këtë vepër merret me tema të rënda, siç janë: literariteti e identiteti, religjiozja e religjioni në literaturë, historia letrare e klasikët e letërsisë, evolucioni letrar, bota misterioze poetike e narrative e autorëve të kanonit anglo-sakson si dhe të kanonit perëndimor, pastaj ndërliidhet me diskutimet për dualitetin e traditës në raport me presionin e së resë ideologjike, politike e globaliste, për të vijuar me analiza konceptuale të letërsisë shqipe, të cilat dëshmojnë një lexim të mprehtë të klasikës letrare dhe të produksionit letrar shqiptar.

Kështu që, intencionalisht, Muhamet Hamiti, kur shkruan për autorët e veprat e mëdha të kanonit perëndimor, mendjen e ka të ndikimi i tyre në botën specifike letrare, e cila do të duhej ta tangjentonte edhe kulturën shqipe. *Dulce et utile* e tij mbetet vizioni për njohje të modeleve të forta artistike, të cilat nëpërmjet procesit të autentizimit do të shndërroheshin në kulturë letrare shqiptare.

Prandaj, në cilësinë e recensentëve të dorëshkrimit-librit, kemi kenaqësinë të propozojmë vijimin e procedurave përkatëse për botimin e kësaj vepre të vlefshme për botën studimore shqiptare.

Prishtinë, 24 nëntor 2023

Zejnullah Rrahmani
Nysret Krasniqi

DOKUMENT

Kristo Floqi

QÉRTHULLI POLITIK

Dr. Kristo Floqi.

Qërthulli Politik

Operettë në 4 akte.

TIRANË,
Shtypshkronja "Tirana",
1922.

Ministria e P. të Mbrendshme.

Nr. 8287 Pgj.

Seksjon 1. Nr. 762.

QARKORE

PREFEKTURAVE

SHKURTIM:

Mbi operetën
 “Qérthulli Potitik”,
 i Dr. Kristo Floqit.

Në Shqypni tue qënë se shtypi asht
 i lirë, QERTHULLI POLITIK, operettë
 origjinale në katër akte, e bamë prej
 ish-Ministrit të Arësimit DR. KRISTO
 FLOQIT nuk pengohet qi të botohet
 dhe për këtë shkak nga ana e kësaj
 Ministerije i jepet lëje për me e çfaqë
 në për theatrat e Shqypnlsë.

Ministri i P. të Mbrendshme,

A. ZOGU. d. v.

Tiranë më 31-V-922.

Vërtetohet njësjja me origjinalin.

Sekretri i I. i M. P. M.

IZEDDIN BESHIRI.

Dr. Kristo Floqi.

Qérthulli Politik

(Rivistë satyrike)

Operetë në 4 akte.



TIRANË,
Shtypshkronja "Tirana",
1922.

Këjo vepre është e ndaluar të çfaqet në sqenën teatrore pa lejen e autorit.

Ç'do kopje sjell edhe nënshkrimin t' em. Ato që s' kanë nënshkrim quhen si vjedhje shtypi dhe vepruësit ndëshkohen mbas ligjës penale.

Qérthulli Politik.

Akt I.

Assemblesistët.

FYTYRAT

FILIPI

RAGIPI

TAIPI

DALIPI

ish-deputetë.

SQENA I.

FILIPI.

A e patë se ç'n'a punuan?

TË TJERËT.

Si, pa n'a thuaj?

FILIPI.

E dijni programin që çpalli Ilias Vrioni. Aju ka thënë se vinte në fuqi si një qeveri e përkohëshme, e kështu u shpërndâ Parlamenti, edhe pa dyshim mbas të shpërndarit e Parlamentit duhet të bëheshe një asamblee konstituante. Po tani?

TË TJERËT.

Tani?

FILIPI.

Çpalli një ligje të re për zgjedhjet e deputetëvev! Ju, si e gjukoni këtë gjë? Nuk ju duket se n'a u shkel statuti i Lushnjës,

4

i cili flet qarisht se, në qoftë se shpërndahet Parlamenti, lipset do e mos të bëhet assembleja, se ndryshe Parlamenti duhesh të vijonte gjer sa të vinte mbreti? Si e shihni ?

RAGIPI.

Ke të drejtë.

TAIPI.

Jam edhe unë me mendjen t'uaj.

DALIPI.

Edhe unë.

FILIPI

Ahere kemi të drejtë ne t'a kërkojmë assemblenë?

TË TJERËT.

Po. po.

FILIPI.

Për ne sot është një shpetim assembleja.

TË TJERËT.

Tamam e ke.

FILIPI.

Do t'i lemë kështu të bëjnë si të duan?

TË TJERËT

Jo, kurrë!

RAGIPI.

Do të protestojmë.

DALIPI

Unë, po të doni mbanj edhe një fjalë për mbi këtë.

TAIPI.

Shumë mirë do bësh.

FILIPI.

S'ke frikë se të pëlcastin haps?

DALIPI.

Edhe më mirë. Ahere më bini nga një paqetë duan ditën ju lutem. (Qeshin).

FILIPI.

A je pak orator?

DALIPI.

Sa të duash. Unë do të flas një herë, pa le të dalë ujë. I mbyturi nuk trembet nga shiu.

TË GJITHË.

Të lumtë!

Këng' e Assemblesistevet.

(QUARTETTO)

Assemblee, assemblee,
Ti je një shpëtim për ne,
Gjithënjë të ëndërojmë,
Nat' e ditë të kërkojmë.

S'ka Statut, s'ka Statut,
Folë, popull mos u tut,
Se për dit ty po të mjelin,
Dhe Statutin po t'a shkelin.

Duhet shpejt, duhet shpejt
Nje Statut, si na përket,
Ta trajtonjë Assembleja
Me reforma krejt të reja.

Sot e sot, sot e sot
Vendit le t'i dalim zot,
Drejtësi e jo për hatër,
Nuku duam as gjë tjatër.

Vepërim, vepërim
Lipset sot e jo dëshprim,
Mos n'a trembin bajonetat,
Mitralozat e shigjetat.

Gegëri, Toskëri,
Ti, o mëma Shqipëri,
Lype, lype Assemblenë
Dhe shtërngoje mirë frenë.

Përparim, përparim
Nuku vjen dot pa kuxim,
Patriotët e vërtetë
Këtë le t'a dfinë vetë.

Assemblee, assemblee,
Ne për ty e ti për ne,
Me ty vetëm do shpëtojmë.
Ç' do armik e protestojmë.

6

FILIPI.

Tani duhet punë.

TË TJERËT.

Po, po, duhet.

DALIPI

A e dini se n'a kanë ardhur edhe organizatorët?

RAGIPI.

Kush, drejtin, i pruri këta?

DALIPI.

Kush tjetër përveç se Qeverija? Kini harruar se e kishte edhe këtë në programin e të dhetë pikavet?

FILIPI. (Tyke qeshur).

Për njëment e ke?

DALIPI.

Po si, po si.

RAGIPI.

Po që ngaj i pruri?

DALIPI.

Do t'ja u thom, po të mos qeshni.

TË TJERËT..

Folë folë.

DALIPI.

Nga nga gjejeni vetë.

FILIPI.

Nga Franca, nga Anglja?

DALIPI.

Jo!

RAGIPI.

Nga Italia. nga Austrija?

DALIPI.

Jo, jo!

TAIPI.

Nga Gjermanija, nga Amerika?

DALIPI.

Jo, mor jo, ç'punë ke me Evrop'e me Amerikë?

FILIPI.

Po ngaj i pruri aherë? Ngaj Sudani?

DALIPI (Tyke qeshur)

Nga Af ga ni stani!

TË GJITHË (Qeshin)

Ho, ho, hooooo!

FILIPI.

Ku në drej ju rã ndër ment gjer në Afganistan!

DALIPI.

T'a merr mendja. Me aqe të holla, sa deshin të harxhonin ata, si munt t'i binin Evropjanë ose Amerikanë? Nuk thua shyqyr që u gjentnë edhe këta?

RAGIPI.

T'ju thom unë pse i prunë prej Afganistaniç. Se po t'i sillnin ngaj Evropa ose Amerika, kishin frikë se mos ju delte edhe kallaji në shesh, se do dukeshin që janë fare të pazotët.

TË TJERËT.

Mirë thua.

FILIPI

Po a janë të zotët këta të n'a organizojnë?

RAGIPI

Unë jam i kënaqur po t'n'a e bëjnë Shqipërinë një Afganistan të vogël. S'dua më tepër.

TAIPI.

Pse. aqe liksht kemi arrirë?

RAGIPI.

Duket se s'e kupëtoni mirë. Po të lutem, a ke udhë këtu? Jo! Ke

8

urra? Ke limane? Ke shëndet, ke paqllëk, ke dritë? Jo! Pastaj a ke administratë, ke arësim, drejtësi, ushtëri, a ç'ke? Apo financat për katand i? Ti s'ke gjë prej gjëje ketu brenda! Ç'më thua? Doni të gënjejnë vet-veten, se pse bëmë edhe ne një Shtet?

TAIPI.

Ke të drejtë!

DALIPI.

Vertët jemi shumë prapa.

RAGIPI.

Nuk e shihni, se Shqipëria është i vetëmi Shtet që ka mbetur ashtu si e ka krijuar Perëndija?

FILIPI.

Sa për atë ke të drejtë. Shqipëria sot është i vetëmi shëmbëll në gjithë botën në pikpamje Shteti.

RAGIPI.

Ne ishim të zotët t'i prishim edhe ato të pakta rruga e urra që n'a lanë Austriakët e Italjanët. S'ishim të zotët të rruanim as atë urrën e Matit, kur u thyen Austriakët. Po le që s'i rrojtëm dot, po s'lamë edhe lenden pa vjedhur, si edhe atë të dekovilave, se n'a lipseshin për gardhe e për qereste shtëpije!

TË GJITHË.

Sa turp i math!

DALIPI. (Po përgjon)

Dikush po vjen (Tyke verejtur). Më duket se janë Organizatorët Mprapsuni, se ata janë . . (Hyjnë Organizatorët.)

Organizatorët

FYTYRAT

ARDUGJAN
FIRDUSTAN
GJULISTAN

| Organizatorë Afganistanas.

SQENË 2.

TË PARËT EDHE ORGANIZATORËT.

Këng' e Organizatorëve.

(MONODHI, MBAS OP. GEISSA)

TË TRE ORGANIZATORËT

Prej Afganistanit vijmë në kryeqytet,
Qeverija Shqipëtare mynasip e gjet,
Organizatorë jemi, ne me të vërtet,
Shqipërinë do t'a ndreqim, do t'a bëjmë Shtet.

Juha, juha, juha, hâ
Si do të punojmë me këta,
Juha, juha, juha, hâ
Mos e marrim punën për shakâ.

Iemi të çuditur shumë si ju râ ndër ment,
E n'a suall tyke lutur gjer në këtë vent,
Duket se s'na njohin mirë, s'jemi ne të zott,
Se në vent q' "utrashëgofshin," themi "për shum-mott",

Juha, juha, juha, hâ,
Si do të punojmë me keta,
Juha, juha, juha, hâ
Mos e marrim punën për shakâ!

10

FILIP. (Organizatorëvet)

Zotërija juaj jini organiztorët e Shqipërisë?

ARDUGJAN.

Si urdhron.

FILIP.

Si ju duket Shqipërija?

FIRDUSTAN.

Si e ka krijuar vetë Zoti.

RAGIPI.

Hoqtë keq rrugës?

GJULISTAN.

Jo edhe aqe keq.

TAIPI.

Me se urdhruat prej Durrësit gjer në Tiranë?

GJULISTAN.

Gjer më një vënt arthmë me automobilin e Qeverisë, pastaj zbritmë më disa vente e përdoruam lundrën.

DALIPI.

Si lundrën?

GJULISTAN.

Nuk shkonte automobili se ishte shumë ujë e kështu muarm lundrën.

DALIPI.

Prapë shyqyr të thoni që arthtë shëndoshë.

FIRDUSTAN.

Pse, ka kuçarë ndhës?

DALIPI.

Jo, se sa për atë n'a vret Perendija po të qahemi, po vetëm desha t'ju thom që, kur niset njeriu prej Durrësit në Tiranë, duhet t'ju bënë nga një duvâ edhe Muhametit edhe Krishtit që të arrinjë shëndoshë një herë pa le të tjerat.

ARDUGJAN.

Inshallah, do të ndreqen edhe rrugët e Shqipërisë.

FILIPI.

Me inshallah e mashallah kemi kaqe vjet që durojmë, more t'ungjatë jeta, po punë s'po shofim. Kemi harxhuar kaqe miliunë për rrugë edhe prapë s'kemi gjë. Paratë i hanë rrush e kumbulla edhe as një rrugë s'kemi të saktë!

ARDUGJAN

Çuditemi si s'është përkujdesuar Qeverija!

RAGIPI.

Cila Qeveri? Ajo, është ngulur në Tiranë edhe s'e ve atë ujë në zjar as pak.

TAIPI.

I kanë bërë magji e e kanë lidhur me zinxkaira. S'lot prej Tirane si kur t'a vraç, veç se kur dalin ministrit jashtë për inspeksjone, ose për misjone.

DALIPI.

Qeverija s'ka ngë zotninj të merret me kësij punë të vogla, se gjithë ditën pret vizita edhe dikur dikur kujtohet se ka edhe detyra të tjera.

ARDUGJAN

Si, s'punojnë këta njerës? Nuk bisedojnë në këshilla?

FILIPI.

Bisedojnë shpeshherë, po vendimet mbeten vetëm të shkruar në letër edhe nga ndo njëherë flenë nënë rrogos.

FIRDUSTAN.

Nënë rrogos?

FILIPI.

Si urdhron, si urdhron, nënë rrogos. Ne Shqipëtarët jemi njerës të çuditshëm; s'n'a kini marrë vesh edhe zotrija jua.j.

ARDUGJAN

Nuk më thoni ç'jini ju?

12

FILIPi.

Jemi, ose ishim, të themi më mirë, deputetë.

RAGIPI.

Edhe kemi shumë ankime t'ju paraqitim.

ARDUGJAN.

Urdhroni. po ju dëgjojmë.

RAGIPI.

Kryeministri t'onë çpallti një ligje për sgjedhjet e deputetëve, me të cilën popullin Shqipëtar e ndan dysh, turq, d. m. thënë edhe kaurë, një e keqe kjo që s'e ka shopen në botë!

ARDUGJAN.

Si, si? Pa shpjegohi më mirë.

RAGIPI.

Ka caktuar në këtë ligje sa deputetë do dalin myslimanë edhe sa të krishterë, si kur se s'jemi Shqiptarë në të gjithë pa një ndryshim edhe barabar përpara kanunit!

FILIPi.

N'a vunë një garth përpara, sa të n'a bashkonin.

TAIPI.

N'a ndanë vëlla me vëlla!

ARDUGJAN.

A, a! Kejo nuk është gjë e mirë

FIRDUSTAN.

Po ju mos e merrni edhe aqe keq, se edhe nevoj dikur na ka ngjarë në Afganistan.

DALIPI.

Këjo s'është e mundur kurrë për në Shqipëri!

GJULISTAN.

Si urdhron, si urdhron, po krijai durim.

Këng' e Minoritëteve.

ISH-DEPUTETET.

FILIPI.

Bre, ç' n'a gjet, po n'a përçajmë,
Po n'a venë garth e mur,
Hallin t'onë nuk e qajnë
Po n'a ndajnë turq-kaur!

SË BASHKU,

Ah, minoriteti
Mjerë ç'na gjet ne,
Më keq se Dovleti,
N'a bënë rajë.

RAGIPI.

Pse kështu po n'a mundojnë,
Pse n'a ndajnë vllâ-me vllâ,
Gjithënjë n'a deshpërojnë,
Po n'a shtijen në belâ.

SË BASHKU.

Ah minoriteti,
etj. etj. etj.

TAIPI

Ç'pat me ne kjo Qeverija
Që më qafë kaq na ra.
Ah, ja sjelltë Perëndija
S' menton popull fukara..

SË BASHKU.

Ah, minoriteti,
Mjerë ç'na gjet. ne
Etj. etj. etj.

DALIPI.

Ne, që mezi u bashkuam,
Dhamë dorën me shoq shoq
E të parat i haruam,
Sot n'a ndajnë po si zoq.

SË BASHKU.

Ah, minoriteti etj.

14

ORGANIZATORET.

(bashkarisht.)

Paskan hak këta të shkretë,
 Që po thresin për bashkim,
 Këta qënkan fort gjak-nxëhte
 Edhe paskan mjaft kuxim.,

Ah, minoriteti,
 Mjerë ç'i ka gjet,
 Si Baba-Dovleti
 U ngjall tjetër Shtet.

Paska hak Europ'e gjorë,
 Që nuk njih një Shqipëri,
 Qeveris i dhënka dorë
 Që të ngjallë një Turqi.

Ah, minoriteti, etj.
 (Dalin deputetët).

Obstruksionistët.

FYTYRAT

NASI
 TASI

|
 |
 ○
 |
 |

Obstruksionistë.

SQENA 3.

ORGANIZATORËT EDHE OBSTRUKSIONISTËT.

NASI.

Zotërinj, ne nuk e pranojmë një ligje të këtillë për zgjedhjet e deputetëve.

TASI.

Do bëjmë obstruksjon.

ARDUGJAN.

Në dorë t'uaj e kini, bëni si të doni.

NASI.

Prandaj ju lutem të ndërmjetësoni pranë Qeverisë, që të ngrihet këjo ligje, ndryshe nuk marrim pjesë në zgjedhjet.

TASI.

15

Do bëjmë një qeveri më vehte me një këshillë të veçantë.

FIRDUSTAN.

Mos u nxehai kaqe fort, se do ndreqen punët.

GJULISTAN.

Këto ngjasin edhe në Afganistan.

Këng' e Obstruksionistëve.

(QUARTETTO, OPERETTA GRAN-VIA)

Shihni si n'a hypnë
Byrokratët e mbëdhenj
Shihhi si n'a shtypnë,
Sikur jemi dhi e dhenj,

Fare nuk mentohen,
Se këtu ka një liri,
E se do pendohen,
Për ç' do dhelpëri.

Obstruksionistë
Po n'a bëjnë me pahir,
Jemi pessimistë
Nuku presim një hair,

Le të mos vonojmë,
Memorandëm t'japim shpejt,
Vendin do t'a nprojmë,
Ne si n'a përket.

Ne, që tjetër herë
Vendit t'on' i dualim zot,
të Disa Jeniçerë
bot po n'a mundojnë kot,

S'kanë pak mëshirë,
Ne nuku durojmë më,
Flet kush është i lirë,
Robi nuk bën zë.

Do të marrim masa
Për një **administration**,
Se nuk çajmë drasa
Duam **descentralisation**,

Dhe memurët t'onë
Shtatë dhjet' e pes' për qint
Nj' her' e për gjithmonë
S'ka se kush n'a bint.

Duam të formojmë
Një të vogël Qeveri,
Vetë t'a sundojmë
Me një Parlament të ri,

Shtetit t'i dërgojmë
Atë pjesën q'i takon,
Nuk i kundrështojmë,
S'ka për se ankon.

Organizatorët

Kini hak të mjërë,
 Që ankohi kaqe fort
 Për ca burllotjerë
 Që ju duken por si mort,
 Kështu vepëroni
 E përpiqi për vatan,
 Se këtu nuk rroni
 Si n' Afganistan.

Edhe mos dëshprohi,
 Se nuk janë gjë këto,
 Lipset të mentohi
 Se kjo lodër ngjet ku do,
 Ne e shohim punën,
 Se kështu n'a ngjau dikur,
 Po i hothmë gunën,
 Bëmë zembrën gur!

Dhe tani qerohi
 E shpërndahi gjithëkush,
 Lahi e fërkohi
 Edhe merrni nga një dush,
 Nervat i qendroni,
 Që s'ju len' as pak rehat,
 Shtrihi e pushoni
 Gjithë kush në shtrat.

FUNT I AKTIT I.

Akt II.

Nacionalistët

FYTYRAT

LLAMBI
KOLI
SELIMI
MUSLIMI

|
|
○ Nacionalistë
|
|

SQENA 1.

NACIONALISTËT PASTAJ ORGANIZATORËT

(OP. GEISSA)

LLAMBI

Kur formoj Iljas Vrijoni kabinet
Një program e çpall me buj' e salltanet,
Tha se merrte Qeverinë
Për të mbajtur qetësinë,
Gjer të mbliidhen deputetët në kuvent,
U premtua se do bjerrë lumtëri,
Se do bënjë shumë vepra për Shqipri,
Do të ndreqë bulqësinë,
Arësimin, Gjyqësinë,
Ushtërin' edhe Financat më ç'do vent,

VALLJA

Rroft' Illjazi Kryeplaku
Se për hovardâ
Ky shok nuk ka
Se është bir oxhaku!

Zgiodhi shokë të nderuar për njëment
Njerës shkollash e të pjekur për ç'do sent,

18

Ministeri u formua
 Gjithsecili u gëzua,
 Po, mjerisht se një ministër shqip s'n'a di!
 Disa forma u vepruan me shpejti,
 Mbetnë shkrojtur veç në letër për çudi,
 Pruri Organizatorë
 Ata që ju jepte dorë
 Do n'a bëjn' Afganistanas për zili.

VALLJA

Rroft' Iljazi Kryeplaku etj. etj.

Çon misjone dit për dit pa një sebeb,
 Miqve t'tij e akrabave gjith u jep,
 Xhymertllëku s'i ka masë,
 Po dhe arka mbeti drasë
 Edhe populli i ngratë nuk di gjë.
 'Iljas beu as një këshillë nuk dëgjon.
 Bu-gjyn-jarën, që të gjitha i mbaron,
 Sa të mblidhet Parlamenti
 Do të jepet falimenti
 Po Vrijoni nuk çan kryet, as bën zë.

VALLJA

Rroft' Iljazi, kryeplaku,
 Se për hovardâ
 Ky shok nuk ka,
 Se është bir oxhaku.

LLAMBI.

Nuk u mentuat ndo një herë si do na vejë ky halli jonë?
 Kjo qeveri, me xhymertllëkun që po rëfen dita-ditën, edhe me
 misjonet e pa masta, punë pa punë, do n'a qitë një ditë me kë-
 pucë të kuqe. Pa le gjith' e gjithë po n'a la edhe ne pa punë.
 Ne nacionalistët, ne veteranët sot s'n'a përfill njeri! E muart vesh?
 Do me thënë ushqyem krimbat që të n'a nxjerrin sot sytë!

KOLI.

Si të mos mbetemi pa punë, të len' akraballëket? Pastaj ne s'dijmë as muamele, as destur e mexhele. Ne s'jemi msuar t'i fshimë këpuçet njërit e tjetrit, andaj s'n'a qasin në punë edhe sot kemi mbetur në ditën e hallit.

SELIMI

Ne kemi edhe diploma, të shkretët; kemi dalë prej shkollave të larta. Pastaj ne e kemi bërë këtë Shqipëri e jo këta, se kur shkonim në burg, ose në syrgjyn këta mernin meashe të majmë edhe as bënin kabull të flisnin shqip. Për veç këtyne, këta janë gjith' ata që n'a ndiqnin e s'na ljinin rehat, se ishin më turq se turqit e Anadollit, e sot janë efendëm, të gjithë në memurijete, edhe hiqen më patriotë se ne!

MUSLIMI.

Sa je i marrë! Po kush të pyjet në ke diplomë? Me diploma s'merret punë sot; duhet të kesh një soj, një fis, akraballëk me një fjalë. Ashtu po, se ndryshe mos prit e mos bëj budallallëk t'ja u kërkosh se të venë drunë. Nga ndo një herë të futin me përdhuni në vapor e të çojnë pa passaportë jashtë Shqipërisë.

LLAMBI

Mirë thotë Myslimi ketu i thonë Arnautllëk. Këtu duhet të kesh dalë prej shkollës së muamelesë, të kesh bërë memur në Sham e n'Anadoll, të dijsh arebi e farësi, vjershat e Firdefsiut e të Nizamint, ose të kesh kënduar në Kreathane të Stambollit a në Mektepi nuvap, se prej Universiteve s'pranohen.

KOLI.

Unë thom se po të kesh akraballëk nuk duhet as diplomë as vesikâ, as gjë; në daç të pyeç nuk të thonë, as në ke vjedhur, as në kë vvarë, as në ke tradhëtuar, as në ke dalë myflis, ose jallanxhi. Të gjitha të pa larat të mbulohen, të gjitha të metat të harrohen, të bëjnë, bilem, edhe temenâ, po patë akrabâ! Apo jo?

20

TË GJITHË.

Kë të drejtë.

KOLI.

Akraballëk edhe prapë Akraballëk s'ka tjetër çare, Akra-
ballëku është sot urdhri i ditës.

Akraballëket.

(MINORE, MUSIKË POPULLORE).

LLAMBI.

Po, po, se ç'n'a ka gjetur,
U bëmë fukarenj,
Pa punë kemi mbetur,
Të vogjël, të mbëdhenj,

Njeri nuk n'a ve veshin,
Për fat të keq, të zi,
Njeri s'n'a huan peshhin
Nuk ka ku shkon më zi!

VALLJA.

Ah, për se, ah për se,
Të mjerët s'kemi pare,
U bëmë qepaze,
Ah, për se, ah, për se,
Këta s'n'a qasin fare
N'a muarr për meze.

Të varfrit në ku shkojmë
Pa një para në xkep,
Çuditemi si rrojmë,
As një njeri s'n'a jep.

Furxhiu edhe bakalli
Nuk sheshin verese,
Si do n'a vejë halli,
Aman të mjerët ne!

VALLJA

Ah, për se, ah për se, etj. etj.

Të duash të gjesh punë
Do jysh në pazarllëk,
Se pse të venë drunë
Bën një budallallëk

Nuk merr memorijete
Po s'ke akraballëk
Nuk shkojnë lajka e mjete,
I thon' Arnautllëk.

VALLJA.

Ah, për se, ah për se,
Të gjitha këto halle
Na ranë si rrufe,
Ah, për se, ah për se,
N'a muarr në për këmbë,
U bëmë qepaze.

S'të pyesin në pate
Diplom' o vesikâ
Sa do të duash sgjatte
S'merr punë sadakâ.

Duhesh të kesh të pakën
Një fis, një akra-bâ
Ashtu s'ta hanë hakën,
Mos ji kabâ-zurnâ!

VALLJA.

Ah për se, ah për se
etj. etj. (si më sipër)

Duhet të dish turqishten,
Të dish muamelé
Persishten, arabishten,
Destur e Mexhelé,

Të marrësh arësime
Në Sham, a n'Anadoll,
E të kesh parë msjme
Të pakën në Stamboll.

VALLJA.

Ah, për se, ah për se,
etj. etj. (si me sipër).

Nuk ka zarar pse vodhe,
Pse dole batakxhi,
Se vllakën diku e hódhe,
A dolle jallanxhi,
Të gjitha të harrohen
Pa pate akrabâ,
Të metat të mbulohen,
Të bëjnë "merr habâ„.

VALLJA.

Ah, për së, ah për se, etj. etj.

Edhe në pate vvarë,
Në je katil, gjaksor,

Atdhenë n'e ke sharë,
Nuk je një tradhetor,
Edhe në pate gjishtin
Në një kallpuzanllëk,
T'a krehin gjithë bishtin
Po ke akraballëk!

VALLJA.

Ah, për se, etc. etc. etc.

Me akrabâ me fise
Do bëhet Shqipëri,
Nuk kanë gjithë hise
Në Shtet, në Qeveri,
Veç me akraballëke
Ze pun'e gjen derman,
Se me qepazellëke
S'lëpin as një sahan!

VALLJA.

Ah, për se, ah, për se
Si mjerë ne të varfrit
Q'u bëmë qepaze,
Ah, për se, ah, për se,
U dëshpëruam fare,
S'ka akrabâ për ne!

Organizatorët

Këta kanë te drejtë,
Po s'i dëgjon njeri,
S'duhet të jesh i shejtë
Këtu në Shqipëri,
Po fole të vërtetën

Do bëhesh fort pishman,
Njeri nuk t'a çmon vleftën
Po s'qe një sharlatan.

VALLJA.

Ah, vatan, ah vatan,

22

Kështu dhe ne pësuam
Atje n'Afganistan,
Ah, vatan, ah vatan,
Kush është i zot' i punës
Guverna nuk e mban

Të shkretët Shqipëtarë
Duket se s'kanë faj,
Nuk janë as të marrë,
As q'i gënjen kollaj,
Këta do vuajn shumë

Të gjejnë selamet,
Do shkojnë vala e lumë,
Si kur se ç'do milet.

VALLJA.

Ah, vatan, ah, vatan,
Kështu dhe ne pësuam
Dikur n'Afganistan,
Ah, vatan, ah vatan,
Në Skqipëri gjen punë,
Veç po të jesh shejtan.

(Dalin nacionalistët).

Inxhinijerë e konduktorë.

FYTYRAT

ALEMI		
KALEMI	o	Inxhinijerë
JOVANI		
STEFANI	o	konduktorë

SQEN' E 3.

KËTA EDHË ORGANIZATORET.

ALEMI

Ama kështu u bëmë fare berbat! Gjer tani u mbajtnë si u mbajtnë këto rrugat t'ona prej Perëndije më fort, se prej Qeverije, po tani që ja filluan edhe shirrat si do t'ju vejë filli? Çudi si s'përkujdesen këta njerës, xkanëm; Thuaji qeverisë se duhen parâ për rrugët, as pak s'ta ve veshin, thuaji se u mbytmë, thuaj se nuk kalohen këto rruga, qeverisë këtej i hyn andej i del! Bëj

23

raporta mbi raporta, kurr gjë! Trokit sa të duash në portë të shurdhamanit. Si dreqin do bëjmë kështu? Edhe se mos janë ngrënë pak parâ aty në punët botore? Ehuhaaa!... Hesap s'bëhet. Po punë? Iç!! Si shkuan gjithë këto të holla? Kush i hengri?... Kush nuk hengri e vraj..... Mua më vjen turp edhe prej këtyre të huajve më fort që n'a vjinë për dit, e n'a shohin në ç'hall jemi, pa sa për ne, ne e dijmë njëri tjetrin sa pare bëjmë.

KALEMI.

Këta s'janë të zotët të mbledhin materijalin që kanë lënë posht e lart Austriakët e Italianët e ti po pret të harxhojnë pa ra për rruga! Më duket se të ka zënë nata lark! Ti bëj hesap që nuk harxhojnë 5-6.000 franga për të mbledhur 10-15 miliun frangash materialin që kanë në Vlorë, që po mvidhet për dit e do mos gjejnë gjë më në funt, e pret të të ndreqin rrugat?

JOVANI.

Pse i humbisni fjalët kot? Këta nuk të goditin rrugën principale Durrës-Tiranë, që rreshperon për minuta. Ju po e shihni se lanë gjithë materialin e Durrësit pa një inventar dobarem, shoqërisë të dekovilave Durrës-Kavajë, Durrës-Tiranë. Qeverija la katundarët e grabitë gjith atë alamet materiali të urrës së Matit, që t'a përdorin për me thurrë gardhe e stane, e për me i kullandrisë si binarë e breza shtëpijet! Le pastaj për lendën tjetër botore, për barakat e Italjanëve në Vlorë, Llogora e Sarandë e gjetk' e gjetkë! ku rruhesh ti?

STEFANI.

More pse shkoni aqë lark? Ju shihni një herë ç'ka në avlli të saj Qeverija pastaj shkoni me tutje. Ajo nuk përkujdesohet për 3-4 kamijone të çkatëruara që ka të sajat e që s'kanë as goma, as llastika, as benzinë, as gjë, përveç se shoferë, që e marrin rrogën bir taman kur vjen muaji. Edhe kur ka nevojë t'i dalë ndo një të huaji përpara i lutet Kryqit kuq Amerikan, ose tregëtarëve të tjerë që kanë automobila! Pret prokopi pastaj ngaj njerës të këtillë?

24

ALEMI

Jazëk, jazëk! Qeverisë s'i mbushet kokka kurrë që komunikacioni është shpirti i qeverisë, jeta e shtetit, zhdrivillimi i tregëtisë, i industrisë, i popullit me një fjalë! Pa le m'andej për lehtësit' e tjera ekonomike e strategjike. Pastaj urrat. Ku janë urrat?

KALEMI.

Ç'i ze në gojë urrat? Qeverisë i pelqen më mirë sistemi i trapevet. Ku ke parë urrë në Shqipëri? Nuk sheh se gjithë lumenjtë kalohen me trap? Në trapet ka rekordin Shqipërija. Në Mat trap, në Drin trap, në Vijosë në Seman, në Osum, në Devoll, në Mifol, në Dragot, trap, trap, trap! Ku ka si trapi?

JOVANI.

Po për kanalizimin e ujravet që* po mbytin Myzeqen' e fushat e tjera, për liqen' e Maliqit, për grykën e Bunës, për forcat hydraulike të lumënjve, për porto e për limanë, për sfrytimin e vaj-gurrit, të minave e metaleve tjera që ka Shqipërija, për një sistem tramway-it e për elektrizimin e vendit, etj. si do të bëjmë?

STEFANI

Ti qenke i marrë e s'të ditkam! Ti s'ke bukë në sofër e hi në carran e po me kërkon fruta? A e di se si flet ti? Si e ëm' e Zeqjos majë thanës. A po kujton se me kanunin e ri të rrugavë, që do votojë Parlamenti i mbarruam të gjitha punët? Ato janë pralla të Haimasë. Ndofta pas një qint vjet do të kemi rruga, po jo sot. Mua me vjen turp vetëm ç't'ju themi këtyre organizatorëve që kanë ardhur.

(hyjnë Organizatorët)

Këng' e P. Botore.

(PAS OPERETTËS "MASCOTTE,,)

STEFANI.

Si t'ja u themi një nga një
Gjith' ato gjërra aq të ralla,
Në ju tregofshin për ç'do gjë
Do n'a i marrin si për pralla,

VALLJA.

Ne rruga nuku kemi
Për qerr' e dekovil,
Si mos më keq po jemi,
S'punon automobil.

Karroca nuk kalojnë dot,
Talike edhe hajvanate,
Veç se në rënçinë më not
Në këto rruga kaq berbate.

VALLIA.

Mungojnë fare urrat,
Disa janë harrâp,
Për të kaluar burrat
Shyqyr që kemi trap.

Fushat u mbytn' u bënë det,
U transformuan në kënetë,
S'duket as ar' as bereqet,
Hethe, mallarija të shkreta.

VALLJA.

S'çan kryet Qeverija
Për një kanalizim,
U prishnë qindra e mija,
Pa dhembje, pa kursim

S'kemi as porto, as liman,
S'kemi fanarë për vaporë,
Përveç se një Pasha-liman,
Që Zoti e krijoi në Vlorë.

VALLJA.

Nuk kemi as tunele
Në Krab' e në Tomorr,
Po vijnë varangjele,
Si breshka kur vjen torr.

Të udhëtosh në Shqipëri,
Duhet të kesh kuaj atllarë
Baltat kalohen me trimri
E jo me kuaj me samarë.

VALLJA.

Duhet të kesh një lundër
Kur gjen baltën liqen,
Se po i shkove kundër
Nishan njeri s'të gjen!

Të duash të vesh në Berat
Të lipset plot një jav' e terë,
Për në Përmet e në Perat
Duhesh t'a kesh zembrën e gjërrë.

VALLJA.

Edhe në shkofsh me thellë,
Delvin' ose Bihlisht,
Nuk di sa ke m'u sjellë
A sosesh sigurisht.

26

ORGANIZATORËT

Këto i djimë edhe ne	Rrugat ndryshojnë krejt atje
Sa do q'Afganistani ynë	N'atë Aiganistanin t'onë,
Nevojë s'ka për port e quai,	Atje punojnë lop' e që,
Vaporët s'kanë ngaj të hynë.	Jo dekovil' e kamijonë,
Po ju, mos u mërzitni	Për urra s'ka nevojë,
Pse s'kini përparim,	As trapi nuk punon,
Edhe kot mos bërtitni,	Me kuaj kush të dojë
Po kijni pak durim.	Lumënjtë i kalon.

(Dalin inxhinjerët e konduktorët).

Arësimtarët

FYTYRAT

MAKSUTI | Professorë.
DAUTI |

SQENA 4.

ARËSIMTARËT, PASTAJ ORGANIZATORËT.

MAKSUTI. (Ardugjânit).

Duket se Zotrija juaj do jini Organizatorët e Shtetit t'onë.

ARDUGJAN.

Si urdhron.

MAKSUTI.

Ne, mjerisht jemi profesorë të literaturës, doktorë të filozofisë edhe tani, jemi, me nder me thanë, mjeshtra shkollash.

FIRDUSTAN.

M'a falni, zotni professor (entre parenthèse), pse përdoroni fjalët "me nder me thanë,,"? Ç' do të thoni me këto?

MAKSUTI.

Dua të thom, se tue qënë një professor i vjetër, i mbaruar, meritonja të marr të pakën 400 franga në muaj. Ministorija e Arësimit, pastë faqen e bardhë, n'a ka barasuar me mjestrat e tjerë e n'a paguan vetëm 180 franga në muaj; edhe nuk është çudi të n'a i zbresin rrogat edhe më poshtë, si të kopistavet. Pra, kur një hamall, për të cilin thonë "me nder me thanë,, merr ose nxjer 200 franga në muaj, ahere nuk duhet me thanë "me hder me thanë,, edhe për ne të shkretët që marrim me pak se ata? Si thoni, kam të drejtë?

FIRDUSTAN.

Kini të drejtë.

DAUTI.

Zotrinj, si u bë sot Arësimi, më mirë të marrim shatën e lopatën, se sa pendën e tebeshirin e të çajmë gjoksin nat' e ditë me nxënësit. tyke bjerrë edhe shëndetin. Sot ata më të mirët arësimitarë figurojnë si sekretarë në për Ministoritë e Prefekturat, ose janë Nënëprefekta, ose direktorë Financash.

FIRDUSTAN.

Pse ashtu?

DAUTI.

Se s'janë të marrë si ne, të rijnë me 180 franga në muaj, kur se marin 350 deri më 500 në muaj. Afa janë sekretarë edhe paguhen më mirë, kanë rehatin' e tyre edhe ittibâr, sa të duash. Nevej n'a rruat titulli i Professorit!

MAKSUTI.

Një kopist ministorigje, një qatip doganet, ose një protokolist nënëprefekturë e heqin vehten me të lartër sot se sa një doktor filosofije, një professor si ne.

DAUTI.

Ka dal-ka dale do n'a bëjnë barabar me kollxhijtë edhe me rrojtaret e pyjevet.

ARDUGJAN.

Sa keq. sa keq!

MAKSUTI.

Zotërinj organizatorë, kemi shumë fjalë t'ju themi.

GJULISTAN.

Urdhroni, urdhroni, po ju dëgjojmë.

MAKSUTI.

Aresimi, i Shqipërisë është mangut nga shumë sende, a më mirë të themi. i mungojnë të gjitha. T'ja u tregoj të tëra do mos kijni kohë të na dëgjoni. Andaj do t'ju flas shkurt.

1. S'kemi libra, as që kemi ndër ment të shtypim.
2. S'kemi vegla shkollore, as që kemi ndër ment t'i bijem.
3. S'kemi msuës e msuëse, as që kemi ndër ment t'i krijojmë.
4. Si professorë, si praktikantë këtu i kemi barabar me një gradë edhe dikur këta të dytët janë direktora e inspektora edhe marrin dyfijsh meash. Nga një herë edhe nxënësat që mbarojnë një shkollë fillore dalin mjeshtra e rrogën e marrin si në.
5. Shkolla kemi shumë në katundet, por ja se s'kanë nxënës, ja se s'kanë ndërtesa. Shumica e mjeshtravet janë analfabeta. Nododhen në për shkollat vetëm kur kalojnë s'andejmi inspektorët, edhe duken në arkë të financës vetëm kur vjen fundi i muajit për të marrë rrogën.
6. Disa mjeshtra të shkollave të katundeve kanë nga dy edhe nga tre zanate, si b. f. tregëti, matrapazllëk, bulqësi; disa janë edhe sekretarë zyrrash, po edhe mjeshtra.
7. Systemë pedagogjike s'kemi për katandi.
8. Baballarët e kujdestarët s'dëgjojnë me i çue çunat e vajzat e tyre në shkollat, edhe ne s'ju bijem prapa.
9. Msimet, si ato të filloreve, si ato të shkollave qytetëse e të mesme e të Normales topallë që kemi në Elbasan, s'janë aspak methodhike. Kemi dy dJalektë, ose më mirë të themi dy gjuhë, që s'bashkohen kurrë në një system njësuër.
10. Kemi aqe gramatika, sa edhe shkrimtarë të gjuhës Shqipe, edhe as u kujdesuam, as do kujdesohemi kurrë të trajtojmë një gramatikë për të qënë. T'a lemë më njanë vokabullarin, ose fjalorin, si i thomi shqip që s'e bëjmë dot.

11. Kemi më tepër msuës besimit, se sa msuës msimit.

12. Si e dijni mirë, moti ka 365 ditë, po shkollat t'ona punojnë vetëm 165 ditë në mot, se 200 ditë janë kremte, festa e tatile. Veç që kemi edhe nga një ditë pushim në mes të javës, se pse bëhet pazar këtu në Shqipëri, e blëmë ç'na lipset për gjithë javën. Po t'i rëzojmë edhe këto ditë nga suma 165, mbeten afër 100 ditë të sakta shkollare. Prandaj n'a vjen shumë keq, zoterinjtë organizatorë që jemi vetëm muslimanë e të krishterë në këtë vend e s'kemi edhe çifutë, që t'i sillnim barabar edhe ato 100 ditë të sakta që tepërojnë.

13. Harxhojmë në muaj 8.000 napolona të verdha për ca studenta që kemi në Itali e n'Austri, pa një rregull, pa një qellim. Disa prej këtyrë kanë baballarët zengjinë, po mjerisht baballarëve të këtyrë ju vjen mirë t'ja u msonjë fëmijën qeverija badjavâ! Disa të tjerë, të zotët, po që s'kanë akraballëk, ose janë fukarenjtë rijnë jashtë tempullit e bëjnë sejr studentët pasanikë që bëjnë qef në për Europë, dikur edhe me amoroza.

14. Fund i fundit kësaj ministrisë së Arësimit s'i ka dhënë kurrrë një rëndësi politika jonë. Si ministër i Arësimit merret kur do herë aji që është më i pafuqishmë, ose që s'është prej oxhaku, prandaj edhe në vendimet ministoriale ky nënëshkruan i fundit!

Këto janë ato më të paktat ankimet t'ona, se kemi edhe shumë të tjera. Ja u paraqitëm zotrisë s'uaj në 14 pika, që të mos thoni se s'mbajtmë si criterium të 14 pikat e Wilsonit!

Kënga e Arësimitarëve.

(PAS OPERETËS MAM'SELLE NITUCHE). QUARTETTO.

S'kemi shkolla, s'kemi libra,

VALLJA.

S'kemi mjeshtra n'Arësim,

Arësim, Arësim.

Veç masraf' e shumë qibra,

Lum' ata që presin msim,

Edhe msuës për besim.

Arësim, Arësim,

S'ka system pëdagogji,

Parâ prishen pa kursim.

Edhe një program llogjik.

Dhe çdo msim edhe ç'do dije

Na mungojnë gjithë veglat,

Nuku bën një metalik.

S'kemi karta, s'kemi gjë,

30

Edhe regllat e tabelat,
Edhe ne nuk nxjerim zë.
N'a mungon një methodhikë,
Një system arësimor,
S'kemi as një gramatikë
Nuku kemi një fjalor.

VALLJA.

Arësim, Arësim,
Lum' ata që presin msim,
Etj. etj. etj.

Msuës edhe professorë,
Nuku kan' as një ndryshim,
Praktikan' ose doktorë
Kanë gjithë një shpërblim.
Dalin nxënësja djelmosha
Me dëshmi, me verëkâ,

Si ca dhëmbë katarosha,
Marrin rroga të mbëdhâ.

VALLJA.

Arësim, Arësim etj. etj.
Professor' e veteranë
Nuku çmohen në Shqipri,
Edhe bukë në mos kanë,
Një sevap s'ju jep njeri.
Arësim nuk do të kemi,
Po nuk ndruam krejt zakon,
Gjithënjë prapa do jemi.
Kot n'a shkojnë ca miljon.

VALLJA.

Arësim, Arësim, etj. etj.

ORGANIZATORET.

Për këto mos u habiti
Në një Shtet kaqe të ri,
Nuku duhet të mërzi,
Dhe më fort në Shqipëri.
Atje tej në vendin t'onë,
Msimet jepen në shtëpi,
Për në shkollat gjithëmonë
Kanë qënë një Utopi!

VALLJA.

Arësim, Arësim,
Sa për ne ti s'ke kuptim,
Arësim, Arësim,
Ne s'na duhesh, s'ke fitim.

Nuk n'a duhet gramatika,
S'çajmë kyqet për fjalor,
Nuk n'a duhet methodhika,
As ndo një program shkollor.
Atje s'kemi professorë,
As doktorë të mbëdhenj,
Veç barrinj e malësorë
Që kullësin dhi e dhenj.

VALLJA.

Arësim, Arësim.
Sa për ne s'ke një kuptim,
etj. etj. etj.

(Dalin jashtë të gjimbe)

Financijerët.

FYTYRAT

PJETRI.

PAVLI.

ADEMI.

RUSTEMI.

Nëpunës financijerë

SQENA 5.

FINANCIJERËT PASTAJ ORGANIZATORËT.

PJETRI.

Si do bëjmë kështu, bre burra? Janë punë këto? Ne s'munt të marrim rrogat e përmuashme nga Financa e Qeverija po dërgon dit për dit njerës me misjone posht e lart në Evropë edhe memurë të tjerë për inspeksjone pa qënë as një nevojë!

PAVLI.

Për Zotin, në qoftë se vazdojmë edhe ca kohë kështu, Financa një herë lan duart, mbetet drasë.

ADEMI.

Duhet t'ju japim të kupëtojnë këtyre të mbëdhenjve t'onë që ne gjendemi në një krizë të madhe ekonomike edhe që lipset t'a mbledhin pak bishtin.

RUSTEMI.

Ah mor' i gjorë, po kush t'a mvarr torbën ty edhe mua? Nevej n'a shkurtuan rrogat e s'thamë gjë, n'a prenë edhe nga 20 për qint edhe u nemitmë, e tani do t'ju heqësh edhe verejtjen për paratë që prishin? Ruaju se mos të t'a mvarrin teneqenë, thom unë.

PJETPI.

Ne s'bëjmë dot gjë prej gjëje, po më mirë le të mbajmë shënime për këto çrregullime që po bëhen edhe kur të mblidhen deputetët ja u themi që të marrin masat.

32

PAVLI.

Mirë, mirë, po gjer sa të mblidhet Parlamenti si do bëjmë, se Fiuanca po jep shpirt që tani. Sa para na bëjnë më tutje deputetët me gjithë Parlamentin? “Si të vdesim prej kolle, pika i rëntë spanjollës,, thotë një fjalë e urtë.

ADEMI.

More si s’patnë turp edhe i bënë rrush e kumbulla gjith’ato parâ që kish Financa? Edhe pastaj thonë se kemi 20 miliunë të ardhura e 18 miliunë të prishura, do me thënë se n’a tepërojnë edhe 2 miliunë.

RUSTEMI.

Pallavra! Hesapi j shtëpisë nuk del në pazar. Ata kanë frikë të thonë të vërtetën, ashtu si është.

ADEMI.

Si?

RUSTEMI.

Si? Ja kështu, në janë njerës të drejtë e jo hypokritë, t’i thonë popullit. Ore popull, kemi 22 miliune të prishura e jo 18, edhe sa do që shihni në budxhenë se kemi 20 miliunë të ardhura, e verteta është që s’kemi as 18! Tani, ore popull i mirë, i qetë e i bindur. ti që paguan vergji, gjymbryk, të dhjeta, xhelepe, gjoba, rruga, ti që shkon ushtar edhe me fort z bathur e xhevshur edhe le edhe lëkurën në për operacionet, pa u mento ku do t’i gjejmë edhe 4 miliunë të tjera që n’a mungojnë? Munt t’i gjënim po s’jemi të zotët edhe s’kemi as kurajon të themi që s’jemi të zotët, se na pëlqen të rrijmë në kulltuket! Po si i paguajm? Nga huat ë Shqypëtarëve t’Amerikës, nga bonot e tjera, et cetera, et cetera merreni vesh vetë (Ademit). A e kupëtove?

ADEMI.

Ke të drejte! Po kështu nuk shkon më tepër se një mot.

RUSTEMI.

Është e ditur. Pastaj duhet t’i thonë edhe këto. Ore popull, kur u pa në Shqipëri të merren nënë gjyq ministrat? Kush u mentua të trajtonjë një **Odë Kontrolli** ose, **Cours des comptes**, si i thonë Francezët, ose **Divâni-muhasebât**, si i thonë Turqit? Kush dha hesap a kush kërkoi hesap për paret që janë

prishur? Ç'nevojë është të dërgohen kaqe njerës me misjone, ose për inspeksjone? Pse të bëhen kaqe komisione sadakash? etj. etj. Pastaj jo po dërgata, jo po mandata, pa punë, si e si të prishen paratë, me një fjalë Quo vadis? Kû shkojmë kështu?

PJETRI.

Mirë thua!

RUSTEMI.

Mirë thom, po kush më dëgjon. Nuk shihni se nuk jemi të zotët të bëjmë një bankë e të kemi monedhën t'onë? Nuk shihni se n'a doli gjithë ari jashtë e po dalin edhe banknotat? Ç'pret ti hur kemi 80 miliune importacion, të hyrë malli edhe 7 miliunë exportacion, të dalë malli? Mos kemi tregëti, bulqësi, industri, a ç'kemi? A po kemi pasunin' e Shtetit, që më tepër prishim se sa marrim e që e grabit kush maunt! Kur u bë një inventar i pasunisë? Kur u bë një kadastro? Ku kanë ngehtë politikanët tonë për këto? Ata humbasin kohën në kumar, në poker, mâus, bakarâ e lansqenë. Kush ju ra ndo një herë prapa? Kumari është i modhës sot.

TË GJITHË.

Ka të drejtë Rustemi.

Këng' e Misjonevet.

(MBAS OPER. "BOCACE"),

(QUARTETTO)

PAVLI.

Ka nevojë shumë Shteti
Për misjone në Evrop,
Si punonte dhe Dovleti
Gjer sa shkriu e bëri stop.

CHORO.

Parat' harxhohen kot e kot,
Harxhohen kot, pa masë,
Financa qan e qan me lot.
Qan me lot, mbet drasë,

Parat' harxhohen kot e kot,
Financa qan e qan me lot'
Se parat' u hëngërn kot!

PJETRI.

Do të sjellim inxhinjerë
Për kanale, për shossë,
Do të bijem dhe pontjerë,
Pa para e veresë.

CHORO.

Parat' harxhohen kot e kot,
etj. etj. etj.

34

ADEMI.

Me misjone shumë shkojnë
Në Evropë e në Austri,
Dhe me marifet fitojnë,
Tykë bërë tregëti.

CHORO.

Parat' harxhohen kot e kot,
etj. etj.

RUSTEMI.

Do të bëjnë inspeksione,
Sa do që nevojë s'ka,
Do formojnë komisjone.
Për hiqë-sadakâ.

CHORO.

Parat' harxhohen kot e kot,
etj. etj.

PAVLI.

Me dërgata, me misjone
Shteti mbeti fukarâ,
Bëjnë kot operacione,
Lozin pocker, bakarâ.

CHORO.

Parat' harxhohen kot e kot,
etj. etj.

PJETRI.

Blihen teshat ushtarake
Dalin letra, mukavâ,
Futen n'ujë e bëhen raqe,
Harxhon Shteti badjavâ.

CHORO.

Parat' harxhohen kot e kot,
etj. etj.

ADEMI.

Me mandata me rushvete
Shteti ynë del çiplak,
S'ke ku lyp mesulijete,
Veç një Zot ju marrtë hak.

CHORO.

Parat' harxhohen kot e kot,
etj. etj.

RUSTEMI.

Po dërgohen oficera
Për të msuar në Evropë
Shtat-madhurin e të tjera,
E disa për arm' e top.

CHORO.

Parat' harxhohen kot e kot,
etj. etj. etj.

PAVLI.

Ka sharruar krejt Financa,
Mbet pa gjë, s'ka metalik,
S'e le qetë Intandanca
E ka futur në rrezik.

CHORO.

Parat' harxhohen kot e kot,
etj. etj. etj.

PJETRI.

S'kemi pare, metalike,
Flasin me paturpësi,
Kemi kriz' ekonomike,
Do t'n'a venë në vasi.

DHORO.

Parat' harxhohen kot e kot,
etj. etj.

TË GJITHË TOK.

Shkuan, shkuan, gjithë paratë,	Harxhohen kot, pa masë,
U harxhuan pa dobi,	Financa qan e qan me lot.
Se i hëngërn maskaranjtë,	Qan me lot mbet drasë,
Rrush e kumblla e neblebi,	Parat' harxhohen kot e kot,
CHORO.	Financa qan e qan me lot.
Parat' harxhohen kot e kot,	Se paratë shkuan kot!

Organizatorët

Këta paskan shumë halle,
 Qenkan mjaft marifetxhinj,
 Do t'n'a futin në një valle,
 Që do lozim si arinj:

CHORO.

Këta me xhepet plot e plot
 Me torba e me thasë,
 Lëshohen kush e kush më not
 Në ark' e në ç'do kasë,
 Në rrugë nuk i sjellim dot,
 Se mbushkan xhepet plot e plot
 Edhe n'a mundojnë kot.

Kot kaluam fusha e male
 Për me arth në Shqipëri,
 Këtu lojtkan karnavale,
 Që nuk i merr vesh njeri.

CHORO.

Këta me xhepet plot e plot,
 Me strajsta, hejbe e thasë,
 etj. etj. etj.

(Dalin gjithë jashtë).

36

Adlijexhinjtë.

FYTYRAT

HASSANI.		Kryetar gjyqi të shkallës I.
HYSSEINI.		Gjyqtar paqtuës.
ISUFI.		Notar e ixhrâ-memûr.

SQENË 6.

ADLIJEXHINJTË, PASTAJ ORGANIZATORËT.

HASSANI.

Unë do të jap istifanë, Hyssen efendi. Nuk durohet kështu. Me këtë organizimin e ri të gjyqeve, ne, përveç që s'paguhemi mirë, po n'a kanë ngarkuar edhe shumë detura e do marrim edhe vehten më qafë. në qoftë se vazhdojmë shumë kohë. Mua më vjen se adilija në vent të verë vetulla këtë radhë kreu sytë!

HYSSENI.

Hakikaten ke të drejtë! Tjetër herë ne, në kohën të, rahmet pastë. Turqisë, edhe punë shumë s'kishim edhe meashe të mira n'a jepnin edhe të gjitha në dorë i kishim. E merr vesh zotrote. Po tani? Punë shumë, t'rogë pak edhe prej të tjerave kurrgjë! A e mbeson, reis-efendi se shëkonj më tepër se 20 d'vâ ditën? Allah selamet!..., Jo, jo duhet të japim istifanë; të bëjmë veqalet më mirë a të bëhemi nënëprefektë, ose krahinarë. S'rijet kështu.

ISUFI.

Kur ankohi ju, po un' i shkreti ç'të them? Nuk e shihni se sa gjërra më ka ngarkuar mua ky qeratâ organizim i ri? Si kur s'ishin injaft gjithë punët e pa sosura të notarisë, po na të të ngarkojnë edhe ixhirâ-dairënë, që jo si kur ke dy kunguj nënë sjetull, po dymbëdhjetë. Për mbi këto dreqi i tha në vesh këtij ministrit t'onë të heqë ngaj këjo zyrë edhe sekretarët si edhe

37

të vetëmin ndihmës, protokolistin që paçë. Tani, vetë ixhrâ-memûr, vetë qatip, vetë protokolist, vetë të gjitha! Këtë as dreqi s'e ka parë! Do të jap istifanë dhe unë. Më mirë shesh gjevrecke ë lakrorë, ose bënj matrapazllëke, se sa këto punë. (Hassanit). Di, ç'do me thënë, Z. Kryetar, të jesh tyke regjistruar kontrata iltizamesh edhe të të vijnë 2-3 veqaletname me një herë, edhe mbi atë e sipër edhe 2-3 protesta të gjata, pastaj edhe nj'a 2-3 avokatë me nj'a 2-3 siqvestra konservative edhe m'anën tjetër të të takojnë 2-3 ilame të tjerë për në ixhra? Si bëhen gjithë këto? Duhet të kesh 100 palë duar te shkruash edhe 200 palë këmbë të shetitësh! Organizim i thonë këtij? Ministri jonë desh të rëfehej i kursyer përpara shokëve, po s'bëri gjë tjetër për veç se i shkurtoj gjyqësisë duar e këmbë. Tani le t'i shkurtonjë edhe kryet të shpëtojmë. S'ishte më mirë t'i ngrinte krejt gjykatoret edhe zyrat e tjëra, ose të bënte një moratorium për një kohë të pa caktume?

HASSANI.

Xhanëm, atë mos e thuaj, se pastaj vdesim për bukë. Nak mentohesh se ç'do bëheshin kaqe adlijexhiuj që ka sot Shqipërija? Gjinokastritët një herë pa le të tjerët.

HYSSEINI.

Po edhe kështu s'hiqet, të kesh kaqe gjyqe ditën, të shkosh në kaqe xhyrmi-meshûte, ose flëgrant delits, si ju thonë francezët e të bësh edhe detura mustentiku. Këjo është një rezalet!

HASSANI.

Le të ngushëllohem. karëndashëm, se shih ti një herë meh-gemei-temizin që u bë për dreq. Gjithë istinafet e Shtetit aty janë grumbulluar, që tartari e merr vesh. Allah qerim kur mbarohen. edhe prapë s'ankohen.

ISUFI.

Ata jane ndryshe, z. kryetar, se marrin edhe meâshe të mbëdha e jo si t'onat.

38

HASSANI.

Mirë po pa verë edhe sa janë munduar ata gjer sa ardhë në atë shkallë?

HYSSANI.

Ata që e meritojnë, po, po aty janë edhe njerëz që janë emëruar për hatër edhe nuk vlejnë të marrim rrogat që po ju japin, se s'janë as më të ditur, as më të zotët se ne.

HASSANI.

Hele, hele, fund' i fundit si do bëjmë?

HYSSANI E ISUFI.

Do të japim istifanë.

HASSANI.

Edhe unë ashtu thom. Po pastaj halli i bukës si bëhet? Ne kemi edhe familje, birader, mentohi mirë.

HYSSANI.

Zotrote kërko të bëheç një nënëprefekt edhe unë një kra-hinar. Se mos janë më të mirë se ne ata që ka sot Shteti Shqipëtar?

ISUFI.

Po unë?

HASSANI (Tyke qeshur)

Ti bëhesh gjevrekxhi, ose matrapasxhi, e the vetë më përpara, mo derëzi.

Këng' e Adlijexhinjve.

(MUSIKË POPULLORE).

HASSANI.

CHORO

Do të japim istifanë,
Se kështu nuk hiqet dot,
Ne n'a shuan e n'a vranë,
Kemi punë shum' e plot.

Adilije, Adilije.
Si n'a sjell e s'i n'a shpije,
Adilijë, Adilije,
Nuk të mbet lezet e shije.

HYSSANI.

N'a tregohen kursimtarë
 Po Adlija u bë shÿt,
 Janë tepër kuximtarë,
 G'do memûr me pun' u zhyt.
Adilije, Adilije, etj,

ISUFI.

Edhe mua më jep dorë,
 Si u bë gjyqsija sot,
 Shesh gjevrekë e lakrorë,
 Se sa vras vehten më kot!
Adilije, Adilije etj.

Organizatorët

Ç'janë këto taksirate
 Për të zinjt' adlijexhinj,
 Këto s'dashkan as ispate
 Paskan dert këta të zinj.

CHORO.

Adilije, Adilije,
 Nuk u vure dot për fije,
 Adilije, Adilije,
 Shëndet, se te paska hije.

Si gjyqtarë, si notarë
 Po të mbeten seirxhinj,
 Bëhen vetëm krahinarë,
 Matrapaz' a gjevrekxhinj.

CHORO.

Adilije, Adilije,
 Nuk të vû njëri për fije,
 Adilije, Adilije,
 Rëndësija po të bije.

(Dalin Adlijexhinjtë).

40

Avokatët

FYTYRAT

ZEJNELI. | Avokatë me diploma.
PANTËLI.

SQENA 7.

AVOKATËT, PASTAJ ORGANIZATORËT.

ZEJNELI.

Si u bë edhe ky avukatllëku në Skqipri është për të marrë syt' e këmbët e për të ikur. Kanë dalë avokatët pratikanë e po n'a i rëmbejnë punët për dit, se ata dijnë mirë si t'a mje-llin popullin. Ministoria ju jep lejë për ditë ketyre edhe nevej n'a rruashin diplomat, që kemi prishur aqe mijë gjër sa i muarm. N'a rruashin mndimet që hoqmë aqe vjete në për shkollat. Herifi, pa mbaruar një shkollë fillore, të del atje me 2-3 nyje të mexhelesë edhe me nja 5-6 të procedurës civile e të bën avu- katllëk! Po kësaj si i thonë?

PANTELI.

Fajn' e ka ministoria që i pranon. Po le gjith' e gjithë, po këta ven' e mbushin popullin që nuk dijmë gjë, që ata n'a i venë të dy këmbët më një këpucë e të tjera e të tjera gjepura! Edhe populli i ngratë nuk mentohet që ata gjer djë ishin kafe- xhinj, terëzinj, kundraxhinj, matrapazë, ose të shumën të shumën qatipka gjykatoresh! Kur dreqin duall avokatë, pa kush ja u dha diplomat?

ZEJNELI.

Pse nuk bëjmë një Barro e t'i nxjerim jashtë këta kërpa- çë? Duhet të vepëronjë ligja.

PANTELI.

More ç'ligje e ç'mërmëligje po thua? Kush të pyet këtu

për ligje? Nuk sheh se edhe ligja e re ju del zot?

ZEJNELI.

Po bashkë me këto në s'kemi edhe gjykatore të prokopisë. Janë mbledhur gjith-farë lëndash e janë bërë si lesht' e harapit. Po shyqyr që ndodhen edhe ca hukkuk-shinasë mektep-llinj e i bijen në rrugë, se ndryshe loste qeni i kallanxhiut. Ç'punë ka terëziu e manifaturaxhiu me mehqemetë? Këjo është një sent tuhaf! Ata të shohin gjilpërën e kutin.

PANTÉLI.

Ler' e mos e nga në ç'derexhe janë sot mehqemetë. Ata më të zotërit sot bëjnë avukatllëk. Sa do të mos fitojnë prapë se prapë fitojnë. S'janë të marrë të bëhen memurët e adlijesë. Pastaj meâshe janë këto që po ju japin adlijexhinjve?

ZEJNELI.

Mos harro për mbi këto edhe vazijetin e sotmë të disa gjyqeve. Nuk ke parë që më të shumtat e zyrave janë transformuar në kahvehâne? Vetëm tavli mungon aty edhe bilardhua. Për veç këtyre po vijnë edhe kur t'ju dojë qefi edhe shume herë bëhen edhe të sëmurë. Pastaj ky sistemi i muzaqerevet, elhyqm' ullah s'hiqet!

PANTÉLI.

Qysh?

ZEJNELI.

Qysh? Po nuk e ke vënë re, se muzaqeretë bëhen shumë herë për të bërë muhabet e për të pirë cigare, disa herë bëhen për të kënduar gazeta e romane, edhe disa herë për të shkruar letra, se s'patnë kohë t'i shkruajn në për shtëpit' e tyrë?

PANTELI.

Tamam, tamam, ashtu është, ke të drejtë, po edhe disa herë bëjnë muzaqerë se s'e kanë marrë vesht mirë punën. Edhe ne presim në divân e me evrake në dorë e n'a pret të ftoftit nga të katër anët se s'kanë xhamllëke penxheret!

42

ZEJNELI.

Ministrija nuk shëkon statistikat e gjyqeve, që të marrë vesh se ç'njerës mban, po shëkon ku është ndo një vent i hapur për të kënapur ndo një deputet.

PANTELI.

Po hapshânet e hapsorët që janë në dit të hallit?

ZEJNELI.

Leri, leri, hidhju kripë. Mua më vjen keq që s'i kam tani ato parâ që kam prishur për të dalë avokat.

PANTELI.

Ç'do të bënje?

ZEJNELI.

Tuxharllëk, samsarllëk, ç'të muntnja.

PANTELI. (më vehte)

Ka të drejtë.

Hallet e gjyqevet.

(QUARTETTO)

Medet si do të rrojme
Këtu në Shqipëri,
Si dreqin do jetojmë,
S'n'a nqaset as njeri!
Si është avukatllëku,
Më ittibar s'n'a mbet,
Më mirë tuxharllëku,
Se sa sa ky rezalet.

Eh, eh, eh, eh, eh, he,
Si ne, si praktikanët
N'a mat një hendesë
Eh, eh, eh, eh, eh, he,

N'a plasi shpirti fare
Me këto mehçemé.

Na rruashin diplomat
Q'i muarm në meqtep,
S'harnohen dot mballomat
Davâ njeri s'n'a jep!
Të gjithë muarn izë
E bëjn' avukatllëk,
Dhe sa që shishnin gjizë
A bënin terzillëk!

Eh, eh, eh, eh, eh, he, etj.

Gjykatat nuk punojnë,
 Gjyqtarët s'kanë ngë,
 Kohën më shumë e shkojnë
 Me ca muzaqerrë,
 Davatë zgjaten shumë,
 Ilamet s'marrin funt,
 Hapsanat jan' për lumë,
 Këjo nuk ngiet gjëkunt.
 Eh, eh, eh, eh, eh, he etj. etj.

Gjyqtarët praktikanë
 Gjyqtarët mekteplinj,
 Në një çanak po hanë,
 Se jan' iktizallinj,
 Meâshet fort të pakë,
 Disa nuk dijn' as shqip,
 Të shkretët kan' edh' hakë
 Në del kush myrteqip.
 Eh, eh, eh, etc. etc.

ORGANIZATORËT.

Tani e kupëtojmë
 Se ç'bëhet në gjyqsi,
 Ankimet i dëgjojmë,
 I dijmë farësi,
 Të mjerët avokatë
 Vërtet që paskan hall,
 S'ju hiqen dot belatë
 Këtu lot një skandall!

Ho, ho, ho, ho, ho, ho,
 Ne le të shohim punën,
 S'na duhen gjë këto,

Ho, ho, ho, ho, ho, ho,
 Prallat e Halimasë,
 Që i dëgjon kudo.

Gjykata mbasi s'kemi
 Atje n'Afganistan,
 Nuk lipset gjë t'ju themi,
 Me gala s'bëhet stan;
 Këta, si avokatë
 I venë pleshtit fre,
 Me djaj e me lugatë
 S'e nxjerim m'banë ne.
 Ho, ho, ho etj. etj.

(Dalin ië gjithë)

Klientët.

FYTYRAT

KOSTANTINI. | Popullorë.
HAJIRUDINI.

SQENA 8.

KOSTANTINI.

Kot e ke që po harxhon për këtë dava kaqe vjet në për avokatët e gjykatoret. Unë po të thom që edhe si kur tre vjet të shkojë kështu davaja ti s'fiton gjë.

HAJIRUDINI.

Sa të gënjen mendja! Po unë shkrihem edhe davanë s'e le!

KOSTANTINI.

Mirë, mirë, po do t'a marrësh vesh më në funt, që po harxhon posht' e lart në për gjyqet e po të mjelin avokatët. Nuk sheh me ç'farë gjykatore ke të bësh? Gjer sa të fillonjë davaja të lisedohet të pëlçet xhani, gjer sa të hysh në esâs te del shpirti edhe gjer sa të mbarosh punë do kesh nxjerë edhe qime të bardha. Pastaj një herë e shtynë davanë gjyqtarët, pesë dhjetë herë avokatët, një herë t'a lenë vjertas, njerë të bëhet batali e kû di unë, hallet e gjygjeve. Edhe fund' i fundit edhe në fitofsh gjyqin prapë do dalç me këmishën e trupit. Mblidhe mendjen.

HAJIRUDINI.

Unë s'i dëgjonj këto. Avukati im më ka siguruar se do t'a fitonj davanë.

KOSTANTINI.

Ashtu të tha? Ahere le t'a marrim pak shtruar; sa i ke dhëne avokatit?

HAJIRUDINI.

Një-zet napolona përpara.

KOSTANTINI

Një-zet napilona? Të lumtë! Çuditëm si s't'u droth dora.
Po të tjera ç'ke paguar?

HAJIRUDINI.

Një napolon për mëkamëstoren, dy napolona për rûbi-harxh, gjysmë napoloni për ca kajdiqe e regjistrime, dy napol. të tjera s'di për se ja dhashë avokatit, dy të tjera s'di pse m'i mori avokati.... Prit, prit, 10 korona për ca teblkije, 10 korona për ca pulla të tjera, 20 korona për ca.....

KOSTANTINI.

Mjaft, mjaft, e mora vesh. Pastaj do të japësh edhe kush e di sa qindra koronash të tjera për ilame, komunikime, apelime diktine e të tjera, veç që do t'i japësh edhe 20 nap. të tjera avokatit.

HAJIRUDINI.

Si urdhron.

KOSTANTINI.

Edhe prej gjithë këtyre harxheve nuk do marrësh të pestën, si kur edhe t'a fitosh davanë. Edhe davanë prapë nuk të lenë t'a fitosh plotësisht.

HAJIRUDINI.

Pse?

KOSTANTINI.

Se gjyqtarët kanë një palë gërshtë që presin nga të dy anët, se janë merhametlinj; edhe ty munt të të japin hakk edhe mua s'më lenë me duar thatë. Ahere, po të pyes, ç'kupëtove?

HAJIRUDINI, (Tyke u mentuar)

A e di se ke të drejtë? Tani po e marr vesht.

46

KOSTANTINI.

Ne miq kemi qënë edhe do të jemi, pse te prishin qef?
A e sheh ti se kot janë ngrehun gjykatoret, kot sillen e mshtil-
len avokatët edhe kot po zembrohemi me shoqi-shoqin, kur munt
t'a gjejmë vetë?

HAJIRUDINI.

Ke të drejtë, po si do t'a ndreqim?

KOSTANTINI.

Zgjedhim dy miq, dy njerës të urtë, ja u qajmë hallë si ti,
si unë me të drejtën e Zotit edhe si t'a vendosin ata ne t'a pra-
nojmë edhe heqim dorë prej gjyqeve e avokateve.

HAJIRUDINI.

Mirë thua. Qoftë për hair. (Zenë dorë shoqi-shoqit).

Këng' e Klíentevet.

(QUARTETTO).

S'n'a duhen mehqemetë,
S'n'a duhet avokat,
Davat' i ndreqim vetë,
Miqsisht e pa inat.
Davâja s'mbaron kurrë
Në gjyq e në ixhrâ
Me kode, më desturë
Harxhohen kot parâ.

Të zgjedhim pleq të urtë
Edhe me urtësi,
T'i zgjidhim çështjet butë
E jo me egërsi.
Më mirë di ç'thumbasim,
Se sa t'harxhojmë kot,
E m'andej të bërtasim
E mos e gjejmë dot.

Funt i Aktit II.

Akt III.

Parlamenti.

(Theatri çfaq divanin e Parlamentit. Për fundi, në midis. duket dera e Parlamentit. Një shumicë deputetësh janë mbledhur grumbull në divan. Organizatorët nga an' e djathtë).

SQENA 1.

DEPUTETË E ORGANIZATORË.

(Dëgjohe për brenda zilja e Parjamentit).

NJË DEPUTET.

Tink, tink, i bije ziles Presidenti,
 Pushoni se po mblidhet Parlamenti,
 Pa shihni sa të bukura salone,
 Me llozhe, ilektrika e poltrone. (bis)
 Tink e tink këmbana po dëgjohe,
 Gjith kush afrohet,
 Tink e tink këmbana po dëgjohe,
 Gjith kush nxitohet,
 Tink e tink po kërcet zilja brenda,
 O burra, zijni vent gjith kush me renda. (bis).

(Hyjnë të gjithë deputetët brenda
 për veç organizatorëvet).

ORGANIZATORËT.

(Dëgjohe^t prapë zilja)

Tink, tink, i bije ziles Presidenti,
 Pushoni, se po mblidhet Parlamenti,
 Bre, ç'janë këta burra, që po hynë,
 Si **Port-Arthurë**, si **Verdûn'** e msynë! (bis)

Tink e tink këmbana po dëgjohe^t,
 Gjith kush nxitohet,
 Tink e tink këmbana po dëgjohe^t,
 Gjith kush sheshohet,
 Tink e tank, nga dale te divâni,
 Se rzohe^t, pa n'a vret Zijâ-Toptani. (bis)

Tink, tink, i bije ziles Presidenti,
 Pushoni, se u mshtuall Parlamenti,
 Kulltuket zunë burrat Shqipëtarë,
 Pleq e të rinj, të kombit baballarë. (bis).
 Tink e tink, këmbana më s'dëgjohe^t,
 Gjith kush po çohet,
 Tink e tink, kurrkush s'kuxon të qeshin,
 Po mbajnë veshin,
 Tink, tink, tink, dëgjoni oratorët,
 Dëgjoni **progressistët, popullorët**. (bis).

Tink, tink, pushoj së rëni Presidenti,
 Sa bukur bisedon ky Parlamenti,
 Po bijen, poshtë tituj e bejlerë,
 Ka dal' **opinga** sot e bën poterë! (bis),
 Tink e tink, këmbana më s'dëgjohe^t,
 Gjith kush mentohet,
 Tink e tink, po jep e merr kuvendi,
 S'lot kush prej vendi,
 Deputetët ardhë me punue,
 Pushoni, se nuk bën me i trazue! (bis).

Tink, tink, po n'a formohen komissija,
 Po ndahen deputetët në partijs,
 Disa prej syresh mbetn' **Indipendentë**
 Si kur zakon që është në Parlamentë. (bis).
 Ligje e kanune po trajtohen,
 Kurrë s'mbarohen,
 Masa fort të rrepta po mentojnë,
 Po s'i zbatojnë,
 Komisionet s'duan të punojnë,
 Se kohën alla-turka po e shkojnë. (bis)

Tink, tink, po vonon shumë Parlamenti,
 Po duket se ve këmbën Presidenti,
 Do t'i mbarojnë punët sa me parë,
 Harron se ka përpara Shqipëtarë. (bis)
 Tink e tink u ndezë dhe kandilat,
 Dëgjo bilbilat,
 Tink e tink, sa her' e marrin fjalën,
 Prej themës dalën,
 Ah. mjerisht, që nuk n'a lenë hallet,
 Tri orë duan veç proces-verbalet (bis).

Tink. tink propozicionet po vazhdojnë,
 Ministrat ven' e vijn' e më s'pushojnë;
 Anketa bëhen mjaft parlamentare,
 Por se, mjerisht, s'ju bijen prapa fare. (bis).
 Oratorët bëjnë shumë bûjë,
 Një vërrë n'ujë,
 Flasin gërra shumë e të ralla,
 Më tepër pralla,
 Flet gjilh kush se punët krejt i ndreqi,
 Po duket se kështu n'a hëngri dreqi! (bis)

50

Koalisjoni.

SQENA 2.

FYTYRAT

NJË LLUSTRO

LLUSTRUA EDHE ORGANIZATORËT.

LLUSTRUA

(Vjen me gazeta nënë sjetull e tyke bërtitur i ndan posht' e lart, u jep edhe Organizatorevet).

Gazeta, gazeta, dorëheqja e Qëverisë Koalisjoni Prap' Iljas Vrijoni kryeministër.

(Llustrua si del një herë jashtë tyke bërtitur, hyn prapë e këndon).

Këng' e Koalisjonit.

(MUZIKË PROF. TH. NASSE)

Dha dorë-heqjen Qeverija,
Kryeministri ish premtû,
Tha, se e lypte njerezija,
Me shokët kishte bisedû,
Pa pasur shkak e arësye
E deklaroi e fjalën dhâ,
Nderin e tij për mos me fye,
Dha demisjonin edhe râ!

CHORO.

Merrni gazetatë,
Shihni të rejatë,
Flasin për Qeveri.
Për kabinetn' e ri.
Çuditi gjith kush,
Se gota u mbush,
këndoni holl,
Se gënjejnë boll.

U mblodhë shpejt partitë tërë
Me bisedû në Parlament,
Perparimtarët muar sërë
Dhe popullorët zunë vent,
Mjaft disa javë u mentuan,
Sa gjithë populli u tunt,
Kush rrintë gozhdën, kush potkuar
Dhe bisedimet s'muar funt!

CHORO

Merrni gazetatë etj. etj.

Nër grupe deputetët mblidhen,
E bëjnë lista kush e kush.
Edhe me shoqi shoqin lidhen,
E gjithë se cili listën mbush,
Edhe u pa me të vërtetë
Ç'do deputet në list' u duk
Ministra delnin gjashtë-dhjetë,
Se gjithë kush desh një kulltuk!

CHORO.

Merrni gazetatë, etj. etj.

Folë me turm e me poterë
Për ç'do ministër një nga një,
Për **Kristo Floqin e Xhaferë**
Nuk bënë zë, as thanë gjë,
Por se keta të dy të zinjte
Pa pasur faj ranë theror,
Kështu e deshnin çorbaxhinjtë
Që shkelë gjithë në lakror!

CHORO.

Merrni gazetatë etj.

Pas disa javësh u mentuan
Të bëjnë një **Koalicjon**,
Të parët gjithë i pranuan
Me një të vogël **exception**,
Edhe me qëne q'ishte vapë,
Ministra dy bënë kurban,
Robat i xhveshn' i kthyen prapë,
Katër i shtuan bisht-kopan!

CHORO.

Merrni gazetatë etj.

ORGANIZATORËT

Kulltuket u ndanë me shortë,
U shtua dhe një portofol,
U bë një Qeveri e fortë
E fjalë shum' e shum' u fol,
Po Qeverija si po duket
As katër muaj nuk qendron,
Nuk do t' i mbanjë dot kulltuket,
Merr passaportën edhe shkon.

CHORO.

Merrni gazetatë etj,

(Dalin jashtë të gjithë)

52

Komisjonet Parlamentare.

FYTYRAT

VASILI.

TAFILI.

Gazetarë.

SQENA 3.

GAZETARËT PASTAJ ORGANIZATORËT.

VASILI.

Të thashë, si vëllaj jem, ne nuk jemi bërë akoma për Parlament. Do të hamë shumë-kulaçe gjer sa të marrim vesh ç'do me thënë Parlament; po në një e një e më thelë! Nuk vë rë ti se si i kapin çastjet deputetët t'onë? Jo e lagu larëska bishtin, jo s'e lagu, jo kishte bisht, jo s'kishte edhe kështu xgjatet fjala e bëhet litar Vranje! Pa le nga ndo një herë kur marrin tatëpjetën e s'e kupëtojnë njëri-tjetrin, sa as në s'marrim vesh për se bisedojnë. Unë s'e kupëtonj dot llogjikën që përdorin.

TAFILI.

Ti s'e ke marrë vesht se ku e kanë qellimin. Ata duan të refuzen se nuk bisedojnë si ç'do njeri, po kanë një specialitet të veçantë, të cilin jo vetëm ne s'e kupëtojmë, po as ata nuk besonj t'a marrin vesh. Disa prapë flasin vetëm që të marrin titullin e oratorit. Unë një gië kupëtonj këtu që ata duan t'i bëjnë një përshtypje popullit që të mos ankohet pse marrin nga 25 gjela në muaj, përveç harxheve të tjera.

VASILI.

Po, të flasim të drejtën, kanë edhe një të mirë këta deputetët t'onë.

TAFILI.

Ç'farë të mirë?

VASILI.

Bisedojnë me gjak të ftohtë e nuk zembrohen kurrë edhe s'vjinë në personalitete, as shajnë shoqi-shoqin. Këtu në Par-

lamentin t'onë nuk ngjet si në disa Parlamente Evropiane, që kërcasin bastunet, që gjëmojnë koburet edhe që shkreptijnë kamat.

TAFILI.

Po jo ama edhe grushtet edhe bacat.

VASILI. (Tykë qeshur)

Po, po, mirë thua.

TAFILI,

A filuan ngaj puna komisjonet parlamentare?

VASILI.

Filluan për të filluar, po ç'e do s'bëhet gjë me këto!

TAFILI.

Pse s'bëhet gjë?

VASILI.

Se përveç që ç'do komisi ka nga 15 gjër më 20 deputetë, gjë që s'bëhet në Parlamentet e tjerë, se duhen të jenë edhe ca rezervë që t'i ndrojnë krye dy muajsh si edhe rezervë të tjerë për enqueta parlamentare, por këta, more zot, s'të vijnë as pak në mbledhjet, me gjithë që ju presin edhe gjoba dita me ditën. Pastaj disa deputetë janë anëtarë më dy a tre komjsjone për reklamë edhe s'vijnë në as një. Veç asaj, kur kanë orët e komjsjoneve, kanë edhe mbledhjet e veçanta të partive të tyre, e bashkë me këto, shumë deputetë marrin lëje për tebtili-hava edhe shkojnë në Evropë për tregëti e për qejfe. Si kërkon ti të mbarohen gjith' ato punë që ka Parlamenti? Pa le, ajo komisija e famëshme e budxhetit, që nuk di se kur do mbaronjë. Lere, lere ç' them, pa ç' të lè?

TAFILI. (më vehte).

Ka shumë të drejtë!

54

Këng' e komiseve parlamentare.

(MUZIKË PREJ OPER. "BEFANA").

VASILI.

Parlamenti bisedoj
Që të bëhen komisi,
Dhe ç'do deputet vendoj
Që të lozë roll' e tija
Komisi u bënë katër,
Dhe gjithçili deputet
Do punonjë jo për hatër
Po për komp edhe për shtet.

CHORO.

Parlament, Parlament,
Ti kërkon burra me ment,
Parlament, Parlament,
Ti do pun' e jo kuvent.

TAFILI.

Po, mjerisht nuk vjen njeri,
Edhe mbledhjet s'bëjnë pare,
Se për Shtet e Qeveri
Nuk e vrasin mendjen fare,
Edhe sa do që ndëshkohen

Me ca gjoba dit për dit,
Nuk mërzhiten, as dëshprohen,
Gjith kush fajn' e përsërit.

CHORO.

Parlament, Parlament,
Ti kërkon burra me ment,
etj. etj. etj.

VASILI e TAFILI

Edhe dikush vepëron
Në dy a tri komisi,
Në një s'vjen, në një mungon,
S'i le qetë as parti,
Punët mbeten, grumbullohen,
Mot' i ârtë po kalon,
Hidhju gunën të mos ftofen,
Fryji qullit se përvlon.

CHORO.

Parlament, Parlament
Ti kërkon burra me ment
etj. etj.

ORGANIZATORËT

Nga këto ne s'marrim vesh,
Nuk kuptojmë as gjë fare,
Fundin nuk munt t'ja u gjes
Lodrave Parlamentare,
Shyqyr Zotit që nuk kemi
Parlament n'Afganistan,
Si këta s'duan të jemi,

Këtu qënka një bostan.

CHORO.

Parlament, Parlament
Që punon si avliment,
Parlament, Parlament,
Të duhen njerës me ment.

Lirija e shtypit.

TAFILI. (Merr pozë oratori).

Zotërinj Organizatorë,

Mos u çuditni se shihni këtu dy gazetarë. Zotërija juaj, si njerës të qytetëruar, e dijni fort mirë ç'do me thënë shtyp. Kemi dëgjuar se, në atë vendin e fanshmë tuaj, liriya e shtypit është një sent për t'u habitur. Atje gazeta quhet gazetë!

FIRDUSTAN.

Më ndjeni, zotni, në Afganistan s'kerni gazeta!

TAFILI.

Edhé më mirë. Këtu, zotërinj, gazeta është një gjë, si t'ju them është (Vasilit). Folë, morë Vasil, se e humba.

VASILI. (Tafilit)

Shkumbini (?)

TAFILI. (Firdustanit).

Shkumbini! (Vasilit). Tjetër desha të them

VASILI. (Tafilit).

Tragzat e mullinit (?)

TAFILI. (Firdustanit).

Tragzat e mullinit! (Vasilit) Uf m'a turbullove mendjen. Më trego një mbiemër.

VASILI. (Tafilit).

Shigeta (?)

TAFILI.

Shigeta! Taman.. Shigjeta Atje në Afganistan shtypit i thonë, më duket shtyp, po këtu në Shqipëri i thonë i thonë (Vasilit). Si i thonë?

VASILI. (Tafilit)

Censurë!

56

TAFILI. (Firdustanit).

I thonë **censurë!** . . . Atje, fjala është e lirë, po këtu, "Fjala e lirë,, ndalohet edhe gazeta mbyllet. Atje gazetata, ndonse s'kini, e kritikojnë shumë ashpër qeverinë, këtu përkundrazi duhet t'a përgëdhelësh, se po i re pak më qafë, të venë haps edhe flë mbi ptoçat ose mbi çimento! Atje s'kanë lagshtinë podrumet. po këtu kanë edhe lagshtinë edhe pezhishka edhe gjithfarë agrepesh, dyzet kembësh etj. etj. insekta, prandaj përveç që merr një pleurit të shëndoshë. a një reumatismë, po shef edhe ëndra të këqija, më keq se ato (Vasilit) Kujtoje ti

VASILI. (Tafililit).

Të Nasr-u-din Hoxhës.

TAFILI.

Të Nastradin Hoxhës. Atje shtypi, sa do që s'existon, është me të vërtet fuqija e katërtë shtetnore, e këtu s'është as e katërmëdhjeta. Atje gazetata, me gjithë që s'i shihni me sÿ, këndohen prej gjithë popullit, po Shqiptarët kanë një zakon të keq që s'i këndojnë dot, se s'janë shkruar turqisht, greqisht, ose italisht. Po kanë edhe një zakon më të keq që duan t'ja u dërgosh badjavâ! E kanë për gjynah të paguajn; në mejhâne e kafehâne prishin, sa të doni, po për gazetë e për literaturë shqipe s'japin metalik! Në vendin t'uaj, kû kû (Vasilit). Ç'tju thom tani?

VASILI. (Tafilijt).

Ku analfabetismi është në urdhrin e ditës.

TAFILI. (Vasilit).

Bretku! Mos fol ashtu; këta janë organizatorët t'onë.

VASILI. (Tafililit).

Më duket se ata po organizohen prej nevej

TAFILI. (Organizatorëvet).

Zotërinj; në embër të Perëndisë, a të Perëndive që mbesoni, në embër të drëjtësisë, a të padrëjtësisë, cilëndo që prano-

ni, në embër të gjithë embrave e mbiembrave të gramatikës Af-
ganistane, kini mëshirë për ne! Mos e merrni për shaka këtë
hallin t'onë. Bindeni qeverinë t'onë për të drejtat e shtypit, të n'a
i njohë e t'i respektonjë edhe t'ju japë urdhër Shqipëtareve të
n'a paguajn pajtimet që n'a kanë, ose dóbarem paret e postës që
harxhojmë kur ja u dërgojmë gazetatat. Merrni masat e duhura, ma-
sat ligjore, sociale, republikane, bolshevikane et cetera et cete-
ra, tani, e për herë e në jetë të jetëvet. Amin! Mbarova!

Këng' e Censurës.

(MUSIKË POPULLORE).

VASILI.

Thonë se shtypi është i lirë,
Dhe ka të drejtë ç'da gazetar,
Të kritikonjë mir' e më mirë,
Si Qeverinë dhe ç'do zyrtar,
Po hëto s'janë përveç pallavra,
Dhe kush gënjehet e bën marri,
Futet në burgjet e çan petavra,
Fle mbi çimento si ashkëti.

VASILI—TAFILI.

E pastaj thonë, qinse gazetatat
Janë të lira flasin si do,
Edhe me **Tragzat** e me **Shigjetat**
Mundesh të tallesh me cilin do.
Hap sytë mirë, rruaje pendën
Dhe mati fjalët, mos u nxito,
Se pogabove shpejt egjen tenden,
Fle mbi çimenton e thret bo, bo!

TAFILI.

Edhe sheh ëndra të tmërshme
shumë
Se ka lagshtinë, ka rytybet,
Edhe shpeshërë nuk ka as gjumë,
Mërr reumatismë e gozhda pret.
Zoti n'a rrujtë e n'a shpëtoftë.
Të marrim masat ç'do gazetar,
Sepse **Censura**, lanet i qoftë,
Të pelcet brenda si kuximtar!

ORGANIZATORËT.

Jemi të lumur në vatan t'onë
Që s'ka gazeta, as punon shtyp,
Sa që të duan le të n'a thonë,
Ne nuk n'a futin kollaj në qyp.
Ne s'dijmë ç'është fuqi censure,
Hallet e dertet, ç'do që n'a dhemp
I msojmë vetëm me tevature,
Endra nuk shohim, burgu s'n'a
trem!

(Dalin të gjithë).

Aspirantët.

FYTYRAT

PASHUKU.		Aspiranta nxënës.
PATUKU.		
PANTUKU.		

SQENA 4.

ASPIRANTËT PASTAJ ORGANIZATORËT.

PASHUKU.

Ky është një turp i math që n'a ngjavi! Nuk është parë as në një analë të ushtërive të botës! Të kesh mbaruar kursin, të jesh munduar kaqe kohë e kur të preç që të dalësh aspirant të të thonë udhën e mbarë, shko ngaj ke ardhur! E pse? Për ekonomi!... Po këtë ekonomi s'e mentuan përpara këta njerës, po tani? Ku n'a dërgojnë, ku do vemi? Le që kanë të drejtë të tallen me në shokët t'onë, po do mos gjejmë as vendet që lamë, se n'a i kanë zënë të tjerët! N'a muar më qafë!

PATUKU

Ekonominë vetëm në aspirantët e gjetnë! Nuk shohin sa kolonellë, majorë, kapitanë, e togerë e nënëtogerë që kanë graduar, që u bëne më tepër oficerë se ushtarë? Shto pastaj oficerët e rëservës e oficerët bashibozukë që u mbush ushtria! Këjo është ekonomija që po bëjnë?

PANTUKU.

Mos harro edhe oficerët turçellinj që n'a vijnë ngaj Turqija e i pranojmë pa një pa dy edhe ju falim në daç, edhe uga një gradë akoma. Harrove sa na ka derguar Mustafa Qemali? Ata kujtojnë se është, çifllik Arnautllëku edhe sulen këtu për meashe si serrat! Edhe s'bëjnë as kabull të flasin shqip. Më vjën keq se marrin më qafë edhe këta t'anët, se tyke dëgjuar

59

turqishten ju vijnë nër ment të shkuarat edhe zen' e flasin edhe këta turqisht.. Pastaj presim përparim! Unë po të ishe Qeveri do t'ju këputnja gjoba të shëndosha atyreve që flasin një gjuhë të huaj pa qënë nevoja, edhe në funt do t'i çonja syrgjyn. që të msohen të nderojnë gjuhën e tyre, gjuhën e vendit!

PASHUKU.

Po tekajytët e Baba-Dovletit që e marrin edhe sot meashin? Për këta pse s'bëjnë ekonomi? Po të jetë për ndo një me-mur të shkretë që mbet sakat, ose lã lekurën e tij në detyr' e sipër, ahere të thonë s'ka ligje për pensjone e s'munt tju japim etj. etj. Sa mirë që ka ligje për tekajytët e mytevelinjët; sã mirë pë ka ligje për hemsherinjtë e mesleqdashët që marrin edhe andej edhe këtej meash! Pastaj thresin për kursim!

PATUKU.

Nuk shohin së ç'bëhet me teshat ushtriake që përveç se vjeth kush munt po edhe robat e kundrat dalin të vjetra e të mbajtura, ose letra e mukavâ? Nuk shohin sa mijë u prishnë për operacionet e Mirditës, për muaxhirët etj. etj. që u shkaktuan kot? Ku është kursimi? Kush lypi responsabilitët për këto?

PANTUKU.

Të drejtë ke, po t'i s'e ke marrë vesht, se këtu sundon klika e jo llogjika? Për çështje personale që kanë me njeri-jatrin, n'a presin nevej kryet. Nuk dijnë ata se ku bëhet kursimi? Nuk di Intendenca se cila është ekonomija? Ata janë ustallarë, morë djalë, po ti je i ri e s'di gjë!

PATUKU.

Kë të drejtë, tani po e marr vesht.

PANTUKU.

Duhet kontroll, kontroll, kontroll, e more vesht? Po s'u vu kontroll gjithënjë kështu do të jetë "rëmbë të rëmbëjmë,,.

60

Këng' e aspirantëvet.

(MUSIKË POPULLORE). TRIO.

Pa një shkak të mjerët,
Po n'a presin krerët,
S'jemi si të tjerët,
Hall i math për né.
Disa komandantë,
Për shkak të veçantë,
S'duan aspirantë,
Kursi n'a u pré!

Sot ku n'a dërgojnë,
As ata s'mejtojnë,
S'dijnë si punojnë,
Dreqi i merr vesh,
Vallë s'i të themi,
Kû në dreq do vemi,
S'gjendet dot mejlemi,
Mbetmë krejt në shesh!

Për ekonominë
Prishnë Shqipërinë,
E bënë lëndinë,
Sa nuk ka lezet,
Dhe nga anë tjetër
Prishin me të tepër,
Edhe për ç'do gjepër
S'kanë kasavet.

Shumat që po shkojnë
Kurrë s'i kujtojnë,
Veç për ne mentojnë
Se bëhet kursim,
Osmanllinj pranojnë,
Dit për dit gradojnë,
Ç'të duan punojnë,
Kanë mjaft kuxim.

S'kanë ushetarë
Aq sa zabitllarë,
Gjëkunt c'është parë
Veç në Shqipëri,
Kështu si po vemi
Gjë në torbë s'kemi
S'dijnë si do jemi
Me këtë ushtri!

Për kursim bërtasin,
Po të gjith' i nqasin,
Edhe pastaj thrasin,
Po gjith kush harron
Sot për sot krekohen
Po nuku mentohen
Se parat' harxhohen
E Shteti sharron!

ORGANIZATORËT.

Sa qënkan të marrë
Këta Shqipëtarë,
Paskan zabitllarë
E jo ushtëri,

E s'mentohen pakë
Që ca Turkushakë,
Po marrin kot hakë
Brenda në Shqipri.

Me ç'n'a shohin sytë,
S'paskan shok të dytë,
Hëngërkan ç'do frytë
N'Arnautistân,

Këto s'i durojmë,
As që i dëgjojmë
Më mirë të shkojmë
Në Afganistân!

(Dalin jashtë të gjithë.

Grupi i shëjtë.

FYTYRAT

SERAFIMI.		Deputet progresist
IBRAHIMI.	o	Deputet popullor.
GJERASIMI.		Deputet independent.

SQENA 5.

DEPUTETËT M'ANDEJ ORGANIZATORËT.

SERAFIMI.

Tani t'i lemë shakatë. Ne e shohim që po kundërshtojmë shoqi-shoqin në Parlament, edhe kështu në vent t'i sjellim një dobi atdheut për kundrazi i bijem një dëm të math. Të gjithë më duket se jemi në një mendje për të rëzuar Qeverinë, po nuk n'a lenë ambicjonet e interesat t'ona personale. Këto duhet t'i lemë më një anë e të bashkohemi. Të kemi gjak të ftohtë e t'a marrim punën shtruar. Si thoni?

TË TJERËT.

Edhe ne atë dëshërojmë.

SERAFIMI.

Pra, unë, tyke ditur që po t'ja lemë njërës, ose tjetrës parti të formojë Qeverinë, munt të punojë me hatër e n'a futin ca persone që s'janë të zotët, e kështu prapë do kërkohet t'a

62

rezojmë Qeverinë, them se po të vazhdojmë kështu që në njërin krizë në tjetrën nuk mbarojmë kurrë edhe Shtetin e vemë në një rrezik të math. Eshtë kështu?

TË TJERËT.

Si urdhron.

SERAFIMI.

Ahere m'a dëgjoni një fjalë?

IBRAHIMI.

Urdhro, folë.

SERAFIMI.

Unë thom të bashkohemi të gjitha partitë e të formojmë një "Grup të shëjtë". Pastaj të zgjedhim tre burra patriotë të paanëshmë e atyre t'ja u lemë në dorë fatin e Shtetit. Ata le të zgjedhin një kabinet si që t'ja u marrë mendja e kështu s'ka se kush ankohet. Ju pëlqen kjo mendje?

TË TJERËT.

Pranohet.

SERAFIMI.

Pra, le të lajmëronjë gjith se cili partin' e vet edhe son-te mblidhemi në Parlament e vendosim edhe nënshkruajm protokollin, tyke zgjedhur edhe triumvirinë, të tre burrat d. m. th., patriotë e të paanëshmë.

TË TJERËT.

Shumë bukur. Rroftë grupi i shëjtë!

Këng' e grupit të shêjtë.

(MUSIKË "MASCOTTE").

SERAFIMI.

Prajni, bre burra, s'ka lezët,	Duhet të bëjmë Qeveri.
Po ja u thom si dëputetë	Me sa të mundim ideâle,
Tash e kam gjet një marifet	Të lemë ç'do armiçësi
Se si t'a shkojm' ujen përpjetë.	Edhe ç'do çeshtje peasonale.

VALLJA.

Kështu nuk vepërohet
 Me lodra, me parti,
 Me gjepura nuk shkohet
 Për vëç se me urti.
Tii, tii, tii, ti. (bis).

VALLJA.

T'a lemë fatin t'onë
 Në një triumvirî
 Edhe ata më vonë,
 Të ngrehin Qeveri.
Rii, rii, rii, ri, (bis).

Gjithë se cili deputet	Me gjak të ftoht' e qetësi
Të mbledhë mendjen të mentohet,	Duhet që sot të përfitojmë,
Se ndryshe hupi krejt ky Shtet,	Të hyjmë gjithë në vasi
Pastaj, për Zotin, do pendohet.	Edhe kështu të vepërojmë.

VALLJA.

Si burra Shqipëtarë
 Të lidhim një kuvent,
 Partitë sa më parë
 Të bëjmë grupn' e shent,
 Sheent, sheent, sheent, sheent.
(bis)

VALLIA.

Ata le të n'a zgjedhin
 Ministra, kabinet,
 Prej rrugash le ti mbledhin,
 Nuk bëhet kijamet!
Meet, meet, meet, met. (bjs)

(Dalin deputetët).

64

ORGANIZATORËT.

U shtryth ç'do grup e ç'do parti	Edhe me brohori
E u formua "grup' i shenjtë,,	Votën me zor e hodhë
Me bujë shum' e batërdi	Për kabinetn' e ri.
U rrukullisnë të mbëdhenjtë.	Rii, rii, rii, ri. (bis).

VALLJA.

Ra prap' Ilias Vrijoni	Edhe kabina u formua,
Me interpelasjôn ,	Po me tri këmbë e pa bisht,
U shduk Koalisjoni	Edhe për pak ment u rëzua,
Vetëm me një mosjon	Se dikush kishte brenda gisht.
Sjoon, sjoon, sjoon, sjon (bis).	

VALLJA

U zgjoth një Qeveri e rë,	Kështu kabina ngeli,
Kryeministri po si trimi	Nuk u plotsua dot,
Gjyzlykët për mbi hënd' i vë	Po Panteli Vangjeli
Edhe kërkon votë-besimi.	Ësht' optimist e s'lot!
	S'loot, s'loot, s'loot, s'lot.
	(bis)

VALLJA.

Dy-zet mezi q'u mblodhë

(Dalin jashtë).

Coup d'Etat N. 1.

SQENA 6.

(Disa deputetë po bisedojnë jashtë Parlamentit bashkë me kryetarin e këshillit kombëtar).

DEPUTET I I.

Psé këjo mbledhje kështu jashtë zakonit?

DEPUTET I II.

Nuk dijmë ç'ngjet.

DEPUTET I I.

Lé të n'a thotë z. Kryetar për se n'a thiri.

KRYETARI.

Edhé unë nuk di mirë për se është kjo mbledhje, po mbase si më lajmoj z. Kryeministër, ju lajmova edhe unë juve të vijni këtu.

DEPUTET I II.

Zoti kryetar s'është punë të mos dijë psé n'a thiri!

KRYETARI.

Për nder, po ju thom, që nuk di gjë. Mua më duket se do n'a tregonjë Kryeministri qysh e plotësoj kabinën edhe si do bashkëpunonjë, ose do n'a kallzonjë situacionin politik të përjashtmin. Kështu një sent ka me qënë, ndryshe s'm'a merr mendja. Po ju urdhroni brenda edhe tani vjen Kryeministri me shokët e tij e do t'a marrim vesht. (hyjnë të gjithë brenda).

NJË LLUSTRO.

(Del me gazetata në dorë e bërtet). Shtojca e gazetës, shtojcaaa..... mbyllja e Parlamentit..... kundrështimet e deputetëve..... Çelja e Parlamentit më një të Janarit..... shtojcaaaa..... (Shpërndan nga një kopje organizatorëve edhe pastaj fillon të këndojë).

Këng' e Coup d'Etat-së.

(MUSIKË POPULLORE).

Kush pandehte, kush kujtonte
 Gjith këtë dumbarallëk
 Edhë kujt ndër ment i shkonte
 Se do ish **kudetallëk!**
 Na u mbyll kështu pa pritur
 Parlamenti me dekret
 Eehë deputenjt e ditur
 E pësuan me t'vërtet.

Thonë, qinse kabineti
 Me regjent u muar vesh
 E ju lut, më qaf' i mbeti
 Që mos mbetej krejt në shesh.
 Kishte frikë se mos binte
 Se e pa që s'kish besim
 Dhe kultuket mos i linte
 Pra e bëri këtë guxim.

Deputetët sërë-sërë
 Ardhë gjith' e zunë vent,
 Po tertipin q'ishte bërë
 As njeri s'e shkoj ndër ment.
 Deklaratat' e Qeverisë
 Si një bombë midis rã,
 Dhe ç'do grûpit e partisë
 I arth po si një dambllã!

67

Deputetët protestuan
 Për këtë **Coup d'Etat-llëk**,
 Ashpër shum' e kritikuan,
 Bënë mjaft kallaballëk,
 Thanë q'është një mynxirë
 Që s'ka ngjarë as gjëkunt,
 Po disave ju arth mirë,
 E pranuan, morri funt.

Kshill' i Kombit nuk përgjungjet,
 Nuk dëgjon as një dekret,
 As një urdhri nuk i unjet,
 Vepëron si që di vet,
 Dhe cakton një ditë tjetër
 Për të mbledhur në kuvent,
 Nuku shkon pas modhës s'vjetër
 Po, punon si Parlament!

Bisedimet i shkurtovi,
 Gjithë ligjet i mbaroj
 Dhe buhxhetin s'e harrovi,
 Me një frymë e votoj,
 Dhe për rregullin e formës
 Tha "Statuti n'a u shkel,"
 E i fryri pakëz çorbës
 Duart lan, për jashta del. (del Llustrua).

ORGANIZATORËT.

Bré, të mjerët deputetë
 Ç' e pësuan me shaká
 Hëngërn grusht me të vërtetë
 Shkelmë-Shteti, **Coup d'Etat!**

68

Po t'a dijnin **sadrivaçin**
Nuk do vijnin në kuvent,
Do të merrnin shpejt kërbaçin,
Do t'ja gjejnin ndo një bent.

Parlamenti ha shuplakën,
Qeverija j'a punoj
Dhe Regjentat muarn hakkën
Komedija kshtu mbaroj;
Deputetët u shperndanë,
Çaré tjetër nuku kish,
Dhe kryeqytetin lanë,
Për byrek hëngërn çervish!

FUNDI I AKTËT III.

Akt i IV.

Coup d' Etat N. 2.

FYTYRAT

AVNIU |
GANIU | Nëpunës

SQENA 1.

KËTA EDHË ORGANIZATORËT.

AVNIU.

(Del nga an' e djathtë me një fanar të ndezur në dorë).
S'paska njeri!... Si bëhet kështu?.... Shteti sot ka nevojë për njerës, ku janë njerëzit?

GANIU.

(Del nga an' e rëmakte gjith' ashtu me një fanar në dorë).
Çudi e madhe! Ngaj do të vertitesh nuk sheh njeri! Edhe në që kemi nevojë për njerës ku t' i do gjejmë sot?

AVNIU. (Tyke parë Ganinë).

Ti Gani jé?

GANIU.

Si urdhron.

AVNIU.

Ç'dashke këtu këtë orë?

GANIU.

Po t' i ç'kërkon?

AVNIU.

Unë dua njeri.

70

GANIU

Edhë unë dua njerës!

AVNIU.

Po me fanar po i kërkon?

GANIU.

Me fanar edhë mezi! Kur s'i gjejmë dot ditën lipset t'i kërkojmë natën.

AVNIU.

Për se i kërkon?

GANIU.

Pyet për sé, si kur s'e di? Për të formuar kabinetin e ri, për se tjetër. Nuk more vesh që rã prapë kabineti?

AVNIU.

Ra prapë, the? Po ç'janë këto punë kështu, si kur lozin me cingla? Eshhtë koha për të ndruar kabinete, si kur janë kë-mishë e ndrohen për javë?

GANIU.

Akoma s'i ké kupëtuat ambicjonet e Shqipëtarëve?

AVNIU.

Po kaqe të verbër janë e s'e shohin rrezikun e Shtetit, që me ndrimet e shpeshta të kabineteve bëhemi qepazë në sýt e botës e më fort të armiqve?

GANIU.

Ah, mor djalë, a thna se janë të marrë politikanët t'onë e s'i kuptojnë këto? Të thashë, i ka verbuar ambicjoni sot e janë si të dehur; mumt t'i venë edhë zjarin shtepisë së tyre edhë prapë të mos e kenë për kasavet! Dikur do t'i gjenjë mushka drutë, po sa parë bën!

AVNIU.

Po kush thua se munt të thiret për kryeministër?

GANIU.

Kush të muntjnë; Qazim Koculi, Hassan Preshtina, Idhomené Kosturi, unë, ti.....

AVNIU. (i pret fjaiën).

Si thë, si thë, unë edhe ti? Ha, ha, ha!

GANIU. (Seriozisht)

Psé qesh? A s'e mbeson? Kështu si kanë filluar ndrimet e kabinetit a thua se domos n'a vinjë edhe nevej radha? Të jesh i sigurt, po t'a them.

AVNIU.

Nuk ishte më mirë t'a caktonin me radhë këta politikanët t'onë, një muaj të mernin Qeverinë disa një muaj tjetër të tjerë e gjithë kështu? Si thua?

GANIU.

Ajo do ish m'e mira ngaj të gjitha; po unë thom, se po të vlijej një ligje që ministrat të mos mernin rrogë, nuk do guxonte njeri të merrtë portofol.

AVNIU.

Atë mos e thuaj, se janë shumë që e bëjnë për titull e madhni. e jo për të holla.

72

Këng' e nëpunësvet.

(MUZIKË PREJ PROF. TH. NASSIT) DUETTO.

Ahmet Dakli, Zija Dibra, tyke bërë itifak
Nga kabina e **Vangjelit** hoqnë dorë pa një shkak,
Kabineti mbeti prapë veç me krye e pa bisht,
Se s'e lanë kundrështarët q'aty brenda kishin gisht,

Holla, lla, holla, lla,
Panteliu ra në belë,
Holla lla, holla lla,
Kabineti prapë rã.

I gjen shkak këshill' e naltë, demisjon i propozon,
Sepsë shokë s'ka të mjaftë dhe kabina po çalon,
E me lutje e kërcnime **Pantelinë** e shtërngon
Dorë-heqjen shpejt t'a japë, interesi (?) e kërkon!
Holla, lla, holla lla
etj. etj. etj.

Kot po thresin dy ministra se këshilla ka gabim,
Se kabina nuk heq dorë, mbasi ka vote-besim;
Po këshilla vuri këmbë, **Ramis Daci** vet' e vjen,
Panteli Vangjel' e bindin, dorë heq, se puna zjen.
Holla lla etj.

Panteliu u tut i shkreti, se ushtare rotull pã,
Protestoj nga njera anë, po edhe kulltukn' e lã.
Del në mest **Qazim Koculi**, një shishman, mnstaqe-zi,
Dhe kryministër bëhet, ndan ushtrin' e sjell qetsi.
Holla, lla etj.

Lëmshi zû të ngatërohet, po Koculi, sý shkëndi
E kuptoj se nuk qendronte edhe tha me qesëndi,
Se, zëvendës do të mbetet sa te marrë kriza funt,
"Unë tha, jam i marines, si kryeministër s'munt!.,
Holla, lla, holla, lla,
etj. etj. etj.

Po këshill' e nalte prapë prej qellimit s'hiqet dot
Edhë thret **Hassan Preshtinën** e i tha "të bëra zot,
"Ti do jesh kryeministër, merri masat që tani
"Mos kujtojnë kundreshtarët se në hamë mish-jani!
Holla, lla etj. etj.

Me të shpejt' Hassan Prishtina gjithë Shqipërin' e mbush
Se u bë kryeministër dhe do bindet gjithë kush,
Tha se do sundojë ndryshe, është adil' e kanuni
E s'ha dardha e gorrica, as pilaf e kabuni!
Holla, lla etj. etj.

Kryetar' i Parlamentit do të çelë shpejt kuvent
E lajmohen deputetët ku do jan' e më ç'do vent,
Qeverija ju kercnohet, telegrafet gjith' i mban
Edhë deputetet tremben edhë ikin n'Elbasan.
Holla, lla etj. etj.

Kapitan **Osman Gazepin** e rrethovi **Zijâ-Beu**,
Po ky nuk u dha në dorë dhe ablokon e shbërtheu
Ushtria e Tiranës të dy Krabat i kaloj
Dhe fuqija militare n'Elbasan zû vent, qendroj.
Holla, lla, holla, lla,
etj. etj. etj,

Hassan Beu e ç'pall një urdhën për firarët deputet
Gjail' a dek' t'i bijen prapë, pa makar të bëhet det,
Por se popull' i Tiranës me një zë i kundreshtoj
Edhë ç'do nëpunës tjetër la detyrën, protestoj.
Holla, lla, etj. etj.

Hassan beu dha dorëheqjen edhë si për kryetar
Zgjodh' **Idhomené Kosturin**, q'ish në Durrës nje tregtar;
Mbi ato erth **Ahmet Zogu**, dhe qetsi mbretroj gjithkunt
Parlamenti kthevi prapë edhë kriza mori funt.
Holla, lla, etj. etj.

(Dalin nëpunësit).

Kulltuket.

FYTYRAT

NJË POLITIKAN.

SQENA 2.

POLITIKANI, ORGANIZATORËT

POLITIKANI.

Këjo Perëndi punokërka me hatër, tani e kupëtova. Kur u bë Shqipëria Shtet mezi që gjetmë ca pashallarë e ca bejlerë oxhakësh që i bëmë ministra edhe formuan një qeveri. E mbanj ment që kishim rënë ne pikë të hallit ahëre, që si do bënim e ku do t'i gjejmë ministrat e tjerë, në qofte se deshëm të ndronim gjellë, do me thënë të rëzonim qeverinë e te formonim një qeveri tjetër. Kujtonim se nuk do gjendeshin njerës të tjerë që e kanë si zanat politikën. Po lavdi i qoftë Kongresit të Lushnjës që na i çeli pak shtë e n'a zgjoj prej gjumit. Besa po shumë u ngushëlluam kur pamë se në Shqipëri munt të gjenden jo vetëm ministra, po edhe kryeministra. Mirë po, qysh ahëre puna ka marrë zjar edhe mbassi dolli në shesht edhe ky Parlamentarizmi, zunë ministrat të dalin si kërpudhurat në maj! Bëni hesap që ahërë sa herë u ndrua kabineti edhe sa ministra kanë dalë gjer më sot. Edhë sa do të dalin,..... si fara e sinapit, edhe pastaj thonë që Shqipëria s'ka ministra! Në krye vijej ré që si ministra të zgjitheshin njerës shkollarë më msime të nalta, me diploma et cetera. Po si muarm pak yrysh e n'a dolli turpi, filluam të bëjmë ministra me diploma e pa diploma, me msime të nalta e me msime të mesme, të zottë e të pazottë, të njojtun e të pa njojtun, e dal nga dale do t'a bëjmë si Mal' i Zi tjetër herë, që s'mbet shtrazar e vojvodë pa u bërë ministër! Do vemë domethënë ata që do politika e jo ata që do arësyja..... Në Shqiptarët jemi edhe pak të çuditshëm.. Në qoftë që kë kapacitet b. f. për Arësim, të bëjnë ministër të Financave, në qoftë se

kë për Drejtesi të bëjnë ministrin e Arësimit, në qoftë se kë specialitet për administratë të hedhin në punët botore! Vërtet, shyqyr që u formua edhe këjo ministri e P. Botore që në kohë të Koalicjonit që. kështu s'mbetët njeri pa u kënaqur.... Ngjet edhe një tjetër çudi me në Shqiptarët edhe ju lutem vijnani veshin. Marrim një zotni edhe e vemë ministër, në Financë, në Arësim, në Drejtesi a ku të duash thuaj. Erifi, pa një pa dy, shtrihet mbi kulltukun ministerial edhe fillon e pret vizita, jep urdhna, tregohet se i di të gjitha, s'pyet njeri, s'peshon njeri, fryhet, kapardiset etj. etj. e s'thotë do barem, more zotninj unë s'jam për këtë punë, kot më zgjothtë, kot m'a ngarkuat për barrë, unë jam për tregëti, a për bulqësi, (sikurse kish kurajon të thotë një here dikush) nuk thotë kështu po zapton kulltukun edhe me azallah se e lëshon gjer sa t'a lëshonjë kulltuku atë! Po këjo me se hahet? Zoti n'a rrujtë në ketë Shqypnin Arbënore!... Dale, dale, se ka edhe më!..... Nuk i harrin zotit ministër që nuk ka malumât për sendet që i përkasin po zë mson edhe ata që kanë malumat e që munt t'a mësojnë shkelqesin' e tij! Po lë gjith' e gjithë, po shumë herë s'të jep as vathtin edhe do të dërsish gjer të marrësh lëjen t'ja shosh pak fytyrën!..... Po un' i shkreti ç'të them që me gjithë kalitetet që kam nuk u bëra një herë ministër? Thres, bërtas se jam i zoti' bosh s'm'a vé veshin njeri! Vé njerës të tjerë që të ma përgatitin një kulltuk, bosh! s'ka kulltuk për mua! E kërkoni me harzullah? s'ka, me gazeta? niënte! me rixhâ ollmâs! Hall' i math, mbeta pa kulltuk!!

76

Këng' e kulltukevet.

(MUZIKË E PROF. TH. NASSIT).

<p>Ah, përsé s'më ndihmoj fati Do të çirrem, do bërtas, Kështu qënka taksirati? Nuk duronj. do të pëlças! Një kulltuk ministorigje Nuk m'a dhan' e lypa kot, S'mora dot nje sandalligje E me vjen të qanj me lott!</p> <hr/> <p>Se u bë kjo Shqipërija Shtet më vehte, Qeverí, Tetë, plot ministorigja Mua nuk më ftoj njerí! Kot u ndrua Kabineti Shtatë herë më një mot, Veç per mua vent nuk mbeti, Një port-fol s'e mora dot!</p> <hr/> <p>Hall i math me këta Shqiptarët, Nuku munt t'i marrësh vesh, Si të vegjlit si te parët Janë bërë një përshesh! Se si bëjn' e si punojnë Edhë unë nuk e di, Se si dreqin i krijojnë Kaq ministra per çudi!</p> <hr/> <p>Ç' do Shqiptar që di me shkrue, Ç' do politikan i ri, Esh' i zoti me veprue Si ministër në Shqipri!</p>	<p>Matrapaz' e tregëtarë, Çertexhinj edhë bakaj, Terëzinj e farkëtarë Duan kulltuk paskëtaj!</p> <hr/> <p>Deputet' e misjonarë, Ç' do nëpunës, ç' do qatip, Msuës, ose kujdestarë E disa që s'dijn' as shqip, Për kulltuket lenë jeten, Kanë dert. kanë marras, Gjithë kush e do kuletën, O kû, kû, më vjen të thras!</p> <hr/> <p>Hajde brë, si n'a shkoj filli, Ç' do njeri n'a ka zill, Sulet për kulltuk gjithcilli, Si i marr' e si deli! Ku do gjenden kaq kulltuke Për ç' do burrë Shqiptar? Janë llokma. a suxhuke, Qe i ha ç' do guximtar?</p> <hr/> <p>Si ndryshuan krejt fytyrë Ministritë ne Shpypni, Nuk e marrin për detyrë, Po për titull e madhni! Ex-ministër veç të quhet, Lé të jet' analfabet, Tjetër kualitet s'të duhet Që të jesh njeri për Shtet!</p>
--	---

Mblithni mendjen, mor të gjorë,
 Mos u bëni serseri
 Kulltuket s'janë lakrorë
 Që mbush barkun ç'do njeri!
 Do t'a kesh pakëz në thua
 Si një zëje, një zanat,
 Ndryshe o lum' e përuea
 Mos u bëj hoxhë në fshat.

Portofolet ishin nj' herë
 Për bejlerët imtijâz,
 Se opinga ish e mjerë
 Si llahutë pa avâz,

Po si mori pakëz forë
 Edhë ngjeu bishtin në mjell,
 Mbi kulltuket vuri dorë
 E tani n'a sjell, n'a mshtjell!

Si trifili në pranverë,
 A si vaji në lakror
 U përhap sa kaqë-herë
 Opingari madhështor,
 Dhë këta më ngjan se janë
 Nga bejlerët më dajinj,
 Mos të gjejmë dhe belanë
 Prej bejlerëve të rinj!

(Dei Politikani).

ORGANIZATORËT.

Tash e marrim vesh më mirë
 Si punon ky Shtet i ri,
 Gjithë kush paska dëshirë
 Për kulltuk, për ministri;
 Si po duket e si shihet,
 Qënkam gjithë barabâr,
 Mbi kulltuk dashka të shtrihet
 Gjithsecili Shqipetar!

Sa çudira n'a shesh syri,
 Me këta qënka tuhaf,
 Si pashaj edhe mydyri
 Mbajtkan gjithë një qylaf,
 Kulltuk njëri, kulltuk tjetri,
 Për kulltuk gjithkush po thret,
 Kulltuk Pali, kulltuk Pjetri,
 Cani, Ceni kulltuk pret!

(Dalin Organizatorët).

78

Klikat.

FYTYRAT.

BANUSHI. |
 PETRUSHI. | Njerës prej popullit.
 ALUSHI. |

SQENA 3.

KËTA, PASTAJ ORGANIZATORËT.

BANUSHI.

Desh Zoti e shpëtuam ngaj Grekët e nga Serbët. Vendet t'ona n'a u lëshuan, kufitë n'a u caktuan edhe Shteti Shqipëtar n'a u njojt de jure e de facto prej shumë Fuqive.

PETRUSHI.

Për atë t'i falemi Zotit dit' e natë. Fat më të mirë se ka pasur këjo Shqipëri s'ka pasur as një Shtet tjetër!

ALUSHI.

More, të mira e të shënjtja të gjitha këto, po, unë kujtonj se rreziku m'i math për Shqipërinë është tani. Nuk harrin që shpëtojnë Shqipërija ngaj thonjt' e të huajve, po duhet të shpëtonjë edhe ngaj thonjt' e Shqipëtarëve. Armiq më të mbëdhenj për Shqipërinë janë vetë Shqiptarët, se këta i kë brenda e s'ke si rruhesh. Mua kështu më duket.

BANUSHI.

Po cili ajy i marrë që do të nxjerë syt' e tija? Esht' e mundur Shqipëtarit të mos dojë Shqipërinë e të punonjë për dëm të vet? Këjo është një vetë-vrasje!

ALUSHI.

Më vjen keq që jini të riyn e s' e kupëtoni rëndësin' e fjalëve të mija. Nuk shihni dit për dit se ç'roll lozin këtu propagandat e huaja? Të huajt, pa pasur shokë Shqipëtarë, munt

të vepërojnë në Shqipëri? Kurrë! Nuk shihni, pastaj ç'bëhet në administratën t'onë. po thuaj së në të gjitha degat? Një njeri që s'di të qitë shtë, ndjekës gjer djë i nacionalistëve shqipëtarë, xhon-turk, gjakpiës, psë ka mikun e vet në Qeveri, akraban' e tij në Parlament a kû të thuash, zë shkallën me të naltë të Shtetit, merr nëpunësinë më të mirë në Qeveri! Nuk shëkoni se, ata që s'kanë lënë gjë pa bërë, ata sabikallinjë gjithënjë preferohen në memurijetet, kur se ata të mentshmët, të urtët, të ndershmët vijnë rotull e s'gjejnë as një punë? Sot për të marrë një nëpunësi duhet të përdorësh ç'do mjetë të ligjshme e të paligjëshme, të jesh mësallë me dy palë faqe, t'ju bësh një mijë komplimenta të mbëdhenjve, t'ju shkundësh pluhurin t'ju ngresh bastunin kur ju bijë në dhë, t'ju ndimosh kur veshin pallton ose mbathin galloshet, a llastikat, e t'ju fshish nga ndo një herë edhe këpucët, me një fjalë duhet të mos kesh karakter e prestizh burri, e më fort, mos harroni, duhet të jesh **robi i klikës**; a dijni ç'do me thënë **klikë**?

TË TJERËT.

Jo, pa n'a thuaj.

ALUSHI.

Klikë do me thënë njerës të zott a të pa zotët, thuaj si të duash, që për interesa personale janë lidhur kokë më kokë, përkrahin njëri-jatrin, shtypin çiltazi. osë tërthorazi ç'do kundrësh-tarin e tyre. përdorojnë gjithë farë mjetësh si e si t'i harijnë qellimit të tyne e janë gati të bëjnë flii e theror edhe ato interesat vitale të Shtetit, harrin vetëm të mbushim dëshirat e tyre.

PETRUSHI.

Po si bëhet kështu?

ALUSHI.

Ja, se si. Me që kanë fuqinë në dorë përpiqen të venë në punë ca njerës të dobët që s'kanë as pak ndjenja jo vetëm kombëtare, po as njerëzore. I shtijen në punë që t'i përdorojnë

80

si vegla të verbra të interesave të tyre, i lenë të bëjnë ç'do paudhësi e të keqe, harrin të kënaqen miqt' e tyrë e t'ju shtohen duvaxhinjtë; ehhë kur ankon populli kundra ca memurëve të hëtitllë, klikanët patronë jo vetëm ja u mbulojnë të gjitha poshtërsit' e tyre, po edhe i mburrin për para Qeverisë për hyneret e bukura që veperojnë, tyke e qitur popullin pa të drejtë. Kësaj i thonë **klikë!** E muart vesh?

TË TJERËT.

Si urdhron.

ALUSHI.

Klikën e gjen ku do që t'a kërkosh, në daç në Qeveri, në daç në Parlament, në daç në degat e ndryshme të Administratës. Në qoftë se s'del një Qeveri kombëtare t'i çrënjosë klikat, frikë kam se mos n'a prishet Shqipëria. Edhë populli ka s'edhë lé t'i diktonjë që t'i njohë edhe Qeverija edhe ç'do njeri tjetër. Tani po ju pyes, a janë patriotë klikanët?

PETRUSHI.

As pak!

BANUSHI.

Po të ishin njëment patriotë do zgjidhnin ata më patriotët e më të zotët për degat administratore e do bashkëpunonin më ata, ose do t'ja u lëshonin vendet atyre.

ALUSHI.

Taman. Po të mos ushqenin qellime të dobëta, po të kishin karakter e t'i losnin kartat çiltazi nuk bëheshin këto që bëhen. Unë s'munt t'ja u përshkruan një nga një se ç'bëjnë klikanët. veç këtë të dijni që ata s'lenë vegël pa përdorur, s'lenë gur mbi gur edhe s'flenë as nat' as ditë. Rrujuni, pra, edhe merrni masat kontra këtyne.

PETRUSHI. (Më vehtë).

Brë, brë ç'po n'a dëgjojnë veshët!

BANUSHI. (Më vehte).

Tani e marr vesht se psë lipset të shpëtojmë Shqipërinë
prej Shqipëtarëve!

ALUSHI.

E pra, kijni mendjen e hapni sytë.

Këng' e Klikavet.

(MUZIKË E PROF. TH. NASSIT).

ALUSHI.

Sa me marifet punojnë
Do Sqiptarë të mbëdhenj
Sa mjeshtri që përdorojnë
Sa na bëjnë budallenj!
Janë lidhur me një fjalë
Shoq me shoq e bisht-për-bisht,
Dhe forcohen dal-nga-dalë,
Dhe punojnë tinëzisht.

CHORO.

Klika, klika, klika, klika,
Na ka marrë tepër frika,
Klika, klika, klika, klika,
Sundon klika, jo llogjika.

PETRUSHI.

Interesat personale
Po i shtynë tepër lark,
Shkelin sende ideale
Veç të mbushin xhep e bark.
Gjithënjë përpara dalin
Shoqi-shoqit i del zot,
Ç'do mekat e faj i falin
E në presh nuk i zë dot!

CHORO.

Klika, klika etj. etj.

S'kanë sendër e namustër,
S'kanë ndjenjë, as vixhdan,
Veç një bojë e një llustër
Edhë shpirt të zî, katran.

Edhë shtijen kot në punë
Parasit e sharlatan,
Ju mbulojnë turp e dhunë
Mos t'ju dalin në mejdan!
Klika, klika etj. etj.

ALUSHI.

Tradhëtorë e gjakpirës
E katil' e faqe-zinj,
Edhë ç'do çanak-lëpirës
E disa **sabikallinj**

Gjejnë shpejt memurijete
Po bashkohen me këta,
Kush vé ré mesulijete
Xhinajët, ose hatat!
Klika. klika etj. etj.

82

PETRUSHI.

Ku të shkon patriotismi,
 Zotësija s'bën parâ.
 Ndjenjat e atdhetarismi
 Sot të lenë fukarâ!
 Nuk do **Klika** patriotë,
 Se, kallaji del në shesh
 E **Klikanët** idiotë
 S'kanë qef t'i marrësh vesh!
 Klika, klika, etj. etj.

BANUSHI.

Duhesh të jesh një mësallë,
 Faqe dy palë të kesh,
 Të dish si t'a sjellsh vërdallë,
 E pastaj punë të gjesh,
 Se, për ndryshe po gabove
 E tregon atdhetari,
 Rruaju se e pësove
 E në burg s'të sheh njeri.
 Klika, klika etj. etj.

ALUSHI.

Që të marrë frë në dorë,
 Që të vinjë në fuqi,
 Sa mundohet klik' e gjorë,
 Me sa mijë dhelpëri,
 E kur merr pastaj fuqinë
 Mjeri ti shko gjej folë,
 Klika është një maqinë
 Që rehat kurrë s'të lé!
 Klika, klika etj. etj.

TË TRE BASHKARISHT.

Po si dreqi ngaj temjani,
 Klika rruhet e gjyrmon,
 Edhë natën, si shejtani
 Posht' e lart ajo vepron.
 Edhë kur t'a gjen volinë
 Të punon ç'do pabesi,
 Nuk mentohet për Shqiprinë,
 As për komp e kombësi!

CHORO.

Klika, klika, klika, klika,
 Na ka marrë tepër frika,
 Klika, klika, klika, klika,
 Sundon klika, jo llogjika.

(Dalin jashtë populli).

ORGANIZATORËT.

Në Shqypni paska klianë,
 Në tani e marrim vesh,
 Në këta politikanë
 Sa rëmon gjithë do gjesh.
 Nuku është gjë armiku
 Qe del sheshit të lufton,
 Po i klikavë rreziku
 Shtetin krejt e copëton.

CHORO.

Klika, klika, klika. klika,
 Për një ment të marka frika
 Klika, klika, klika, klika,
 Kështu bëhet politika.

Rrugini nga intrigantët
 E mos rijni në qetsí,
 Dijnë shumë fabrikantët
 Dhelpëri e dreqësi.
 Janë tepër të rrezikshmë,
 Janë tepër të këqinj,
 Të dyshimshmë e të frikshmë
 Jan' yëna, gjarpërinj.

CHORO.

Klika, klika, klika, klika,
 Për një ment të marka frika,
 Klika, klika, klika, klika.
 Kështu bëhet politika.

(Dalin Organizatorët.)

84

Coup d'Etat N. 3.

FYTYRATNJË SEKRETAR
I
PARLAMENTIT

SQENA 4.

SEKRETARI PASTAJ ORGANIZATORËT.

SEKRETARI.

Bëri si bëri e fitoj një herë pontin e tij Parlamentit! Ketij i thonë Coup d'Etat-llëk mbi Coup d'Etat-llëk. Tani do të ndahen dardhat edhe do shohim se kush do qeshin i fundit..... Me ç'ka po shof unë, këta Parlamentarët t'onë ja u kanë venë sÿnë deputetëve te Dibrës që i kanë po si alë në sÿ! Pastaj, kujtonj se do të qërojnë hesapet që kanë me regjentët edhe më në funt do mentohen edhe për Qeverin' e ré..... Kush dreqin e di në kanë edhe qellime të tiera, si ato të grupit të shëjtë?..... Se mos të rëfen gjarpri këmbët?..... Po, mirë se Pariamenti ka fuqinë në dorë tani edhe ka me i ardhë hakut gjithsecilit, po këtij më në funt kush do t'ja marrë hakun?

Parlamentarismi.

(TEMPO DI MARCIA, MUZIKË E PROF. TH. NASSIT)

SEKRETARI.

Një gëzim mbretëron në Tiranë
Edhë populli gjithë po pret
Parlamentin me gas po e thret
E gjëmon an' e mb' anë,

Deputetët të lodhur po vijnë,
 Kryetari në ballë shkëlqen,
 Dhe Karvani me zile po zjen,
 Deputetët ja mbrijnë.

Parlamenti u hap si nga hera,
 Turren gjithë me hov e furri
 Dhe dikush po ankon për ushtri
 Që po rruan ne dera.

Jep shpjegime mbi 'të Qeverija
 Që mos tutet as një deputët,
 Se me masat që mori ky Shtet
 Sigurohet lirija.

Deputetët e Drinit së pari
 Parlamenti i vë në nishân,
Bamp në votë dhe **bump** i shpërndan,
 Se s'i linte nakari!

I vërvitët këshillës së naltë
 Edhë dy nga këta i rëzon,
 Fiton pontin e tij e mbretron
 E nuk mbetet në baltë!

Dy të tjerët e dhanë dorheqjen,
 Se prej shokëve s'ndaheshin dot
 U larguan me vaj e me lot,
 S' e duronin të keqen!

Parlamenti dakiken nuk mbesi,
 Këshilltarët i vuri ne vënt
 Edhë lodrën e lojti me mënt,
 Si ja desh interesi.

Dhe kështu prej kompllotit s'ka frikë,
 Qeveritë në dorë i kâ,
 I rëzon, a i ngreh për shakâ.
 Ka një tjetër taktikë.

86

Parlamenti tani nuku luan
 Do t'a sjellë ç'do shkelës në vent
 Do gjykonjë gjith cilin me rent
 Do t'a gjejnë ç'kërkuan!

ORÇANIZATORET.

Brë, ç' dëgjojmë për dit, e nga hera
 Këta lojtkan të math sadrivaç,
 Nuk paguajn as dyshkën harraç
 Të thumbokan si grera.

Paskan gjakun e sert për ç'do punë
 Nuk e lënkan të ftohet as pak,
 S'rijnë urtë po s'muarn dot hak,
 Qënkan djaj, firaftine!

Parlamenti e mori shpërblimin,
 Po këtë s'ka se kush e gjykon,
 Ky s' e gjen atë gjë që kërkon
 Kush t'ja ndreqë gabimin?

Për statutin e Lushnjës n'a thanë
 Se u shkel prej regjentve dikûr,
 Po statuti nuk ishte një mûr
 Që nuk lot ngaj ç'do ane!

(Dalin Organizatorët)

Le Ministie Ambassadeur.

FYTYRAT.

LUTFIU. |

AVNIU. |

REMZIU. |

SQENA 5.

LUTFIU, AVNIU, REMZIU.

AVNIU (Tyke zënë për dore Lytfinë).

Përgëzimet t'ona Lutfi bej. Jemi shumë të kënaqur që të pamë zotrinë t'ënde në këtë shkallë. Bravo, se e meritoni vallah!

REMZIU. (Gjith' ashtu).

Këjo ishte shumë një pun' e pëlqyer. Ju fatmironj me gjithë zembër, dhëntë Zoti n'a u bëfshi edhe kryeministër.

LUTFIU. (me nonocle në syn' e djathtë).

Ju falem nderit fort. Edhë unë ju uronj tani shpejt me do memurijete të nalta edhe zotrinë t'uaj.

AVNIU.

Meâ mafi jam çuditur shumë si u bëre tajin kaqe shpejt, po duket se kë pasur mik të fortë në ministri.

LUTFIU.

El-hamd-ollsun. vetë ministri më bëri kabull posa që ja propozova. Ju e djini sa zembër-bardhë që është ministri i Puneve të Jashtme.

88

REMZIU.

Ashtu kemi dëgjuar me të vërtet. Eshtë njeri tepër merhametllí; kush do që t' i thotë për një memurijet të ri s'ja prish qefin, po me një herë nxjer tefterkën ngaj xhepi edhe e shënon.

LUTFIU.

Hakikaten ashtu është.

AVNIU.

Si? Pa një pa dy, pa pyetur në ka efsafi-kanunijëtë?

LUTFIU.

Po, po. Zaten kush të pyet sot për asij gjerrash?

AVNIU.

Ahere munt të bëhemi edhe né shehbenderë.

LUTFIU.

Si jo? Në mos shehbenderë, konsulozë, ç'ka të bënë, po veç ju këshillonj të shkoni ca me parë se mos ja u zenë vendet të tjerë.

REMZIU. (Avniut).

Ahere ç'rijmë né këtu? A shkojmë?

AVNIU.

Shkojmë (Lutfiut). Falemi nderit që n'a thé, Lutfi bej.

REMZIU. (Lutfiut).

Edhë unë. (Shkojnë Avniu me Remzinë).

Këng' e Ambasadorit

(MUZ. RATAPLAN)

LUTFIU

Sa gëzim që po ndjen zemra ime,
 Quel plaisir, quelle joie, quelle bonheur,
 Sa të ëmbla më shkojnë mejtime,
 Je suis, donc, un ambassadeur!
 Dhe dekretin në xhep po e kam,
Mon dieu sa i lumur që jam
 Do formonj ma nouvelle carrière,
 Enchanté de tout coeur et de l'âme.

Do të flas me mbretin e sovranë,
 Do të hynj në palais, në chateaux,
 Me spaleta, me pallën më nj' anë,
 Mbretëresha, princesha do shoh,
 Do të vete në ballo en trac,
 Me monocle, me smoking, me frac,
 Do drejtonj cotillon et quadrilles,
 Si danseur nuk do tutem as pak.

S'ka zarar se kush ishte im' atë,
 Bostanxhi, shkembexhi, a berbër,
 Sot gjithë bota n'a thret "diplomate",
 Je m'en fiche pour cela, I don't care,
 Në sallone me luks do të ri,
 Dhe champagne et bordeaux do të pi,
 Me ministra plenipotentiaires,
 Do shetitim en pleine galerie.

Sa para bëjn' agents consulaires-ët,
 Les consuls et le corps diplomatique,
 Edhé gjithë chargés d'affaires-ët,
 Jam bajloz, shehbendër magnifique,
 Nuk prish punë që di le français
 Si e dijnë les braves Albansais,
 Nuk të pyesin orthografinë,
 Veç në jé gentille-homme tout à fait.

Do të lidhemi me relacione,
 Do trajtojmë traktat' e traités,
 Shumë herë edhe pa kondicione,
 Ça n'importe, quand on a liberté.
 Les meâshes sont en pleine sûreté,
 Që të rrojmë toujours en gaîté,
 Për këtë nuku çajmë as kryet,
 Vive l'Etat, vive le Shtet Albanais!

Është e tepër të kesh qualitéte,
 C'est une chose bagatelle, mon ami,
 Shqipërija nuk ka fakultéte,
 As **Droit des Nations** s' di njeri;
 Kush të pyet në jé homme d'Etat,
 Kush të thotë, në bën një hatâ,
 Ne s' e kemi zanat politikën,
 Mjaft që bëjmë raport, mazbatâ.

Sot për sot nuk kërkohen hesapë,
 Mesuljët n'existe pas as gjëkunt,
 Në Shqypni ka të tjerë kassapë
 Që rrijepin gjithcili si munt;
Cour de Comptes e Kontroll nuku ka,
 Po kush di e kush munt merr e ha,
 Kush menton se po dalim myflyzë,
 Né ç'do punë na duket shaka!

Unë jam i kënaqur një herë,
 Très content, satisfait, consolé,
 Se po shoh që emnohen të tjerë,
 Që ky Shtet i dërgon havalé;
 Do të bëjmë një diplomaci,
 Si e kishte dikur Mal'i-zi,
 Do dërgojm' edhe né ca Sefirë,
 Se e dó la nouvelle ALBANIE.

(Del ambasadori).

Konsollozët.

SQENA 6.

FYTYRAT

KAMBERI.		Konsullôs.
ZYBERI.	o	Sekretar.
XHAFERI.		Kavâs.

KAMBERI. (Tyke hyrë).

Shumë mirë u bëmë! Ashk-ollsun i qoftë Shtetit edhe më fort ministrit t'em që më emëroj konsollos. (Të tjerëve). A e dini se sa rytbë e madhe është këjo?

ZYBERI.

E dijmë, zotni. e dijmë. Zot-rote jë një agent consulaire jo konsollos.

KAMBERI.

Do me thënë se jam m'i math se një bajlos. Apo jo?

XHAFERI.

Ashtu është vërtet. Zotrote të mos jesh, po kush tjetër do jetë, morë t'u ngjatë jeta? Nënë sajë të zotrisë s'ate po hamë bukë dhë në, edhe ty Zoti të madhnoftë Jarebi!

KAMBERI. (Zyberit.)

Të kam porositur pastaj edhe një palë roba që lëri e mos i nga. Të bukura fort, me sumbulla, me gajtane, me shirita, kor-dhele, ehû ehû, hesap s'ka.

ZYBERI. (ironisht)

Po qylafin do t'a marrësh me vehte?

KAMBERI.

Qylafin? Me azallah. Kush të do me qylaf në Evropë, dërëzi? Do të mbanj kapellë. orë kapellë; do të bëhem tamam

92

një Evropallî. Do të ndronj tabijat, do të ndronj syfet, të gjitha do t'i ndronj e more vesh?

ZYBERI.

Nuk muarm edhë ndo një gjellaxhi prej Tirane, se atjë s'ka se kush n'a bën pilaf të mirë edhë dollma me japrak.

KAMBERI.

A. a, tani do hamë të tjera gjellë; do msohemi si Evropallinjtë. Ç'thua, se mos jemi në Ballëk-Pazâr, a në Sirqexhi? Atjë i thonë Evropë, orë Evropë, Allamanjë, Gjermani Avustri, Maxharî, Nemse, ku rruhesh ti, atjë s'ka pilaf e dollma.

XHAFERI. (Zybërit)

Mirë thotë zotnija.

ZYBERI. (me vehte)

T'u thattë koka edhë ty. (Kamberit), Po frëngjishten e di zotrija jote, se është nevojë t'a dish frëngjishten.

KAMBERI.

Cilë frëngjishte? Francështjen do të thush? Si s'e di jahû? Avez-vous mon chapeau? Avez-vous ma viande? J'ai votre plume. Je n'ai pas celle de notre voisin. P'ai tu as, il a, nous avons, vous avez, ils ont.-Préterit. Prétérit indefini.-Nominatif, genitif, datif, ablatif, substantif ou nom, verbe, adverbe, si s'i di, si s'i di, nuk sheh sa të thashë me një herë?

ZYBERI. (Tyke qeshur).

Shumë bukur. E shoh që i mbajtke ment më gojë (qesh)

KAMBERI.

Funt i fundit, psë të kam ty? Atjë ku të gabonj unë m'a ndreq ti. S'është' ashtu?

XHAFERI.

Ashtu është vërtet.

ZYBERI. (Xhaferit).

Mbytu ti, xhahil, exhel. (Kamberit). Zotni mua më kë marrë për sekretar më duket, e jo për terxhuman!

KAMBERI.

Sekretar, tërxhuman hepsi bir. A jë memuri jem? O kadhâr, qafi. Pandaj paguan Shteti. (Zyberi del tyke qeshur, pastaj edhe Xhaferi).

Këng' e Konsollozit të rî.

(MUSIKË PROF. TH. NASSI)

Hapuni se po shkonj unë
Se më thonë **Konsollôs,**
Shakâ s'është këjo punë,
Jam m'i math se një **Bajlôs!**
Ndofta nuk ja u mbush sÿnë
Se nuk kam ndo një nishan,
Po shëndoshë Shtëti ynë
Do të gjendet një derman.

Edhë robat i porsita
Të qëndisura me âr,
Me gajtane, me sherita
Me kordone, me çapâr.
Deh, or deh, ç'do bëjm' ahenge,
Kush n'a mban e kush n'a pret,
Me kokona renge-renge
Njeriu gjen tjetër lezet.

Vallahî. nuk ka më mirë
Se në Konsolloshané,
Atjë ka liqueur e birë
Shkon një jetë shahané,

Me sherbet' e ëmbëlsira
Bakllavâ mualebî,
Kadaife, revanira.
Dondurmâ, tauk-gjoksí.

Do të ndrojmë krejt fytyrë,
Sot nuk jam një Osmanlli,
Do të ndrojmë dhe natyrë
Tam si një Evropalli!
Harronj **Konjën, Ankarânë,**
Aidin, Hudavendqâr,
Bej-ogllûnë, Gallatânë,
Kadî-qoj e Ysqydar.

Ashk-ollsûn i qoftë Shtetit
Që n'a dha këtë rytbë,
Do t'i bëjm' huzmet Miletit,
Myqemël, feuk-aladè,
Passaporta kush të dojë
Shehadéte, verekâ,
Me nevoj' a pa nevejë,
Me parâ, o sadakâ.

94

Në Shqipri, mbanja një herë
Fés të kuq, ose qylaf
Dhe me gishtat si të tjerë
Hanja qofte e pilaf;
Po tani do mbanj kapellë
Fés, qylah janë jasâk,
Do të ha të tjera gjellë
E jo dôllma me japrak.

Se psé s'kam të nalta msime,
Ndo një punë nuku prish,
Nuku jep njeri provime,
Sot harrin sa do të dish.
Është mjaft një **idadije**,
Një **meqtëp ibtidaji**
Një fillore, një **rushdije**,
A një shkollë **hususí**.

Le të flasë kush të dojë
Për këtë né mé lazëm,
Se n'a mbajnë në per gojë
A n'a bijen ndo një dëm?
Jo të cektë, jo abdallë,
Për këtë as bënj dikat,
Lé të sillen kot verdallë,
Sa të mbetemi rehat.

Kur dërgohen konsollozë
Djem të vegjël, miturinj.
Né si njerës seriozë
Munt të rijmë seîrxhinj?

Neve jemi më te ditur,
Të mbëdhenj e bojallinj
E më tepër të stërvitur
Mektepllinj e mustakliinj.

Dhe francështen në mos ditsha
Do t'i jap atësh, dumân,
Edhé krejt në u nemitsha,
Mjaft që kam një terxhumân,
Edhe sa për etiqetat
Do t'i bëhet një çarë
Do t'i ndreqim krejt të metat
Në për çaj' e **suarë**.

Hulasâ s'më zé qederi
Se më marrin në majtâp,
Nuk do tretem si sheqeri'
As i jap njeriut hesâp,
Si të tjerët edhe unë
Mbasi jam një diplloamat,
S'kam gajlé, as më prish punë,
Ha e pi e flé rahat.

Ka nevojë shumë Shteti,
Konsollozë s'gjen kollaj,
S'është yni kabaheti,
Né nuk kemi ndonjë faj;
Shqipërinë s'e qertojnë
Se psé bën sot një hatâ,
Se dyvelet e shëkojnë
Q'është një **Raison d'Etat**.

(dël konsollosi)

Organizatorët.

FYTYRAT

ARDUGJAN. |
 FIRDUSTAN. | ○ Organizatorë Afganistanas.
 GJULISTAN. |

SQENA 7.

ARDUGJAN.

Si e shoh unë, arkadashët e mij, kot u munduam që arthmë në Shqipëri. Shqipëtarët nuk janë një komp që t' i organizosh mbas kanunit e mbas zakonit. Nuk të thom, ne jemi më për dreq se këta po me këto që n'a panë sÿte s'm'a merr mendja të organizohen shpejt, edhe në qofte se organizohen ndo një ditë, prapë kanë ca sëmundje që do mos organizohen si duhet. Bil fars, kanë **akraballëket** një herë që s'ka plagë m'e madhe për një shtet; kanë sëmundjen e **misjoneve, inspeksjoneve, të operacjoneve, të kumarit e të bixhazit, te muzaqerevet, të kafë-oxhakëvet, te tembellëkut** etj. etj., kanë një **ksenomani** të dobët që s'duan te flasin gjuhën e tyre, se bëjnë mëkat; pas-taj vdesin për **meâshe e ylefë** lenë kokën per **kulltuke** e më fort për **kulltuket ministoriale** etj. etj.

FIRDUSTAN.

Unë them se Shqipëtarët janë mjaft të zgjuar, po mjerisht e kanë kapur punën për bishti edhe do vonojnë shume gjer sa t'a marrin vesh kû qendron puna edhe si lipset të bëjnë që të përparojnë.

GJULISTAN.

Vërtët ashtu është; se të vesh rë mirë, ata të mjerët që janë munduar për këtë Shqipëri e e kanë vënë veten e tyre kush e di sa herë në rrezik, në qoftë se janë gjall sot, gjenden pa punë, ose kanë punë shumë të vogla sá nuk ushqejnë as fëmijën,

96

as vëten e tyre, kur se punët më të mbëdha të Shtetit ju jepen atyre që kanë qënë armiq' e Shqipërisë, ndjekës të rrebtë të **Idealit kombtar** etj. etj. Shpesh herë vijet rë, se në gjë të popullit ka shumë djelm e burra të zottët që munt t'a udhëheqin sigurisht Shqipërinë e t'i bëjnë ballë ç'do rreziku, po mjerisht këta s'i përfill njeri!

ARDUGJAN.

Kë të drejtë, ashtu është, prandaj ëdhë ata që kanë sot frenat e Stetit në dorë duhet të hapin sÿte mirë e t'i zgjedhin këta patriotë ku do që jane, t'i shtijen në punë, të përfitojnë prej tyre e jo t'a bëjnë **monopol** nëpunësinë, se janë **responsablë** përpara historisë e përpara Zotit.

FIRDUSTAN.

Në dëshrojmë përparimin e këtij kombi. i cili meriton të rronjë edhë ndofta do dalë edhë më i zoti ngaj fqinjët e tjerë. Psé të mos përparonjë kur i ka të gjitha në dorë? Harrin të dojë vetëm.

GJULISTAN.

Unë mbesonj se posa Shqipëtarët të shpetojnë prej propagandave të huaja e klikave, do vijnë nër mënt e do qerojnë e do sherojnë një nga një të gjitha plagët e rutinës politike që kanë sot, se sikur të mbeten kështu, ahë, **Bir Selman i nënes ç'të të qanj më parë**, më mirë të marrë njeriu sÿt' e këmbët e të ikinj, se sa të rijë këtu!

ARDUGJAN.

Tamam. Edhë unë ashtu them. Me këtë gangrenë që kanë sot Shqiptarët, shumë më mirë jemi në atjë në Afganistan.

Këng' e Organizatorëvet.

(MUZIKË "GEISSA").

Prej Afganistanit vijmë në kryeqytet
 Se Kabina Shqipëtare mynasip e gjet,
 Organizatorë jemi, kishim një nijet,
 Për të ndrequr Shqiperinë sikur i përket.

Juha, juha, juha. hâ
 Sa n'a panë sÿtë dreqi nuk i hâ,
 Juha, juha, juha, hâ,
 Nuku bëhet kurrë punë me këta.

Hall' i math i këtij Shteti nuk tregohet dot
 Udhët krejt shkatruarë, sa të qash me lot,
 Plot hendeke plot batake, balta gjer më gjû,
 Arë, lusha si kënetë, s'ka njeri me trû.

Juha, juha, juha. hâ.
 Sa n'a panë sÿtë dreqi nuk i hâ etj. etj,

Ku do shkel, ku do vertitësh qelbësira plot,
 Llome, plera e pislliqe, sa të vjen dhe ndot
 Disa zyra transferuar në kafë-oxhak,
 Me ibrike, me tabake, kahvenë anxhak!

Juha, juha, juha, hâ
 Sa n'a panë sÿtë dreqi nuk i hâ, etj.

Këtu s'flasën gjuhën shqipe, s'bëjnë tenezûl,
 Veç turqishtja e greqishtja paskan tedavûl,
 Qënkam gjuhë të sallonit, gjuhë me manâ
 Edhë shqipen kush t'a flasë bëkerka gjynâhi!

Juha, juha, juha, hâ.
 Sa n'a panë sÿtë dreqi nuk i hâ, etj,

Këta qënkan fort tembela. shokun s'ju a gjen,
 Dashkan bukën mu ne goja. sa dhe keq të vjen.
 S'lozën vendit, s'unden fare, qënka hall i math,
 Sa çorapi po t'ju bjerë, as nieri s'e mbath!

Juha, juha, juha, hâ.

Sa n'a panë shtë dreqi nuk i hâ, etj. etj.

Plot meâshe jepen xhaba për tekayllëk
 Dhe kulltukët rezervohen për akraballëk,
 Njerëzit e duhurë s'kanë këtu vënt,
 Një rutinë an' e mb'anë s'ka nieri me mënt.

Juha. juha. juha, hâ,

Sa n'a panë shtë dreqi nuk i ha, etj. etj.

Onxho-bonxhot gjejnë punë, Shteti nuk i lë,
 Se të tjerët s'bëjnë pare, s'dijnë muamelë,
 Sa që dbohen prej Turqijet bëhen shpejt kabull,
 Patriotët e vërtetë hanë lënk e qull!

Juha. juha, juha, hâ, etj. etj.

Dalin grumbull si mushkonjat, si dhëmp arpallëk,
 Futin hundët por si shûjzat në Arnautllëk,
 Njerës t'humbur, t'arratisur, qinse Arnabût,
 Derdhen të lëpijnë koska, çok si një harbât.

Juha, juha, juha, hâ, etj. etj.

Patriotë hiqen gjithë me fedaqarllëk,
 Bëjnë buj' edhe poterë veç për meashllëk
 ylefet' i ndjekin shumë, syrin si bakër,
 Për të marr' e për të ngrënë janë mjaft kadër.

Juha, juha, juha, hâ etj. etj.

S'dijmë qysh të vepërojmë me këtë milët,
 Nuk i sjellim dot në rrugë. është një siklët,
 Që të gjitha ju mungojnë, njeri s'ju ka faj,
 Se si do t'ju vejë filli s'dijët paskëtaj.
 Juha, juha, juha, juha, ha etj. ett.

Marrim s'yt' e marrim këmbët, shkojmë në vatan,
 Këtu qënka më keq shumë se n'Afganistan
 Ngaj t'a zemë pa ç'të lemë, as ment nuku mbanj
 Bir **Selman** i nënesë më parë ç'të të qanj!
 Juha, juha, juha. hâ etj. etj.

(Bije napa).

Funt i Aktit të IV. e i operëtës.

Shënim. Për gabimet e shtypit e për letrën e dobët lypim ndjesë prej këndonjësve.

Veprat e Auktorit

I.

TË SHTYPURA

Dëshir' e vërtet' e Shqipëtarëve—Çallje II.
 Fé e Kombësi—Dramë në 4 akte.
 Rrogat e nëpunësve—Komedi në një akt.
 Lojnat e Studentëve " " "
 Do të vras vedin " " "
 Vëllazëni e interesë " " "
 E bij' e bankjerit " " "
 Dhëndër me përdhuni " " "
 Qerthulli politik—Operetë në 4 akte.
 Tingëllimet e zembrës—Këngë.
 Shqyptarët—Poesi didaktike.
 E drejta themelore—Libër ligjuer.

II.

PËR TË SHTYPUR

Fé e Kombësi—Dr. në 5 akte, Çallje II.
 Karlo Topiça—Dramë në 5 akte.
 Pirro Neoptolemi—Tragjedi në 5 akte.
 Qypërlinjë " " "
 Skander-beu në Itali—Dramë në 5 akte.
 Fat-zeza " " "
 Kopraci—Komedi në 5 akte.
 Rrogat e nëpunësve—Komedi. Çallje II.
 Merre t'a marrim—Komedi në 1 akt.
 Zi e më zi " " "
 Nder e Qytetni " " "
 Reklamë e blofë " " "
 Kundrështarët e prikës " " "
 Pësimet-mësime " " "
 Monologë komikë theatrorë
 Shkëndijat—Anthologji vjershash.
 Kossova—Serbi e vjetër!—Studim ethnografik.
 Administrata—Libër ligjuer 400 faqesh.
 E drejta themelore—Çallje e dytë e plotësuar.

STUDIME
Revistë për studime filologjike
30
2023

2024

Botues:
AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS

Lektor:
Imri Badallaj

Redaktor teknik:
ASHAK

Realizimi kompjuterik:
ASHAK

Madhësia: 23 tabakë shtypi
Tirazhi: 200 copë
Formati: 16x24 cm

Shtypi:
Focus Print
Shkup

